monumentet



DO NOT COPY

2 /1982

DO NOT COPY

tina e parë: Banesë karakteristike e tipit kullë në fshatin Romajë (Prizren)

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E KULTURËS
INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS
TIRANË

DO NOT COPY

monumentet

2/1982 (24)

KOLEGJIUMI I REDAKSISË

DO NOT COPY

Pronë letrare e Institutit të Monumenteve të Kulturës
Pranë Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës

Adresa e Redaksisë: Rruga «Alqi Kondi» Nr. 7

Tirazhi 1005 copë

Formati 70x100/12

Stazh: 2204

Shtypur në Kombinatin Poligrafik Shtypshkronja «Mihal Duri» Tiranë

PASQYRA E LËNDËS

		Faqe
	ARTIKUJ:	
Emin RIZA	– Tipare të krijimtarisë popullore në banesën qytetare shqiptare	5
Isuf SUKAJ	– Vështrim mbi zhvillimin e urbanistikës dhe arkitekturës së Kavajës (deri në fund të shek. XIX)	29
Stilian ADHAMI	– Mbi urbanistikën dhe arkitekturën e pazarit të vjetër të Përmetit	43
Robert BALLAURI	– Mbi arkitekturën e një kompleksi banimi të shek. XIX brenda zonës-muze të Korçës	55
Genc SAMIMI	– Kamerietë e qytetit të Beratit	83
Ilia PAPANIKOLLA	– Masat kundër lagështirës në banesën gjirokastrite	103
Mark TIRTA	– Mbi zanafillën e disa motiveve në gurëgdhendje në shtëpitë fshatare shqiptare	119
	KRITIKË E BIBLIOGRAFI	
Ali MUKA	– Banesa popullore e Kosovës në veprën «Gjurmë e gjurmime» të Mark Krasniqit	131
Aleksandër MEKSI	– Monumentet në një vepër historike	143
	Alain Ducellier: «La façade maritime de l'Albanie au Moyen-Age. Durazzo et Valona du XIe au XVe siècle». Institut for Balkan Studien, Thessaloniki, 1981, XLI, 682, XIV tab.	
Apollon BAÇE	– Tabula imperii byzantini 3. Nikopolis und Kephallenia. Von Peter Soustal unter mitwirkund von Johannes Koder. Verlag des österreichischen akademie der wissenschaften, Wien 1981 (325 faqe, 2 harta topografike 1 : 300.000).	153
	JETA SHKENCORE	
	– «Mjeshtëria e të ndërtuarit në krahinën e Kolonjës», Ersekë 31 Maj 1982 (Sesion shkencor)	157
	– Seminar mbi kriteret e restaurimit dhe dokumentimit të banesave popullore	157
	– Dy botime të Institutit të Monumenteve të Kulturës	158

DO NOT COPY

TABLES DES MATIERES

Page

ARTICLES:

Emin RIZA — Traits de la création populaire dans l'habitation urbaine albanaise 21

Isuf SUKAJ — Aperçu sur le développement de l'urbanisme et de l'architecture de Kavaja (jusqu'à la fin du XIXe siècle) 41

Stilian ADHAMI — Sur l'urbanisme et l'architecture du vieux bazar de Përmet 52

Robert BALLAURI — L'architecture d'un ensemble d'habitations du XIXe siècle dans la zone musée de Korça 77

Genc SAMIMI — Les mezzanines de la ville de Berat 100

Ilia PAPANIKOLLA — Les mesures prises contre l'humidité dans l'habitation de Gjirokastra 117

Mark TIRTA — Sur l'origine de certains motifs gravés dans les maisons paysannes albanaises 129

CRITIQUE ET BIBLIOGRAPHIE

Ali MUKA — L'habitation populaire de Kosova dans l'oeuvre «Traces et recherches» de Mark Krasniqi 137

Aleksandër MEKSI — Les monuments dans une oeuvre historique 149
Alain Ducellier «La façade maritime de l'Albanie au Moyen-Age, Durazzo et Valona du XIe au XVe siècle» Institut for Balkan Studies, Thessaloniki 1981, XLI, 682, XIV tab.

Apollon BAÇE — Tabula imperii byzantini 3. Nikopolis und Kephallenia. Von Peter Soustal unter mitwirkund von Johannes Koder. Verlag der österreichischen akademie der wissenschaften, Wien 1981 (325 pages, 2 cartes topographiques 1 : 300.000) 155

LA VIE SCIENTIFIQUE

— La maestria de la construction dans la region de Kolonje (Séance scientifique) 159

— Séminaire sur les critères de la restauration et de la documentation des habitations populaires. 159

— Deux éditions de l'Institut des Monuments de Culture 160

DO NOT COPY

Nr. 2 1982

monumentet

DO NOT COPY

Emin RIZA

TIPARE TË KRIJIMTARISË POPULLORE NË BANESËN QYTETARE SHQIPTARE

Studimet mbi arkitekturën popullore shqiptare, veçanërisht të shumta këto vitet e fundit, kanë krijuar një kuadër të zhvillimit morfologjik të saj dhe më tej të tipareve në planin arkitektoniko-konstruktiv, në lidhje të ngushtë me kuadrin historik të kohës. Këto studime kanë pasur për objekt si ndërtimet fshatare, ashtu edhe ato qytetare, ndër të cilat vendin kryesor e zë padyshim banesa. Tashmë, kur është arritur në vijat themelore rajonizimi tipologjik i banesës shqiptare, krahas punës për thellimin e studimeve të veçanta mbi tipa të caktuar banesash, apo njësi dhe elemente të ndryshëm kompozicionalë, krijohen rrethana për vështrime përgjithësuese. Këto të fundit duke qënë momente sinteze, japin mundësi të shihet mbarë krijimtaria jonë popullore në njësinë e saj të natyrshme, jashtë analizave të pjesshme, të cilat megjithëse të domosdoshme për të arritur në përgjithësime të bazuara, shkëpusin dukuritë e veçanta nga kuadri i jetës së tyre, si pjesë e një konteksti të gjerë arkitektonik e shoqëror. Artikulli është një sprovë për të vënë në dukje disa nga tiparet më të dallueshme të krijimtarisë në lëmin e banesës popullore qytetare shqiptare, të konsideruar në lidhjen e saj organike, në hapësirë dhe në kohë. Ai mbështetet mbi materialet e botuara deri më sot mbi arkitekturën e banesës qytetare shqiptare,[1] duke përfshirë arritjet e saja, kryesisht gjatë shek. XVIII-XIX, por duke u shtyrë edhe më herët në kohë, mbi bazën e dëshmive të pakta që ende ruhen, si dhe të burimeve apo botimeve të ndryshme.

Arkitektura popullore shqiptare në përgjithësi, dhe ajo qytetare në veçanti, është një krijimtari me parimet e saja, të cilat kanë në bazën e tyre, në radhë të parë kushtet ekonomiko-shoqërore, kuadrin historik të kohës, si dhe rrethana të tjera si trualli, materialet e ndërtimit, mjeshtrat ndërtues, klima etj. Këto parime kanë kushtëzuar një sërë tiparesh të kësaj krijimtarie, të cilat nuk janë të gjitha një konstante në krijimtarinë tonë popullore. Në vazhdën e gjatë të krijimtarisë, kushtet që kanë përcaktuar këtë apo atë parim, e për pasojë këto apo ato tipare kanë ndryshuar, prandaj qëndrueshmëria kohore e shumë prej parimeve dhe tipareve që karakterizojnë krijimtarinë në fushën e ndërtimeve popullore i nënshtrohen procesit dialektik të lindjes, zhvillimit dhe më tej të zëvendësimit me norma të reja.

Arkitektura popullore në qytetet tanë është pjesë e krijimtarisë popullore në përgjithësi. Duke pasur në qendër figurën e mjeshtrit popullor, ideues dhe ndërtues të saj, kjo krijimtari shquan në drejtimet kryesore për arritje të shëndosha që kanë ndjekur mbarë zhvillimin e saj. Këto arritje shprehin zbatimin e disa parimeve themelore, të cilat në thelbin e tyre janë kërkesa që pasqyrojnë mënyrën e jetesës. Prandaj dhe një prej parimeve më kryesore e më jetëgjate të krijimtarisë popullore në këtë fushë,

1. **Historia e arkitekturës Shqiptare (nga fillimet deri në vitin 1912 (maket),** Tiranë 1979, f. 440-511. E. Riza, **Banesa qytetare shqiptare gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX, deri rreth çerekut të parë të shek. XX,** «Monumentet» 20. E. Riza, **Arkitektura popullore në qytetet tona gjatë shek. XVIII-XIX,** «Kultura popullore» 1980/2. E. Riza, **Banesa popullore në qytetin-muze të Beratit,** «Monumentet» 1/1981, etj.

duhet mbajtur, lidhja e ngushtë e zgjidhjeve tipologjike, e më tej e trajtimit arkitektonik, me dinamikën e zhvillimit të kushteve ekonomiko-shoqërore. Ky parim bazë i ka dhënë arkitekturës së banesës qytetare shqiptare shumë tipare pozitive, duke e larguar atë nga zgjidhje formale dhe duke i hapur një fushë të gjerë kërkimesh drejt përmbushjes sa më të përshtatshme të nevojave jetësore të klasave e shtresave të ndryshme shoqërore në kohë. Tiparet e krijimtarisë popullore në këtë fushë rrjedhin dhe si zbatim i parimeve të tjera më pak të rëndësishëm me shtrirje kohore më të kufizuar, apo me intensitete të ndryshme përhapjeje në klasa të ndryshme të shoqërisë. Thjeshtësia, utilitarizmi, përkujdesja për mbrojtje, njësimi i zgjidhjeve kompozicionale dhe atyre arkitektoniko-konstruktive, lidhja me natyrën, shfrytëzimi i materialeve të vendit, janë parime që shfaqen herë më qartë e herë më zbehur e madje në disa periudha nuk gjejnë zbatim, duke shprehur kështu ecurinë dialektike, zhvillimin në kohë të banesës qytetare. Është e kuptueshme se ndërmjet dy koncepteve, parim e tipar, nuk ka një kufi të prerë. Ata janë në lidhje të ngushtë në kuptimin se një parim qëndron në bazën e disa tipareve, apo një tipari të vetëm. Në rastin e fundit shpesh kemi një bashkëshkrirje të tyre. Kështu parimi i përkujdesjes për mbrojtje është materializuar në tiparin mbrojtës etj.

Në literaturën tonë shkencore lidhur me studimin e banesës popullore, tashmë është bërë e qartë lidhja ndërmjet porositësit si pjesëtar i një klase, apo shtrese të caktuar shoqërore, programit, në vartësi të drejtpërdrejtë nga i pari dhe kompozimit që tërthorazi përcaktohet nga porositësi. Theksojmë se në kompozim një kontribut të rëndësishëm ka mjeshtri ndërtues, në përpjesëtim të drejtë me ndërlikimin e tij, pa lënë mënjanë edhe faktorë të tjerë. Pra në fund të fundit morfologjia e banesës, ndjek dhe pasqyron kërkesat jetësore të familjes, si një njësi në lidhje të drejtpërdrejtë me kushtet e dhëna ekonomiko-shoqërore. Rrjedhimisht kompozimi planimetriko-volumor, synon të plotësojë kërkesat jetësore të klasave e shtresave të ndryshme shoqërore, duke qënë tipari më i qënësishëm i banesës. Kompozimi materializon në zgjidhje të caktuara kërkesat funksionale ndaj banesës, duke arritur në disa skema funksionale pak a shumë të caktuara, të cilat i ka miratuar përvoja jetësore. Si të tilla, ato kanë gjetur një shtrirje relativisht të gjerë, me kufij elastikë interpretimi, sipas kërkesave konkrete të porositësit, nivelit profesional të mjeshtrit ndërtues dhe kushteve të tjera materiale.

Kuptohet pra se kërkesat funksionale ndaj banesës, brenda parimesh të caktuara, përbëjnë faktorin kryesor në zhvillimin e saj. Këto kërkesa funksionale ndryshojnë në përputhje me formacionin ekonomiko-shoqëror dhe shprehen qartazi në diferencimin klasor respektiv. Kërkesës themelore ndaj banesës si strehë banimi, në kuptimin e ngushtë të fjalës, në periudha të ndryshme, në përputhje me shkallën e zhvillimit shoqëror, i shtohen edhe të tjera. Këto bëjnë që banesa të përfshijë në programin e saj një sërë ambientesh apo trojesh për të plotësuar këto kërkesa. Kështu ajo zgjeron diapazonin e funksioneve që kryen, të cilat mbulojnë krahas strehimit dhe nevojave jetësore, të lidhura drejtpërdrejt me të, edhe funksione të tjera.

Në kuadrin e shoqërisë feudale, kur ekonomia familjare në mjaft drejtime ishte e mbyllur, dhe kur lidhja me prodhimin bujqësor drejtpërdrejt, apo tërthorazi, duke gëzuar të ardhurat nga pronat tokësore, ishte dukuri e spikatur, bënin që banesa të merrte mjaft funksione të tjera. Mungesa e një rrjeti të mjaftueshëm shërbimesh për plotësimin e nevojave jetësore, plotësohej pikërisht me dhënien e disa prej këtyre funksioneve ekonomisë familjare edhe për pasojë banesës në kuptimin e gjerë, e cila përfshinte të gjithë hapësirën që kufizonte muri rrethues. Me lindjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve kapitaliste, që u shoqërua me fuqizimin e rrjetit të shërbimeve, shumë prej funksioneve, që më parë i kryente familja, brenda kuadrit të banesës, shkëputen prej saj.

Përmbledhtazi, veçanërisht në formacionin feudal të shoqërisë, krahas banimit si funksion themelor, banesa duhej të siguronte ambiente për ruajtjen e rezervave ushqimore për një kohë relativisht të gjatë, vendstrehim për kafshë të ngarkesës apo bagëti, furrën brenda banesës, apo në oborr, duhej siguruar grumbullimi, apo nxjerrja e ujit të pishëm, etj. Krahas, duheshin krijuar ambiente për punimin e zejeve tradicionale shtëpiake, si përpunimi i mëndafshit natyral, punimet në avlëmend etj. Kopshti për kultivimin e zarzavateve dhe pemëve shoqëronte thuajse gjithmonë banesën veçanërisht në trojet e rrafshët. Veçanërisht në shtresat e pasura, banesa ishte edhe vend takimesh me karakter shoqëror e politik.

Konkretisht, lidhur me kërkesat për funksionet e mësipërme, në banesat qytetare që lidhen me formacionin feudal të shoqërisë gjejmë shpesh qilarin e zahires, si një ambient të veçantë, në pjesën më të freskët të banesës për ruajtjen e produkteve ushqimore. Hambari (fig. 1) ndeshet sidomos në banesat e mëdha gjirokastrite, pronarët e të cilave zotëronin çifliqe. Katoi për depozitimin e druve për djegie, si dhe kafshëve të ngarkesës është një dukuri e njohur, krahas furrës për pjekje, të ndërtuar zakonisht brenda volumit të banesës, në ambientin e shtëpisë së zjarrit, apo në një ambient të veçantë që emërtohet «qilar» në Gjirokastër. Çardaku i banesës shkodrane, përveç të tjerash është një ambient që i shërben

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 1



Fig. 3



Fig. 2

përpunimit të mëndafshit natyral. Së fundi, duhet përmendur ndërtimi në trupin e banesës i sterave për grumbullimin e ujërave të shiut (fig. 2) aq të përhapura në Gjirokastër, dhe më pak në Berat, si dhe i puseve (fig. 3) thuajse në mbarë qendrat e tjera qytetare, në kushtet e veprave të pakta hidrike për sigurimin e ujit të pishëm nëpërmjet ujësjellësve. Në oborrin e banesës qytetare shqiptare të kohës ka një numër ndërtimesh ndihmëse, të cilat lidhen me kërkesat e parashtruara më sipër. Kështu në oborrin e banesës shkodrane me çardak, ndeshim shpesh «kullën e sanës» dhe «jerevinë». E para është një ndërtim me kat, e cila në katin përdhe ka stallën, në të sipërmin me ballë të hapur ambientin për ruajtjen e barit, ndërsa jerevija shërbente si ambient për larjen e teshave, gatim etj. Të njëjtat funksione i kryen edhe «ashefi«» në banesën korçare, i cili gjithashtu është një ndërtim ndihmës.

Pranë banesave të mëdha gjirokastrite ndeshim shpesh një ndërtim të veçantë, që thirret «odajashta» (fig. 4) i cili, sipas pozitës shoqërore të pronarit shërbente si vendpritje për miq të dorës së dytë, vendstrehimi për shërbyesit dhe në disa raste për njerëzit e armatosur në shërbim të pronarit të banesës. Në familjet e shtresave të pasura, në disa raste gjejmë si aneks të banesës kryesore një ndërtim të dytë që thirret «shtëpi e miqve». Raporti i madhësisë së këtyre dy ndërtimeve është i ndryshëm. Zakonisht shtëpia e miqve është më e vogël, por ka edhe raste kur

DO NOT COPY



Fig. 4



Fig. 5

madhësia e saj është thuajse e njëjtë me atë të banesës së familjes. Feudalët e pasur të vendit kanë ndërtuar shtëpi miqsh relativisht të mëdha,[2] por edhe shtresat e mesme kanë ndërtuar të tilla, natyrisht me përmasa më të vogla. Shembuj shtëpish për miq ndeshim veçanërisht në qytetet e Shqipërisë së Mesme, si dhe në ato të Kosovës (fig. 5). Në disa raste si anekse të banesës ndeshim edhe kullën për mbrojtje pasive, ku mbyllej familja në rastet e ndonjë rreziku jete. Shembuj të tillë relativisht të rrallë i gjejmë në banesat e shtresave të pasura të popullsisë.

Përgjithësisht banesa qytetare shqiptare ka oborr. Madhësia dhe organizimi i këtij të fundit është në varësi të pozitës shoqërore të familjes, karakterit të ekonomisë familjare si dhe të truallit në dispozicion. Këta faktorë nuk janë pa lidhje me njëri tjetrin sepse shtresat e pasura të popullsisë zakonisht ndërtonin në troje të sheshtë, apo jo tepër të pjerrët, siç shihet qartazi në Berat, ndërsa përkundrazi shtresat e mesme e të varfëra të popullsisë, ndërtonin në troje të pa përshtatshëm. Pikërisht në rastet e fundit ndeshim edhe banesa që dalin drejtpërdrejt në rrugë (fig. 6) duke mos pasur fare oborr, ose në disa raste një oborr fare të vogël. Shembuj tipikë të këtyre rasteve i ndeshim kryesisht në lagjet Mangalem e Goricë të Beratit. Por siç theksuam, oborret relativisht të mëdhenj janë një dukuri e zakonshme në banesat e qyteteve shqiptare të shek. XVIII-XIX, ndër të cilët mund të përmendim në radhë të parë ata të banesave të Shkodrës, Elbasanit, Tiranës, Prizrenit, Gjakovës etj. Përgjithësisht banesa ka një oborr të vetëm, por ka edhe zgjidhje me dy oborre, kur pranë banesës kryesore, është ndërtuar shtëpia e miqve. Si rast i veçantë i ndërtimit të tre oborreve, duhen përmendur disa banesa të mëdha gjirokastrite dukuri kjo që duhet shpjeguar kryesisht me synimin për të rritur aftësinë mbrojtëse të banesës.

Oborri rrethohet gjithmonë me mure relativisht të lartë. Banesa në qytetet fushorë, zakonisht nuk del në rrugë, ose i jep asaj vetëm faqen fundore apo anësore, ndërsa siç përmendëm vetëm në banesat e ndërtuara në troje të pjerrët, ndërtimet shpesh në formë vargu dalin drejtpërdrejt në rrugë me pamjet kryesore, apo edhe ato fundore e anësore. Kur banesa qarkohet me mure rrethues, ajo lidhet me rrugën, nëpërmjet portës së jashtme. Kjo e fundit përveç funksionit të qartë ndërlidhës, ka edhe funksion përfaqësues në kuptimin se nëpërmjet saj merret takimi i parë me banesën në kuptimin e gjerë të fjalës. Variacionet dhe pasuria e trajtimit të këtyre portave është aq e pasur (fig. 7), sa shtjellimi i tyre kërkon një trajtim më vete.

Nga sa u trajtua lidhur me kërkesat funksionale ndaj banesës e veçanërisht asaj të lidhur me formacionin feudal të shoqërisë, vërehet se këto janë relativisht të shumta dhe e tejkalojnë ndjeshëm kërkesën themelore ndaj banesës si ambient strehimi. Kjo shpërndarje e funksioneve të banesës edhe në ambiente ndihmëse, brenda oborrit, është një dukuri me rëndësi e banesës qytetare që lidhet me for-

2. E. Riza, **Studim për restaurimin e një banese me çardak në qytetin e Krujës,** «Monumentet» 9, 1975.

macionin feudal, ndërsa me lindjen e marrëdhënieve kapitaliste, banesa në kuptimin e ngushtë të fjalës bëhet shkallërisht bartësja e shumë funksioneve, natyrisht duke hequr disa të tilla, që tashmë nuk përputheshin me kushtet e reja, apo plotësoheshin me mënyra të tjera.

Vetë banesa qytetare shqiptare, në kuptimin e ngushtë të fjalës, materializon kërkesat ndaj saj nëpërmjet një tipologjie të caktuar. Brenda kësaj tipologjie vërehen tre kritere kompozicionale.

Kriteri i parë karakterizohet nga zgjidhjet që zhvillohen rreth një bërthame kompozicionale, e cila nuk është e njëjtë në tipa të ndryshëm. Kriteri i dytë i përket kompozimit me blloqe kompozicionalë pak a shumë të njësuar, ndërsa kompozimet e lira përbëjnë grupin e tretë.



Fig. 6



Fig. 7

Kompozimet (Tab. I) e zhvilluara sipas kriterit të parë, kanë një përhapje mjaft të gjerë në tipologjinë e banesës qytetare shqiptare. Brenda këtij parimi bazë kompozicional ndeshemi me tre lloj ambientesh që formojnë bërthamën kompozicionale. Së pari duhet përmendur banesa tiranase, në zgjidhjen e së cilës vendin qendror funksional e kompozicional, e ze shtëpia e zjarrit, rreth së cilës, sipas variantesh të ndryshëm grupohen ambientet e tjerë, në lidhje të drejtpërdrejt me të. Ky tip jep rastin më të pastër të zbatimit të kriterit të parë kompozicional. Një zgjidhje tjetër, paraqet banesa e hapur me hajat dhe çardak, në të cilat përkatësisht hajati dhe çardaku, përbëjnë qendrën kompozicionale të banesës. Ashtu si edhe në banesën tiranase, ambientet e mbyllura, qëndrojnë sipas varianteve, përbri hajatit apo çardakut, apo e qarkojnë atë nga dy apo tre anë, përkatësisht në variantin e banesës me një dhe dy krahë. Në qytetet e Kosovës, ndeshet një nënvariant interesant i banesës me çardak, në të cilin për shkak të ngushtimit të çardakut, në variantin me dy krahë, qoshku del përtej volumit të çardakut, duke formuar një njësi disi të veçantë, por të lidhur me pjesën qendrore të çardakut, tashmë vetëm me funksione ndërlidhëse. Brenda këtij kriteri kompozicional përfshihet dhe banesa korçare, në të cilën qendër e kompozimit në të gjithë variantet mbetet salloni qendror, kryesisht me funksione ndërlidhës.

Kriteri i dytë kompozicional i zbatuar në banesën gjirokastrite (Tab. I) i përket atij me blloqe. Në

Fotokopje

DO NOT COPY

të gjithë variantet trekatësh të banesës gjirokastrite vërehet se në themelin e kompozimit mbetet një njësi e përcaktuar kompozicionale, e cila është një konstante në të gjitha arritjet. Kjo njësi kompozicionale, e formuar që në variantin perpendikular trekatësh lëviz numerikisht nga një deri në tre e madje rrallë katër, për çdo banesë. Kjo njësi ka një përcaktueshmëri thuajse të pandryshueshme si përsa i përket trajtimit, ashtu edhe funksioneve, dhe bëhet kështu elementi themelor formues i varianteve të ndryshme. Blloqet vendosen në raporte të ndryshme karshi njëri tjetrit, duke treguar një elasticitet të madh në skemat kompozicionale, kryesisht për shkak të ndikimit të truallit.

Krahas kompozimeve, sipas dy kritereve të mësipërme, banesa qytetare shqiptare shfaqet edhe në një masë relativisht të gjerë ndërtimesh, ku kompozimet janë të tilla që nuk mund të grupohen sipas kriteresh pak a shumë të qëndrueshme, prandaj do të përfshihen në grupin e kompozimeve të lira. Termi kompozim i lirë, natyrisht nuk duhet marrë në kuptimin e mohimit të çdo parimi kompozicional, por vetëm në kuptimin se këto kompozime nuk mund të grupohen brenda kriteresh pak a shumë të përcaktuara. Shmangiet nga skemat kompozicionale të kristalizuara në shumicën e rasteve kushtëzohen nga trualli mbi të cilin ngrihet banesa si dhe mundësitë ekonomike të porositësit. Ndikimi i truallit në këto zgjidhje mjaft të larme është veçanërisht i qartë në Berat. Mjaft të përmendim lagjen Mangalem, ku trualli i thepisur shkëmbor nuk lejon vendosjen e skemave të njohura kompozicionale të banesës së zhvilluar me çardak, aq të përhapur në këtë qytet. Por kjo duhet lidhur edhe me shkakun shoqëror të vendosjes në këtë lagje kryesisht të shtresave zejtare me mjete të kufizuara, për të cilat ishin të paarritshme banesat e mëdha. Megjithëse në këto kompozime, që po i emërtojmë të lira, ka një larmi të madhe, realizimesh, shpesh krejt të veçanta, mjaft kërkesa, në thelb kompozicionale, janë pasur gjithmonë parasysh. Këtu duhet të përmendim së pari ndarjen funksionale të ambienteve sipas kateve, vendosjen e ambienteve të banuar, duke marrë parasysh funksionin e tyre, e për pasojë nevojën për ndriçim natyral, ndërlidhjen me ambientet e tjerë, si dhe konsiderata të tjera. Këto kompozime flasin qartë se mjeshtrat shqiptar gjithë duke punuar në rrugën e drejtë të kërkimeve me karakter tipizues, kanë pasur përherë të gjallë fuqinë krijuese, e cila u ka mundësuar zgjidhje të veçanta plot vlerë.

Siç shihet nga të tre kriteret kompozicionalë mbi të cilët është ndërtuar banesa qytetare shqiptare, vendin kryesor e ze kriteri i parë, i cili përfshin një pjesë të mirë të tipologjisë së kësaj banese. Në vendosjen kronologjike duke filluar me banesën tiranase, banesën me hajat, atë me çardak e më pas me banesën korçare, vërejmë se shfaqet prirja drejt uljes së vlerës funksionale të ambientit që shërben si bërthamë e kompozimit. Kjo shihet qartë po të krahasojmë rolin e dorës së parë të shtëpisë së zjarrit në banesën tiranase me funksionet thuajse thjesht ndërlidhëse të ambienteve qendrorë në banesën korçare. Kjo prirje shpreh zhvillimin e familjes nga format me mbeturina patriarkale drejt atyre më të zhvilluara. Të dy kriteret e tjera janë ndikuar qartë edhe nga trualli, por ndërsa në Gjirokastër për vetë kushtet e jetës është arritur te një tip i kristalizuar, i cili nuk mund të lejonte luhatje të shumta, në Berat kompozimet e lira gjetën fushë të përshtatshme zhvillimi kryesisht nga shtresat zejtare të qytetit.

Lidhur me karakterizimin e banesës qytetare shqiptare në planin e kompozimit volumor, vërejmë dy kritere, banesa me kompozim horizontal dhe banesa me kompozim vertikal. Banesat me kompozim horizontal, përfshijnë kryesisht tipat e banesës së hapur me hajat dhe çardak. Këto të fundit siç dihet janë ndërtuar kryesisht në troje të rrafshët dhe të bollshëm, me lidhje të ngushtë me oborrin e natyrën. Pikërisht për këto arsye kompozimi i theksuar me shtrirje horizontale i plotëson kërkesat funksionale ndaj këtyre banesave. Por në disa raste, edhe ngushtësia e madhe e truallit ka kushtëzuar kompozime me prirje të theksuara drejt shtrirjes, siç i ndeshim në lagjet Mangalem e Goricë të Beratit. Kompozimi me prirje të theksuara drejt zhvillimit vertikal është karakteristik për banesën gjirokastrite. Shkaku kryesor për këtë duhet kërkuar përveç ndikimit të truallit në synimin për rritjen e aftësisë mbrojtëse të banesës dhe programin e pasur të saj.

Banesa popullore qytetare shqiptare, është përgjithësisht banesë me kat. Vetëm tipi i banesës me hajat, është përdhes. Ky i fundit, siç dihet ka pasur përhapje të gjerë në qendrat qytetare të Shqipërisë së Mesme. Parapëlqimi për banesën me kat, është një tipar me rëndësi i banesës qytetare shqiptare. Në përgjithësi, ekziston një ndarje e qartë funksionale sipas kateve, e cila në formacionin feudal të shoqërisë karakterizohet nga kati përdhe i pa banuar, ndërsa kati, apo katet e tjerë të banuar. Në banesën gjirokastrite përgjithësisht trekatëshe, ambientet e katit të ndërmjemë, me lartësi më të ulët se ai i katit të sipërm, zakonisht shërbejnë gjatë dimrit, ndërsa kati tjetër i banuar ku ze vend edhe oda e miqve, shërben gjatë verës. Me lindjen e tipit të ri të banesës korçare, aty rreth gjysmës së dytë të shekullit. XIX, dhe theksimin e jetës qytetare në kuptimin e gjerë të fjalës, funksionet ndihmëse të katit përdhe, pakësohen, apo largohen krejtësisht, duke vendosur aty am-

biente banimi, kryesisht për qëndrim në periudhën e dimrit.

Në zgjidhjet konkrete kompozicionale sipas tre kritereve të përmendura më sipër, vërehet se në tipa të ndryshëm ka kërkesa funksionale të pabarabarta karshi ambienteve të banimit, apo atyre ndihmës. Më tej akoma edhe brenda një tipologjie të caktuar, në variantet e ndryshme të saj, kërkesat funksionale karshi ambienteve janë të ndryshme. Në radhë të parë shkaku për këtë duhet kërkuar në përkatësinë klasore të banuesve, pra të gjendjes ekonomike të tyre. Prirja drejt humbjes së disa funksioneve nga banesa, si dhe rruga drejt shpërndarjes së funksioneve jetësore nga një numër relativisht i kufizuar ambientesh, në një numër më të madh, shpreh ngritjen e kulturës së banimit si pasojë e kërkesave në rritje ndaj banesës.

Kështu shtëpia e zjarrit, njëri prej ambienteve më të lashtë në rrugën e gjatë të zhvillimit të banesës qytetare, ka vende dhe funksione të ndryshme në tipologjinë e saj. Në banesën tiranase ajo ze vendin qendror në kompozim, dhe shquhet nga përmasat e mëdha, sepse ajo bart një numër të madh funksionesh jetësore. Në të tre tipet e tjerë të banesës qytetare, banesën me hajat, atë me çardak dhe banesën gjirokastrite, vendi dhe funksioni i saj luhaten sipas varianteve. Kështu në përgjithësi në variantet e thjeshtë me dy kthina banimi, shtëpia e zjarrit luan një rol të rëndësishëm funksional. Më tej në variantet e zhvilluar, ajo shkallërisht fillon të humbasë funksionin e vendqëndrimit, duke u kthyer në një ambient gatimi, dhe shpesh duke u larguar nga vendi tradicional. Kështu në disa banesa të zhvilluara gjirokastrite, gatimi bëhet kryesisht në qilar, një ambient në pjesën e prapme të banesës. Në disa variante të banesës me çardak në Shkodër, gjithashtu shtëpia e zjarrit largohet nga pjesa, të themi, qendrore e banesës. Kuptohet pra se ashtu siç ndryshon e zhvillohet tipologjia e banesës po ashtu ndryshojnë dhe funksionet e për pasojë trajtimet e ambienteve të veçantë të saj.

Odat e banimit, përbëjnë një njësi tjetër themelore në banesë. Kuptohet se me shtimin e numërit, theksohet edhe diferencimi i funksioneve të tyre. Megjithkëtë në banesën shqiptare të të gjitha tipave, oda e miqve është një dukuri e ngulitur. Në kompozim ky ambient ze vendin më të mirë. Në përgjithësi gjatë shek. XVIII-XIX trajtimi i odave të miqve dhe atyre të zakonshme, paraqet një njësi të dalluar. Kjo shprehet në radhë të parë në kompozimin e odës e cila, në të katër tipet tradicionale të banesës qytetare, është e paisur me kompleksin musandër-mafil. Por ka edhe raste kur mafili është i pazhvilluar, ose mungon, siç shohim shembuj në banesën tiranase dhe



Fig. 8

atë të qyteteve të krahinës së Kosovës. Oda ka thuajse gjithmonë pjesën ballore me dritare të shumta, si vendin më të pëlqyer për qëndrim. Në disa banesa të zhvilluara të Gjirokastrës e Beratit, pjesa ballore e odës është e diferencuar nga pjesa tjetër nëpërmjet ngritjes së dyshemesë dhe tavanit të veçantë (fig. 8). Oxhaku, dollapet e murit e kamaret janë të ndërtuara gjerësisht. Ambienti sanitar në çdo odë, është një karakteristikë tjetër e odës shqiptare. Oda e miqve, shkëputet nga odat e tjera jo vetëm nga vendi i zgjedhur në kompozim, por edhe nga trajtimi i pasur dekorativ, i cili fillon që prej derës dhe theksohet në daltimet në dru të tavanit, musandrave, dollapeve të murit në oxhakët dekorativë dhe rrallë edhe në pikturimin e mureve. Thjeshtësimi, dhe më tej largimi nga dekori në banesën korçare shprehet edhe në prirjen drejt njësimit nga ana e përpunimit arkitektoniko-dekorativ të odës së miqve me ambientet e tjerë. Oda e banesës qytetare shqiptare deri aty nga fillimi i shek. XX thuajse nuk ka mobilje. Instalimet fikse, pjesë të vetë ndërtimit, kryejnë të gjitha funksionet e mobiljeve. Qëndrimi ndënjurazi mbi mindere dhe sofra për «shtrimin e bukës» kanë zgjidhur çdo kërkesë, pa nevojën e mobiljeve.

Lidhur me kompozimin e banesës qytetare të së kaluarës, që lidhet me formacionin feudal të shoqërisë, duhet të vemë në dukje tiparin karakteristik të ndërlidhjes së brendshme ndërmjet ambienteve, pa qënë i domosdoshëm kalimi në ambientet ndërlidhës.

DOKUMENT

Kjo zgjidhje krijon një lehtësi të madhe nga ana funksionale, gjithashtu këtu duhet theksuar prakticiteti i madh i saj në banesat me trema të hapura për t'iu shmangur daljes në to në muajt e ftohtë. Ndërlidhja vertikale me shkallë shërbimi ndërmjet ambienteve të banuar dhe atyre përdhe, shpreh përpjekjen për zgjidhje komode funksionale. Përveç këtyre konsideratave edhe fanatizmi, veçanërisht në shtresat e pasura të popullsisë ka pasur ndikimin e vet në këtë tipar. Përdorimi i gjerë i persianeve, madje edhe në ballet e çardaqeve në troje të pjerrët, siç shohim në Berat është një tregues në këtë drejtim.

Vendi i shkallëve në banesat qytetare me kat, dhe në përgjithësi ndërlidhja ndërmjet dy kateve, është zgjidhur në mënyra të ndryshme. Në banesën tiranase për vetë kompozimin e saj, shkallët nuk zenë ndonjë vend me rëndësi. Ato janë të thjeshta prej druri, dhe krahas shtëpisë së zjarrit, ku nëpërmjet mafilit sigurojnë ndërlidhjen e odave të banimit me këtë të fundit, i gjejmë edhe në çardak apo në pjesën fundore të odave, duke u ndërlidhur kështu drejtpërdrejtë ambientet respektive në lartësi. Në banesën me çardak shkallët vendosen thuajse gjithmonë në ballë, në qendër të pamjes kryesore. Ato dalin brenda sipërfaqes së çardakut, apo në variantet e zhvilluar, përbri saj. Përgjithësisht shkallët ndërtohen prej guri një dhe dyfishe, mbi një sistem qemeresh. Roli i tyre në formulimin arkitektonik të pamjes kryesore është tepër i dukshëm. Veçanërisht në banesat beratase me çardak ai theksohet ndjishëm sepse në shumë raste balli i hajatit trajtohet me harkadë guri. Në banesën gjirokastrite, me përjashtim të variantit të thjeshtë, perpendikular dy dhe tre katësh, ku shkallët, gjithmonë të gurta, janë të jashtme, në variantet e tjerë ato janë të brendshme, apo rrallë krahas tyre ka edhe shkallë të jashtme deri në katin e parë. Përgjithësisht në banesën gjirokastrite shkallët zhvillohen brenda volumit të nëndivanit e divanit, duke i shkuar rreth këtyre volumeve, mbajtur nga një sistem kollonash e qemeresh, por ka edhe raste kur shkallët zhvillohen përbri faqes ballore, duke të kujtuar vendosjen karakteristike të tyre në banesën me çardak. Në banesën korçare shkallët zhvillohen në sallonin qendror. Pra siç shihet përgjithësisht ndërlidhja vertikale arrihet me vendosjen e shkallëve në ambientet që formojnë qendrën kompozicionale të banesës, të cilat kanë pa përjashtim, por në shkallë të ndryshme e disa herë të vetme edhe funksionin ndërlidhës. Ato, herë të lidhura organikisht me banesën nga ana arkitektoniko-konstruktive, si në Gjirokastër, apo duke punuar disi si njësi e veçantë në banesën me çardak, veçanërisht në variantet e zhvilluara të kësaj banese, bëhen një element i rëndësishëm në rritjen e vlerave arkitektonike të banesës.

Siç kemi përmendur trajtimi i brendësisë së banesës qytetare që lidhet me formacionin feudal të shoqërisë, shquan për një dekor të pasur, veçanërisht në variantet e zhvilluara të banesës me çardak dhe asaj gjirokastrite. Në se do kemi parasysh trajtimin e jashtëm arkitektonik të katër tipave tradicionalë, do të vemë në dukje një karakteristikë me rëndësi, atë të trajtimit me përkujdesje thuajse vetëm të pamjes kryesore. Në mbarë tipologjinë e përmendur për pamjet e tjera tregohet një përkujdesje e vogël. Në pamjen kryesore përgjithësisht gjejmë hyrjen, tremat e hapura, ballet e odave kryesore, të cilat me trajtimin e tyre i japin një përpunim të dalluar kësaj pjese të banesës. Në banesën tiranase për vetë karakterin e saj, pamja kryesore ka një trajtim të thjeshtë. Ajo gjallërohet disi vetëm nga tremat e hapura. Në tipat e banesës me hajat dhe çardak, në pamjen kryesore mbizotërojnë këta elemente, të cilët i japin asaj një karakter të theksuar piktoresk, duke e shkrirë thuajse banesën me oborrin përreth. Strehët e gjera, trajtimi me disnivel i qoshqeve, rrjeti i dendur i elementeve prej druri që formon ballin e hajatit, apo çardakut, krijojnë dritë-hije të theksuar, që lejon të shfaqen qartë volumet gjysmë të hapura të ndërtesës. Banesa gjirokastrite shquan për pamjen monumentale, e cila duke kaluar nga kati përdhe në atë të dytë, vjen gjithmonë e pasurohet në elemente e trajtim, duke shpërthyer ndjishëm me ballet e odave të katit të sipërm e çardakut transparent, në kontrast me bllokun e ashpër mbi të cilin ngrihet. Në dallim nga kompozimet e qeta të banesës me hajat e çardak, këtu ndeshim një dinamizëm të spikatur si në trajtimin sipërfaqësor, ashtu edhe në thyerjet e theksuara të volumeve. Në të gjithë këtë tipologji hyrja nuk theksohet, dritaret ende nuk luajnë ndonjë rol me rëndësi, ndërsa konstruksioni i çveshur mbetet një tipar thelbësor. Vendosja e ambienteve sipas kërkesave funksionale, dhe për pasojë trajtimi i pamjeve kryesore të tyre në përputhje me këto funksione i ka vënë vulën trajtimit të jashtëm. Është tipike për këtë trajtimi i banesës gjirokastrite, ku ballet e katit (fig. 12) flasin qartë për funksionet e ambienteve. Në përgjithësi në arkitekturën e jashtme të tipave në shqyrtim punojnë masat e mëdha, kompozimi volumor, ndërsa përpunimi i hollësive arkitektonike krijon disa theksime të goditura, siç është rasti i balleve të odave të miqve në Gjirokastër, disa herë të dekoruara me piktura murale.

Me lindjen e tipit të banesës korçare, dhe valën e gjerë të rindërtimeve të tipologjisë tradicionale, vërehet një prirje karakteristike, ajo e përkujdesjes më të madhe për trajtimin e pamjes së jashtme dhe largimi nga dekori i mbingarkuar i brendësisë. Arrijmë kështu në një drejtpeshim të dalluar, i cili përbën një

DO NOT COPY

koncept të ri. Heqja dorë nga tremat e hapura, i jep një rol të madh dritares, si një element me shumë rëndësi në trajtimin e pamjes së jashtme. Ajo tashti, duke u larguar thuajse plotësisht nga mbulimi me hark, zmadhohet dhe trajtohet me përkujdesje duke e kornizuar me dru e më vonë me teknikën e suvasë. Futja e ambienteve të banuar edhe në katin përdhe kushtëzon njësinë e theksuar të pamjes kryesore, dhe më tej funksionalisht bën të domosdoshme barastrajtimin e të gjitha pamjeve. Hyrja kryesore theksohet ndjishëm, duke dalluar kështu pamjen kryesore nga pamjet e tjera. Elementet e pamjes së jashtme vishen



Fig. 12

të gjithë, konstruksioni nuk shihet më. Më parë mbisundon veshja dhe kornizimi me dru, më pas dekori me teknikën e suvasë bëhet zotërues. Fryma qytetare theksohet dhe me uljen e lartësisë së mureve rrethues e shpesh me transparencën e murit përbri pamjes kryesore i cili në shumë raste trajtohet me kangjella hekuri. Në zgjidhjet e ndryshme kompozicionale të tipologjisë së banesës qytetare shqiptare, lidhur me simetrinë dhe asimetrinë në përgjithësi vërehet një qëndrim i lirë i pakushtëzuar nga ndonjë synim paraprak pak a shumë i shkëputur nga kërkesat funksionale. Shembujt e shumtë si të zgjidhjeve simetrike, ashtu dhe atyre asimetrike, po të kemi parasysh mbarë morfologjinë e banesës qytetare shqiptare, tregojnë qartë për arritje të pasforcuara në këtë apo atë zgjidhje, e cila ka lindur si pasojë e plotësimit të kërkesave funksionale, programit dhe formës së truallit. Në mbarë tipologjinë e banesës në shqyrtim, takohen shembuj të thjeshtë e të zhvilluar që mbështeten mbi të dy këto kritere të cilët nuk mund të konsiderohen të një rëndësie të dorës së parë. Në këtë pikëshikim mendojmë se edhe klasifikimi i banesës qytetare kosovare mbi simetrinë dhe asimetrinë e kompozimin e lirë[3] ka në bazën e tij një kriter formal, i cili nuk mund të karakterizojë tiparet thelbësore të kësaj krijimtarie.

Banesa qytetare shqiptare, është pothuajse gjithmonë banesë një familjare. Ajo i shërben nevojave jetësore të familjeve me përbërje të ndryshme numerike, duke qënë e qartë prirja drejt familjeve të vogla, me kalimin nga formacioni feudal në atë kapitalist të shoqërisë. Me rëndësi është të theksohet dukuria e njohur në mjaft nga qytetet shqiptare si Gjirokastër, Shkodër, Tiranë etj. ku familje me lidhje gjinie, ndërtojnë banesat pranë njëra tjetrës, paralele kjo e qartë me fshatin shqiptar, deri vonë nga fillimi i shek. XX. Por, megjithse banesa njëfamiljare përbën dukurinë mbizotëruese, gjatë shek. XVIII-XIX, dhe deri nga çereku i parë i shek. XX, ndeshim edhe shembuj banesash dyfamiljare, të cilat nuk paraqesin ndonjë risi nga ana kompozicionale, por zakonisht dyfishojnë mekanikisht variantet e ndryshme të tipologjisë së njohur të banesës qytetare shqiptare.

Arkitektura e banesës qytetare shqiptare, karakterizohet nga një tipar i rëndësishëm, ai i zgjidhjeve të shëndosha funksionale. Në kushtet e së kaluarës, kur në përgjithësi, ritmet e zhvillimit shoqëror, për arsye të kuptueshme ishin të ulëta, dhe për pasojë kërkesat jetësore në kuadrin e diferencimit klasor të kohës, ishin pak a shumë të përcaktuara, mjeshtri

3. B. Kojiç, **Stara gradska i seska arhitektura u Serbiji,** Beograd 1949. B. Kojiç, **Shtëpia e vjetër qytetare në Kosovë e Metohi dhe problemet e mbrojtjes së saj.**

popullor, krijues dhe zbatues i veprës arkitektonike, kishte arritur në një njohje të thellë të nevojave jetësore të shoqërisë. Në anën tjetër, pjesëmarrja e pronarit të banesës në hartimin e projektit, ishte tepër aktive. Pikërisht këto arsye janë në bazën e zgjidhjeve shumë funksionale në mbarë krijimtarinë, tonë popullore. Kjo lidhet si me kompozimin në përgjithësi, ashtu edhe me trajtimin e çdo njësie kompozicionale, deri në elementet e ndryshëm të banesës. Mbarësia funksionale, vendosja në vendin e duhur të çdo elementi, shpreh qartë zgjidhjen e drejtë të kërkesave utilitare ndaj banesës. Por këto kërkesa themelore asnjëherë nuk kanë qënë të vetme, ato gjithnjë kanë qënë të shkrira edhe me kërkesat estetike. Këto dy kërkesa janë në marrëdhënie të ndryshme në vartësi të kohës, përkatësisë klasore të pronarit të banesës dhe llojit të ambientit.

Është provuar qartë se banesa popullore është një prej kategorive arkitektonike më drejtpërdrejt e lidhur me kushtet e jetës, pra me strukturën klasore të një shoqërie të caktuar. Ky diferencim klasor i shoqërisë qytetare shprehet qartazi në variantet e ndryshëm, brenda një tipologjie të caktuar të banesës. Këta variante shprehin qartë materializimin e kërkesave jetësore nga klasa dhe shtresa të ndryshme të shoqërisë qytetare. Kjo shihet edhe në qëndrueshmërinë e gjatë të varianteve të thjeshtë të tipeve të ndryshme të banesës qytetare shqiptare, të cilët ishin të arritshëm nga shtresat e skamura të shoqërisë. Ruajtja e variantit perpendikular, shpesh me gjysmëkat, shpreh qartë këtë dukuri. Diferencimi klasor pra shfaqet në zgjedhjen e varianteve gjithnjë e më të zhvilluar nga shtresat e pasuruara të shoqërisë qytetare, në valën e luftës klasore e të shfrytëzimit të pjesës dërmuese të popullsisë qytetare. Morfologjia e banesës qytetare shqiptare, është një tregues mësimdhënës i qartë në këtë drejtim. Më tej akoma, diferencimi klasor shfaqet edhe në zgjedhjen e truallit për ndërtim. Kështu Berati, Gjirokastra, Prizreni, Shkodra etj. flasin qartë për dasitë klasore dhe madje edhe ato fetare.

Në kushtet e së kaluarës, në kuadrin e shoqërisë me klasa banesa krahas funksioneve utilitare, ishte edhe shprehëse e fuqisë ekonomike dhe pozitës shoqërore të pronarit të saj. Në këtë kuptim në disa elemente të banesës shihet një trajtim i cili nuk i përgjigjet plotësisht nevojave funksionale në madhësi, apo trajtim, duke qënë ndikuar kështu nga synimet për të shprehur bujshëm pasurinë e për pasojë pushtetin në jetën shoqërore të kohës. Vetkuptohet se këto prirje formale ndeshen kryesisht në banesat e shtresave të pasura, në «portat e mëdha» apo në «oxhakët», siç cilësoheshin atëhere familjet e pasura. Pikërisht me këtë rrethanë duhen shpjeguar portat e



Fig. 11

jashtme monumentale, aq të përhapura, veçanërisht në Gjirokastër e Shkodër. Oxhaku gjithashtu bëhet një element i shprehjes së prejardhjes «fisnike». Karakteristikë për këtë janë si pjesa e tymtarëve mbi çati, që përpunohet me përkujdesje të veçanta, ashtu edhe tamburët e oxhaqeve në odat e miqve (fig. 11) të cilët nuk janë funksionalë, dhe të ngarkuar me një ornamentikë tepër të pasur. Shtresat e pasura në mjaft raste ruanin me forcë, të drejtën ekskluzive për të ndërtuar oxhakë dhe porta mbuluar me hark e qemer. Shtresat e varfëra apo banorët që ruanin besimin e vjetër, në mjaft qendra nuk lejoheshin të ndërtonin porta me hark. Ngritja e oxhakëve nuk ndalohej vetëm në fshatrat çifligje, por edhe në disa qytete. Mjaft të përmendim Tiranën, ku për të ngritur oxhaqet, kundër dëshirës së feudalëve Toptanas, u

PO NOT COPY

vranë disa anëtarë të një familje. Edhe trajtimi i pasur dekorativ, veçanërisht ai i odës së miqve në banesat e mëdha, synonte të shprehte me forcë fuqinë ekonomike të pronarit.

Parapëlqimi për tremat e hapura është një nga tiparet dallues të banesës qytetare shqiptare. Kjo është më e qartë në tipologjinë që lidhet me formacionin feudal të shoqërisë. Krahas tipave të banesave me hajat e çardak, ku tremat e hapura, përbëjnë qendrën kompozicionale dhe luajnë një rol me rëndësi në jetën e familjes, veçanërisht gjatë stinëve të ngrohta, edhe në banesën tiranase dhe atë gjirokastrite, tremat e hapura janë një shfaqje thuajse e zakontë. Gjithashtu krahas ambienteve tradicionale të hapur, si hajati e çardaku njihen edhe kamerietë, të cilat kanë pjesërisht, apo plotësisht funksionin e vendqëndrimit në ambient të hapur. Me lindjen e marrëdhënieve kapitaliste, për vetë kërkesat e reja jetësore ndaj banesës, tremat e hapura fillojnë e humbasin parësinë. Merr rrugë procesi i gjerë i mbylljes së tyre dhe natyrisht i mosndërtimit të banesave të hapura. Por edhe në tipin e ri të banesës korçare, erkeri karakteristik me dritare të shumta, është një lloj qoshku i mbyllur, i njohur gjerësisht në formën e hapur në banesat e katër tipave tradicionalë të banesës shqiptare. Më tej ballkoni në banesën korçare, lidhet pikërisht me dëshirën për të qëndruar sa më pranë natyrës.

Pra në kushtet e reja shoqërore kjo kërkesë ndaj banesës zbehet ndjshëm dhe shfaqet në forma të reja. Tremat e hapura, siç shihet nuk lidhen vetëm me një tipologji të caktuar, dhe as me një qendër të caktuar. Ato i gjejmë në forma të ndryshme në mbarë tipologjinë e banesës qytetare, shqiptare prej Gjirokastrës, në Berat, Elbasan, Shkodër, Prizren, Gjakovë, Prishtinë, Pejë etj. Kushtet ekonomiko-shoqërore të së kaluarës, si dhe periudha e ngrohtë relativisht e gjatë, kanë bërë që ambientet e hapura, si një shfaqje mjaft e lashtë dhe me vazhdimësi të madhe kohore të jenë një tipar i rëndësishëm i banesës qytetare shqiptare.

Në kushtet e së kaluarës, pasiguria shkaktuar nga rrethanat historiko-shoqërore, ishte një faktor që kishte ndikimin e vet edhe në banesë. Veçanërisht kjo shihet qartazi në banesën që lidhej me formacionin feudal të shoqërisë, ndërsa në banesën korçare kjo përkujdesje nuk ka më vend. Përkujdesja për mbrojtje në banesën e katër tipave të hershëm të banesës shqiptare nuk është e njëllojtë. Gjithashtu duke iu afruar fundit të shek. XIX ky tipar vjen në rënie. Mënyrat konkrete për të siguruar banesën, kanë qënë gjithashtu të ndryshme.



Fig. 9

Në banesën tiranase e vetmja masë që synon sigurimin e banesës është ndërtimi i mureve të lartë rrethues. Këta mure janë gjithashtu të tillë në Elbasan e veçanërisht në Shkodër, ku mbisundojnë banesat e hapura. Krahas ndërtimit të mureve të lartë kryesisht në Shkodër, ndërtohen edhe frengji për pushkë, në portën e oborrit, pika më e dobët e mbarë rrethimit. Tipi, në të cilin përkujdesja për mbrojtje ka qënë e një rëndësie të madhe përfaqësohet në banesën gjirokastrite, apo kullën qytetare. Për këtë shkaqet duhen kërkuar në kushtet e veçanta të kësaj qendre.[4] Ky tipar në banesën gjirokastrite del më i qartë për arsye të kuptueshme në banesat e shtresave të pa-

4. E. Riza, **Qyteti-muze i Gjirokastrës,** Tiranë, 1981.

DO NOT COPY



Fig. 10

sura. Konkretisht ai shfaqet në muret rrethues, oborret dyfishe, kompozimin në lartësi dhe më qartazi në përdorimin e gjerë të frengjisë për pushkë. Atë e gjejmë në portën e jashtme dhe në trupin e banesës (fig. 9), madje edhe në odën e miqve, mjaft që ajo të mbikqyrte çdo pikë nga ku mund të pritej sulmi eventual. Një vend të veçantë në tipologjinë e banesës qytetare shqiptare zenë disa shembuj banesash të fortifikuara të tipit kullë deri diku të përhapura në Pejë.[5] Këto ndërtime trekatëshe (fig. 10) me volum të theksuar prizmatik dhe dysheklläkun karakteristik në katin e dytë, përsa i përket trajtimit të jashtëm arkitektonik janë të njëjta me banesën fshatare të fortifikuar të tipit kullë.

Struktura klasore e shoqërisë në të kaluarën dhe ecuria relativisht e ngadaltë e saj, kanë bërë që të marrë formë një tipologji e qëndrueshme në banesën qytetare shqiptare. Kjo tipologji e cila përfshin në radhë të parë kompozimin dhe që shtrihet më tej në njësitë dhe elementet kompozicionale, është një tipar tjetër me rëndësi i kësaj krijimtarie. Brenda formacionit feudal tipizimi në planin kompozicional nuk është aq i spikatur. Kjo shpreh atë realitet ekonomiko-shoqëror që kushtëzohej në radhë të parë nga copëzimi ekonomik i shoqërisë feudale. Më tej, me lindjen e marrëdhënieve kapitaliste, edhe krijimin e tregut të brendshëm kombëtar, tipologjia bëhet më e njësuar. Përkundrazi në arkitektuarën e njësive bazë kompozicionale, atë të elementeve të ndryshëm arkitektonikë e konstruktivë, njësia ka qënë e spikatur edhe në kaq tipat tradicionalë të banesës qytetare shqiptare. Për t'u theksuar është se tipizimi si një prirje e qartë normative, nuk ka njësuar krijimtarinë popullore në kuptimin e përsëritjes mekanike të disa skemave, dhe në përgjithësi arritjeve edhe në plane të tjerë. Shembujt e shumtë të ndërtimeve në fushën e banesës qytetare flasin qartë për një zbatim vërtet krijues të këtyre arritjeve të njësuara. Kjo ka bërë që krijimtaria popullore të ruaj vlera të veçanta, në kuptimin se çdo vepër, megjithëse e ndërtuar sipas disa kritereve të njësuara, spikat si një krijim origjinal. Vetë procesi i veprimtarisë praktike, për konceptimin dhe ngritjen e një vepre ndërtimore, në kushte asnjëherë të barabarta përjashtonte apriori çdo njësim tipologjik të standartizuar. Tipizimi pra shihej si një sintezë e përgjithshme parimesh kompozicionale dhe më tej njësish dhe elementesh të veçantë, duke i lënë hapësirë të lirë çdo krijuesi për zbatime me kufij relativisht të gjerë interpretimesh, çka i ka ruajtur krijimtarisë popullore spontanitetin dhe larminë e spikatur të zgjidhjeve.

Një karakteristikë të banesës qytetare shqiptare, përbën edhe aftësia e saj për t'iu përshtatur kërkesave të reja të kohës, si dhe nevojave të ndryshme familjare. Forca e saj adaptive është e madhe. Kjo shihet veçanërisht qartë në gjysmën e dytë të shek. XIX e më pas, kur banesat e ndërtuara sipas tipologjisë tradicionale i nënshtrohen një procesi të gjerë rindërtimesh. Mbyllja e tremave të hapura, ritrajtimi i pamjeve të jashtme, dhe i ambienteve më anakronike si shtëpia e zjarrit dhe më tej riprekje e gjerë, thuajse e mbarë katit të banuar, veçanërisht në tre lagjet-muze të Beratit shprehin qartë këtë karakteristikë. Këtu spikat edhe njëherë shija dhe kultura e gjerë e mjeshtrave shqiptarë, që kanë përfillur njësinë stilistike të veprës, duke futur me ndjenjë të hollë mase trajtimet e reja.

Banesa qytetare shqiptare lidhur me formën e truallit ngrihet mbi rrafshe dhe terrene të pjerrët shkëmbore. Në rastin e parë lidhja me truallin, nuk paraqet probleme, në kuptimin se nuk ndikon në kompozim, prandaj në këto kushte ndeshemi në zhvillime të barabarta të kateve të banesës, si dhe shfaqet parapëlqimi për ndërtimin e banesave me trema të hapura rrethuar me kopshte, duke krijuar një lidhje të ngushtë të banesës me ambientin natyror përreth. Përkundrazi në trojet e pjerrëta shkëmbore, ky i fundit ka një ndikim të dukshëm në kompozimin volumor të banesës. Koncepti i gjysmëkatit, i cili shprehet në ndjekjen e rënies së truallit me kompozim vo-

5. M. Krasniqi, **Shtëpia shqiptare në Kosovë,** «Gjurmime albanologjike — Folklor dhe Etnologji», I, 1971.

DO NOT COPY



Fig. 13



Fig. 14

lumor të shkallëzuar, në rritje prej katit përdhe e sipër, është një dukuri mjaft e përhapur që përfshin mbarë tipologjinë e banesës shqiptare me kat, ndërtuar me troje të pjerrët. Ky koncept kompocizional ka bërë të mundur lidhjen e arritur të ndërtimit me truallin, si një nga tiparet e rëndësishme të banesës qytetare shqiptare, ndërtuar në troje të pjerrët. Janë pikërisht këto raste, që përbëjnë shumicën e atyre kompozimeve që i emërtuam të lira, për të shprehur shmangien nga konceptet e kristalizuara kompozicionale.

Des études effectuées jusqu'à ce jour, l'habitation urbaine albanaise apparaît comparativement nette dans sa morphologie et dans ses traits au cours des XVIII-XIXe siècles. Plus tard dans le temps c'est jusque vers le seuil de l'occupation osmane que mènent, indirectement et de façon non approfondie les peu de traces matérielles, des sources, ou bien des données d'auteurs de l'époque. Donc, quant'aux traits de l'habitation urbaine albanaise, les cinq siècles d'occupation osmane peuvent être suivis, mais naturellement à des niveaux différents de profondeur. Ce sont précisément ces cinq siècles liés à l'inclusion de notre peuple dans le cadre de la politique de l'Etat osman, qui incluait un grand nombre de peuples, parmis lesquels étaient aussi ceux des Balkans. Dans ces conditions, où les circonstances économiqjues et sociales avaient des choses essentielles communes dans tous les Balkans on comprend que les parallèles entre la typologie de l'habitation urbaine albanaise et celle des autres unités ethniques voisines sont un phénomène compréhensible. Cela se voit tout d'abord dans la vaste étendue de l'habitation à vestibule ouvert (à porche et tchardak), d'origine ancienne, qu'on rencontre largement dans les villes des Balkans, avant la naissance des rapports capitalistes. Mais de pair avec elles, toujours sur le plan typologique, chez-nous se conservent deux types sans parallèles avec l'habitation des Balkans et c'est précisément l'habitation de Tirana et celle de Gjirokastra. Particulièrement dans le cadre de la société féodale de l'époque, les conditions particuières sociales, la tradition de construction et d'autres causes expliquent ce phénomène. Lorsqu'on parle de la vaste construction d'habitations ouvertes dans tous les Balkans, en Turquie et généralement dans les pays méditerrannéens, on ne peut pas mentionner que les hbaitations albanaises de ce type se distinguent par la netteté accentuée compositionnelle et par la typisation évidente sur ce plan. En ce qui concerne le traitement des éléments architectoniques et en général de l'intérieur et de la vue extérieure, il y a des parallèles nettes entre l'habitation albanaise, celle des peuples des Balkans et l'habitation turque.

Les grands pachaliks albanais ont inclu à l'intérieur de leurs territoiers une très grande partie des contrées habitées par les albanais. Dans cette période la nouvelle couche dominatrice était intéressée à un développement rapide de l'économie urbaine. C'est précisément dans ces conditions que l'habitation urbaine albanaise arrive aux variantes, les plus développées. En cette époque-là, s'élèvent les habitations les plus renommées dans la typologie de l'habitation à tchardak et celle de Gjirokastra, les deux types aux réalisations les plus parfaites dans le cadre de la société féodale. Précisément pendant cette période, couvrant approximativement la période allant des dernières décennies de la fin du XVIIIe siècle, jusqu'au premier quart du XIXe siècle environ, l'habitation urbaine albanaise se place aux premiers rangs de la création dans ce domaine, dans tous les Balkans.

Le grand mouvement de la Renaissance, le renforcement de la bourgeoisie, et la formation du marché national ont amené l'unification accentuée de l'habitation urbaine albanise, qui à présent est plus proche de l'architecture de l'habitation des peuples des Balkans. Ce passage rapide au nouveau type, avait devant lui un long chemin, allant de l'habitation ouverte à celle fermée, avec un salon central, un vaste répertoire traditionnel sur le plan technique ainsi que des maîtres de talents, expérimentés et d'une grande force créatrice. Ces circonstances ont fait que l'habitation albanaise de cette période conserve ses caractéristiques.

Le peu d'études comparatives effectuées jusqu'à ce jour, surtout en raison du fait qu'on n'a pas recueilli de façon systématique des matériuax, ne permettent pas d'aller plus loin quant'aux relations entre l'habitation albanaise et celle des autres peuples des Balkans, tâche qui incombe aux études futures.

Dans cette épreuve visant à caractériser certains des traits de la création populaire dans l'habitation urbaine albanaise, on ne peut pas souligner l'activité authentique créatrice des maîtres de talents albanais. Ce sont ces créateurs, en général anonymes, dont la connaissance de certains d'entre eux, peut être réalisée seulement à travers l'analyse des oeuvres de l'art décoratif de l'habitation urbaine, qui ont projeté et appliqué l'oeuvre architectonique. Bons connaisseurs du mode de vie, des matériaux de construction et de la construction en général, en se consacrant dès leurs jeunesse à cette activité, avec l'expérience séculaire de leurs prédécesseurs, toujours près d'eux, ils ont laissé une création vraiement populaire, qui est impréigné de l'esprit sain d'une architecture pleine de vraies valeurs.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

monumentet

Isuf SUKAJ

VËSHTRIM MBI ZHVILLIMIN E URBANISTIKËS DHE ARKITEKTURËS SË KAVAJËS (DERI NË FUND TË SHEK. XIX)

Territori fushor në të cilin shtrihet sot qyteti i Kavajës, së bashku me fshatrat e tij, në kodrat nga ana perëndimore dhe lindore e këtij qyteti bën pjesë në prapatokën e afërt të qytetit të Durrësit. Historia e lashtë dhe ajo mesjetare e Durrësit është e lidhur ngushtë edhe me atë të prapatokës së tij.

Deri më sot zanafilla e Kavajës si qendër e banuar është parë diku nga mesi i shek. XVI, por zbulimet e disa fragmenteve arkitektonike dhe disa mbishkrime e shtyjnë atë në shekujt e parë p.e.s. Nga të dhënat për qendrat arkeologjike të Zig-Xhafes, Kanapares, Spanjojt dhe Qerretit që ndodhen nga një deri katër kilometra larg qytetit të sotshëm të Kavajës, vërtetohet ekzistenca e qytetërimit në këtë zonë në periudhën helenistike. Nga gjetjet në Kalanë e Zig-Xhafajt, që i përket shek. IV-II para erës sonë, si e vetmja qendër e fortifikuar ilire që njihet deri më sot në rrethin e Durrësit, kuptohet se në këtë zonë ka pasur një qendër administrative për banorët e zonës përreth.[1]

Tre mbishkrime të gjetura në qytetin e Kavajës janë botuar prej arkeologëve francezë Hezej e Domje.[2]

Mbishkimi i parë (CIL III 63) gjendet mbi një altar të vogël portativ, i cili i kushtohej Manit të hyjnueshëm dhe lidhet me emrin Sintia Arete. Mbishkrimi i dytë (CIL III 622) i punuar në një pllakë mermeri është epitafi i Publio Maecilio nga tribuja e Emilëve që dihet se banonin në qytetin e Dyrrahut.

Zona ku shtrihet sot qyteti i Kavajës dhe rrethi i saj që në shek. I p.e.s përfshihej brenda territorit të Durrësit, i cili shtrihej deri në vendin e quajtur nga Qezari Asparagun Dyrrhachinorum, një etapë marshimi drejt jugut në Shkumbin.[3]

Të dhënat e mësipërme tregojnë qartë se në Kavajë ku kalonte Via Egnatia, kalldrëmi i së cilës ruhet në lagjen Sallbeg përballë kodrës së Qenzes 150--200 m larg nga përroi i Foses,[4] mendohet të gjendej një lokalitet, vicus. Në vitin 1853 Hani zbuloi në Kavajë një gur varri me një basorelief që paraqiste tri figura në këmbë.

Hezej-Domje e lidhin qënien e këtij vicusi me faktin se ky vend furnizonte me mermer romakët.[5] Vazhdimin e kësaj qendre edhe në vitin 531, të paktën deri më 17 Shtator të këtij viti, e dëshmon një mbishkrim tjetër në greqishte.[6] Fillimisht duket se në

1. H. Myrto, **Mbi disa qendra arkeologjike ndërmjet Kavajës e Durrësit,** Monumentet, nr. 7-8, 1974, f. 247.
2. L. Heuzey.-H. Daumet, **Mission archéologique de Macédoine,** Paris 1876, f. 390.
3. M. Sufflau, **Städte, und Burgen Albaniens hauptsächlich whährend des Mittelakters,** Wien und Leipzig, 1924, f. 15.
4. H. Myrto, **Vep. cit.,** f. 252.
5. L. Heuzey-H. Daumet, **Vep. cit.,** f. 191.
6. L. Heuzey-H. Daumet, **Vep. cit.,** f. 190.

këtë pikë ka qënë një stacion rrugor për shkëmbim e shlodhje udhëtarësh, mansio, i cili dora dorës në sajë të kushteve të mira për zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë dhe tregtisë u kthye në një lokalitet gjithnjë të varur nga Durrësi.

Me emrin Kavalje këtë vendbanim e hasim më 1431 në regjistrat osmane të Sanxhakut Arvanid.[7] Në vitin 1583 atë e gjejmë përsëri në regjistrin e Sanxhakut të Elbasanit me po këtë emër.[8] Sipas këtij dokumenti Kavaja në këtë vit kishte 132 shtëpi.

Zhvillim me ritme relativisht të shpejta ky qytet pati veçanërisht në shek. XVII. Në çerekun e dytë të këtij shekulli formimi i Pashallëkut të Kavajës,[9] krijoi kushte të favorshme për një zhvillim të mëtejshëm të ekonomisë. Në këtë periudhë kemi një rritje të shtresës zejtare me një organizim të fuqishëm esnafor.[10] Rritja e hovshme e forcave prodhuese i dha një shtytje të mëtejshme ndërtimit të objekteve të ndryshme.

* * *

Në shek. XVIII kur filloi të shthurrej ekonomia natyrore e fshatrave siç del dhe nga të dhënat e Çelebiut[11] duket qartë se zhvillimi ekonomik tashmë kishte konsoliduar pozitën e qytetit të Kavajës si qendër prodhimi dhe shkëmbimi. Sipas tij në vitin 1670 Kavaja kishte 4 lagje banimi (Sharre, Zgurraj, Sallbeg dhe Bukaq) me 400 banesa dhe 200 dyqane.

Një nga kushtet kryesore që përcaktoi kthimin e saj nga fshati në qytet ishte nevoja për krijimin e një tregu si qendër e rëndësishme prodhimi dhe këmbimi të produkteve bujqësore, blegtorale, të frutikulturës dhe artizanatit për trevat rreth saj. Fakti që ekonomia bujqësore luajti një rol me rëndësi në jetën e këtij qyteti, shprehet qartë në karakterin e urbanistikës së saj, madje dhe në arkitekturën e banesës.

Periudhë tjetër e rëndësishme e zhvillimit ekonomiko-shoqëror dhe e zhvillimit urbanistiko-arkitektonik e qytetit të Kavajës ka qënë ajo e shek. XVIII--XIX. Në këtë periudhë Kavaja vazhdon të jetë qendër administrative e rrethit. Durrësit për shkak të klimës së keqe moçalore banohej nga një numër i vogël njerëzish dhe Kavaja të paktën që nga viti 1670 është selia administrative e Durrësit. Nga korrespondenca e konsujve venedikas të Durrësit Pietro Roza dhe Xhorxhio Kumano në vitet 1696-1707 njoftohemi për banimin e tyre si dhe të gjykatësit të Durrësit, të doganierëve dhe administratorëve të tjerë në Kavajë.[12]

Pamundësia e grumbullimit të banorëve në Durrës dhe kushtet e mira ekonomike, shoqërore e klimaterike i dhanë përherë e më tepër dorë Kavajës të bëhet kryeqendra administrative-ekonomike dhe krahas këtij funksioni ajo filloi të luante edhe rolin e një skele anekse tregëtare kryesisht për drithra.[13] Edhe në vitin 1838 kur J. Myler vizitoi Kavajën, informohemi se ajo është qendër rrethi me 3000 banorë dhe rrethi i saj me 28.000 banorë. Pra në këtë periudhë Kavaja është një qytet i rëndësishëm dhe i zhvilluar sepse plotësonte më së miri kushtet e zhvillimit të një qyteti si qendër e rëndësishme urbane.

Terreni në të cilin është ndërtuar qyteti i Kavajës është fushor. Duke u bazuar në banesat e sotme më të vjetra rezulton se zhvillimi urbanistik i qytetit është bërë sipas dy rrugëve kryesore: Rrugës së Madhe (Fig. 1) që lidhet me Durrësin e Rogozhinën dhe rrugës së lagjes Zguraj që formon me të parën një kënd 90^0 në drejtimin perëndimor të qytetit. Këto dy rrugë takohen me njëra tjetrën në qendër të qytetit atje ku ishte pazari i tij. Pra ndërtimet e qytetit të vendosura kryesisht gjatë këtyre dy rrugëve i japin atij formë planimetrike me atë të gërmës «T». Rruga e Madhe e drejtimit veri-jug është më e zgjatur se ajo e lagjes Zguraj. Pjesën tjetër të rrjetit rrugor e përbëjnë rrugicat. Gjerësia e të dy rrugëve kryesore të qytetit ka qënë 6.5 m duke përfshirë kanalet anësore për largimin e ujërave atmosferike. Ato ishin shtruar me kalldrëm guri me gjerësi 2,5 m secila.

Një veçori e rrjetit rrugor të qytetit janë rrugicat pa krye. Në të dy anët e tyre zakonisht ndodheshin 10-15 banesa (fig. 1). Gjerësia e rrugicave ka qënë 3.5-4 m, të cilat shtroheshin me kalldrëm guri me një gjerësi 1.2-1.5 m. Këto rrugica janë mjaft intime dhe karakteristike në disa qytete të vendit tonë si në Tiranë, Shkodër etj.

Duke pranuar gjysmën e dytë të shek. XVII si cakun e përafërt të shtrirjes së plotë të qytetit, mund të

7. H. Inalçik, **Suret-i defter-i Sançagi Arvanid,** Ankara 1954, f.
8. **Defteri i Sanxhakut të Elbasanit Nr. 66 në drejtorinë e përgjithshme të tatimeve dhe kadastrës në Ankara,** (Arkivi i Institutit të histori-Gjuhësi)
9. **Historia e Shqipërisë,** Vëll. I, Tiranë, 1967, f. 422.
10. Z. Shkodra, **Esnafet shqiptare,** Tiranë, 1973, f. 54.
11. F. Babinger, **Rumeliche streifen. Evlija Tschelebis Reisewege in Albanien,** Berlin 1938, f. 29-30.
12. Z. Shkodra, **Dokumenta mbi Shqipërinë në shek. XVIII,** vëll. II, (1676-1707), Tiranë, 1975.
13. Z. Shkodra, **Po aty,** f. 291.

DOKTORATURA

DO NOT COPY



Fig. 1

DO NOT COPY



Fig. 2

pohojmë se fizionomia urbanistike e kësaj periudhe është ruajtur deri në ditët tona me ndryshime të vogla të formës, por me rritjen e dendësisë së ndërtimeve, ndërsa arkitektura e ndërtimeve si element më i ndryshueshëm se urbanistika ka evoluar me kohën.

Bërthamën e kompozimit urbanistik të qytetit të Kavajës e përbënte pazari i tij i ndërtuar në qendër dhe i shkëputur nga lagjet e banimit (Fig. 2). Ky pazar si në periudhën e sundimit të marrëdhënieve ekonomike feudale dhe më vonë me fillimin e marrëdhënieve kapitaliste ka qënë i lidhur ngushtë me zhvillimin e qytetit. Ai ishte qendra zejtaro-tregtare e qytetit dhe formonte një ansambël arkitektonik e urbanistik me një shtrirje planimetrike të gjatë 230 m. Dyqanet në secilën nga këto rrugë shërbenin për një zeje të caktuar. Ata ishin kompozuar në blloqe horizontale të vendosura përkundrejt njëri tjetrit.[14]

Ndërtesat e banimit dhe dyqanet ishin të ndërtuar me një dhe dy kate por dominonte ndërtimi me një kat (Fig. 2, 3).

Në qendrën e qytetit në pazarin e tij ishin tre sheshe kryesore: Sheshi i «Manave të pazarit», sheshi i fruta-zarzavateve dhe sheshi i shitjes së bulmetrave. Këto sheshe shërbenin për shitjen e produkteve bujqësore e blegtorale në ditën e pazarit.

Qyteti kishte një gjelbërim të dendur nëpër oborret e banesave, kopshtet përkatëse dhe në sheshet e rrugët e pazarit. Në sheshet dhe rrugët e pazarit zakonisht mbilleshin mana dhe akacje, për këtë arsye njëri nga sheshet ishte emërtuar sheshi i «Manave të pazarit».

Furnizimi me ujë bëhej kryesisht nga puset që kishte çdo shtëpi në oborrin e saj, po ashtu edhe në pazar kishte 5 puse të hapur në pikat kryesore të tij. Gjithashtu me ujë të pijshëm qyteti furnizohej pjesërisht nga çezmat që shfrytëzonin burimet e kodrës së qytetit dhe më vonë më 1735 edhe me çezmën e shatërvanit të xhamisë Kubelie. Në zonën e pazarit në periferinë e tij kanë qenë ndërtuar edhe disa hane.

Në kompozimin urbanistiko-arkitektonik përveç banesës, pazarit, shesheve dhe haneve në ndërtimet e këtij qyteti një rëndësi kanë pasur dhe faltoret e kultit mysliman, të cilat sot i njohim nga të dhënat mbishkrimore të mbledhura.[15] Në Kavajë në vitin 1561-1562 nga Ali Hajdari u ndërtua xhamia Plake në periferi të pazarit nga ana juglindore e tij. Në vitin 1650-1651 në lagjen Sallbeg nga Haxhi Hysen Kaiku u ndërtua një faltore tjetër e njohur me emrin xhamia e Kaikut. Ndërsa më 1714-1715 pranë sheshit të bulmetrave në hyrje të rrugës së lagjes Zguraj ndërtohet xhamia e Haxhi Alushit. Këto faltore të shpërndara si në qendër ashtu edhe në lagjet e qytetit karakterizoheshin nga zgjidhje të thjeshta arkitektonike dhe nuk patën ndikim të ndjeshëm në strukturën urbanistike të ansambleve të banesave, të cilat e kishin fituar më parë fizionominë e tyre.

Zhvillimi i mëtejshëm ekonomiko-shoqëror në shek. XVIII solli dukuri të reja në fushën e urbanistikës dhe të arkitekturës. U shtua popullsia, numri i banorëve dhe qendra filloi të marrë një fizionomi të re në sajë të ndërtimeve të shumëllojshme që filluan të bëhen.

Kështu më 1735-1736 në qendër të qytetit, në pazarin e tij, u ndërtua xhamia Kubelie, portiku i saj i jashtëm, shatërvani dhe medreseja (fig. 2).

Në planin urbanistiko-arkitektonik në shoqërinë me klasa këto objekte të kultit kanë qënë më të mëdhatë dhe të rëndësishmet e qytetit. Prandaj për ndërtimin e tyre është zgjedhur vendi më i mirë, materialet më të çmuara dhe mjeshtrit më të dëgjuar vendas të asaj kohe.

Karakteristikë tipike e xhamisë Kubelie ishte simetria e planimetrisë së saj drejtkëndëshe me kupol e shoqëruar me një portik të hapur që rri përpara në formë prostili. Salla e lutjeve të saj ka pasur formë katrore 8.6 x 8.56 m,[16] e cila paraqet një vëllim unik të mbuluar me kupolë sferike me tambur oktagonal mbi bazament katror. Portiku në pjesën veriore të sallës së lutjeve dhe në anët lindore e perëndimore të saj ishte rrethuar me arkada të gurta respektivisht me 5 harqe në hyrje dhe me tre harqe anash. Në të djathtë të hyrjes ka qënë ndërtuar minarja me gurë të gdhendur. Në këtë monument, mjaft karakteristik ishte portiku i dytë i ndërtuar rreth portikut të vetë xhamisë i përbërë prej kollonash dhe harqesh të gurtë që zinte një sipërfaqe të konsiderueshme përpara xhamisë në oborrin e saj (fig. 4).

Ky portik me siluetën mjaft të bukur e proporcional të arkadave të tij, me kapitelet me gurë dhe gurët e gdhendur me mjeshtëri të harqeve së bashku me shatërvanin, plotësonte me një shije të hollë urbanistike e arkitektonike kompleksin e qëndrës së qytetit.

Përbri xhamisë Kubelie më 1817 u ndërtua kulla e sahatit, e cila matjen e kohës e bën njëkohësisht si orë diellore dhe si orë e zakonshme me mekanizmin e saj përkatës (fig. 4).

14. I. Sukaj, **Urbanistika dhe arkitektura e pazarit mesjetar të Kavajës,** Monumentet nr. 1/1981, f. 36.
15. **Mbishkrimet turko-arabe** (përkthyer në Arkivin e Institutit të Historisë).
16. A. Meksi, **Ndërtimet e kultit mysliman në Shqipëri,** Studime historike, Nr. 1, 1980, f. 189.



PAMJE NGA PIKA O_1

Fig. 3

DO NOT COPY

Përvoja e pasur ndërtimore e mjeshtrave të ndërtimit me të drejtë e konceptoi kullën e Sahatit si një objekt me shumë rëndësi. Duke e ndërtuar atë përbri xhamisë në një kuotë të tillë, që ajo të shihej në çdo skaj të qytetit, mjeshtrit vendas e zgjidhën shumë mirë si funksionin praktik dhe atë estetik, në harmoni e unitet të plotë, dhe kështu arritën të japin një kompozim urbanistiko-arkitektonik me vlera të larta artistike. Xhamia me portikën e saj në ansambël me kullën e sahatit dhe gjelbërimin e dendur, me një zhvillim të theksuar në lartësi, dallonin qartë dhe merrnin pjesë aktive në siluetën e qytetit të shtrirë.

Banesa në kompleks me ndërtimet e tjera të qytetit është elementi themelor në kompozimin urbanistik e arkitektonik të tij. Nga burimet e shkruara të studiuesve dhe udhëtarëve të ndryshëm për këtë periudhë, kemi të dhëna mjaft të pakta për banesën tradicionale të Kavajës. Ato plotësohen deri në një farë mase nga gjurmimi i disa shembujve të vjetër që ende ruhen në këtë qytet.

Këto banesa tregojnë se tipi mbizotërues në këtë qytet gjatë shek. XVIII-XIX, ka qënë banesa përdhese me hajat. Ky tip i banesës qytetare shqiptare ka qënë mjaft i përhapur në shumë qytete të Shqipërisë së Mesme si në Elbasan, Tiranë, e në Peqin.[17]

Banesa me hajat e Kavajës, siç tregojnë shembujt



PORTIKET DHE KULLA E SAHATIT
KAVAJE

Fig. 4

17. E. Riza, Banesa popullore e disa qendrave të Shqipërisë së Mesme, Monumentet, Nr. 5-6, 1973, f. 101.

DO NOT COPY

që janë ruajtur deri kohët e fundit, ka ruajtur për një kohë të gjatë tiparet e saj themelore, duke u ndërtuar me variante të ndryshme. Tipi i banesës me hajat ka një ndikim të qartë si nga organizimi planimetrik i ambienteve ashtu edhe nga kompozimi volumor e arkitektonik me banesën «e hapur» fshatare.

Gërshetimi i ekonomisë qytetare me atë bujqësore dhe blegtorale duhet shikuar si faktor kryesor i kësaj dukurie që nuk është karakteristike vetëm për Kavajën. Megjithëse në përgjithësi banesat e Kavajës kanë pësuar ndryshime të mëdha, mund të ndiqet ecuria në kohë e kësaj banese.

Në përgjithësi banesa e Kavajës e tipit përdhes me hajat karakterizohet nga një kompozim i thjeshtë volumor e planimetrik dhe formohet nga ambientet e banimit, ambientet ndihmëse dhe hajati. Në shumicën e rasteve banesa ndërtohet në troje me sipërfaqe të konsiderueshme të rrethuar me mure duke formuar kështu oborrin e veçantë. Oborri i rrethuar me mure është karakteristik për shumë qytete të vendit tonë. Në këtë mënyrë banesa e ndërtuar në brendi të oborrit nuk merr pjesë gjithmonë në formulimin arkitektonik të rrugës sidomos në rrugicat.

Përbërja e ambienteve të brendshme të banesës, madhësia dhe numri i tyre, diferencimi i tyre sipas funksioneve kanë evoluar me kohën në etapa të ndryshme të zhvillimit të shoqërisë. Nga të dhënat gojore rezulton se embrioni i kësaj banese ka qënë një ambient me përmasa të konsiderueshme, në të cilin organizoheshin brenda për brenda tij ndarjet funksionale të gatimit, fjetjes, ruajtjes së ushqimeve, ujit, mbajtjes së enëve etj. Ngjitur me këtë ambient në pjesën e pasme të tij aneksohej quri që shërbente si depo ku bënte pjesë dhe nyja sanitare. Përpara tij ishte organizuar hajati.

Varianti më i përhapur i banesës përdhese kavajase me hajat në shek. XVIII-XIX është ai me dv dhoma banimi: shtëpia e zjarrit dhe oda e miqve, përpara të cilave ndërtohet hajati, ndërsa në pjesën e pasme ndërtohej quri zakonisht në të gjithë gjatësinë e banesës.

Shtëpia e zjarrit ose dhoma e ditës me sipërfaqe 20÷40 m² përgjithësisht organizohej me vatër për nde-



Fig. 5

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 6



zjen e zjarrit për ngrohje e gatim, e cila vendosej në mes të ambientit me distancë 3/4 e gjatësisë së tij duke u nisur nga dera e hyrjes kryesore. Asaj zakonisht nuk i ndërtohej tavani. Mobilimi i shtëpisë së zjarrit ishte i thjeshtë me një sergjen për mbajtjen e enëve të vendosur në murin tërthor pranë derës së hyrjes kryesore përballë vatrës. Ngjitur me muret e shtëpisë së zjarrit në njërin kënd të saj pranë vatrës ndërtohej sofati me konstruksione druri me një sipërfaqe 6-10 m^2 i ngritur nga dyshemeja e dhomës 50--60 cm. Ky shërbente për të qëndruar në orët e lira njëkohësisht edhe për të fjetur në rast nevoje. Për vendosjen e ndriçuesve të ambientit, ndërtohej pishtari prej druri i cili ngrihej 70-80 cm. mbi kuotën e sofatit dhe zbukurohej me gdhendje.

Oda e miqve ka një interier më të përpunuar nga ana arkitektonike se shtëpia e zjarrit. Ajo lidhet direkt me qurin dhe ka nyje sanitare të veçanta.

Lartësia e katit në ambientet e banimit ndërtohej 3-3.5 m ndërsa quri kishte një lartësi kati më të ulët, mbasi mbulesa e tij ishte vazhdimi i flegrës së çatisë pa thyerje nga ana e pasme e banesës.

Ndriçimi natyral i ambienteve të banimit bëhej nëpërmjet dritareve që zakonisht liheshin nga dy për çdo ambient nga ana e hajatit. Dritaret fillimisht nuk kanë pasur kanate me xhama, për sigurimin e banesës atyre i ndërtoheshin kapakë prej druri që mbylleshin nga brenda.

Quri ndriçohej vetëm me anën e baxhave të rrafshta që liheshin në vazhdimin e pjerrësisë së flegrës së çatisë.

Hajati është një element dallues në kompozimin arkitektonik të banesës kavajase. Ai përveç funksioni të rëndësishëm që kryente i ka dhënë tiparet karakteristike pamjes së jashtme të banesës. Në krahasim me banesën elbasanase me hajat, banesa e Kavajës e të njëjtit tip dallon së pari sepse ajo ka një ngritje nga toka relativisht të vogël, dhe së dyti, hajati për



Fig. 7

DO NOT COPY

gjithësisht nuk është i organizuar si në banesën elbasanase.[18]

Hajati kryen funksionin e mbrojtjes së banesës në hyrjen e saj nga agjentët atmosferikë, lidh të gjithë ambientet e banesës të cilët komunikojnë direkt me atë dhe shërben si vend pune dhe pushimi (fig. 5). Duke qënë se klima e Kavajës është e butë mesdhetare, banori mund të qëndrojë jashtë në ambiente të hapura 4-5 muaj në vit. Për këtë arsye përgjithësisht hajati me banesën kavajase orientohej nga veriu. Një orientim i tillë kishte për qëllim të krijonte në hajat një ambient të freskët e të këndshëm, i cili në periudhën e verës kryente funksionin e ndejtjes, ngrënies, pritjeve dhe shpesh herë dhe të fjetjes. Sipërfaqja e konsiderueshme e tij me thellësi 3,5-4 m dhe me gjatësi sa e gjithë banesa bënte të mundur të kryheshin lirisht të gjitha këto funksione. Nëpërmjet hajatit kjo lloj banese është lidhur mirë organikisht me natyrën, me oborrin, të cilët së bashku qëndrojnë në unitet me njera tjetrën.

Krahas banesës me dy dhoma banimi në Kavajë kanë qënë ndërtuar dhe banesa me tre, katër dhoma si dhe banesa të përngjitura për dy familje (fig. 5). E parë kjo nga pikëpamja e kompozimit planimetriko-volumor, banesa kavajase e tipit me hajat u zhvillua në drejtimin horizontal. Pra kjo është një dukuri e përhapur në Kavajë ku ambientet e reja shtohen përbri banesës fillestare duke krijuar kështu një vëllim tepër të shtrirë në drejtim horizontal të ambienteve të banimit të vendosura radhazi dhe të lidhura gjithnjë përpara me hajatin.

Muret mbajtës të banesës përdhese me hajat të Kavajës njëlloj si të Tiranës, Elbasanit e Peqinit[19] janë ndërtuar me trashësi 50-70 cm me qerpiç e llaç balte të lidhura me breza druri të vendosura në çdo 60-70 cm. Themelet dhe muret deri në lartësinë 50 cm nga kuota e tokës natyrale janë ndërtuar me gurë kave të lidhura me llaç balte.

Në Kavajë përveç banesës përdhese tradicionale me hajat ka qënë ndërtuar edhe banesa me dy kate nga shtresat e pasura të qytetit. Për këtë njoftimet e para i jep Çelebiu më 1670.

Kjo dukuri në shoqërinë me klasa është e pashmangëshme. Urbanistika dhe arkitektura karakterin klasor në këtë rast e shprehin me ndërtimin e banesave të thjeshta përdhese të masës së varfër të qytetit nga njëra anë dhe me banesat lluksoze e të mëdha me dy kate e të pasurve nga ana tjetër.

Nga të dhënat gojore rezulton se në këtë qytet banesat me dy kate kanë qënë ndërtuar të tipit me çardak dhe të tipit kompakt të mbyllur me formë planimetrike drejtkëndëshe. Këto tipe banesash siç tregojnë dhe shembujt e ruajtur deri kohët e fundit kanë qënë të përhapura më shumë në lagjen «Sallbeg» dhe «Zguraj».

Një shembull i banesës me çardak në Kavajë është dhënë në fig. 6 i ndërtuar në rrugën e «Skolisë» sot rruga «Riza Sukaj» Nr. 7. Ndërtimi i saj daton vitin 1812. Më vonë rreth vitit 1840[20] e deri në vitin 1946 ajo është adoptuar dhe ka funksionuar si shkollë. Fillimisht si shkollë fetare, pastaj që nga viti 1913 si shkollë fillore në gjuhën shqipe. Në këtë shkollë për një kohë të gjatë kanë mësuar vetëm vajzat, prandaj ajo mori emrin shkolla e «gocave» (e vajzave). Banesa i përket tipit me çardak në qendër. Mendojmë se mbyllja e çardakut është bërë mbasi ka ndryshuar funksioni i saj nga banesë në shkollë.

Rruga e «Sarajt» sot rruga «Vangjel Thanasi» (fig. 7) në krahasim me rrugët e tjera të qytetit ka patur më shumë banesa me dy kate të cilat karakterizoheshin për zgjidhje më të arritura nga kompozimi urbanistik dhe arkitektonik. Kjo është edhe arsyeja e emërtimit të saj rruga e «Sarajt». Nga kjo rrugë kemi marrë si shembull banesën Nr. 152 e cila paraqet një volum kompakt me dy kate me formë planimetrike këndrejtë (fig. 8).[21]

Megjithëse formulimi i planimetrisë së përgjithëshme të qytetit të Kavajës nuk është bërë në bazë të një plani paraprakisht të studiuar, zhvillimi i ndërtimeve është bërë duke respektuar disa rregulla dhe kritere të caktuara në atë kohë për ndërtimet e reja. Me përjashtim të ndërtimeve të kultit karakteristikë e banesave dhe e objekteve të tjera të kësaj qendre është kompozimi horizontal. Në banesën përdhese kjo dukuri vihet re shumë qartë, ndërsa në banesat me dy kate si në tipin me çardak, ashtu edhe në atë me vëllim kompakt ky kompozim horizontal shprehet në atë që çdo kat përpunohet në vetvete deri diku i pavarur nga tjetri. Kështu çdo kat ka sistemin e vet të përpunimit të pamjes duke shprehur qartë funksionin e brendisë. Arkitektura e jashtme është në unitet me funksionin e ambienteve të godinës, në varësi të funksionit të ambienteve.

18. E. Riza, **Po aty,** f. 111.
19. E. Riza, **Po aty,** f. 119.
20. M. Kautsky, **Mittelislamische Statdt und Wirtschaftsbilder,** Në rev. «Österreichische monatsschrift für der Orient» 1916, Janar Nr. 1-6.
21. Skicat e paraqitura nga fig. 3 deri në fig. 8 janë vizatuar nga materiali fotografik që ndodhet në Muzeun Historik të qytetit të Kavajës.

DOCUTEX

DO NOT COPY



BANESA Nr. 152

NE RRUGEN "VANGJEL THANASI"

KAVAJE



Isuf SUKAJ

DO NOT COPY

RESUME

APERÇU SUR LE DEVELOPPEMENT DE L'URBANISME ET DE L'ARCHITECTURE DE KAVAJA (JUSQU'A LA FIN DU XIXe SIECLE)

Jusqu'à nos jours, l'origine de Kavaja, en tant que centre habité, est située vers le milieu du XVIe siècle, mais la découverte de quelques fragments architectoniques et quelques inscriptions la situent aux premiers siècles avant notre ère. Les données sur les sites archéologiques de Zig-Xhafe, Kanapare, Soanjoj et Qerret qui se trouvent entre un et quatre kilomètres loin de la ville actuelle de Kavaja, attestent l'existence de la civilisation dans cette zone à l'époque héllénique.

Trois inscriptions découvertes dans la ville de Kavaja ont été publiées par les archéologues français Heuzey et Daumet.

La zone où s'étend actuellement la ville de Kavaja et son arrondissement, depuis le premier siècle avant notre ère était inclue dans le territoire de Durrës, qui s'étendait jusqu'à l'endroit que César appelait Asparagun Dyrrhachinorum, une étape de la marche vers le sud du Shkumbin.[2])

Les données sumentinnées démontrent clairement qu'à Kavaja, où passait la via Egnatia, dont le pavé est conservé dans le quartier de Sallbeg, en face de la colline de Qenze, à 150--200 m de distance du ruisseau de Fose,[3]) se trouvait un vicus. En 1853, Han a découvert à Kavaja une stèle avec un bas-relief, représentant trois figures debout.

Heuzey-Daumet liaient l'existance de ce vicus au fait que cet endroit fournissait de marbre les romains.[4])

L'existance de ce centre même en 531, du moin jusqu'au 17 Septembre de cette année là, est certifiée par une autre inscription en grec.[5]) Il semble qu'au début à cet endroit il y avait une station routière d'échange et des repos pour les voyageurs, mansio, qui peu à peu, grâce au bonnes conditions pour le développement de l'agriculture, de l'élevage et du commerce se transforma en une localité toujours dépendante de Durrës.

La dénommination de Kavalje de ce centre habité, on la rencontre en 1431 dans les registres osmans du Sançagi Arvanid.[6]) En 1583 on la retrouve encore dans le registre du Sançagi d'Elbasan.[7]) Selon ce document Kavaja en cette année là avait 132 maisons.

Cette ville connut un développement à des rythmes relativement rapides particulièrement au XVIIe siècle. Dans le second quart de ce siècle, la formation du Pachalik de Kavaja[8]) créa des conditions favorables à un développement plus poussé de l'économie. En cette époque, a lieu l'accroissement de la couche d'artisans avec une puissante organisation corporative. L'accroissement impétueux des forces productives fournit une autre poussée à la construction de divers objets.

* * *

Au XVIIIe siècle lorsque commençait la décomposition de l'économie naturelle des villages, comme il ressort aussi des données de Çelebi,[10]) on s'aperçoit clairement que le développement économique avait déjà consolidé la position de la ville de Kavaja, en tant que centre de production et d'échange. Selon lui en 1670, Kavaja avait 4 quartiers d'habitation (Sharrë, Zguraj, Sallbeg et Bugaq) avec 400 habitations et 200 boutiques.

Une des conditions principales, qui détermina sa transformation de village en ville, était le besoin de la création d'un marché, comme centre important de production et d'échange des produits agricoles, d'élevage, d'artisanat et des fruits pour les contrées alentour. Le fait que l'économie agricole joua un rôle important dans la vie de cette ville, s'exprime clairement dans le caractère de son urbanisme, et même dans l'architecture de l'habitation.

Une autre période importante du développement économique et social et du développement de l'urbanisme et de l'architecture de la ville de Kavaja a été celle des XVIIIe-XIXe siècles. En cette période Kavaja continue d'être le centre administratif de la région. Durrës en raison de son mauvais climat marécageux était habité par un petit nombre d'hommes et Kavaja au moins à partir de l'année 1670 est le siège administratif de Durrës. Par la correspondance des consuls vénétiens à Durrës, Pietri Rosa et Georgio Cumano des années 1696-1707, on apprend que les juges de Durrës, les douaniers et les autres administrateurs, ainsi qu'eux-même, ils habitaient à Kavaja.[11])

L'impossibilité du rassemblement des habitants à Durrës et les bonnes conditions économiques, sociales et climatiques aidèrent toujours davantage Kavaja à devenir le chef-lieu administratif et économique et de pair avec cette fonction, elle commença à jouer aussi le rôle d'un port annexe de commerce principalement pour les céréales.[12]) Même en 1838, lorsque J. Muller visita Kavaja, on s'informe qu'elle était le centre de la région avec 300 habitants alors que sa régoin en comptait 28.000. Donc en cette période Kavaja est une ville importante

et développée, parce qu'elle remplissait on ne peut mieux les conditions de développement d'une ville, en tant que centre important urbain.

En acceptant la seconde moitié du XVIIe siècle comme limite approximative de l'étendue complète de la ville, on peut affirmer que la phisionomie urbaine de cette période est conservée jusqu'à nos jours avec de petits changements de forme, mais avec l'accroissement de la densité des constructions. Tandis que l'architecture des constructions en tant qu'élément plus changeable que l'urbanisme, a évolué avec le temps.

Le noyau de la composition de l'urbanisme de la ville de Kavaja était constitué par son bazar construit au centre et détaché des quartiers d'habitation. (photo 2). Ce bazar, à la période de la domination des rapports économiques féodaux, ainsi que plus tard avec le début des rapports capitalistes a été lié étroitement, avec le développement de la ville. Il était le centre artisanal et commercial de la ville et formait un ensemble architectonique urbain d'une étendue planimétrique longue de 230 m. Les boutiques dans chacune des rues servaient à un métier déterminé. Elles étaient composées de blocs horizontaux placés vis à vis l'un de l'autre.[13])

Les bâtiments d'habitation et les boutiques étaient construits avec un ou deux étages, mais dominait le bâtiment à un seul étage. (fig. 2, 3).

Dans la composition urbaine et architectonique, à part l'habitation, le bazar, les places et les auberges, parmi les constructions de cette ville, d'importance ont été aussi les temples du culte musulman, que nous connaissons actuellement par des données recueillies dans les inscriptions.[14]) Ces temples éparpillés aussi bien dans le centre que dans les quartiers de la ville étaient caractérisés de solutions architectoniques simples et n'ont pas eu d'influence sensible sur la structure urbaine des ensembles d'habitations, qui avaient bien avant gagné leur phisionomie.

Le développement économique et social plus poussé au XVIIIe siècle apporta de nouveaux phénomènes dans le domaine de l'urbanisme et de l'architecture. La population s'est accrue, le nombre d'habitants et le centre commença à prendre une phisionomie nouvelle grâce aux constructions variées qui commencèrent à s'élever. Ainsi en 1735-1736, au centre de la ville, dans son bazar fut construite la mosquée Kubelie, son portail extérieur, le jet d'eau et la médersa (fig. 2). A côté de la mosquée Kubelie, en 1817, on a construit la tour de l'horloge qui simultanément donne l'heure solaire et celle habituelle avec son mécanisme respectif (fig. 4).

L'habitation, dans l'ensemble des autres constructions de la ville, est l'élément fondamental de sa composition urbaine et architectonique. Les sources écrites des hommes d'études et de divers voyageurs sur cette période nous fournissent peu de données sur l'habitation traditionnelle de Kavaja. Dans une certaine mesure elles sont complétées par les recherches effectuées sur quelques cas anciens qu'on conserve encore dans cette ville.

Ces habitations témoignent que le type dominant dans cette ville, au cours des XVIIIe-XIXe siècles, a été l'habitation à simple rez-de-chaussée avec porche. Ce type d'habitation urbaine albanaise a été assez-répandu dans beaucoup de villes de l'Albanie Centrale, comme à Elbasan, à Tirana et à Peqin.

L'habitation à porche de Kavaja, comme le démontrent les cas conservés jusqu'à ces derniers temps, a gardé pour longtemps ses traits fondamentaux, se présentant sous différentes variantes. Le type d'habitation à porche a exercé une influence nette, tant par l'organisation planimétrique des volumes que par la composition volumétrique et architectonique sur l'habitation «ouverte» rurale.

A Kavaja, à part l'habitation traditionelle à simple rez-de-chaussée avec porche a, été en usage aussi la construction d'habitations à deux étages parmi les couches riches de la ville. Sur cela, les premières informations sont données par Çelebi en 1670.

Ce phénomène dans la société à classes est inévitable. L'urbanisme et l'architecture, dans ce cas, expriment leur caractère de classe avec la construction d'habitations simples à rez-de-chaussée par les masses pauvres de la ville d'une part et avec les grandes habitations luxueuses à deux étages par les riches d'autre part.

Des données orales, il résulte que dans cette ville les habitations à deux étages ont été construites selon le type à tchardak et le type compact fermé de forme planimétrique rectangulaire. Ces types d'habitation, comme le démontrent aussi les cas conservés jusqu'aux derniers temps, ont été répandus le plus dans le quartier de «Sallbeg» et de «Zguraj».

Bien que la formulation de la planimétrie générale de la ville de Kavaja ait été faite sur la base d'un plan préliminairement étudié, le développement des constructions a été effectué en respectant certaines règles et critères déterminés en cette époque-là pour les nouvelles constructions. A l'exception des constructions de culte, la composition horizontale est la caractéristique des habitations et des autres objets de ce centre. Dans l'habitation à simple rez-de-chaussée, ce phénomène apparaît plus clairement, tandis que dans les habitations à deux étages, aussi bien dans le type à tchardak, que dans celui à volume compact, cette composition horizontale s'exprime en ce que chaque étage (dans une cerataine mesure) est élaboré à part, indépendamment de l'autre. Ainsi, chaque étage a son système d'élaboration de la vue, en exprimant clairement la fonction de l'intérieur. L'architecture extérieure se trouve en unité avec la fonction des volumes du bâtiment, en dépendance de la fonction des volumes.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

monumentet

Stilian ADHAMI

MBI URBANISTIKËN DHE ARKITEKTURËN E PAZARIT TË VJETËR TË PËRMETIT

Të dhëna të piota mbi themelimin e saktë të qytetit të Përmetit nuk ka. Duket se si vendbanim duhet t'i përkasi mesjetës së hershme; megjithatë nga disa materiale arkeologjike që janë zbuluar rastësisht gjatë hapjes së themeleve të shkollës së re unike në vitin 1948 dhe që i përkasin periudhës helenistike, mosha e këtij vendbanimi shtyhet më tej se mesjeta e hershme.[1] Sidoqoftë, në shek. XV, nëpër dokumentat e shkruara Përmeti del si qendër e një njësie administrative, që përfshinte një trevë të gjerë. Duke qënë si kaza më vete, gjatë sundimit turk Përmeti herë është lidhur me Korçën dhe herë me sanxhaqet e Gjirokastrës apo Vlorës. Në rrjedhën e kohës ka pasur ndryshime edhe përsa i përket juridiksionit të saj administrativ. Kështu, më 1840 Përmeti përfshinte 154 fshatra, më 1872 mbeti me 118 fshatra, kurse në 1938 vetëm me 104 fshatra, duke qënë një nga të gjashtë nënprefekturat e prefekturës së Gjirokastrës.[2]

Nga ana etnografike treva e Përmetit ndahet në 6 krahina: Rëza (me qendër Përmetin), Dangëllia (me qendër Frashërin), Shqeria (me qendër Kovaçishtin), Dëshnica (me qendër Këlcyrën), Cerja (me qendër Hotovën) dhe Malëshova (me qendër fshatin me të njëjtin emër).

Sipas të dhënave që japin regjistrat fiskale të vitit 1431-1432 dhe të fillimit të shek. XVI, Përmeti në vitin 1431 kishte 42 shtëpi, ndërsa Këlcyra numëronte 100, në fillim të shek. XVI numri i shtëpive të Përmetit arrinte në 260, në një kohë që Këlcyra shënonte rritje më të madhe, në 514 shtëpi.[3] Ndërkohë, në shek. XVI si Përmeti ashtu dhe Këlcyra figurojnë ndër qytetet e vogla të pajisura me pazare, dyqane, magazina dhe hane, dhe ku bëheshin edhe pazare të pasura javore me produkte të ndryshme të ekonomisë fshatare.[4] Një gjë e tillë del tërthorazi edhe nga një katalog që përmban shumën e të ardhurave nga qyteti i Përmetit më 1516-1518.

Kur më 1806 Përmetin e pati vizituar konsulli francez pranë Ali Pashë Tepelenës, Pukvili, qyteti i Përmetit numëronte 700 shtëpi. Në këtë kohë ai përfshinte 120 fshatra, ndërsa Dëshnica 35. Pak a shumë këtë madhësi të qytetit na japin për këtë periudhë edhe dy burime të tjera.[5] Por nuk mungojnë edhe burime që për periudhën e mëvonëshme të shekullit të kaluar japin edhe ndonjë shifër deri diku të pabesueshme. Kështu, sipas Aravantinoit Përmeti më 1856 numëronte 134 shtëpi, kurse në të njëjtën kohë Këlcyra kishte 86 shtëpi dhe Malëshova 156. Ka mundësi që për këtë të fundit shifra të jepet si krahinë.[6] Si-

1. Hasan Ceka, **Zbulimi i dy qendrave të reja antike në Shqipëri,** Bul. i Institutit të Shkencave, Seria shk. shoq. V. II, N. 2-3/1948, f. 71; Kristo Frashëri, **Mbi Parauejtë, banorët e lashtë të luginës së Vjosës së Sipërme,** (Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve, Tiranë 1969, f. 133-139).
2. **Përmeti gjatë Luftës Nacionalçlirimtare 1939-1944. I. (maket)** Tiranë 1970, f. 8.
3. H. Inalçik, **Encyclopaedia of Islam,** Leiden-London 1958, vol. I, f. 655.
4. Z. Shkodra, **Esnafët shqiptarë (shek. XV-XX),** Tiranë 1973, f. 35.
5. O. Daniel, **Choix de documents historiques et geographiques concernant l'Albanie,** v. II, f. 51; H. Holland, **Travels in the Ionian Isles, Albania, Thessaly, Macedonia ec. during the years 1812 and 1813,** London 1815.
6. P. Aravantinos, **Hronografia tis Epeiron,** Athinë 1856, f. 370-376.



Fig. 1



Fig. 2

DO NOT COPY

doqoftë të dhënat e këtij autori duhen marrë me shumë rezervë, sepse flasin për një rënie shumë të theksuar të popullatës së Përmetit, që nuk argumentohet historikisht dhe që bie në kundërshtim me një burim tjetër, sipas të cilit në vitet 1830-1840 Përmeti kishte 4800 banorë dhe 100 dyqane.[7] Në një kronikë të lënë në kodikun e Mitropolisë së Korçës më 1879, lexojmë këtë shënim për Përmetin: «Qyteti duket shumë i lashtë dhe tani përfshin 600 familje... ka rreth 3000 banorë».

Në vitet 80 të shekullit XIX Përmeti si rreth me 148 fshatra kishte 416 dyqane, 18 hane dhe 113 mullinj, pra paraqitet me një rrjet tregtar mjaft të rëndësishëm. Këto të dhëna janë tregues të qartë se, kapitali i vogël tregtar dhe zejtar në këtë kohë po gjallërohej në zonat e këtij rrethi ku dhjetra tregtarë të vegjël dhe zejtarë të profesioneve të ndryshme kishin hapur dhe po hapnin dyqanet dhe punishtet e tyre, në të cilat zhvillonin tregtinë dhe shërbimet e tjera në brendi të krahinave të thella fshatare.

Nga sa kuptohet në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar pazari i këtij qyteti ka shënuar një rritje të dukshme, sepse në fund të shekullit kishte arritur në 183 dyqane,[8] shifër kjo thuajse e barabartë me ato që jepen për dekadat e para të këtij shekulli. Kështu për periudhën 1900-1912 Përmeti kishte 190 dyqane,[9] kurse në vitin 1926 ka pasur 200 dyqane dhe 2718 banorë.[10] Këtë numër dyqanesh shohim edhe në vitin 1938, kur popullata vërtitej rreth 2800 banorë dhe dyqanet e zejtarëve dhe tregtarëve arrinin në 235. Pra mund të themi se pazari i vjetër i Përmetit në vitet 30 kishte pak a shumë të njëjtën fizionomi, trajtë e madhësi që ka pasur në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar, kur është përvijuar definitivisht formulimi urbanistiko-arkitektonik.

Kemi të bëjmë, pra me pazarin e një qyteti të vogël (fig. 1-2) që nga pikëpamja ekonomiko-shoqërore mund të karakterizohej si një qytet mikroborgjez, pa industri moderne. Pjesa më e madhe e popullsisë jetonte me zejtari, kopshtari e vreshtari. Në pazarin e Përmetit, përveç tregtarëve gjithëfarësh në vitet 30 prodhonin, tregtonin e shërbenin rreth 160 zejtarë të profesioneve të ndryshme. Këta zakonisht ishin pronarë punishtesh të vogla, një numër i vogël i tyre kishin nga një çirak dhe shumë rrallë nga dy çirakë e lart.[11] Madje masën dërmuese të popullsisë prodhuese në mbarë qytetet shqiptare që nga fundi i shek. XIX e përbënin zejtarët, të cilët kishin tradita të lashta në vendin tonë, por që për shkak të konkurencës së industrisë kapitaliste europiane, kishin filluar të ndienin pasojat rrënimtare të saj. Në pazarin e Përmetit gjendeshin mallra nga më të ndryshmet: prodhime zejtare vendase, artikuj bujqësorë e blegtoralë, por edhe mallra të importuara. Në ditët e pa-

7. Z. Shkodra, **Çështje të tregut shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare,** në «Studime historike» 2-1978, f. 66.
8. Z. Shkodra, **Esnafët shqiptarë...**, f. 338
9. Z. Shkodra, **Çështje të tregut shqiptar...**, f. 66
10. T. Selenica, **Shqipëria më 1927,** Tiranë 1928, f. 277-278.
11. A. Kotani, **Lëvizja Nacionalçlirimtare në rrethin e Përmetit,** (1939-1944), Tiranë 1969, f. 7.

zarit, për shkak të vërshimit me shumicë të mallrave çmimet e tyre ishin më të ulëta se ditët e tjera.

Nga një përshkrim që na ka lënë Thimi Mitkua e që mban datën 1884 del se në pazarin javor të Korçës shkonin për të blerë edhe nga rrethi i Përmetit.[12] Ra dyshim duhet të jetë fjala kryesisht për krahinën kufitare të Dangëllisë dhe për artikuj të caktuar, që nuk tregtoheshin në pazarin e Përmetit.

Sipas të dhënave gojore, mallrat e importuara (manifakturë, sende koloniale, kinkaleri etj.) tregtarët e Përmetit kryesisht i siguronin nga tregtarët grosistë të Durrësit, Vlorës, Gjirokastrës, Sarandës etj.

Për të krijuar një ide rreth veprimtarisë ekonomiko-shoqërore që zhvillohej në pazarin e Përmetit në dekadën e tretë dhe atë të katërt të këtij shekulli në bazë të njoftimeve të grumbulluara me anë anketash nga autorë të ndrysnëm,[13] si edhe nga ana e autorit të këtij shkrimi, po japim këtu poshtë një pasqyrë të njësive tregtare e zejtare me llojet e ndryshme të profesioneve: rreth 60 dyqane tregtie (tregtarë stofrash, bakenj, kinkaleri e sende të ndryshme koloniale, duhanshitës, pemëshitës, zarzavateshitës etj.) mbi 20 dyqane këpucarësh, opingarësh e mballomaxhinjsh, mbi 10 dyqane rrobaqepësish e xhokaxhinjsh, 10 kasapë, 8 furrtarë, 4 ëmbëltore, 9 kovaçë, 6 teneqexhinj, mbi 20 marangozë e tavanxhinj, 5 gjellëbërës, 10 berberë, 4 samarxhinj, 2 orëndreqës, 1 argjendar, 1 dyfekçi etj. Këtyre u duhen shtuar mbi 10 lokale të profesionistëve të lirë (2 farmacistë, 3 avokatë, 2 dentistë, 1 noter etj.) si edhe 2 hotele e 7 hane, 6 kafe e 2 pijetore. Nuk po përmendim këtu edhe një numër relativisht jo të vogël prodhuesish e punëtorësh, që ushtronin veprimtarinë e tyre në këtë qendër pa pasur lokale e punishte, si muratorët e sharrëxhinjtë, qymyrxhinjtë e gëlqerexhinjtë, etj. ose kategori të tjera punëtorësh pa front pune të përhershme si hamenj e karrocjerë, druvarë e argatë etj. Vlen të vihet në pah se kishte edhe tregtarë që shisnin rroba të qepura në dëm të zejtarëve, sikundër kishte dhe këpucarë e opingarë që prodhonin në seri për shitje këpucë e opinga. Vetëm shitja e kripës ka qënë monopol i një dyqani.

Treva e Përmetit në të kaluarën cilësohej si një vend bujqësor blegtoral i varfër dhe i prapambetur. Pjesa më e madhe dhe më pjellore e sipërfaqes së tokave të punueshme dhe e kullotave u përkiste pronarëve feudalë e çifligarë, laikë e fetarë. Një numër i mirë i kryefamiljarëve nga qyteti e fshati detyrohej të merrte rrugën e mërgimit. Ashtu si në mbarë vendin, edhe në trevën e Përmetit kriza ekonomike vazhdoi gjatë tërë periudhës së regjimit zogist, duke shkaktuar që ekonomia bujqësore e zejtare, jo vetëm të mos bënte hapa përpara, por këto të hynin në një gjendje hamullie.[14] Fshatarët dhe zejtarët synonin jo më të përmirësonin, por të paktën të shpëtonin ekonominë e tyre nga rrënimi i plotë. Meqenëse fshatarët ishin klientët kryesorë të tregut të Përmetit e të Këlcyrës, varfërimi i tyre ndikoi sidomos në rrënimin e zejtarëve të vegjël, të cilët e paksuan prodhimin ose u detyruan në disa raste edhe t'i mbyllnin punishtet e tyre. Me varfërimin e klientelës u ul edhe lëvizja tregtare, nga e cila pësuan sidomos tregtarët e vegjël. Nuk munguan raste që edhe firma jo të vogla tregtare të detyrohen të falimentojnë. Duke bërë një krahasim nga një dekadë në tjetrën përsa i përket zejtarëve që patën rënie të theksuar, mund të themi se në këtë drejtim pësojnë më shumë zejtaritë e opingarëve, xhokaxhinjve, lëkurëregjësve etj. Kjo është e pashkëputur nga faktorët e ndryshëm ekonomiko-shoqërorë.

Si për hapje në mëngjes apo për mbyllje të dyqaneve në mbrëmje as që kishte ndonjë orar të caktuar, vetëm në stinën e verës ishte vendosur nga Bashkia një farë orari për mbyllje në drekë (ora 12) dhe hapje pasdite rreth orës 15, por ky orar nuk zbatohej.

Për ndonjë shpallje ose lajmërim të popullatës nga ana e organeve shtetërore zakonisht përdorej tellalli, i cili në disa vende të caktuara jepte njoftimet me zë të lartë. Tellalli përdorej zakonisht edhe kur vinte koha e shitjes së të dhjetave në ankand, të cilat shteti ua jepte sipërmarrësve nga radhët e çifligarëve, tregtarëve etj. Po në sipërmarrje jepeshin edhe peshëmatja (oktrova), vjelja e taksave nga shitja e kafshëve (iltisapi), nga therja e bagëtive (pare gjaku) etj.

Në shqyrtimin e pazarit të vjetër të këtij qyteti kemi parasysh gjendjen e tij ashtu siç paraqitej deri në pragun e Çlirimit d.m.th. para djegjeve që pësoi nga pushtuesit fashistë e nazistë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ka të dhëna se ky pazar ka qënë rindërtuar aty nga gjysma e dytë e shekullit të kaluar, pasi

12. Z. Shkodra, **Çështje të tregut...**, f. 68.

13. Për gjendjen ekonomike shoqërore të Përmetit, si qytet e rreth në katër dekadat e para të këtij shekulli, shih hollësira në botimet: **Përmeti gjatë Luftës Nacionalçlirimtare 1939-1944** (maket për diskutim), Tiranë 1971, f. 59-69; A. Kotani, **Lëvizja Nacionalçlirimtare në rrethin e Përmetit (1939-1944)**, Tiranë 1969, f. 7-15; T. Selenica, **Shqipëria më 1927**, f. 304-305.

14. **Përmeti gjatë Luftës Nacionalçlirimtare...**, f. 50.

DO NOT COPY



Fig. 3

pazari i dikurshëm ishte djegur.[15] Me sa duket zjarri ka dhënë shkas për ritrajtimin tërësor të kompleksit të dyqaneve si nga ana urbanistike ashtu edhe ajo arkitektonike. Në të vërtetë si formulimi arkitektonik ashtu edhe teknika e ndërtimit e përdorur dëshmojnë për ndërtime të një kohe relativisht të vonë.

Dihet se tregjet e qyteteve shqiptare kanë pasur pak a shumë të njëjtën fizionomi me atë të qyteteve të tjerë ballkanikë orientalë, me dyqane të vegjël, përgjithësisht prej druri, me rrugë të ngushta e sheshe publike dhe ngandonjëherë edhe me ndonjë treg të hapur.[16] Të gjitha këto mund t'i vishen edhe pazarit të këtij qyteti, me ndonjë përjashtim për shkak të rindërtimit të tij. Mjaft analogji ky pazar ka pasur me atë të Korçës.[17] Pra kemi të bëjmë me një pazar të ndërtuar në truall të sheshtë, në parcela të rregullta në trajtë katërkëndëshi këndrejtë, ku dyqanet ngriheshin me dy vargje njëri përballë tjetrit dhe vendosur shpinë më shpinë, me konstruksione guri dhe vetëm ballet prej druri, me rrugë të drejta dhe pak a shumë të gjera për kohën. Mendojmë se skema urbanistike e këtij pazari, që përbënte një ansambël me vlerë arkitektonike-historike, paraqiste disa veçori që vërehen në planimetrinë (TAB. I), hyrjet pë pazar dhe lidhjet me lagjet e qytetit, trajtimin e dy qaneve nëpër blloqe etj. Nga ana tipologjike nu mund të themi se ky pazar hynte në grupin e atyr më të lashtë të vendit tonë, si pazari i Krujës etj. Me gjithatë, për nga madhësia kemi të bëjmë me nj pazar jo të vogël, në krahasim me qytete të tjerë t sërës së Përmetit, me një numër të mirë ndërtimesh të llojeve të ndryshme me funksione që drejtpërdrejt apo tërthorazi lidheshin me veprimtarinë e gjerë eko nomike që zhvillohej në pazar.

Ngritja rishtaz e këtij pazari bëhej në një koh kur qytetet shqiptare, bashkë me to në një shkall më të ulët edhe i Përmetit, kishin njohur një far zhvillimi ekonomik në kuadrin e ekonomisë feudal dhe kur, me shthurrjen e sistemit mesjetar të esna feve, kishte filluar shfaqja e marrëdhënieve kapitaliste Krahas nivelit të zhvillimit ekonomik të qytetit rrite edhe roli i zonës ekonomike të tij, pazarit, kundrej qendrave fshatare përreth si në sferën e prodhimi zejtar ashtu edhe në atë të shkëmbimit. Sigurisht j në shkallën e pazareve të mëdhenj të qyteteve krye sore të vendit, por mund të themi se edhe në kët pazar ndihej një farë gjallërimi kryesisht nga pun e zejtarëve që prodhonin thuajse gjithshka që i ne vojtej fshatarit dhe qytetarit.

Ashtu si mbarë qendrat zejtaro-tregtare të qy teteve shqiptare të kohës, edhe pazari i vjetër i Për metit përbënte një njësi më vete të spikatur qartë ku zhvillohej e gjithë veprimtaria e prodhimit dh shkëmbimit. Në raport me lagjet e banuara të qyteti pazari nuk ishte i shkëputur prej tyre, por shtrihe në periferi nga ana lindore dhe jugore e tyre. Kësht që qendra e banuar shtrihej në vazhdim të tij ng ana veriore e perëndimore, pak a shumë ashtu si qëndron edhe sot. Si çdo pazar edhe ky, në vazhdë e kohës ruante tiparet e veta urbanistike. Ka shum mundësi që, duke u nisur nga pozicioni i qytetit, t njëjtin formulim do të ketë pasur pazari lidhur m qytetin edhe në kohë më të hershme. Në këtë mënyr qendra e banuar ka qëndruar pak a shumë e qet larg trafikut sado të kufizuar dhe zhurmës tipike pë pazaret e kohës.

Konstruksionet e të gjithë dyqaneve kanë qën prej guri, ndërsa çatitë prej druri, qenë mbuluar m pllloça (fig. 3-4) guri. Pjesa më e madhe e dyqaneve kanë qënë dykatëshe, por ka pasur edhe njëkatësh dhe rrallë trekatëshe. Zakonisht katet e dytë shër

15. Sipas hulumtuesit Dhosi Liperi.
16. P. Pepo, **Les materiaux des cartulaires et leur importance pour l'histoire du pays,** «Studia albanica» nr. 2, 1977, f. 164.
17. E. Riza, **Arkitektura e ansambleve të pazareve në qytetet e shekujve XVIII-XIX,** në «Tradita në arkitekturë dhe art», Tiranë 1980, f. 21.



Fig. 4

benin për depozitim mallrash të tregtarëve, ndërsa për zejtarët që nuk ishin banorë të qytetit, por nga fshatrat përreth, përdoreshin dhe për fjetje. Shumë nga dyqanet dy e trekatëshe kishin edhe bodrume që veçanërisht tregtarët i përdornin për depozitë mallrash. Për t'i siguruar mallrat nga zjarret kishte tregtarë që mbanin edhe depo të nëndheshme me qemer. Ndërlidhja me katet e sipërme dhe bodrumet sigurohej nga përbrenda katit përdhe. Në shumicë për këto ndërtime janë përdorur gurë lumi, ndërsa gurët e mirë për fasadat, qoshet, pragjet e dyerve dhe dritareve fillimisht siguroheshin në zonën përtej teqesë dhe më vonë ustallarët kishin hapur një gurore përbri xhadesë që shkonte për Korçë, në afërsi të fshatit Lëshicë.

Më të shumtit e dyqaneve mbylleshin me kanata prej druri që ishin më disa kanata. Kur këto mbylleshin u fiksohej një binar në qoshet e të cilit kishte dy vrima, ku vendoseshin gozhda të mëdha kovaçi si shula hekuri; duke u kapur këto nga brenda dyqani nuk mund të hapej dot nga jashtë. Një pjesë e dyqaneve ishin me qepena të varianteve të ndryshme, prej druri e metalike; kurse shumë pak dyqane të ndërtuara vonë, qenë me role metalike e portë të hekurt.

Thuajse të gjitha qoshet e blloqeve të dyqaneve ishin si të prera për t'u vendosur aty dera e hyrjes së dyqanit. Kjo më tepër për shfrytëzim të vendit, por edhe për të mos penguar kalimtarët. Në pamjen e jashtme dyqanet binin në sy për gurin e përpunuar.



Fig. 5

DO NOT COPY

Pavarësisht nga trajtimi unik i tërë ansamblit të pazarit, nuk mungonte dhe një farë larmie që shkaktonin veçoritë e trajtimit të çdo dyqani.

Tërë dyqanet kishin përpara nga një trotuar rreth 1 m të gjerë të shtruar me pllaka të mëdha guri, që në fund puthiteshin nga një kornizë guri 10-12 cm. Thuajse krejt tregu ka pasur strehë prej llamarine të vendosura në lartësinë e katit të parë, të mbërthyera mirë mbi një skelet dërrase dhe të mbajtura me shufra hekuri. Këto strehë, me gjerësi thuajse të trotuarit, kishin një farë pjerrësie për të rënë ujët jashtë trotuarit, duke i mbrojtur pazarakët si dhe vitrinat nga agjentët atmosferikë.

Me përjashtim të dyqaneve ku shiteshin fruta e perime, të cilat i ekspozonin mallrat edhe nëpër trotuare; në dyqanet e tjerë të tregtarëve e zejtarëve përdoreshin për këtë qëllim vitrina të brendshme. Ishin të rrallë rastet kur zejtarët i ekspozonin jashtë vitrinave prodhimet e tyre (këpucë, opinga, konfeksione etj.).

Të gjitha rrugët e pazarit kanë qënë shtruar me kalldrëm. Ndryshe nga kalldrëmet e rrugëve të qytetit, këta ishin shtruar më tepër me gurë lumi. Gjerësia e rrugëve duke përfshirë dhe trotuaret, arrinte rreth 5 m; bënte përjashtim rruga kryesore e hyrjes për në qytet që ishte e gjerë rreth 8-9 m. Pak a shumë të njëjtat përmasa ka pasur edhe rruga që zbriste nga çezma deri në breg të lumit nga ana lindore e pazarit.

Ndërsa në sheshet e pazareve të hapura vijat e ujit për pastrim e freskim kalonin anëve, në të gjitha rrugët e pazarit ato kalonin në mes tyre. Duke pasur rrugët një pjerrësi fare të vogël të gjitha ujërat më në fund derdheshin në lumë, duke kaluar kryesisht nga thertorja pranë qoshkut. Ishte bërë zakon që sidomos në verë, ujërat që zbrisnin nga «Gurra e madhe» (burim i madh ujërash që rridhnin nga mali i Dhëmbelit), pasi përshkonin e ushqenin disa mullinj me radhë, lëshoheshin pjesërisht për vaditje të kopshteve dhe pjesërisht çdo pasdite kalonin nëpër lagjet e qytetit dhe zbritnin në pazar nëpërmjet tri vijave të ndryshme. Çdo dyqanxhi e bënte vetë pastrimin përpara dyqanit ose me anë të çirakut.

Si në gjithë qytetin ashtu edhe në treg kanalizimet mungonin. Tregu furnizohej me ujë të pijshëm vetëm nga një çezmë në qendër të tij.

Dyqanet e këtij pazari kanë qënë të përziera dhe jo sipas zejeve. Bënin përjashtim kovaçët dhe teneqexhinjtë që kanë qënë vendosur radhazi në dy blloqe të veçantë.

Në Përmet spikaste edhe më tepër veçoria që, shumë zejtarëve, përveç mbiemrit të tyre të vërtetë populli u kishte ngjitur sipas profesioneve llagape të tjera; me këto emërtime ata njiheshin më tepër në popull.[18]

Si në tërë qytetin edhe ndriçimi i zbehtë i pazarit bëhej me fenerë me vajguri, të vendosur shumë rrallë, që ndizeshin prej të njëjtit person shëtitës; aty nga vitet 30 u arrit të vihej vetëm një petromaks në qendër të pazarit.

Pazari ruhej natën me anën e dy rojeve (pasvanë) që caktoheshin nga Bashkia dhe paguheshin nga vetë dyqanxhinjtë. Për shuarjen e zjarreve disponohej vetëm një tullumbë që punohej me dorë dhe që se kryente shërbimin e kërkuar.

Në sistemin e pazareve bënin pjesë edhe sheshet e vogla për tregtimin e produkteve të ekonomisë fshatare, por edhe qytetare. Në Përmet, ka pasur këta tre pazare të hapura, ku tregtohej kryesisht një herë në javë, ditën e shtunë, që ishte dita e pazarit:

a. **Pazari i drithit,** që zhvillohej tek sheshi i madh në mes të pazarit, i cili kishte përmasa afërsisht 60 m gjatësi dhe 30 m gjerësi. Në këtë shesh sillnin drithë për shitje kryesisht prodhuesit e Dëshnicës, Mallakastrës etj. veçanërisht në kohën e korrjeve kur vërehej një farë gjallërimi dhe tregu mbushej me pazarakë. Përveç drithrave (grurë, misër, thekër etj.) këtu shiteshin edhe artikuj të tjerë bujqësorë e blegtoralë, si vaj, lesh, vezë, pula, ndonjë punim leshi (çorape, fanella etj.).

Si fuqi blerëse, veç qytetarëve të Përmetit, qenë edhe fshatarët që zbrisnin nga fshatrat përreth, sidomos ato malore, që nuk prodhonin drithin e që mbaheshin më tepër me kurbete.

Në mes të sheshit të këtij pazari ka qënë një kullë e lartë ku ishte vendosur ora me këmbanë. Ka të dhëna që këtë kullë e ka prishur ushtria greke në Prill 1913, ndërsa këmbana u çua në kishën e Shën Mërisë së Pazarit, me që ishte këmbanë kishe.[19]

b. **Pazari i bulmetrave,** që zhvillohej në një shesh më të vogël aty pranë dhe që nga pema që kishte në mes pati marrë emrin «sheshi te mani». Këtu përveç bulmetrave (djathë, gjalpë, gjizë) tregtoheshin edhe zarzavate, por dhe pula e vezë.

c. **Pazari i gjësë së gjallë,** që zhvillohej në sheshin e quajtur «Qoshku». Këtë emër ky vend e ka

18. Kështu thirreshin: Stavro Opingari, Spiro Kundurai (këpucari), Miti Duhanxhiu, Çome Kasapi, Andon Berberi, Vangjel Samarxhiu, Stiri Kafexhiu, Naumi i fenerëve (ai që ndizte fenerët e qytetit dhe pazarit), Vangjeli i gurrave (ai që ndreqte çezmat) etj.

19. Kujtime nga plaku 80 vjeçar Taqi Kristo.

DOKUMENT COPY

marrë nga pozicioni i vet, që hapej si një farë ballkoni mbi bregun e Vjosës (fig. 5). Në këtë shesh shiteshin e bliheshin kafshë të ngarkesës, qe e lopë dhe bagëti të imta.

Është për t'u shënuaar se në të tre këta pazarë gjatë ditëve të tjera të javës thuajse nuk kishte fare lëvizje. Ata gjallëroheshin në ditët e pazarit javor që shënonte pikën kulmore të lëvizjes ekonomike në jetën qytetare. Përveç elementit fshatar dhe matrapazëve të interesuar për çdo lloj tregtie dhe spekullimi fitimprurës, në këtë ditë vinin edhe gra fshatare që shisnin punime dore, sidomos prej leshi dhe produkte të tjera të «industrisë shtëpiake».

Pazari i Përmetit, si qendër ekonomike, tregtie e zejtarie, e një rrethi me mbi 100 fshatra, të cilët shtriheshin në një truall të gjerë që arrinte në kufi të Kolonjës e Skraparit, Tepelenës e Gjirokastrës, frekuentohej nga pazarakë të shumtë, të largët e të afërt. Shumë blerës e shitës, që banonin larg qytetit vinin në pazar që të premten mbrëma për të bërë pazarin javor. Prandaj rritja e vëllimit të shkëmbimit të mallrave, kërkesat përherë në rritje të fshatarsisë për prodhime artizanati, vegla pune etj, i dhanë shkas dhe bënë të domosdoshëm ndërtimin e mjaft haneve për të siguruar kalimin e natës si për udhëtarët ashtu dhe për kafshët e ngarkesës. Duke filluar që nga hyrja e pazarit dhe të shpërndarë nëpër pazar në këtë qytet ishin ndërtuar 7 hane përveç dy hoteleve të ndërtuar nga fillimi i këtij shekulli. Hanet në përgjithësi kanë qënë dykatësh, në katin përdhes grazhdet e kafshëve dhe sipër dhomat e fjetjes. Hanet kryesore kishin një kompozim të tillë: brenda një konturi të mbyllur shtrihej një oborr i gjerë; katin e sipërm, që merrte trajtën e një U-je, e rrethonte një çardak i ngushtë me funksion ndërlidhës. Në këta hane, që në të dy anët e hyrjes së oborrit kishte dyqane, nuk mungonte edhe nallbani për mbathjen e kafshëve.[20]

Nga një dekadë në tjetrën të këtij shekulli u shënua një rënie e haneve, numri i të cilëve filloi të kufizohej. Pakësimi i tyre shpjegohet me një sërë faktorësh: me fuqizimin e pazarit të Këlcyrës, që bënte të panevojshme ardhjen e shumë pazarakëve në Përmet, ndërtimin e hoteleve në qytet dhe krijimin e disa dyqaneve nëpër fshatra e sidomos në Frashër, që filloi të rigjallërohej pas djegjes që pësoi gjatë Luftës së Parë Botërore. Një arsye tjetër ka qënë edhe fakti që ndonjë bakall e dyqanxhi tjetër kishte sajuar sadopak vend për mbajtjen e kafshëve të klientëve të



Fig. 6

tyre, që më tepër përbëheshin nga fshatrat më të afërta të Rrëzës, Cerjes, Shqerisë. Por, mbi të gjitha, në rënien e përgjithshme të tregut të qytetit ndikuan krizat ekonomike që pllakosën vendin gjatë viteve 30, varfërimi, papunësia dhe gjendja e mjeruar e popullatës gjatë regjimit antipopullor të Zogut, si edhe në një shkallë të kufizuar ajo farë konkurrence që i bëhej sidomos në drithra e prodhime të tjera bujqësore nga pazari në rritje i Këlcyrës, për të cilin vlen të ndalemi.

Këlcyra ka qënë dhe vazhdon të jetë qendra e dytë tregtare e rrethit të Përmetit. Mund të thuhet se ajo ka qënë pronë e bejlerëve të Këlcyrës për deri sa nga afro 60 dyqanet që kishte 40 ishin pronë e asaj familjeje çifligare. Kjo e shtrinte shfrytëzimin e saj jo vetëm mbi bujqit çifçinj me anën e tokës, por edhe mbi fshatarët e vegjël dhe të mesëm me anën e tregut.[21] Në fakt në vitet 90 të shek. XIX këta bejlerë u bënë shumë agresivë. Me përkrahjen e valiut të Janinës, Hifzi Pashës, ata organizuan në kurriz të fshatarëve të Dëshnicës një valë të pashembullt grabitjesh në formë taksash e haraçesh arbitrare, pasi kishin kthyer me kohë tregun e Këlcyrës në pronë personale, duke vjelur nga fshatarët, si në kohën e sundimit otoman, një taksë të posaçme sa herë vinin në tregun e Këlcyrës, duke grumbulluar kontribute arbitrare prej tyre etj.[22]

20. Mbi bazën e kujtimeve personale të autorit dhe të të dhënave të vetë pronarit kemi mundur të bëjmë rikonstruksionin hipotetik të njërit nga hanet kryesore, planimetria e të cilit shoqëron këtë studim (TAB. I).
21. A. Kotani, **Lëvizja Nacionalçlirimtare...**, f. 11.
22. **Përmeti gjatë Luftës Nacionalçlirimtare...** I, f. 19, 40.

Tregjet e Këlcyrës dhe të Frashërit kanë qënë të njohur dhe në shekullin e kaluar sepse për ta flitet nga një sërë autorësh që nga Hani e deri te Karmici e Thesproti-Psalidha. Në rrjetin e dyqaneve dhe popullsisë së qendrave të reja urbane në vitet 1900--1912 figurojnë edhe Këlcyra me 63 dyqane dhe Frashëri me 20 dyqane.[23] Sipas rilindasit tonë Sami Frashërit «më 1890 Frashëri kishte një treg me 20 dyqane dhe një han. Aty çdo të martë bëhej një pazar i pasur që vizitohej nga popullsia e 28 fshatrave të Dangëllisë. Edhe Këlcyra, fshati i madh i krahinës së Dëshnicës kishte në këtë kohë 63 dyqane dhe 8 hane dhe një treg javor.[24]

Në sistemin e pazarit të Përmetit duhen përfshirë edhe 11 mullinjtë, që ndodheshin në anën e sipërme të qytetit, mbi lagjet e banuara nga ana perëndimore. Këta mullinj që punonin për nevojat e popullsisë qytetare e fshatare e që ushqeheshin nga ujët e shumtë të «Gurrës së Madhe», u shkatërruan nga përmbytjet e shkaktuara prej Përroit të Bardhë. Për disa vjet funksionoi edhe një fabrikë mielli, por shpejt ajo u kthye në punishte lëkurësh.

Si ndërtuesa të pazarit të vjetër të Përmetit, të këtij ansambli urbanistiko-arkitektonik dikur të hijshëm, kanë qënë muratorë të ardhur nga krahinat e Kolonjës, Vakëfeve, Oparit, dhe Dangëllisë (Koblara) që pjesërisht kanë qënë vendosur familjarisht në Përmet ose në fshatrat e afërta. Mundet në vrullin e ndërtimeve të kenë ardhur dhe muratorë sezonalë, sepse dihet që muratorë vakëfllinj (sidomos nga fshati Trebickë) që në shekullin e kaluar vinin në këto anë me punë sezonale, ndërsa me familje disa u shpërngulën në Përmet pas djegjeve të viteve të Luftës së Parë Botërore.[25] Vetë Përmeti nuk ka qënë i përmendur për muratorë, ndërsa për punime zdrukthtarie dalloheshin tavanxhinjtë e Përmetit, një pjesë e të cilëve na rezulton se kryenin punime të tilla edhe nëpër fshatrat e Skraparit e gjetkë.[26] Nënkuptohet, pra, që punimet e zdrukthtarisë në dyqanet e pazarit të Përmetit, janë bërë nga vetë vendasit.

Një pjesë e dyqaneve kanë qënë në pronësi të vetë tregtarëve ose zejtarëve, ndërsa shumica dërmuese e zejtarëve i mbanin me qira prej pronarëve të ndryshëm dhe komuniteteve fetare.

Gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare qyteti i Përmetit dhe pazari i tij pësuan katër valë djegjesh me radhë. Pushtuesit fashistë italianë dhe nazistët gjermanë, përveç masakrave e dëmeve të tjera që i shkaktonin popullatës, dogjën me gjithë plaçka thuajse të gjitha shtëpitë e qytetit dhe mbarë tregun me gjithë mallra të rreth 200 dyqaneve, pasi plaçkitën sendet më me vlerë.[27] Që me djegjen e parë, që ndodhi më 6 Korrik 1943 u dogjën rreth 177 dyqane, pra pothuajse i gjithë pazari.[28] Ushtarët fashistë italianë me plaçkën e grabitur filluan të bënin tregti pranë kazermave të tyre.[29] Një ditë më parë, më 5 Korrik, një autokolonë me fashistë italianë, duke depërtuar nëpër Këlcyrë kishte djegur edhe tregun e atjeshëm me 60 dyqane.

Me tri djegjet e tjera që kryen nazistët gjermanë në Përmet, më 9 Tetor 1943, më 28 Janar 1944 dhe më 11 Qershor 1944 u plotësua vepra barbare e filluar nga fashistët italianë, duke u bërë shkrumb e hi tërë qyteti me gjithë pazar.

Një pjesë e vogël e dyqaneve, u riparuan qysh gjatë luftës dhe vitet e para pas çlirimit për t'u përdorur si dyqane, por me kalimin e kohës për shkak të ndërtimeve të reja që u bënë mbi këtë truall, humbi çdo gjurmë e këtij pazari.[30]

DO NOT COPY

23. **Z. Shkodra, Çështje të tregut shqiptar...**, f. 66.
24. S. Frashëri **Kamusilaalam,** vëll. V, Istambul 1881, 1898, f. 3693, 3881..
25. Informacion gojor nga muratori i vjetër Lili Ndreko Dhimitri, i dt. 1908.
26. Të dhëna nxjerrë nga disa historikë të fshatrave të Skraparit.
27. A. Kotani, **Lëvizja nacionalçlirimtare...**, f. 10, 169.
28. Buletini i Lajmeve 6 dhe 7 Korrik 1943. A.Q.P., shkresa nr. extra, dt. 13.VII.1943 e Nënprefekturës së Përmetit mbi djegjen e Përmetit drejtuar Prefekturës së Gjirokastrës, AQH i RPSSH.
29. A. Kristo, **Një sy mbi Përmetin e zhuritur, «Bashkimi»** N. 56, dt. 25.II.1945.
30. Sot prej këtij pazari ka ngelur vetëm një dyqan, por dhe ky është ndërtim i dekadave të para të këtij shekulli (fig. 3).

TAB. I

DO NOT COPY



PAZARI I VJETER - Përmet

PLANIMETRI E GJENDJES PARA DJEGJES SE 6 Korrikut 1943

(Rikonstruksion hipotetik)



HANI I MYFTARAJT - Përmet

(Rikonstruksion hipotetik)

Stilian ADHAMI

DO NOT COPY

SUR L'URBANISME ET L'ARCHITECTURE DU BAZAR DE PËRMET

Selon les données fournies par les registres fiscaux des années 1431-1432 et du début du XVIe siècle, Përmet en 1431 avait 42 maisons, tandis qu'au début du XVIe siècle 260. Cependant, au XVIe siècle, Përmet figure parmis les petites villes pourvues de bazar, où avaient lieux des marchés hebdomadaires riches en divers produits de l'économie paysanne.

Lorsqu'en 1806, Përmet fut visité par Pouqueville, consul français auprès d'Ali Pacha Tépéléna, il comptait 700 maisons. Dans une chronique écrite dans le codicille de la métropole de Korça, en 1879, on lit la note suivante sur Përmet: «La ville semble très ancienne et actuellement elle inclut 600 familles... elle a environ 3000 habitants».

Dans les années 80 du XIXe siècle, Përmet en tant que région avec 148 villages, avait 416 boutiques, 18 auberges et 113 moulins. Ces données démontrent clairement que le petit capital commercial et artisanal, en cette époque, s'animait dans les zones de cette région.

A ce qu'on comprend, dans la seconde moitié du siècle passé, le bazar de cette ville a enregistré une croissance évidente, parce que à la fin du siècle, il avait 183 boutiques, chiffre presque égal à ceux donnés par les premières décennies de ce siècle. Ainsi, au cours de la période inclue entre 1900-1912, Përmet avait 190 boutiques, tandis qu'en 1926, il a eu 200 boutiques et 2718 habitants. C'est ce nombre de boutiques qu'on retrouve en 1938. Nous avons donc à faire avec le bazar d'une petite ville, qui, du point de vue économique et social, pourrait être caractérisée comme une ville petit-bourgoise, sans industrie moderne, La plus grande partie de la population s'occupait d'artisanat, de jardinage et de viticulture.

Pour avoir une idée sur l'activité économique et sociale qui se déployait dans le bazar de Përmet, au cours de la troisième et quatrième décennie de ce siècle, sur la base des informations recueillies, au moyen d'enquêtes effectuées par de differents auteurs, ainsi que par l'auteur de cet écrit, nous allons reproduire plus bas un tableau des unités commerciales et artisanales avec les différentes sortes de métiers: environ 60 boutiques commerciales (commerçants d'étoffes, épiciers, quincailleries et divers articles coloniaux, vendeur de tabac, vendeurs de fruits, vendeurs de légumes etc.) plus de 20 boutiques de cordonniers, plus de 10 boutiques de tailleurs et de Xhokaxhinj,* 10 bouchers, 8 fours, 4 pâtisseries, 9 forgerons, 6 ferblantiers, plus de 20 menuisiers et de vitriers, 5 restaurants, 10 coiffeurs, 4 fabricants et marchands de bâts, 2 orlogers, 1 orfèvre, 1 armurier etc. Il convient d'ajouter à ce-ci 10 locaux des proffessions libres (2 pharmaciens, 3 avocats, 2 dentistes, 1 notère etc.), ainsi que 2 hôtels et 7 auberges, 6 cafés et 2 débits de boissons.

Dans cet examen du vieux bazar de cette ville, on tient en considération l'état dans lequel il se présentait jusqu'à la veille été reconstruit vers la seconde moitié du siècle dernier, car le envahisseurs fascistes et nazis, qu'il subit au cours de la Seconde Guerre Mondiale. Il y est des données que ce bazar a été reconstruit vers la seconde moitié du siècle dernier, car le bazar de jadis avait été incendié. A ce qu'il paraît, l'incendie a été la cause du traitement nouveau intégral de l'ensemble des boutiques, tant du point de vue de l'urbanisme que de celui architectonique. En vérité, la formulation architectonique aussi bien que la technique de construction appliquée témoignent de constructions datant d'une époque relativement tardive.

Ce bazar a eu pas mal d'analogies avec celui de Korça. On a donc à faire à un bazar construit sur terrain plat, sur des parcelles régulières en forme de quadrilatère rectangle, où les boutiques s'élevaient sur deux rangées l'une en face de l'autre et placées dos contre dos, avec des constructions de pierre et les fronts seulement de bois, avec des rues droites et plus ou moins larges pour l'époque. Nous pensons que le schéma urbain de ce bazar, qui constituait un ensemble de valeur architectonique et historique, représentait certaines particularités, qu'on remarque dans la planimétrie, le entrées donnant accès au bazar, et le lien avec les quartiers de la ville, le traitement des boutiques en bloc etc. Du point de vue typologique, on ne peut dire que ce bazar entre dans le groupe de ceux des plus anciens de notre pays, comme le bazar de Kruja etc.

Par rapport aux quartiers habités de la ville, le bazar n'en était pas détaché, mais il s'étendait dans leur périphérie dans le côté Est et Sud. Ainsi, le centre habité, s'étendait à son opposé, dans le côté Nord et Ouest, plus ou moins tel qu'il est de nos jours.

Les constructions de toutes les boutiques ont été de pierre, tandis que les toits de bois étaient couverts de plaques de pierre (fig. 4,5). La plupart des boutiques avaient deux étages,

* tailleurs des étoffes de laine brute.

Provisoire

mais il y en a eu à simple rez-de-chaussées et rarement à trois étages. D'habitude le second étage servait à déposer les marchandises à vendre, tendis que les artisans, qui n'étaient pas de la ville, mais des villages alentour, s'en servait pour y dormir. Nombre des boutiques à deux et à trois étages avaient aussi des caves, que les commerçants en particulier, utilisaient de dépôts pour les marchandises. Afin d'assurer les marchandises contre le feu, il y avait des commerçants qui possédaient aussi des dépôts souterrains à voûte. La communication avec les étages supérieurs et avec les caves s'assurait de l'intérieur du rez-de-chaussée. Dans ces constructions ont été utilisées en grande quantité des pierres du lit des rivières, tandis que les bonnes pierres des façades, des angles, des seuils de portes et des fenêtres, initialement étaient assurées dans la zone au-delà du monastère de derviches et plus tard les maçons ont ouvert une carrière à côté de la route, allant à Korça, à proximité du village de Lëshica. La plupart des boutiques se fermaient de battants en bois, faits de quelques pièces pliantes. Lorsqu'on fermait ces battants, on leur fixait une poutrelle, aux extrémités de laquelle il y avait deux trous, où l'on introduisait de grands clous de forgeron comme des verrous de fer, en les coinçant de l'intérieur, la boutique ne pouvait s'ouvrir de l'extérieur. Une partie des boutiques avaient des stores de diverses variantes, de bois et métalliques; tandis que près des boutiques, construites plus tard, étaient à grille métallique mobile et à porte de fer.

Toutes les boutiques avaient devant un trottoir d'environ un mètre de large et couvert de grandes plaques de pierre entourées d'un cadre de pierre de 10 à 12 cm. Presque tout le marché était doté, d'avant-toits de tôle placés à la hauteur du premier étage, bien cloués sur une ossature de bois et soutenus par des barres de fer. Ces avant-toits d'une largeur presque égale à celle du trottoir, avaient une certaine inclinaison, pour que l'eau coulât au delà du trottoir, en protégeant ainsi les clients et les vitrines des agents athmosphériques.

A l'exception des boutiques de fruits et légumes, où l'on exposait les marchandises même sur le trottoir, dans les autres boutiques de commerçants et d'artisans, à cette intention, on utilisait des vitrines intérieures. Il était rare les cas où les artisans exposaient, à l'extérieur des vitrines, leurs produits (chaussures, confections etc.).

Toutes les rues du bazar étaient couvertes de pavés. Différamment aux rues de la ville, le pavé des rues du bazar était fait de pierres du lit de rivières. La largeur des rues en incluant aussi les trottoirs, arrivait à 5 m, faisait exeption la grand-rue de l'entrée en ville, qui avait 8 à 9 m de largeur. C'est plus ou moins les même dimensions qu'a eu la rue, descendant de la fontaine au bord de la rivière sur le côté Est du bazar.

Alors que, sur les places des bazars ouverts, les canaux d'évacuation des eaux passaient sur les côtés, dans toutes les rues du bazar, ils passaient au milieu d'elles.

Comme dans toute la ville, dans le marché les canalisations faisaient défaut. Il n'y avait qu'une seule fontaine au centre du bazar, qui fournissait celui-ci d'eau potable.

Les boutiques de ce bazar ont été mixtes et non selon les métiers. Faisaient exception les forgerons et les tôliers qui ont été installés l'un à côté de l'autre, dans deux blocs particuliers.

A Përmet, on relevait aussi la particularité, selon laquelle, à part leur nom véritable, le peuple appliquait d'autres appellations aux artisans. C'est sous ces appellations qu'ils étaient plutôt connus dans le peuple.

Dans le système des bazars faisaient partie aussi les petites places, servant à la commercialisation des produits de l'économie paysanne, et même urbaine. A Përmet il y eu trois bazars ouverts, où l'on commercialisait surtout une fois par semaine, le jour de marché, qui était le samedi. C'était le bazar des céréales, celui des produits laitiers et celui du bétail.

Dans le réseau de boutiques des nouveaux centres urbains des années 1900-1912 figurent aussi Këlcyra avec 63 boutiques et Frashër avec 20 boutiques. D'après notre patriote de la Renaissance Sami Frashëri «en 1890, Frashër avait un marché de 20 boutiques et une auberge. Chaque mardi avait lieu un riche marché qui était visité par la population de 28 villages de Dangëlli. Këlcyra aussi, le grand village de la région de Dëshnica avait en ce temps-là 63 boutiques et 8 auberge, ainsi qu'un marché hebdomadaire.

Les constructeurs du vieux bazar de Përmet, de cet ensemble urbain et architectonique jadis charmant, ont été des maîtres bâtisseurs venus des régions de Kolonja, des Vakëf et d'Opar et de Dangëlli (Kobara), qui en partie, ont été installés avec leur familles à Përmet ou dans les villages voisins.

Une partie des boutiques ont été la propriété des commerçants eux-même ou biens des artisans, tandis que la majorité écrasante des ortisans les louaient aux diverses propriétaires des communautés religieuses.

Pendant la Lutte Antifasciste de Libération Nationale, la ville de Përmet et son bazar furent incendiés quatre fois de suite par les occupants italiens et allemends.

Une partie des boutiques ont été réparées durant la lutte et les premières années après la libération et ont été réutilisées comme boutiques, mais avec le temps, en raison des nouvelles constructions qui y ont eu lieu, toute trace du vieux bazar a disparu.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Robert BALLAURI

MBI ARKITEKTURËN E NJË KOMPLEKSI BANIMI TË SHEK. XIX BRENDA ZONËS-MUZE TË KORÇËS

Në këtë shkrim do të japim një gjykim mbi kohën, vendin dhe kushtet në të cilat u ndërtua një kompleks banimi në një nga zonat më të vjetra të qytetit të Korçës. Në këtë drejtim do të përpiqemi ta studiojmë atë si një ansambël me tipare të veçanta në zgjidhjen arkitektonike dhe funksionale.

Do të jetë e dobishme që krahas trajtimit të kompleksit të banimit në fjalë, i cili përbëhet nga dy banesa jo të po atij lloji arkitektonik dhe me kritere të ndryshme ndërtimi, t'i hedhim edhe një sy të shpejtë urbanistikës dhe arkitekturës së Korçës gjatë shek. XIX.

Planimetria e qytetit të Korçës (Tab. 1) nxjerr në dukje dy pellgje me rrugica gjarpëruese, që përcaktojnë zonat e banuara[1] me ndërtime nga më të vjetrit e qytetit, duke ruajtur larminë e një vendosjeje planimetrike të çrregullt, asimetrike, ku këto parcela harmonizohen me rrugicat mesjetare, të veshura me kalldrëm. Dikur në mesin e këtyre rrugicave kishte një koritë gjatësore, që shërbente si kanal për të larguar ujërat e shiut që mblidheshin nga kullimi i çative. Sot është shumë zor të gjesh një trakt të tillë rruge. Të gjitha rrugicat janë kthyer me dy kullime anësore. Përbri tyre shtrihen kuartallet e rinj e të rregullt në forma të katërkëndëshit kënddrejtë. Pikërisht në këta dy pellgjet më të vjetër[2] morri rritje dhe zhvillim qyteti. U përcaktuan shumë mjedise me vlera ekonomike dhe kulturore-artistike, të cilët krijuan ata komponentë të nevojshëm që e bënë Korçën një qytet të veçantë, me arritje të mëdha në artin e të ndërtuarit dhe me kërkesa funksionale dhe estetike që ishin vazhdimisht në rritje.

Edhe kompleksi i banimit për të cilin do të bëjmë fjalë në këtë shkrim, që ndodhet në rrugën «Mihal Grameno» në numrat 17 dhe 19 është në një mjedis të tillë. Ky kompleks i ka shërbyer për banim për mëse një shekull një familjeje tregëtare korçare të shumtë në numër.

Deri në fillim të shekullit të kaluar, Korça si një qendër ekonomiko-tregëtare në formim nuk bëri përpjekje të frutshme për të çuar përpara, krahas zhvillimit të ndërtimeve qytetare edhe urbanistikën e saj. Kështu që në zonat e vjetra për të cilat bëmë fjalë më lart, ndeshim banesa me vlera të veçanta arkitektonike, ndonëse gjurmët më të vjetra të këtyre ndërtimeve mezi shkojnë deri në dekadat e para të shek. XIX. Dhe kjo është më se e pranueshme, përderisa tipet më të vjetra të banesës, në gjithë trevën e Korçës, sot janë shumë të rralla. Megjithatë në këto banesa, sado të ralla qofshin, duket niveli i kërkesave funksionale dhe stilistike, interpretimi bindës i arkitekturës vendase, si në planin e ndërtimit, në atë morfologjik dhe mbi të gjitha në planin e arritjes së shërbimeve dhe funksionit. Materialet e ndërtimit, si

1. Njëri pellg filloi të formohet rreth xhamisë së Mirahorit, që siç dihet përfundoi së ndërtuari në vitin 1496, kurse pellgu tjetër u zhvillua më pas, gjatë shek. XVIII e më vonë, rreth katedrales së qytetit, që u ndërtua në vitin 1707. Edhe sot e kësaj dite përreth këtyre dy ndërtimeve të kultit gjenden ende ekzamplarë të vjetër të banesës qytetare korçare, një numër i të cilëve me kohë, ka pësuar ndryshime në komponentët arkitektonikë.
2. E. Riza, B. Strazimiri, **Mbi arkitekturën e qytetit të Korçës,** «Monumentet 3, 1972, f. 119.

DO NOT COPY



Fig. 1

kudo në banesën shqiptare tradicionale, janë materiale të gjetur në vend – druri, guri, balta dhe gëlqerja. Të tilla banesa u realizuan në shek. XVII, XVIII dhe fillimi i shek. XIX, duke krijuar një tipologji të qartë dhe të pasur të arkitekturës vernakulare. Nga tipi i shtëpisë me kat unik, evolucioni i saj krijoi llojet e banesës dykatëshe të mbyllur ose të hapur[3] me verandë dhe ballkon, siç mund të duken edhe sot gjurmët e tyre në trevën e Korçës dhe në krahinat fqinje të Oparit, Tomoricës, Kolonjës. Të gjitha këto ndërtime, që shprehin frymën popullore dhe aftësitë krijuese e ndërtimore të kryemjeshtrave vendas, krijojnë një varietet të pasur në kompozimin e tyre funksional. Mbi të gjitha planimetria e këtyre ndërtimeve karakterizohet nga zgjidhje asimetrike, ku nyja bazë e shtëpisë, çardaku i hapur ose i mbyllur lëviz nga njëri krah i vëllimit tek tjetri dhe krijon variante të shumtë. Shumë të rallë janë dokumentat fotografike, për të ilustruar këto ndërtime. Megjithatë, në rastin tonë, mund të shihet larmia e kësaj arkitekture vendase në një pamje të pjesëshme të fshatit Marjan, i krahinës së Oparit, fotografi e fundit të shekullit të kaluar (Fig. 1). Me kalimin e kohës, në këto banesa strukturat e vjetra[4] qoftë nga degradimi ose

3. P. Thomo, **Banesat e hapura në qytetin e Korçës dhe disa probleme të restaurimit të tyre,** Monumentet, 1, 1982, Porse në këtë shkrim nuk do të trajtojmë probleme të restaurimit.
4. Gjysma e parë e shekullit të kaluar i ka sjellë Korçës shumë fatkeqsira: dy zjarre të mëdhenj në treg dhe pjesërisht në lagjen e Kasabasë, (**Shqipëria më 1927,** Tiranë 1927, f. 336. Zjarri i parë më 1822 dhe i dyti në vitin 1858), plaçkitja dhe prishja e madhe që iu bë tregut të Varoshit gjatë viteve 1824-1828 (Martiniani, J. **I Moskopolis 1330-1930,** Thesaloniki 1957, f. 239-241) dhe pasojat e luftës klasore midis feudalëve e derbedenjve vendas dhe forcave të pushtuesve turq (**Historia e Shqipërisë,** Vol. I, Tiranë 1959, f. 484).

prishja e tyre, qoftë nga zëvendësimi i tyre, ua lanë vendin konstruksioneve më të reja, që u rezistojnë më shumë kohës dhe fatkeqsive të ndryshme, siç është rasti i zjarrit të tretë që i ra tregut të Korçës më 1879 nga i cili u dogjën më shumë se 600 dyqane.[5] Duke bërë rindërtimin e tyre dhe duke përdorur materiale ndërtimi të tjera (në vend të dërrasës u përdor guri, në vend të çatmasë muri me tulla ose me gurë) sigurisht që edhe ana arkitektonike ndryshoi nga arkitektura e ndërtimeve të para dhe si rrjedhim edhe urbanistika, mbasi në fund të shekullit të kaluar në Korçë ishin rritur edhe kërkesat urbanistike. U krijuan kështu parcelat e rregullta katërkënddrejtë dhe një rrjet rrugësh perpendikulare me njëra tjetrën, që i dhanë tregut dhe qytetit të Korçës një fizionomi të re.

Në rast se e shohim në prizmin e zhvillimit të arkitekturës së ndërtimeve qytetare korçare, tipik është rasti i kompleksit tonë (Tab. II), ku të dy banesat që po trajtojmë ndryshojnë jo vetëm si koncept arkitektonik, por edhe nga formulimi funksional e përdorimi i strukturave të ndërtimit, megjithëse ndërtimi i dytë është bërë rreth 30 vjet më vonë se i pari.[6] Kemi të bëjmë me një mendim mjaft të avancuar mbi banesën, që është rezultat jo vetëm i kërkesave që lidhen me ambientin morfologjik dhe gjeografik, por dhe si një ndikim i drejtpërdrejtë i zhvillimit të nivelit ekonomik dhe kulturor që po kryhej në qytetet tona dhe banorët e tyre.[7]



Fig. 2

Banesa dykatëshe, ndërtim i vitit 1841 dhe kushtet në të cilat lindi dhe u zhvillua ky tip ndërtimi

Sikundër dihet, mëkëmbja dhe zhvillimi i mëtejshëm i qyteteve tona u krye me ritme të shpejta, si rezultat i shthurrjes së ekonomisë natyrore të fshatarëve dhe i krijimit të shtresave të borgjezisë qytetare,[8] por edhe si rrjedhim i faktit që perandoria osmane gjatë shek. XVII dhe në krye të shek. XVIII filloi rrugën e të tatëpjetës dhe kështu fuqia ushtarake e Perandorisë sa vinte po dobësohej. Në të kundërtën shtetet evropiane po forcoheshin dhe me disfatat ushtarake që pësuan ushtritë osmane, Porta e Lartë u detyrua t'u japë koncesione fuqive evropiane. Kështu këto fituan të drejtën për të ndërhyrë në punët e brendshme të Turqisë.[9] Këto ndërhyrje ishin të shumëllojshme dhe u vunë re në fushën ekonomike, kulturore dhe më vonë edhe në mënyrën e jetesës. Ato ndikuan edhe në art dhe në arkitekturën osmane,

5. Nuçi D. Naçi, **Korça dhe fshatrat përqark,** Shtypshkronja shqip «Mbrothësia», Sofie 1901, f. 24-25: «Pas zjarrit të tretë korçarët e ndërtuan tregun të gjithë të gurtë e me hekura».
6. R. Ballauri, **Një kompleks arkitektonik i mesit të shek. XIX në Korçë** në «Mjeshtrat dhe arkitektura popullore» 1978, f. 192. Në banesën dykatëshe, në hyrje mbi gur është gdhendur data 1841 (Fig: 2), kurse në ndërtimin trikatësh, sipas kujtimeve të pronarit, në fasadën kryesore, mbi ballkonin e katit të tretë ka qënë shkruar viti i ndërtimit, Korrik 1870.
7. **Historia e Shqipërisë,** vol. I, Tiranë, 1959, f. 409-410.
8. **Po aty,** f. 406.
9. **Po aty,** f. 386-389.

DO NOT COPY

sidomos në kryeqytet dhe në gjithë provincat ballkanike të perandorisë osmane.[10] Kështu fryma e ndërtimeve të pasrilindjes evropiane dhe elementet e barokut bënë që të krijohej një stil i ri arkitektonik, që i përgjigjej më së miri kërkesave funksionale dhe të jetesës së shtresave të larta të shoqërisë. Ky proces vazhdoi për afro një shekull, deri në fillim të shek. XIX[11] kur në kryeqytetin e Perandorisë dhe sidomos në qytetet kryesore të gadishullit ballkanik u krijuan ekzemplarë të asaj arkitekture që përmban edhe elemente të barokut dhe konsiderohet si arritje e re. Ky stil lulëzoi në shumë qendra urbane në zhvillim të vendeve të Ballkanit.[12] Duke qënë se borgjezia e madhe qytetare dhe shtresat e pasura të pronarëve të çifligjeve të vendit tonë ishin vazhdimisht në kontakt me njerëz të lartë të Perandorisë dhe me mënyrën e tyre të jetesës, ata u kopjuan edhe banesat, dhe si rrjedhim ndërtime të tilla dykatëshe u ngritën në fillim të shek. XIX në shumë nga qytetet tona veçanërisht në atë të Korçës.

Po të krahasohen këto ndërtime me ato bashkëkohëset që janë ngritur në qytete të tjera ballkanike, tek banesat tona ndjehet i fortë ndikimi i arkitekturës vendase, aq sa këto duken si një vazhdim i mëtejshëm i ndërtimeve shqiptare të traditës, ku dalin në pah shumë elemente arkitektonike, dekorative dhe artistike të përbashkët dhe me një vazhdimësi të gjatë.

Këto ndërtime kanë si tipar karakteristik simetrinë e plotë: në qendër zhvillohet vëllimi kryesor dhe në të dy krahët shtrihen vëllime të barabarta. Ky stil, aq sa mundi të përhapet në vendin tonë, bën pjesë në një farë mënyre në periudhën e ndërtimeve në prag të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Fryma e arkitekturës së banesave simetrike të Beratit dhe më vonë të Voskopojës dhe Elbasanit[13] ndeshet edhe në Korçë, për vetë faktin që mënyra e jetesës pothuaj se e ngjashme e këtyre qyteteve diktoi në një farë mase edhe ndërtimin e elementeve arkitektonike të ngjashëm. Gjithë kjo erdhi si rezultat i lidhjeve ekonomike dhe tregtare që u vendosën, në filim midis Beratit e Voskopojës dhe më vonë midis Beratit, Voskopojës dhe Korçës, të cilat çuan edhe në formimin e një numri mjeshtrash të profesioneve të ndryshme, që ndërtuan banesa dhe institucione qytetare ndër to edhe banesat simetrike si në Berat e në Voskopojë, ashtu edhe në Korçë. Por ky tip banese lindi edhe në qytete të tjerë, në Elbasan, Tiranë, Krujë, Durrës ndeshim ekzemplarë të tij.

Edhe në Gjirokastër ky stil u asimilua nga arkitektura vendase, duke u zhvilluar me shumë variante në vëllim dhe në madhështi. Kështu u krijuan vlera të rralla arkitektonike dhe ambiente të brendshëm me arritje të veçanta artistike.

Në qytetet e Kosovës – Prizren, Pejë, Gjakovë etj. po ashtu i hasim këto ndërtime. Edhe këtu ky është shkrirë me ndërtimet e vendit duke fituar vlera të reja në artin e të ndërtuarit.

Në fillim, ky stil krijoi banesa me dalje të të gjithë fasadës së katit të sipërm dhe me një numër të madh dritaresh, njëra pas tjetrës, siç janë tipike banesa të tilla në Berat (fig. 3). Më vonë në fillim të shek. XIX dolën ndërtimet me një dalje në pjesën qendrore të katit të sipërm,[14] që fillimisht mund të



Fig. 3

10. A. Refik, **Lale Devri,** Istambul 1932, f. 3-6.
11. E. Arseven, **L'art turc,** Istambul 1939, f. 4-10.
12. O.R. Hille, **Annales de l'Institut bulgare d'Archéologie,** VIII, Sofia, 1934.
    Në fjalorin e arkitekturës së shek. XIX në gjithë provincat e Ballkanit të pushtuara nga osmanët filloi të futet shprehja «Sulltan japie» që do të thotë «ndërtim i Sulltanit», ku nënkuptojmë influencën e mënyrës së banimit të funksionarëve të lartë të administratës turke. Këto janë banesa me facadën kryesore simetrike të cilat në fillim u ndërtuan në qytetin Plovdiv dhe më vonë u përhapën në gjithë provincat ballkanike të Perandorisë, kryesisht në fund të shekullit XVIII dhe gjatë shekullit XIX.
13. **Shqipëria para dy shekujsh,** (botimi në shtyp. Shkodra) Tiranë viti 1930, f. 60 dhe 107. Sipas Evlia Çelebiut në fillim të shek. XVIII Berati numëronte 5000 shtëpi, kurse Elbasani 900 dyqane.
14. Këto dalje janë një zhvillim i mëtejshëm i qoshkut të mëparshëm Fjalës «dalje» i korrespondon në frëngjisht **encorbellement** dhe **ercker** në gjermanisht.

DO NOT COPY

vërehet në banesën e Beratit dhe të Voskopojës (fig. 4). Këto veçori arkitektonike i gjejmë lehtë në banesën korçare, siç janë dalja ose erkeri i katit të sipërm, harkëzimi i pjesës qendrore të çatisë, konstruksionet e lehta çatma në katet e dyta ose edhe detaje të tjera si fashaturat prej druri horizontale dhe vertikale të fasadave, etj. që mbi të gjitha përbëjnë një lidhje dhe vazhdimësi në arkitekturën e Rilindjes sonë Kombëtare, duke iu përshtatur më së miri kushteve rrethanore dhe klimaterike.

Shumë studiues që trajtojnë këtë çështje dhe ndërtimet simetrike me dalje në fasadë ose erker i cilësojnë si «banesa të tipit maqedon».[15] Termi mund të mos jetë i saktë si shprehje arkitektoniko-historike, porse, mendojmë ai i përgjigjet një realiteti historik. Fakti që ky tip banese gjeti zhvillim në fillim të shek. XIX në gjithë vendet ballkanike të pushtuara nga osmanët, tregon se ky lloj ndërtimi bartëte diçka të re në mënyrën e jetesës dhe ishte lidhur me idetë e reja kryengritëse të popujve shqiptar, grek, maqedonas, bullgar që përpiqeshin dhe luftonin për çlirimin e tyre kombëtar.

Banesa me erker, nuk e ndërpreu zhvillimin e arkitekturës shqiptare. Përkundrazi ajo e shpuri më përpara atë duke i veshur një përmbajtje të re funksionale dhe estetike, që është një vazhdimësi në komponentët kryesorë të banesës tonë tradicionale. Njëkohësisht, kjo shprehje e re arkitektonike mishëronte frymën e kryengritjes antiosmane të popullit tonë, si dhe të popujve të tjerë të shtypur të Ballkanit.[16] Nuk mund të përjashtohet fakti që, meqënëse ky lloj ndërtimi gjeti shtrirjen më të madhe në qytetet Shkup, Manastir, Ohër, Follorinë, Edesa etj. me termin «banesë e tipit maqedon» është bërë një përpjekje e frutshme për t'u vënë një emër këtyre ndërtimeve.[17]

Berati ka qënë një qendër ekonomike në lulëzim, me tregëti të zhvilluar dhe që mbante marrëdhënie të vazhdueshme tregtare me Voskopojën.[18] pastaj edhe me Korçën. Shumë familje voskopojare, përveç marrëdhënieve ekonomike bënë edhe lidhje familjare me Beratin, lidhje këto që krijuan kushte të favorshme edhe për huazime në mënyrën e jetesës dhe



Fig. 4

për më tepër edhe huazime në formulimin arkitektonik të banesës.[19] Mirëpo banesa e Beratit e kishte gjetur zgjidhjen e saj kompozicionale si në anën funksionale ashtu edhe në atë arkitektonike,[20] ku midis kushteve themelore ishte edhe klima. Si rrjedhim dritaret në gjithë fasadën siguronin jo vetëm ndriçim optimal, por edhe ajrosje në ambientet e banimit. Ndërsa Voskopoja dhe Korça, vende me klimë kontinentale, me dimëra të gjatë dhe të ftohtë, numrin e dritareve e reduktuan. Fasadat me dy dritare për dhomë janë tipike në arkitekturën e këtyre dy qyteteve. Ndërsa erkeri, si pjesë përbërëse e çardakut të mbyllur të katit të dytë ose të tretë u pajis po me dritare, në disa raste edhe në gjithë gjatësinë e tij. Duke qënë një konstruksion konsol, erkeri dhe muratura e fasadës kryesore nga ku ai del janë ndërtuar si struktura të lehta çatmaje. Për Korçën një zgjidhje e tillë ishte shumë e dobishme dhe me leverdi, si zonë me sizmisitet të lartë dhe njëkohësisht një ndërtim i tillë nuk ul as aftësinë e ngrohjes së ambienteve, duke marrë parasysh se Korça ka arritur në minimume të konsiderueshme të temperaturës.

15. **Historia e Shqipërisë,** vol. I, Tiranë 1959, f. 140; J. Bourcart, **Les confins albanais administrés pour la France,** Paris 1922, **L'Albanie et les Albanais,** Paris 1921,
16. Hr. D. Peev, **Plovdivskata kasta prez Vazrazdaneto,** Sofia 1960,
17. E. Riza, B. Strazimiri, **Po aty,** f. 127-128.
    Mendojmë se termi «banesë korçare» nuk mund të përfaqësojë atë tip banese, që ndonëse me frymë thjesht popullore, si koncept arkitektonik përmban ndikime funksionale dhe estetike nga arti dhe arkitektura e pasrilindjes europiane.
18. **Historia e Shqipërisë,** Vol. I, Tiranë 1959, f. 407.
19. S. Adhami, **Të dhëna rreth fizionomisë së qytetit mesjetar të Voskopojës,** Monumentet 3, 1972, f. 106.
20. Evlia Çelebiu, **vep. cit.,** f. 60: «Shtëpitë janë të mbuluara me tjegulla, të ndërtuara qargjir, me dy pate, shtëpi të bukura e të stolisura si qoshqet e parajsës».

DO NOT COPY



Fig. 5



Fig. 7



Fig. 6

DO NOT COPY

Banesa dykatëshe e kompleksit që po trajtojmë është një ndërtim i veçantë, ekzemplar i vetëm në ndërtimet e Korçës të mezit të shek. XIX. Si skemë konstruktive, ajo është një zhvillim i mëtejshëm i ndërtimeve qytetare me dy kate, me mure guri dhe pjesërisht çatma në fasadat kryesore, ku vendosen një sërë dritaresh, në këtë rast tre për çdo ambient. Është një zgjidhje planimetrike e pranueshme për klimën e Korçës (Tab. III).

Duke marrë parasysh se shumë elemente jo të fshehur dhe të dukshëm edhe përpara restaurimit (fig. 5) dëshmonin për praninë në krahun e djathtë të një fashature vertikale të dritares së tretë, si edhe zgjatimin e traut horizontal në fasadë, ku mbështete-

shin strukturat e drunjta të çatmasë, nxjerrim si konkluzion se banesa ka pasur edhe në krahun e djathtë fillimisht tre dritare dhe më vonë nga ndonjë fatkeqsi natyrore ose zjarr, vëllimi i këtij krahu është zvogëluar. Kështu, kjo fasadë ka qënë simetrike[21] (fig. 6) dhe si rrjedhim kemi të bëjmë me një ndërtim simetrik ku vëllimi i qendrës në fasadë ngrihet më lart se sa të dy krahët anësorë simetrikë. Këtu gjurmët e ndërtimeve tona të traditës janë shumë të theksuara dhe e kanë ngritur në një shkallë më të avancuar kërkesën funksionale dhe estetike. Në këtë banesë spikat thjeshtësia e formulimit arkitektonik dhe eleganca e formave, që duket sidomos në pjesën qendrore të fasadës, që del në erker mbi hyrjen dhe që formohet nga tri harqe të mbështetur mbi dy kolona, ndërsa skajet anësore pushojnë mbi muraturën e gurtë (fig. 7).

Duke e zhvilluar më tej këtë banesë dykatëshe simetrike me erker, shohim se gradualisht, me kalimin e kohës, lindi nevoja e përmirësimit të funksionit, me nxjerrjen e shkallëve sa më jashtë sipërfaqes së çardakut. Kjo zgjidhje krijoi kushte që të ecet akoma më tej për të përsosur kompozimin e këtij tipi të banesës qytetare dhe lindën format e para të erkerit, në fillim shumë pak të dalë në konsol siç është rasti ynë. Veçse, siç e pamë, erkeri në qendër të fasadës kërkon gjithënjë një konfiguracion simetrik të planimetrisë së banesës, ku pjesa e dalë është një zhvillim i mëtejshëm i çardakut.

Më pas si rezultat i evoluimit të banesës qytetare në përgjithësi dhe i erkerit në veçanti, si në funksion ashtu edhe në vëllim, sidomos në fundin e shek. XIX, gjejmë në Korçë, ekzemplarë banesash ku erkeri është komponenti kryesor i shkallëve të hyrjes, deri në raste të banesave me shkallë monumentale ku këto lloj ballkonesh të mbyllur[22] mbështeten mbi kolona dhe krijojnë zgjidhje arkitektonike mjaft të theksuara.

Duke u kthyer tek banesa jonë, shohim se planimetria e të dy kateve na jep zgjidhje simetrike, me përjashtim të cungimit që i është bërë gjatë rikonstruksioneve të mëvonëshme krahut të djathtë. Kati përdhe lidhet me katin e parë me një shkallë, që fillon nga arkada e djathtë e hyrjes dhe del në çardakun e katit të parë, ku zakonisht përdorej një qepen dërrase për të mbyllur këtë hapësirë drite. Në çardak hapen katër dhoma, ndërsa me disa këmbë shkallë kalohet në një ambient tjetër që del me erker në fasadën kryesore. Pikërisht ky ambient dhe çardaku formojnë vëllimin qendror të banesës dhe krijojnë një varitetet mjaft të larmishëm të saj.



Fig. 8

Funksioni i katit përdhes ka shërbyer fillimisht si në të gjithë llojet e banesës tradicionale: ambientet për mbajtjen e ushqimeve dhe të zahireve të dimrit, nyja e të gatuarit, vendi për larjen e teshave, vendi i druve të zjarrit etj. Kurse në katin e sipërm të katër

21. E. Riza, B. Strazimiri, **Po aty,** f. 123; P. Thomo, **Po aty,** f. 76.
22. **Historia e Shqipërisë,** vol. I, Tiranë 1959, f. 410; «Dhomat e katit të sipërm nga ana e përparme dalin jashtë murit të katit përdhes duke formuar një lloj ballkoni të mbyllur».

DO NOT COPY

dhomat shërbenin për banimin e familjes: dhoma me oxhak ku dimërohej, «oda e mirë» ose dhoma ku priteshin miqtë, dhomat e gjumit (Tab. IV). Të dy dhomat anësore kishin grupin e musandrave, oxhakun përballë portës së hyrjes dhe nga tri dritare që hapeshin mbi oborr. Kurse të dy dhomat e tjera përballë, ajo në krah të majtë që ka qënë me oxhak ka shërbyer si «odë e mirë», ndërsa tjetra në krah të djathtë, si dhomë gjumi. Ambienti që del në erker, ku ngjitesh me tri këmbë shkallë, ishte një vend shlodhjeje e argëtimi, por në raste festash të familjes atje vendosej edhe orkestra.

Me kalimin e kohës familja u shtua në numër dhe dhomat lart nuk i plotësonin dot nevojat për banim, kështu që u ndje nevoja për të bërë një rikonstruksion të shtëpisë duke shtuar ambientet e banimit. Kështu dy bodrumet anësore u shndruan në dhoma për banim. Për këtë ato u pajisën me dollapë në të dy krahët e dyerve, u shtruan me dysheme, duke u ngritur kështu mbi nivelin ekzistues të bodrumit. Kjo është një fazë e dytë e funksionit të banesës, që solli ndryshime edhe në fasadat e saj. Nuk mund të lihet pa përfillur fakti që dritaret e katit përdhes nuk janë në një aks me ato të katit të parë (fig. 8). Duket qartë se ato dritare janë hapur në një kohë të mëvonëshme. Nuk na duket e pranueshme që dritare të tilla të jenë lënë fillimisht nga mjeshtrit ndërtues, në një kohë kur po këta mjeshtër kanë ngritur një banesë aq të përsosur dhe me kërkesa simetrie. Një



Fig. 9

argument tjetër që vërteton se qilaret ishin në fillim të pabanuar, është edhe ky: niveli i bodrumeve anësorë është dy këmbë shkallë më poshtë nga niveli i oborrit, kurse të dy bodrumet ballorë futen më thellë akoma edhe tre këmbë shkallë të tjera (Tab. V). Të dy këta argumenta hedhin dritë mbi një fakt shumë të rëndësishëm që vërteton se ka pasur një fazë të dytë rindërtimi dhe ajo ka ndodhur pikërisht në dekadat e fundit të shekullit të kaluar, kur filluan të martohen fëmijët.[23]

Lidhur me skemën funksionale të katit përdhes të banesës që po trajtojmë, studiues të arkitekturës së banesës korçare shprehin mendime të ndryshme. Një mendim shprehet kështu: nga të katër ambientet e katit të parë (katit përdhes – R.B.) vetëm njëri prej tyre është i pajisur me oxhak, kurse tre të tjerët do të kenë shërbyer për depo.[24]

Kurse një mendim tjetër e trajton kështu këtë problem: në katin përdhes përfshihen katër ambiente, dy prej të cilëve përdoreshin për banim dhe dalin në ballë të ndërtesës, ndërsa dy të tjerët në pjesën e prapme kanë qënë përdorur si katoje e depo.[25] Por vetë argumentat që parashtruam më lart i kundërshtojnë këto të thëna, edhe për vetë faktin që në rast se do të ishin ndërtuar fillimisht ambientet e banimit në bodrum, ato duhej të vendoseshin në kushte më të mira higjeniko-shëndetsore dhe jo nën nivelin e oborrit dhe me dritare të vogla ose dhe pa dritare fare, siç është rasti që po shqyrtojmë. Kështu vlerësohet teza që bodrumet në fillim ishin për shërbime dhe jo për të banuar.

Muratura e gurtë perimetrale ngrihet me breza druri të vendosur afërsisht në çdo metër larg njëri tjetrit dhe materiali lidhës është pjesërisht baltë me byk dhe pjesërisht baltë e përzier me një përqindje gëlqereje. Fasada kryesore e katit të parë është më e trajtuar dhe muret e saj janë ndërtuar me çatma, një konstruksion i lehtë dhe me shumë avantazhe, sidomos lidhur me vendosjen e elementeve dekorativë, si në ambientet brenda ashtu edhe në fasadat e jashtme. Trajtimi dekorativ si ai i jashtëm ashtu edhe ai i ambientit të banimit, përgjithësisht në banesën korçare është i përmbajtur porse në rastin tonë, që kemi të bëjmë me një arritje më të avancuar lidhur me evoluimin e arkitekturës së banesës, zgjidhja dekorative fiton vlera të rëndësishme, për më tepër kur trajtimi dekorativ gërshetohet me vetë konstruksionin. Më poshtë po e ilustrojmë këtë mendim me disa shembuj tipikë.

23. Sipas kujtimeve të një pjesëtari të familjes.
24. E. Riza, B. Strazimiri, **Po aty**, f. 122
25. P. Thomo, **Po aty**, f. 74.

DOKTORATURA



Fig. 10



Fig. 11

DO NOT COPY

Hyrja monumentale e banesës është një rast që meriton një vëmendje të posaçme. Harku i mesit e ka shigjetën më të madhe dhe dominon mbi dy të tjerët (fig. 9). Në këtë kompozim të gurtë, me një simetri të plotë që harmonizohet edhe me simetrinë e banesës, ndjehet finesa dhe eleganca e arkitekturës, duke e bërë sa më të lehtë peshën e vëllimit të erkerit mbi të. Pikërisht këtu takohen ato vlera dekorative që në ndërtimet e mëparshme në Korçë nuk i ndeshim megjithëse thamë më lart se ekzemplarët e tyre sot janë shumë të rrallë. Dhe këto vlera nuk janë thjesht profesionale, ndër to ndjehet fryma e një ndërtimi më të guximshëm në pikëpamje inxhinierike dhe më të zhdërvjellët si koncept arkitektonik.

Një element tjetër që mendojmë se ruan vlera të veçanta konstruktive dhe dekorative është nyja që mban traun konsol mbi të cilin ngrihet erkeri (fig. 10). Edhe këtu del qartë mendimi i avancuar, i cili arrin të krijojë një jastëk mbështetës me një finesë në punimin e elementeve të drurit (fig. 11) dhe me një pastërti në shtrirjen horizontale të elementeve.

Më lart përmendëm se çardaku në banesën popullore në përgjithësi dhe në atë qytetare në veçanti, është një nga komponentët kryesorë që përcaktojnë anën funksionale. Pozita dhe vëllimi i tij janë një rrjedhim llogjik i ecurisë dhe i zhvilimit të arkitekturës së banesës. Çardaku i mbyllur, për vetë tipet e banesës në zonën e Korçës, i është imponuar asaj si nga pikëpamja morfologjike ashtu dhe nga faktorët social-kulturorë dhe si i tillë ai e ka justifikuar funksionin e tij në kohë dhe në evoluimin arkitektonik të formave dhe strukturave ku ai merr pjesë. Për rastin tonë, çardaku jo vetëm shërben si nyje ku kalohet në ambientet e katin përdhes ose nga përjashta në ato të katit të parë, por nëpërmjet tij komunikohet edhe me ambientin e dalë në konsol[26] që për vetë funk-

26. L. Lazimi, **Çardaku në banesën beratase,** Monumentet 11, 1976, f. 173.
Ambienti që del në konsol në formën e erkerit, në tipin e banesës që po trajtojmë nuk është tjetër veçse **«sofa-ja»,** që pasi bëri një rrugë të gjatë evoluimi mori kuptimin e një ambienti të mbyllur, që i duhej familjes për të pushuar dhe për argëtim. (A. Hadjimihali, **La maison grecque,** Athènes, 1949 f. 17-19; R. Günau, **Geleneskel Safranbolu Elveri ve Olusumi,** Ankara, 1981; G. Megas, **I Eleniki Oikia,** Athinai, 1949, f. 27-30; B. Kojiç, **Stara gradska i seoska Arhitektura u Serbi,** 1949, f. 86, 90-91, 94-95)



Fig. 12



Fig. 13

sionin e saj është vend shlodhjeje. Pikërisht edhe trajtimi dekorativ i elementeve në ornamentikën e çardakut përmban po atë frymë elegance që dalluam edhe në elementet që trajtuam më lart. Parmaku i drunjtë dhe kapiteli mbi kolonë ku mbështetet trau i tavanit, jo vetëm që kanë një vizatim të ngjeshur, por edhe një frymë që ndihmon në transparencën midis dy ambienteve, çardakut dhe sofasë. (fig. 12). Kurse në veçanti kapiteli paraqitet me mjaft interes, në radhë të parë si gdhendje në dru, ku spikat linja shumë harmonike dhe punimi i kujdesshëm, por edhe për faktin që në gjithë banesat e tjera bashkëkohore në Korçë, nuk gjejmë një kapitel me vlera të tilla artistike dhe arkitektonike (fig. 13).

* *
*

Nga sa u përpoqëm të argumentojmë më lart, del se kjo banesë dykatëshe e ndërtuar në gjysmën e parë të shek. XIX, jo vetëm që është një ndërtim me arritje të mira inxhinierike dhe artistike, por ajo shënon një pikë kalimi në zhvillimin e banesës qytetare të Korçës, dhe hap rrugën e stilit të banesave simetrike me dalje në fasadën kryesore, stil, sipas të cilit u krijuan variante të shumtë, që e shpunë shumë më tej këtë tip ndërtimi, në gjysmën e dytë të shek. XIX.



Fig. 14

DO NOT COPY



Fig. 15



Fig. 16

Në rast se duam të hapim një parantezë dhe të citojmë një nga tipet e banesave paraardhëse të kësaj që po shqyrtojmë, që siç e përmendëm më lart ndodhen në trevën e Korçës ose në krahinat limitrofe, do të shohim se elemente të kësaj arkitekture vendase siç është çatmaja, erkeri pak i dalë dhe harku i vazhduar, të gjitha këto të konceptuara sipas zgjidhjes asimetrike tradicionale (fig. 14), u transmetuan në banesën tonë dykatëshe simetrike, me dalje në pjesën qendrore (fig. 15). Në këto dy banesa del qartë lidhja e vazhdimësisë në arkitekturën tonë të traditës.

Banesa që morëm në shqyrtim është një ndërtim i fundit të shek. XVIII në Zaloshnjë të Skraparit (sot ruhet si monument historik) me dy kate, ndërtuar me gurë të latuar, ku duket qartë zgjidhja asimetrike e saj.[27]

Në banesën që jemi duke shqyrtuar, në Korçë, gjatë gjithë jetës së saj pati edhe rikonstruksione të tjera. Vlen për t'u përmendur ai pas tërmetit të Janarit 1931, nga i cili u rrëzuan të dy faqet jugore dhe veriore të banesës, gjithashtu u dëmtuan rëndë gjithë strukturat, muret e tjerë perimetrale dhe çatia. Rikonstruksioni që iu bë banesës pas tërmetit i ndryshoi disa elemente funksionalë, duke bllokuar hyrjen e mëparshme (fig. 16) dhe duke i bërë një hyrje anësore si edhe zvogëlimin e sipërfaqes së një dhome në krahun e djathtë.[28]

Duke e interpretuar si arkitekturën ashtu edhe funksionin e kësaj banese në kuadrin historik dhe ndërtimor-artistik, duke i evidentuar gjurmët e ecurisë së monumentit në kohë, del se kemi të bëjmë me një ndërtim të rallë dhe me një ekzemplar unikal për Korçën në artin e të ndërtuarit.

Si përfundim mund të themi se ndërtimet qytetare të gjysmës së parë të shek. XIX në qytetin e Korçës, nuk duhen parë vetëm në fushën ekonomike-shoqërore, por në vetë morfologjinë e banesës fshatare dhe qytetare, në kushtet e klimës dhe në ndikimin e arkitekturës së krahinave limitrofe.

Banesa trekatëshe, ndërtim «kullë» i vitit 1870

Përmendëm më sipër se sipas një dëshmie gojore, në fasadën kryesore, mbi derën e ballkonit të katit të tretë, ndodhej e shkruar në mur data e ndërtimit «Korrik 1870».[29] Kështu që kjo banesë trekatëshe është ndërtuar rreth 30 vjet më vonë se banesa e parë dhe ndërtimi është i llojit të banesave

27. Ky tip ka gjetur shtrirje në krahinat e Oparit, të Gorës dhe të Tomoricës dhe mund të konsiderohet si tip predominues në këtë trevë.
28. Gjatë viteve 1930-1943 këtu banonte një familje me aktivitet të theksuar në Lëvizjen Punëtore e Komuniste të Korçës si dhe më vonë në Luftën Nacionalçlirimtare. Kështu u pa e nevojshme që ndryshimet që kishte pësuar banesa të ruheshin, sidomos hyrja në rrugën «Mihal Grameno» me nr. 19, e cila është një shtesë e mëvonëshme dhe nga e cila kanë kaluar me dhjetra herë natën, në borë e në shi, pjesëtarët e grupit komunist të Korçës ose punëtorët përparimtarë për të marrë pjesë në mbledhjet ilegale që janë zhvilluar në këtë shtëpi. Kështu e gjithë faqja jugore e banesës është trajtuar si një ndërtim i fillimit të shek. XX, ndryshe nga pjesa tjetër (fig. 17).
29. Sipas tregimit të banorit të fundit të saj, që ka lindur e jetuar në këtë banesë dhe vdiq po atje, më 1978 në moshën 85 vjeç.

DO NOT COPY



Fig. 17



Fig. 18

«kullë». Këto ndërtime janë pa tipare mbrojtëse, ndonëse për vetë funksionin e tyre kanë proporcione që i afrohen paralelopipedit.[30] Zgjidhja planimetrike dhe kompozimi vëllimor na japin tipin e asaj kulle qytetare (fig. 18) të shekullit të kaluar që e hasim edhe në qytetet e tjera.[31] Kështu, gjatë kësaj kohe shumë të shkurtër 30 vjeçare, kemi dy banesa që ndryshojnë shumë midis tyre, qoftë si koncept arkitektonik dhe funksional, qoftë si teknologji ndërtimi. Dhe ky është një argument më shumë që vërteton se Korça vetëm në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar është zhvilluar si qytet me një nivel të lartë ekonomik dhe kulturor dhe si një qendër administrative e rëndësishme.[32] Duke analizuar këtë kullë qytetare, si një ndërtim të përsosur dhe me një arkitekturë të frymëzuar ne do të përpiqemi të vemë në dukje veçoritë e saj dhe shtrirjen planimetriko-vëllimore, në raport me banesën dykatëshe për të cilën folëm më lart.

Karakteristikë e kësaj kulle qytetare është se ajo nuk ngrihet më brenda truallit dhe e rrethuar nga të gjitha anët me oborr, por ka dy fasada mbi rrugën publike (Tab. IV). Shumë komponentë funksionalë të kullës, si ambientet e shërbimit në katin përdhes, shkallët e brendshme për të tre katet ose pushimet e kateve, dhomat e banimit etj. i gjejmë të shprehura me një gjuhë të pastër arkitektonike në këtë ndërtim sa madhështor aq edhe solid, me një larmi ambientesh dhe elemente të shumtë arkitektonikë. Vlen të përmendim oborrin e brendshëm në hyrje të kullës, në qendër të të cilit ngrihet një kolonë me seksion katror që mban të mbështetur tri arkitrarë, që zhvendosen njëri nga tjetri me kënde 84° dhe 108°, mbi të cilët lartësohen muret perimetralë të fasadave veriperëndimore të banesës. Ky është një konstruksion mjaft i guximshëm, që ia rrit vlerën këtij ndërtimi, po të marrim parasysh që kjo është arritur rreth 110 vjet përpara. Për të krijuar mjedise estetike, hapësirat e përftuara në këtë mënyrë janë trajtuar si arkada duke përdorur konstruksione të lehtë çatmaje. Kështu është arritur të krijohet një oborr i brendshëm me theks të një ambienti shqiptar, në të cilin harku është një nga komponentët kryesorë të arkitekturës sonë popullore (fig. 19).

Si anë konstruktive, muret perimetralë ngrihen

30. E. Riza, **Kullat në Shqipërinë e Jugut,** Monumentet historike në vendin tonë, 1978, f. 17.
31. E. Riza, **Po aty,** f. 17; E. Riza, H. Nallbani, **Një ndërtim i tipit kullë në Berat,** Monumentet 10, 1975, f. 117: «Kompozimi në lartësi i këtij ndërtimi dhe karakteristikat e veçanta të elementeve arkitektonikë e shkëpusin atë qartazi nga masa e ndërtimeve të lagjes ku ai ngrihet, Ai bart karakteristikat e njohura të banesës së tipit kullë».
32. P. Pepo, **Materiale dokumentare për ambientin shoqëror të Varoshit të Korçës,** Studime historike, , 1972:... Qeveria e Stambollit më 1865 këtë qytet në pikëpamje administrative nga nënprefekturë e kishte ngritur në shkallën e prefekturës», f. 184.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 19

prej guri në të tri katet dhe lidhen me tiranta metalike në nivelin e tavanit të çdo kati, si masë antisizmike (fig. 20). Me siguri që është banesa e parë që u ndërtua në Korçë me konstruksion të posaçëm antisizmik. Përpara vitit 1870 nuk kemi hasur asnjë banesë që ta gëzojë këtë cilësi, kurse të shumta janë ndërtimet me tiranta antisizmike pas kësaj date. Qoshet e mureve janë me gurë të gdhendur me dimensione të përafërt me njëri tjetrin. Shumë elementë arkitektonikë dhe dekoracione në dru, në hekur ose në gur e pasurojnë këtë ndërtesë siç janë parmakët e ballkonit në katin e dytë me një kompozim të bukur dhe të pasur në motive të barokut (fig. 21) dhe par-



Fig. 20

makët e shkallës spirale që të shpie po në katin e dytë bashkë me parapetin e ballkonit mbi shkallë (fig. 22). Kati i parë dhe i dytë i kësaj kulle ka pasur ambiente me dekoracione murale që përfaqësonin disa kolona ku gërshetohej edhe ndonjë motiv floreal. I gjithë ky zbukurim qëndron në gamën e ngjyrave gri-blu. Gjithashtu hasim në dhomën e katit të parë edhe disa fragmente të një dekoracioni tavani, por pa ndonjë vlerë të madhe artistike (fig. 23). Si pikturat murale, ashtu edhe tavani dëshmojnë për motive me ndikime nga periudha e pasrilindjes.

Materiali lidhës që është përdorur në muraturën e kësaj banese është llaç gëlqereje e një kualiteti të mirë. Kati përdhes që ndodhet në nivelin e rrugës ka një oborr të brendshëm që lidh të dy hyrjet e kullës me një dhomë përdhese (që fillimisht ka shërbyer si «kuzhinë») dhe me shkallët në formë spirale që të shpien lart. Oborri dhe kuzhina janë shtruar me pllo-ça (rrasa guri) të dimensionit 45 x 45 cm që kanë gjetur një përdorim të gjerë në ndërtimet e traditës, në të gjithë trevën e Korçës. Në faqen lindore të katit përdhes hapet një derë, që dikur të çonte në hashefet dhe në nyjen higjenike. Gjurmët e çatisë që duken në pjesën e jashtme të murit perimetral lindor dëshmojnë për këtë ndërtim njëkatësh, jashtë «kullës». Nuk vihet në dyshim që ky ndërtim të jetë i mëvonshëm, pikërisht i asaj kohe kur familja u shtua në numër dhe vëllezërit u ndanë.

Shkallët e drunjta janë zgjidhur bukur dhe përmbushin më së miri kërkesën funksionale, duke siguruar për të dy katet e sipërme sipërfaqe optimale

DO NOT COPY



Fig. 21



Fig. 22



Fig. 23

të çardaqeve. Në katin e parë dy dhomat hapen në çardakun e mbyllur, njëra prej tyre me oxhak dhe me musandër në mur, ka shërbyer si odë zjarri, kurse tjetra si odë gjumi. Ndërsa dy të tjera që janë në katin e dytë, njëra që është më e madhja e gjithë ndërtesës, rreth 40 m^2, i ka shërbyer si odë për miq dhe tjetra si dhomë gjumi. I gjithë kati i dytë (çardaku, platforma prej dërrase mbi shkallë dhe dy dhomat) ka shërbyer për ceremonitë e familjes, në raste gëzimi ose hidhërimi. Vendosja planimetrike ka përcaktuar hapësirat e dritës dhe si rrjedhim ndriçimin e ambienteve. Në drejtim të lindjes numri i dritareve është shumë i përmbajtur (fig. 24), kurse fasadat e tjera kanë dritare në gjithë gjatësinë e tyre (fig. 25).

Ndërtimi i kësaj banese trekatëshe, në radhë të parë është diktuar nga nevoja për zgjerimin e familjes dhe pastaj nga dëshira për të banuar në ambiente më të gjera, më komode dhe me më shumë dritë. Kjo e fundit vjen si rezultat i zhvillimit të vazhdueshëm dhe të pandërprerë në pikëpamje ekonomike, sociale dhe kulturore të borgjezisë qytetare dhe veçanërisht të asaj pjesa që kishte lidhje me jashtë. Dekadat e fundit të shek. XIX sollën me vete edhe ritme të mëdha ndërtimi në qytetin e Korçës, shumica dërmuese e banesave të ndërtuara në këtë kohë janë dykatëshe. Këto ndërtime të bukura dhe të qarta nga ana arkitekturale tërhoqën në Korçë nga viset rreth e rrotull shumë mjeshtër të zotë për ngritjen e muraturave dhe për bërjen e elementeve dekorativë prej druri, guri dhe hekuri të rrahur. Njëkohësisht u shtua numri i kallfëve, që ishin projektuesit e talentuar të këtyre banesave. Kështu që Korça lulëzoi shumë shpejt dhe në fund të shekullit arriti të kishte 2027 shtëpi.[33]

Oborri i banesës kullë shtrihet në të gjithë kompleksin deri te hauret që kanë qënë në skajin verior të tij. Gjurmë të unazave ku lidheshin kuajt ose vendet ku pushonin ata, dallohen edhe sot. Tregojnë se nëpërmjet portës kryesore të hyrjes, dikur futeshin karroca që tërhiqeshin nga një dhe dy kuaj.

Ky ishte një vështrim i përgjithshëm mbi këtë kompleks banimi. Nevoja për ta ruajtur këtë trashë-

33. I. N. Papiniu, **Les frontières d'Albanie**, «La question albanaise» Paris 1919, nga të dhënat statistikore të vitit 1901, f. 74;

DO NOT COPY



Fig. 24



Fig. 25

gimi kulturore të rrallë të arkitekturës tradicionale të Korçës shtroi detyra për restaurimin e tij, nëpërmjet të cilit banesa trekatëshe i rifitoi vlerat arkitektonike dhe ndërtimore[34] që pjesërisht i kishin humbur dhe sot qëndron me dinjitet si një ndërtim i veçantë në arkitekturën e gjysmës së dytë të shekullit të kaluar (fig. 26 dhe 27).

Monumentet e kulturës janë një trashëgimi shumë e vlefshme e popullit dhe si të tillë meritojnë një kujdes të veçantë, në mënyrë që studimi dhe soditja e vlerave historike, arkitektonike dhe artistike të jenë optimale. Në rastin e kompleksit tonë, megjithse trajtimi artistik i elementeve të veçantë është deri në një masë i përmbajtur, kemi arritje të mira në vështrimin historik dhe arkitektonik, sidomos duke parë raportin e harmonishëm të njërit vëllim karshi tjetrit, dhe anasjelltas.

Për ndërtimin trekatësh është thënë se mund të jetë ndërtuar si «mysafiranë» ose ambiente për miq.[35] Deri diku kjo banesë mund të ketë edhe një destinacion të tillë, qoftë edhe atë të festave dhe riteve të familjes, por duke iu rikthyer kësaj teze na duket si paradoksal fakti që shpenzime të tilla të bëheshin vetëm për të krijuar «mysafirane». Pyetëm njerëz bashkëkohës dhe mbi të dhënat e tyre mblodhëm dokumentacionin e duhur që hedh dritë se ky ndërtim i ka shërbyer familjes kryesisht për banim, e cila në atë kohë ishte zmadhuar shumë në numër.[36] Kurse duke e parë si funksion dhe arkitekturë, mendoj se do të jetë më drejtë të thuhet që kërkesat për një jetesë më të kulturuar ishin në plan të parë dhe përkonin më së miri edhe me zhvillimin e vetë qytetit, në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar. Prandaj edhe ky ndërtim kaq i avancuar është frut i kohës së tij.

Këto sondazhe dhe të tjera që mund të bëhen do të shërbejnë si argumenta për destinacionin e ambienteve gjatë kthimit të këtij kompleksi në një muze.

34. Projekti i restaurimit për banesën «kullë» u hartua nga autori ndërsa punimet restauruese i bëri Ateljeja e Korçës, gjatë vitit 1979-1981.
35. R. Ballauri, **Po aty,** f. 194; P. Thomo, **Po aty,** f. 74.
36. Në Korçë, banorë të moshuar mbajnë mend se nga fillimi i shek. XX në një dhomë të katit të parë të kësaj kulle ka patur klinikën e vet një mjek, pjesëtar i familjes që e ushtroi për vite me radhë profesionin.

DO NOT COPY



Fig. 26

Ndërsa banesa e tipit kullë, me ambientet e gjera dhe të larta në katin e parë dhe të dytë mund të ketë një ekspozitë të plotë të inventarit me përfaqësues të kulturës popullore. Pikërisht këtu mund të përdoren vitrina, podiume, manekina dhe aksesore të tjera për një vendosje sa më funksionale dhe me efekte optimale.

Kjo ekspozitë e kulturës popullore do të plotësohet atëhere kur në oborrin përreth këtij ansambli do të krijohen edhe disa elemente të fshatit në natyrë, siç mund të jetë kasollja e fshatarit, mulliri, vatha e bagëtive, ose edhe pika të veçanta me ndërtime utilitare për jetesën si një pus, një çezmë etj. Kjo do të bënte të plotë idenë e një muzeu etnografik e folklorik për atë kohë të caktuar, ku krahas zhvillimit të qytetit, të dalë në antitezë dhe varfëria, mjerimi dhe shfrytëzimi i fshatarëve.

Ky kompleks paraqet një interes të veçantë nga



Fig. 27

Muzeu i ardhshëm etnografik dhe folklorik i Korçës

Treva e Korçës paraqet një shumëllojshmëri në fushën e traditave dhe të kulturës popullore, ashtu edhe në gjinitë e veçanta siç janë folklori, etnografia, mënyra e mjetet e punës e të jetesës dhe banesa popullore. I gjithë ky mozaik vlerash materiale dhe kulturore që përbën një fond të rrallë për studimet në fushën ekonomiko-shoqërore, do të zërë vend në këtë kompleks të veçantë, në mënyrë që edhe arkitektura e dy banesave të shkrihet me vetë eksponatet.

Për Muzeun Etnografik me anën e këtij kompleksi u sigurua një sipërfaqe prej afro 600 m^2, me ambiente për ekspozim dhe ku jepet mundësia për të krijuar shumë mjedise muzeale të rrethit të Korçës. Po kështu qënia e dy banesave të veçanta krijon të dhëna që shtëpia dykatëshe të vishet në të gjitha kthinat e saj me pajisjet e plota të një banese të gjysmës së dytë të shekullit të kaluar si qylyma, velenxa, llampa ndriçimi, karike etj. me një fjalë të krijohet një ambient jetësor i asaj kohe. Gjithashtu të pajisen edhe ambientet e shërbimit, të rikrijohen stalla e dikurshme, hashefet përjashta, sofatet në të dy anët e rrugës, oborri i shtruar me pllloça dhe deri te llampadarët me vajguri në oborr dhe në portën e jashtme. pikëpamja arkitektonike, si një hallkë e kalimit nga arkitektura e banesës qytetare e fundit të shek. XVIII në atë të fundit të shek. të XIX dhe fillimit të shekullit tonë. Skemat funksionale konstruktive të këtyre dy tipeve të ndryshëm dhe unikale janë vazhdë llogjike e skemës bazë të banesës sonë popullore. Veçse duhet theksuar edhe një herë se në ndërtimin trekatësh spikat mendimi dhe talenti për ta ngritur sa më madhështor, duke ia përshtatur bukur këtë krijim kërkesave urbanistike të qytetit si një ndërtim me plot dritë dhe hapësirë.

PLANIMETRIA E QYTETIT TË KORÇËS

FILLIMET E SHEK. XX



DO NOT COPY

DO NOT COPY

PLANIMETRIA



PLANI I PËRGJITHSHËM I KOMPLEKSIT, NË RRUGËN MIHAL GRAMENO

BANESAT ME NR. 17 DHE 19



PAMJE AKSONOMETRIKE

DO NOT COPY

BANESA DYKATËSHE

NDËRTIM I VITIT 1841



PAMJE KRYESORE

PAMJE ANËSORE



PLANIMETRIA E KATIT PERDHE

PLANIMETRIA E KATIT I



SIPAS RILEVIMIT
TË VITIT 1970

FUNKSIONI FILLESTAR I BANESES DYKATESHE

0 1 2 3 4 5 M.



PLANIMETRIA E KATIT PËRDHE



PLANIMETRIA E KATIT TË PARË

DO NOT COPY

BANESA DYKATËSHE

PRERJA a-a



PRERJA b-b



RILEVIMI I VITIT 1970.

0 1 2 3 4 5 M.

DO NOT COPY


BANESA TRIKATËSHE
PAMJE ANËSORE
PAMJE KRYESORE
HYRJA
KATI PERDHE
KATI I
KATI II
0 2 4 6M.

DO NOT COPY

Robert BALLAURI

L'ARCHITECTURE D'UN ENSEMBLE D'HABITATIONS DU XIXe SIECLE DANS LA ZONE MUSEE DE KORÇA

DO NOT COPY

RESUME

Dans cet article, nous allons donner une opinion sur l'époque, l'endroit et les conditions de construction d'un ensemble d'habitations dans une des plus anciennes zones de la ville de Korça. Nous allons essayer de l'étudier en tant qu'ensemble à traits particuliers dans la solution architectonique et fonctionnelle.

Il serait utile, à part le traitement de l'ensemble d'habitations en question, qui se compose de deux habitations, lesquelles du point de vue architectonique ne sont pas du même type ayant des critères différents de construction, de jeter un coup d'oeil rapide sur l'urbanisme et l'architecture de la ville de Korça le long du XIXe siècle.

La planimétrie de cette ville (tab. 1) met en évidence deux zones formées de ruelles qui serpentent, lesquelles définissent les zones habitées aux constructions les plus anciennes de la ville, en préservant la diversité d'une planimétrie irregulière, assymétrique. Ces parcelles s'harmonisent avec les ruelles pavées médiévales. Sur les deux zones les plus anciennes s'est agrandie et développée la ville. On a déterminé beaucoup de milieux à valeurs économique, culturelle et artistique lesquels ont crée les composants nécessaires qui ont fait de Korça une ville particulière, avec de grandes réalisations dans l'art de la construction et avec des exigences fonctionnelles et esthétiques croissantes.

Même l'ensemble d'habitations en question qui se situe rue Mihal Graméno, 17 et 19, s'inclut dans un tel milieu. Il a servi d'habitation pendant plus d'un siècle à une famille nombreuse de commerçants.

Korça, en tant que centre économique et commerciale, jusqu'au début du siècle précédent, n'a pas fait d'efforts fructueux pour faire progresser le développement de son urbanisme, de pair avec celui des constructions urbaines. Ainsi, dans les zones anciennes mentionnées plus haut, nous rencontrons des habitations à valeurs architectoniques particulières, bien que les traces les plus anciennes de ces constructions remontent à peine aux premières décennies du XIXe siècle. Les matériaux de construction, le bois, la pierre, la chaux, la boue comme partout dans l'habitation traditionnelle albanaise, sont trouvés localement. De telles habitations ont été réalisées pendant le XVIIe, XVIIIe et le début du XIXe siècle et créent une typologie nette et riche de l'architecture vernaculaire.

La planimétrie de ces constructions se caractérise surtout d'une solution assimétrique, où le noyau principal de la maison, le tchardak ouvert ou fermé, se déplace d'un côté du volume à l'autre, créant ainsi de multiples variantes. Les documents photographiques illustrant ces constructions sont toutefois, très rares dans le cas présent. Nous pouvons voir la diversité de cette architecture locale dans une vue partielle du village Marjan, de la région d'Opar (photo, fin du dernier siècle fig. 1). Avec le temps, dans ces habitations, les anciennes structures, soit à cause de leur dégradation ou de leur destruction, soit par leur substitution, ont cédé la place aux nouvelles constructions qui résistent mieux aux temps et aux différents dégâts, comme c'est le cas du troisième incendie du marché de Korça en 1879, qui a causé la perte de 600 boutiques. En faisant leur reconstruction et utilisant d'autres matériaux de construction (au lieu du bois on utilise la pierre, ou bien des cloisons en bois, le mur en pierre ou en tuiles), certainement le côté architectonique a différé de l'architecture des constructions antérieures et en conséquence même l'urbanisme a changé parce qu'à la fin du dernier siècle, à Korça ont accru les exigences urbaines. On a crée ainsi les parcelles régulières rectangulaires et un réseau de rues perpendiculaires l'une à l'autre, qui ont donné au marché et à la ville de Korça une nouvelle physionomie.

Si nous le considérons du point de vue du développement de l'architecture des constructions urbaines de Korça, le cas de l'ensemble dont on parle est typique (tab. II). Les deux habitations dont nous sommes en train de traiter varient non seulement en tant que conception architectonique mais aussi du point de vue de la formulation fonctionnelle et de l'utilisation des structures de construction, bien que la deuxième construction ne soit faite qu'environ 30 ans plus tard que la première. Nous avons à faire là à une idée assez avancée sur l'habitation.

L'habitation à deux étages, construction de l'année 1841 et les conditions dans lequelles est né et s'est développé ce type de construction.

Comme on le sait déjà, le redressement et le développement plus poussé de nos villes à cause de la dissociation de l'économie naturelle des paysans et la formation des couches de la bourgeoisie citadine, a été fait à rythmes rapides. Ce développement a été encouragé aussi par le fait que l'empire ottoman pendant le XVIe siècle et le début du

DO NOT COPY

XVIIIe siècle allait vers la chute et la puissance militaire de l'empire s'affaiblissait. Au contraire les pays européens se renforçaient. La Sublime Porte après les défaites des armées ottomanes, a été obligé de faire des concessions aux puissances européennes. Ainsi ces dernières, ont eu le droit de se mêler dans les affaires de la Turquie. C'étaient des interventions de toute sorte dans les domaines économiques, culturels et ensuite dans le mode de vie aussi. Elles ont influé sur l'art et l'architecture ottomans surtout à la capitale et à toutes les provinces balcaniques de l'empire ottoman. Ainsi les constructions de l'après renaissance européenne et les éléments du style baroque ont fait naître un nouveau style architectonique qui répondait très bien aux demandes fonctionnelles et à la vie des couches riches de la société. Ce processus a continué environ un siècle, jusqu'au début du XIXe siècle, où à la capitale de l'Empire et surtout dans les principales villes de la péninsule des Balkans, ont été créés des exemples d'une telle architecture, qui même en contenant des éléments du style baroque, se considérait comme une nouveauté. Ce style s'est épanoui dans plusieurs centres urbains en voie de développement des pays des Balkans. Etant donné que la grande bourgeoisie citadine, ainsi que les couches riches des propriétaires fonciers de notre pays étaient constamment au contact avec de hautes personnalités de l'Empire et leurs mode de vie, elles ont aussi imité leurs habitations et par conséquent au début du XIXe siècle dans beaucoup de nos villes surtout à Korça, ont été construites de telles habitations à deux étages.

Si l'on compare ces constructions avec celles contemporaines des autres villes des Balkans, nous allons constater l'influence vernaculaire de nos habitations à un tel degré, qu'elles apparaissent comme une suite ultérieure des constructions albanaises de la tradition, où se mettent en évidence beaucoup d'éléments architectoniques, décoratifs et artistiques communs d'une longue continuité. Le trait caractéristique de ces habitations est la symétrie: au centre se développe le volume principal et des côtés s'élèvent des volumes égaux. Ce style, tant qu'il a pu se répandre dans notre pays, fait partie dans une certaine manière, à la période des constructions à la veille de la Renaissance Nationale Albanaise. Le principe de l'architecture des habitations symétriques de Berat et plus tard de Voskopoja et Elbasan, se rencontre aussi à Korça parce que le mode de vie presque pareil de ces villes a dicté dans une certaine mesure la construction des éléments architectoniques similaires. On rencontre le même type d'habitation dans d'autres villes telles, Elbasan, Tirana, Kruja, Durrës.

A Gjirokastra aussi, ce style a été assimilé par l'architecture vernaculaire en se développant en plusieures variantes quant'au volume et à la grandeur. Ainsi ont été créées de rares valeurs architectoniques et des volumes intérieurs aux réalisations artistiques particulières.

On rencontre de telles habitations même dans les villes de Kosove, Prizren, Pejë, Gjakovë etc. Même là ce style s'est fusionné avec les constructions du pays en gagnant de nouvelles valeurs dans l'art de la construction.

Tout d'abord ce style a créé des habitations à saillie de toute la façade de l'étage supérieur et à grand nombre de fenêtres, l'une à côté de l'autre, ce qui est typique pour la ville de Berat (f. 3). Plus tard, au début du XIXe siècle, apparaissent les habitations à saillie dans la partie centrale de l'étage supérieur.[14] Les traits architectoniques qu'on rendontre le plus souvent dans l'habitation de Korça, tels la saillie de l'étage supérieur, l'arc de la partie centrale du toit, les parois légers des deuxièmes étages, les bandes verticales et horizontales en bois des façades etc. sont une suite de l'architecture de notre Renaissance Nationale, s'adaptant le mieux possible aux conditions du terrain et du climat.

Le fait que ce type d'habitation s'est développé au début du XIXe siècle, dans tous les pays des Balkans occupés par les ottomans, montre qu'il apporte quelque chose de nouveau dans le mode de vie et qu'il est lié aux nouvelles idées insurrectionnelles des peuples qui luttaient pour leur liberté nationale. L'habitation à erker n'a pas interrompu le développement de l'architecture albanaise. Au contraire elles l'a poussé en avant en lui donnant un nouveau contenu fonctionnel et estétique qui est une suite dans les principaux compositions de notre habitation traditionnelle.

L'habitation à deux étages de l'ensemble dont nous traitons est une construction particulière, un exemplaire unique parmi les constructions de Korça du milieu du XIXe siècle comme schéma de construction, elle est le développement le plus poussé des constructions urbaines à deux étages, avec les murs en pierre et partiellement avec des cloisons dans les façades principales, où se trouvent une série de fenêtres, dans notre cas trois pour chaque volume. C'est une évolution planimétrique acceptable pour le climat de Korça (tab. III).

Beaucoup d'éléments non cachés et évidents même avant la restauration démontrent que du côté droit, l'habitation a eu trois fenêtres lesquelles ont été détruites à cause de quelque incendie ou autre chose, diminuant le volume de ce côté. Ainsi cette façade a été symétrique (f. 6), en conséquence, nous avons à faire à une construction symétrique où le volume de la partie centrale de la façade s'élève plus haut que dans les deux autres côtés symétriques. Dans cette habitation se fait remarquer la formulation architectonique et l'élégance des formes qui se distinguent surtout à la partie centrale de la façade qui forme l'encorbellement et qui est composée de trois arcs appuyés sur deux colonnes, tandis que les côtés latéraux reposent sur deux murs en pierre (f. 7).

En développant davantage cette habitation symétrique à encorbellement, nous remarquons graduellement qu'avec le temps le besoin est né d'améliorer sa fonction en faisant sortir l'escalier autant que possible en dehors du tchardak. Cette solution a créé les conditions d'améliorer encore plus la composition de ce type d'habitation urbaine et ainsi les premières formes de l'encorbellement apparaissent. Mais, comme nous l'avons déjà vu l'encorbellement au centre de la façade exige toujours

Do Not Copy

une configuration symétrique de la planimétrie de l'habitation où la partie en saillie est le développement du tchardak.

Plus tard, comme résultat de l'évolution de l'habitation urbaine en général et de l'encorbellement en particulier, surtout à la fin du XIXe siècle, nous trouvons à Korça des habitations dans lesquelles l'encorbellement constitue le principal composant de l'escalier d'entrée, même dans les cas d'habitations à escalier monumental où ces sortes de balcons formés, s'appuient sur des colonnes, créant ainsi des solutions architectoniques assez remarquables.

Revenant à notre habitation, nous remarquons que la planimétrie des deux étages nous donne une solution symétrique, à part la mutilation faite, pendant les reconstructions ultérieures de la partie à droite. Le rez-de-chaussée est lié au premier étage par un escalier qui part de l'arcade droite de l'entrée sortant au tchardak du premier étage où généralement utilisait un store en bois pour former cette espace de lumière. Du tchardak on fait accès à quatre pièces et au moyen de quelques marches on passe à un autre volume qui mène à l'encorbellement de la façade principale. Notamment ce volume et le tchardak forment le volume central de l'habitation.

Comme dans toutes les autres habitations traditionnelles, le rez-de-chaussée a servi à garder les prévisions à faire la cuisine, à faire la lessive etc., tandisque le premier étage servait d'habitation à la famille; la pièce avec cheminée où on recevait les hôtes, et les deux chambres à coucher (tab. IV). Dans les deux chambres latérales se trouvait le placard, la cheminée en face de la porte d'entrée et les trois fenêtres qui donnaient sur la cour. Quant'aux deux autres chambres d'en face, celle du côté gauche a servi de «bonne chambre», tandis que l'autre du côté droit, de chambre à coucher. L'encorbellement était un lieu de repos de divertissement, mais en cas de fêtes de famille on y méttait l'orchestre.

Avec le temps, quand la famille s'est agrandie et les chambres de l'étage supérieur ne satisfaisait plus ses besoins d'habitations, il a été nécessaire de faire une reconstruction de l'habitation en ajoutant d'autres volumes. Ainsi les deux caves latérales se sont transformées en chambres. Elles ont été munies de placards des deux côtés des portes et pavées de plancher s'élevant ainsi au dessus du niveau des caves. Cela est une deuxième phase du fonctionnement de l'habitation qui a apporté des changements même dans la façade. Il ne faut pas négliger le fait que les fenêtres du rez-de-chaussé ne sont pas dans le même axe que celles du premier étage (photo 8). Il est clair que ces fenêtres sont ouvertes plus tard. Il ne nous semble pas juste d'accepter que ces fenêtres sont laissées ainsi par les maîtres constructeurs quand nous voyons que ces mêmes maîtres ont construit une telle habitation si parfaite et symétrique. Un autre argument qui prouve que les caves au début étaient inhabitées est aussi le fait que le niveau des caves latérales était deux marches plus bas que le niveau de la cour, tandis que les deux caves frontales, s'enfoncent encore de trois marches de plus. Ces deux arguments jettenet la lumière sur un fait assez important qui atteste qu'il y a eu une phase de reconstruction qui a eu lieu notamment pendant les dernières décennies du dernier siècle, avec le commencement des mariages des enfants.

La maçonerie périmétrale en pierre s'élève avec des bandes en bois placées à une distance d'environ 1 m et le matériel liant est en partie en boue et vannure et en partie en boue mêlée à un pourcentage de chaux. La façade principale du prémier étage est plus traitée et ses parois sont des cloisons, une construction légère avec beaucoup d'avantages surtout pour la fixation des éléments décoratifs dans les intérieurs aussi bien que sur les façades extérieures. Le traitement décoratif des intérieurs et de l'éxtérieur de l'habitation de Korça en général est modéré, mais dans notre cas où nous avons à faire à une réalisation plus avancée quant'à l'évolution de l'architecture de l'habitation, la solution décorative revêt des valeurs importantes d'autant plus lorsque le traitement décoratif se combine avec la construction même. L'entrée monumentale de l'habitation est un cas qui mérite une attention particulière. L'arc du milieu a une flèche plus grande et domine les deux autres (photo 9). Dans cette composition en pierre, avec une pleine symétrie qui s'harmonise avec la symétrie de l'habitation, on sent la finesse et l'élégance de l'architecture qui rend plus léger le poids du volume de l'encorbellement qui se trouve au-dessus. C'est précisément là qu'on rencontre les valeurs décoratives qu'on ne trouve pas dans les anciennes constructions de Korça, bien que nous ayions dit plus haut que leurs exemplaires sont assez rares à l'heure actuelle. Et ces valeurs ne sont pas simplement professionnelles, on sent chez-elles le sentiment d'une construction plus courageuse au point de vue d'engineering et plus souple comme conception architectonique.

Un autre élément qui garde des valeurs constructives particulières est le noeud qui supporte la poutre console au-dessus de laquelle s'élève l'encorbellement (photo 10). Même ici, apparait très clairement la pensée avancée, laquelle arrive à créer un support où les éléments en bois sont traités avec finesse (photo 11) et l'étendue horizontale des éléments est réalisée avec netteté.

Le «tchardak fermé» vu le type d'habitation de la région de Korça, lui est imposé, tant sur le point de vue morphologique que pour les facteurs socio-économiques et autant que tel il a justifié sa fonction dans le temps et dans l'évolution architectonique des formes et des structures où il fait partie. Dans notre cas, le «tchardak» ne sert pas seulement de noeud par où l'on passe dans les autres volumes du rez-de-chaussée, ou du dehors dans ceux du premier étage, mais par l'intermédiaire de celui-ci on communique avec le volume de devant, console, qui par la fonction et la forme dans le type d'habitation en question n'est pas autre que la «sofa», laquelle petit à petit a évolué devenant un volume fermé utilisé par la famille pour repos et distraction.

Les éléments décoratifs dans l'ornement du «tchardak» sont présentés de la même élégance que ceux dont nous avons vus dans les éléments traités ci-dessus. La rampe en bois de l'es-

DO NOT COPY

calier ainsi que le chapiteau où se pose la poutre du plafond non seulement est d'un dessin serré mais elle crée également quelque chose qui aide dans la transparence entre les deux volumes «le tchardak» et «le sofa».

* * *

De ce qu'on a pu argumenter ci-dessus, il ressort que cette habitation à deux étages, construite dans la première moitié du XIXe siècle, est une construction non seulement à bonnes relations au point de vue d'engineering et artistique, mais elle marque un point de transition vers le développement de l'habitation urbaine de Korça et ouvre le passage au style d'habitations symétriques à saillie sur la façade principale suivant laquelle on a créé de multiples variantes qui ont développé ce type de construction au cours de la deuxième moitié du XIXe siècle.

Pour conclure, on peut dire que les constructions urbaines de Korça au cours de la première moitié du XIXe siècle ne doivent pas être considérées seulement au point de vue économico-sociale mais aussi dans la morphologie de l'habitation urbaine et rurale elle même, dans les conditions du climat et sous l'influence de l'architecture des régions limitrophes.

L'habitation à trois étages de type «kulle» (tour) de l'année 1870

Nous avons mentionné plus haut que d'après un témoignage oral, sur la principale façade, au-dessus de la porte du balcon du troisième étage, se trouvait écrite sur le mur, la date de construction «Juillet 1870». Ainsi, cette habitation à trois étages a été construite environ trente années plus tard que la première habitation et sa construction est de type «kullë» (tour). Ces constructions n'ont pas de traits défensifs bien que conforme à leurs fonctions, elles aient des proportions qui s'approchent du parallélépipède. La solution planimétrique et sa composition volumétrique nous donnent le type de la «kulle» rurale (fig. 18) du dernier siècle que nous rencontrons aussi dans les autres villes. Ainsi pendant cette période plus ou moin courte de 30 ans, nous avons deux habitations qui diffèrent beaucoup, soit comme conception architectonique et fonctionnelle, soit comme technologie de construction. Cela est un argument de plus qui atteste que la ville de Korça seulement pendant la deuxième moitié du dernier siècle s'est développé autant que ville à haut niveau économique et culturel, et en tant que centre administratif important. Ce qui est caractéristique pour cette «kulla» urbaine, c'est qu'elle ne s'élève plus à l'intérieur du terrain et elle n'est plus entourée de la cour, mais elle a deux façades qui donnent sur la rue publique (tab. IV). Beaucoup de composants fonctionnels de la «kulla» tels les volumes de service au rez-de-chaussée, les escaliers intérieurs pour les trois étages, les chambres etc., sont nettement exprimés du point de vue architectonique dans cette construction si majestueuse et si solide avec une gamme de volumes et de nombreux éléments architectoniques. Il faut mentionner la cour intérieure à l'entrée de la «kulla» au centre de laquelle s'élève une colonne à section carrée surmontée de trois architraves au-dessus desquelles s'élèvent les murs des façades nords-ouests de l'habitation. Ainsi on a pu créé une cour intérieure typiquement albanaise.

Du point de vue constructif, les murs du périmètre sont en pierres sur les trois étages et sont liés de tirants métaliques au niveau du plafond de chaque étage comme une mesure antisismique (fig. 20). Les coins des murs sont construits en pierres gravées aux mêmes dimensions. Cette habitation s'enrichit de beaucoup d'éléments architectoniques et décoratifs en bois, en fer et en pierre. Les deux premiers étages de cette tour ont eu des volumes avec des décorations qui représentaient des colonnes où s'enchevêtre quelque motif floréal. On rencontre aussi dans la chambre du premier étage quelques fragments d'une décoration de plafond sans grande valeur artistique (fig. 23).

La construction de cette habitation à trois étages a été dictée tout d'abord par la croissance de la famille et puis par le désir d'habiter des volumes plus large, plus commodes et plus éclairés. Le deuxième facteur résulte du développement continnuel et ininterrompu au point de vue économique, social et culturel de la bourgeoisie de la ville et surtout de cette partie qui avait des rapports avec l'étranger. Les dernières décennies du XIXe siècle ont apporté avec elles aussi des rythmes de construction plus accélérés dans la ville de Korça. La plupart des habitations construites pendant ce temps-là sont à deux étages. Ces belles constructions ont attiré beaucoup de bons maîtres (des régions alentour de Korça) pour construire la maçonerie et graver les éléments décoratifs, en bois, en pierre et en fer battu. Entre temps le nombre d'apprentis qui étaient les auteurs talentueux des projets de ces habitations s'est accru. Ainsi la ville de Korça s'est épannouie très vite et à la fin du siècle elle a atteint le nombre de 2027 maisons.

La cour de l'habitation de type «kulle» s'étend dans tout le complexe jusqu'aux étables qui se trouvaient sur son côté nord. Des traces d'anneaux où l'on attachait les chevaux, ou des endroits où ils se reposaient, se distinguent aujourd'hui encore. On raconte qu'à travers la porte cochère autrefois entraient les carrosses tirées d'un ou de deux chevaux.

Le besoin de conserver ce précieux héritage culturel de l'architecture traditionnelle de la ville de Korça, a exigé sa restauration laquelle a redonné à cette habitation les valeurs architectoniques et constructives partiellement perdues. Ajourd'hui cette habitation s'élève avec dignité, comme une construction particulière de la deuxième moitié du dernier siècle (fig. 26 et 27).

Les monuments de culture sont un héritage très précieux du peuple et en tant que tels ils méritent une attention particulière pour que l'étude et l'observation des valeurs historiques, architectoniques et artistiques soient optimales. Dans le cas de notre ensemble, malgré le traitement artistique des éléments particuliers dans une certaine mesure réservé, nous avons de bons résultats du point de vue historique et architectonique surtout

en ce qui concerne le rapport harmonieux d'un volume à l'autre et vice-versa. Tandis qu'en voyant sa fonction et son architecture, nous pensons qu'il serait plus juste de dire que les exigences d'un meilleur mode de vie étaient de premier ordre et s'harmonisaient bien avec le développement de la ville pendant la deuxième moitié du dernier siècle. Ainsi cette construction si avancée est le fruit de son époque.

Ces sondages et d'autres qui peuvent s'effectuer serviront d'arguments pour la destination des volumes pendant la transformation de cet ensemble en un musée.

Le prochain musée ethnographique et folklorique de la ville de Korça

La contrée de Korça présente une variété dans le domaine des traditions et de culture populaire, ainsi que dans les autres genres particuliers tels que le folklore, l'ethnographie, le mode de vie et les instruments de travail et l'habitation populaire. Toute cette mosaïque de valeurs matérielles et culturelles, qui constitue un fond rare pour les études dans le domaine économique et social, prendra place dans cet ensemble particulier de manière à ce que même l'architecture des deux habitations se fusionne avec les objets exposés.

De même, l'existance des deux habitations particulières crée la possibilité que la maison à deux étages se complète de toutes ces pièces, avec les équipements complets d'une habitation de la deuxième moitié du siècle passé tels les tapis, les couvertures en laine, les lampes, les chaises etc., en un mot, créer une ambiance réelle de cette époque-là. Il faut compléter aussi les volumes de service, recréer les étables d'autrefois, les «sofas» de pierre sur les deux côtés de la rue, la cour pavée de dalles et les lampadaires à pétrole dans la cour et à la porte d'entrée.

Tandis que l'habitation de type «kulla» avec ses larges et hauts volumes des deux premiers étages peut servir d'exposition complète de l'invetaire le plus typique de notre culture populaire. On peut utiliser ici des vitrines, des podiums etc.

Cette exposition de la culture populaire sera complétée quant à la cour qui entoure cet ensemble seront crées quelques éléments du village en nature tels la chaumière du paysan, le moulin, la bergerie, le puits, la fontaine etc. Cela rendrait plus complète l'idée d'un musée ethnographique et folklorique pour cette période de temps précise, où de pair avec le développement de la ville apparaîtra en antythèse la pauvreté, la misère, l'exploitation des paysans.

Cet ensemble représente un intérêt particulier du point de vue architectonique, comme un maillon de passage de l'architecture de l'habitation urbaine de la fin du XVIIIe siècle à celle de la fin du XIXe siècle, et du commencement de notre siècle. Les schémas fonctionnels constructifs de ces deux différents types sont la suite logique du schéma de base de notre habitation populaire. Mais il faut souligner encore une fois que de la construction à trois étages ressort l'idée et le talent visant à l'élever le plus majéstueux possible, en l'adaptant bien aux exigences de l'urbanisme de la ville, comme une construction pleine de lumière et d'espace.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Genc SAMIMI

KAMERIETË E QYTETIT TË BERATIT

Në kompozimin e banesës beratase me program të zhvilluar përfshihej edhe një ambient i hapur me emërtimin kamerie, i cili kishte funksionet e tij. Thellimi i mëtejshëm në studimin e këtij ambienti ka qartësuar mënyrën e kompozimit, skemën e ndërtimit, zgjidhjet e ndryshme arkitektonike si dhe funksionin, zhvillimin në kohë dhe raportin me pjesën tjetër të banesës në të cilën bën pjesë.

Kameriea është një shesh qëndrimi, soditjeje e vëzhgimi, e pa mbuluar, rrethuar plotësisht, ose pjesërisht me parapete prej guri të trajtuar arkitektonikisht me kujdes duke krijuar mundësinë e mbjelljes së luleve. Ajo është ndërtuar duke shfrytëzuar mbulimin me qemere guri të ambienteve shumë të vegjël të katit përdhes. Në tre lagjet muze të Beratit, Kala, Mangalem, Goricë ruhen të plota disa kamerie si dhe shumë fragmente, gjurmë dhe pjesë kameriesh të dëmtuara. Në programin e banesës beratase kamerieja si vend pushim i hapur i rrethuar me lule, ka hyrë me kohë.

Kameriea (fig. 1) ndërtohet mbi katin përdhes. Nën të ndodhen gjithmonë një ose dy ambiente shumë të vegjël të mbuluar me qemere guri, që shfrytëzohen për qëllime të ndryshme. Zakonisht nën sipërfaqen e kameriesë përfshihet dhe porta e jashtme e banesës[1] karakteristikë kjo për banesën beratase, duke marrë pjesë plotësisht në kompozimin e banesës. Kameriea është e shtruar me pllaka guri të zeza. Kamerieja në përgjithësi i bashkëngjitet banesës dhe shumë rallë ndërtohet e veçantë. Ndërlidhja e kameriesë me banesën, ose shfrytëzimi i saj është zgjidhur në mënyra të ndryshme. Kur në kamerie ngjitesh nga kati përdhes, ajo është e pajisur detyrimisht me shkallë, të cilat janë të vendosura përbri ose larg hyrjes (fig. 2) për banesë. Ndeshen edhe raste kur ka-



Fig. 1

1. E. Riza, **Banesa popullore në qytetin-muze të Beratit,** Monumentet 1, 1981; E. Riza, **Kamerietë në banesën qytetare shqiptare,** në «Traditat ndërtimore në Shqipëri» 1981.



Fig. 2



Fig. 3

meriea nuk është e pajisur me shkallë dhe sipërfaqja e saj lidhet drejtpërdrejt me ambientet e banimit. Shpesh shkallët e banimit përdoren njëkohësisht edhe për kamerienë. Në përgjithësi sipërfaqja e kameriesë është me konfiguracion katërkëndësh kënddrejtë, por nuk mungojnë dhe format e çrregullta trapezoidale, që kanë nxjerrë në pah shfrytëzimin racional të vendit të ndërtimit.

Me interes është se si është zhvilluar edhe mënyra konstruktive dhe dekorative e pjesës së parapetit të ballkonit që krijon vend për mbajtjen dhe rritjen e luleve. Gjithmonë, kameriea në drejtimin e pamjes nga rruga, është konstruktuar me pllaka guri të dala konsol, të cilat formojnë korniza me profile të ndryshme. Kështu e gjithë pjesa ku mbillen lulet është zhvendosur nga muri i katit përdhes. Një zgjidhje e tillë konstruktivo-arkitektonike nuk është kërkuar zakonisht në pjesët e muraturës së kameriesë që nuk rrihen nga syri i kalimtarit si p.sh. në anët e brendshme të kameriesë. Pllakat e gurit të dala konsol në profil kanë forma të ndryshme me hark nga jashtë, të pjerrët dhe hark nga brenda, ose me kombinimin e tyre (Tab. I). Kuptohet qartë se kjo zgjidhje është bërë nga dëshira për të krijuar diçka të bukur. Më vonë konstruksioni mbajtës i parapeteve të muraturës së luleve gjatë zhvillimit dhe përsosjes së ti ka krijuar skema të tjera më të vështira e të dekoruara, me konsola e profile me dy shkallëzime të gdhendura në formë harku nga brenda, ose nga jashtë. Përveç zgjidhjes me pllaka guri të zeza, konsoli mbajtës i parapetit të luleve është ndërtuar edhe me konsola prej guri, d.m.th. kur trashësia e konsolit kalon trashësinë e pllakës. Në këto raste, gdhendja e konsolit është realizuar me një përkujdesje më të madhe duke arritur në dekoracion me forma të tilla ku gur është gdhendur dhe punuar në mënyrë të njëjtë s kapitelet prej druri të shtyllave të banesave me çardak (Tab. I).

Muratura e parapetit mbajtës të ballkonit të luleve, është zgjidhur në dy mënyra. Mënyra e parë është ajo me pllaka guri të zeza të gdhendura në formën e katërkëndëshit kënddrejtë, me trashësi rreth 8 cm të vendosura në këmbë dhe të lidhura me gan xha hekuri të fiksuara me plumb. Sipas kërkesave dhe mundësive që lejonte guri i zi, në gdhendjen e pllakës tregohej kujdes deri në punime të imëta. Mënyra e dytë e ndërtimit të parapetit është me rreshta gur të bardhë, të gdhendur drejt duke formuar një mu që arrinte nga dy në pesë e më shumë rreshta (Fig. 3) Në distancë rreth një metër bëhej lidhja tërthore muraturës së parapetit (Fig. 4).

Mënyra e nxjerrjes konsol të pllakave prej gur ka gjetur përdorim të gjerë në shumë fagje të qyteti të Beratit. Ajo ka siguruar mundësinë e mbajtjes dh

DO NOT COPY



Fig. 4



Fig. 5



Fig. 5



Fig. 6

DO NOT COPY

rritjes së luleve poshtë dritareve (fig. 5). Gjithashtu kjo mënyrë është trajtuar dhe përdorur për sigurimin dhe mbrojtjen nga rreshjet e shiut të portave të jashtme të banesës e sidomos të atyre pa oborr, ku muratura e banesës vazhdon mbi portën e jashtme. (fig. 6).

Duke parë dhe analizuar materialin mbi shembujt e ndryshëm të kamerieve që ruhen sot në tre lagjet muze të Beratit klasifikimi i tyre mund të bëhet në shumë drejtime; duke pasur parasysh numrin e ambienteve poshtë sipërfaqes së kameriesë, d.m.th. me një, dy apo tre të tillë, duke pasur parasysh vendosjen e kameriesë në lidhje me banesën si dhe mënyrën e sigurimit të ndërlidhjes me sipërfaqen e kameriesë. Klasifikime mund të bëhen duke pasur parasysh edhe specifika të ndryshme të kameriesë si mënyra e vendosjes dhe konstruimit të ballkonit të luleve, apo raportit të kameriesë me portën e jashtme.

Duke kuptuar me termin kamerie vetëm sipërfaqen e qëndrimit dhe jo krejt volumin e ndërtimit, vetëkuptohet që nuk mund të bëjmë klasifikimin e kamerieve si ato të Gjirokastrës.[2] Por edhe në qoftë se do të pranojmë për një moment kuptimin e termit kamerie si volum ndërtimi përsëri tipet e ndryshme të banesës beratase, në përgjithësi nuk kanë karakter mbrojtës për vetë natyrën ekonomike të kësaj qendre zejtaro-tregëtare, ku sistemi esnafor ishte i zhvilluar.

Për këtë arsye mendojmë se më i përshtatshëm do të ishte klasifikimi i kamerieve në funksion të ndërlidhjes me sipërfaqen e saj. Lidhur me këtë kriter, atëhere do të kemi: Kamerie në të cilat ndërlidhja sigurohet nëpërmjet shkallëve të veçanta dhe kamerie në të cilat ndërlidhja sigurohet drejtpërdrejt nga ambientet e katit të parë.

Megjithkëtë, ruhen disa shembuj banesash në të cilat shkallët i shërbejnë njëkohësisht banesës dhe kameriesë. Kështu në kamerienë e paraqitur në Tab. II, a, shkallët të ngjisin njëkohësisht si në derën e hyrjes për në banesë ashtu dhe në sipërfaqen e kameriesë. Kjo e fundit është bashkëngjitur me banesën dhe është datuar nga fundi i shek. XVIII.[3] Kameriea siç duket nuk i ka plotësuar kërkesat prandaj më vonë sipërfaqja e saj është shtuar nga 8.4 m^2 në 18.2 m^2. Për mendimin tonë kjo shtesë është bërë re-

2. E. Riza, **Qyteti muze i Gjirokastrës,** Tiranë 1981.
3. E. Riza, H. Nallbani, **Një ndërtim i tipit kullë në Berat,** Monumentet 10, 1975.

lativisht shpejt mbas ndërtimit të banesës, siç tregon punimi i konsolave. Shtesa vihet re jo vetëm nga fuga[4] por edhe nga muratura e parapetit të luleve i cili në pjesën fillestare është ndërtuar me pllaka guri të zeza, të vendosura vertikalisht, ndërsa shtesa është me teknikën e rreshtave të drejtë punuar me gurë të bardhë. Sipërfaqja e kameriesë është katërkëndëshe kënddrejtë e shtruar me pllaka guri të zeza dhe është përftuar nga shfrytëzimi i pjesës së sipërme të dy qemereve të bashkëngjitur prej guri. Pjesa e poshtme e tyre është e hapur.

Kamerieja e paraqitur në Tab. II, b, është e thjeshtë. Sipërfaqja e shfrytëzimit në formë trapezi është ngritur mbi dy qemere prej guri. Poshtë njërit nën sipërfaqen e dyshemesë së tij është ndërtuar një sterë. Qemeret janë të hapur në dy krahë, ndërsa njëri krah mbyllet me murin e oborrit dhe tjetri me murin e fqinjës. Shkallët e përbashkëta si për banesën ashtu dhe për kamerienë janë me kthesë dhe rampa e dytë është zgjidhur si në banesat me çardak, me skemën e qemerit çerek rrethor prej guri. Kameriea i bashkëngjitet banesës. Punimi i ballkonit të luleve është i thjeshtë, ai nuk del jashtë sipërfaqes së muraturës vertikale por zbukurohet me dy rreshta gurësh që dalin konsol mbuluar me një pllakë guri. Ky dekoracion është bërë vetëm në anën e rrugës.

Kameriea e tretë që paraqesim (Tab. III, a) është më e ndërlikuar në ndërtim se të parat. Mjeshtri në këtë rast ka zgjidhur mirë arkitektonikisht dhe funksionalisht ndërtimin dhe ka arritur përfundime me vlerë në shfrytëzimin e sipërfaqes që kishte në dispozicion. Nën sipërfaqen e kameriesë përfshihen porta e jashtme e banesës dhe dy ambiente mjaft të vegjël njëri prej të cilëve shfrytëzohet si ambient sanitar. Ndërtuesi me anën e kameriesë ka mundur që sipërfaqen e oborrit të çrregullt ta kthejë afërsisht në sipërfaqe të rregullt katërkëndëshe. Shkallët që shërbejnë vetëm për kamerienë janë të ngushta rreth 65 cm, me skemën e çerek qemerit dhe me lartësi bazamaku mjaft të lartë. Porta e hyrjes për në banesë është e mbuluar me hark prej guri, ndërsa gjerësia e murit kufizues të portës është e mbuluar me qemer të shtrirë në mënyrë që sipërfaqja e sipërme të shfrytëzohet për kamerie. Dy ambientet e vegjël janë mbuluar me qemer gjysëm rrethor. Kameriea e përftuar mbi këto ambiente ka sipërfaqe të çrregullt trapezoidale pa vendin e portës. Konsolat e ballkonit të luleve të kameriesë janë të thjeshtë me pjerrësi ndërsa ato të mbulesës së derës me hark kanë dy funksione pjesërisht për të dalur dhe formuar dhëmbëzimin e murit të kameriesë dhe pjesërisht për të mbrojtur nga rreshjet kanatet e portës. Ujërat e shiut në sipërfaqen e kameriesë mblidhen në një pikë të fasadës dhe nëpërmjet një lugu në formën e një sqolli derdhen jashtë. Në anën e brendshme kameriea nuk ka konsola prej guri. Sot si parapet mbrojtës shërbejnë parmakë hekuri.

I vetmi ekzemplar që kemi takuar deri më sot me vendosje të shkëputur nga banesa ndodhet në lagjen Kala (Tab. 6, III, b) (Fig. 7). Në kompozimin e saj sipërfaqja e kameriesë përfshin shkallët prej guri (Fig. 8) të zgjidhur me skemën e zakonshme, gjithashtu poshtë saj portën e jashtme të banesës dhe një ambient të vogël me sipërfaqe 2.6 m^2. Sipërfaqja e



Fig. 7



Fig. 8

4. H. Nallbani, E. Riza, **Po aty**, f.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 9

pushimit është përftuar mbi mbulimin me qemer guri të ambientit të poshtëm i cili përdorej si depozitë për materiale të ndryshme. Vendpushimi është i rrethuar në të katër anët me lule, përveç vendkalimit të shkallëve. Konsolat, parapeti, lulet që e rrethojnë kamerienë tregojnë se ajo soditej në të katër anët nga kalimtarët, dhe me të vërtetë pozicioni i saj lidhur me vendosjen karshi rrugicave është e tillë që ajo soditet në të tre anët. Konsolat prej pllakash guri të ballkonit të luleve, ngjyrë gri, janë të gdhendur me pjerrësi nga brenda, ndërsa parapeti është i ndërtuar me dy rreshta gurësh. Kjo kamerie datohet në vitin 1827. Data është e vendosur mbi harkun e portës në mesin e saj mbi një pllakë guri të zezë. (Fig. 9). Banesa së cilës sot i përket kjo kamerie është një rikonstruksion por mendojmë se edhe banesa e parë nuk ka pasur lidhje direkte me kamerienë.

Përhapje më të gjerë ka grupi i dytë me kamerietë në sipërfaqen e të cilave kalohet nga ambientet e ndryshme të banimit, d.m.th. që nuk kanë ndërlidhje direkte me shkallët që të ngjisin në banesë. Në përgjithësi këto kamerie kanë shfrytëzuar dhe sipërfaqen që krijohet nga mbulimi i portës së jashtme me qemer.[5]



Fig. 11



Fig. 10

Një kamerie tjetër (Tab. 7, IV, a) (fig. 10) në lagjen Goricë, është me sipërfaqe të rregulit katërkëndësh kënddrejtë dhe lidhet me një derë dykanatëshe në mesin e dhomës së mirë të banesës. Me intuitë dhe duke përvetësuar mënyrën e kompozimit dhe të konstruimit të njërit krah të kishës tip kryq i brendashkruar është përfituar sipërfaqja e vendpushimit dhe soditjes së kameriesë. Në katin përdhes, siç shikohet nga planimetria, është ndërtuar një mur gjatësor në ndërprerjen e të cilit është vendosur hapësira e portës së jashtme. Përkundrejt tij në distancë rreth 130 cm, janë ndërtuar dy kollona prej guri. Muri gjatësor dhe kollonat lidhen respektivisht në lartë-

5. L. Suli **Banesa e vjetër e zonës së Konispolit,** në «Monumentet historike në vendin tonë», Tiranë 1978.

si ndërmjet tyre me qemere guri (Fig. 11), në mënyrë që të krijojnë bazament për ndërtimin e qemerit të madh në drejtim tërthor me të parët. Sipërfaqja e sipërme e këtij qemeri është shfrytëzuar për kamerienë. Në drejtim të rrugës kameriea është e pajisur me parapetin prej guri në formë konsoli ku janë mbjellë lulet, ndërsa në anën perëndimore është krijuar një pezul me gjerësi 60 cm mbi të cilin mund të ulesh ose të vendosësh vazo lulesh. Në fund muratura e parapetit është e ndërtuar me dy rreshta gurësh. Nga brenda parapeti ka lartësinë 60 cm. Ujërat e rreshjeve të shiut mblidhen në një pikë, ku nëpërmjet një lugu në formë sqolli zbrazen në pjesën ballore. Sipërfaqja e kameriesë ka lartësi të konsiderueshme dhe kjo rrjedh se terreni nuk është i thyer por i rrafshët e mbulohet shikimi, soditja përtej vargut të përparmë tij. Kështu me anën e konstruksioneve prej tubash dhe ulluqesh llamarine ku përmblidheshin ujërat e rreshjeve të sipërfaqes së çatisë ajo mbushej dhe shfrytëzohej nga një lëfyt në formë muslluku nga poshtë. Në sipërfaqen e pushimit të kameriesë është lënë vendi i futjes për pastrimin e sterës. Sot ndërlidhja me banesën është zënë, dhe ajo kryhet nëpërmjet dritares. Parapeti i ballkonit të luleve është përfituar nga konsola guri të gdhendur në mënyrë të pjerrët dhe rreshta gurësh që krijojnë parapetin për mbjelljen e luleve. Në pamjen ballore të kameriesë dallohen mjaft mirë tre ganxha hekuri që shërbejnë për të fiksuar tre tiranta metalike që shërbejnë për të mbajtur sforcimet tërheqëse të qemerit të kameriesë si dhe të sterës kur mbushej me ujë.

Në banesat me çardak, ndërtimi i kameriesë du-



Fig. 13



Fig. 12

të banesave gjatë pushimit. Kameriea ze të gjithë sipërfaqen ballore të banesës.

Në lagjen Kala (Tab. IV, b) gjendet një kamerie, e cila është ndërtuar në pjesën midis dy krahëve të banesës. Nga pozicioni i vendosjes ajo ngjan plotësisht me ato të qytetit-muze të Gjirokastrës. Pjesa e poshtme e saj, duke pasur parasysh që kjo lagje ka vuajtur për ujë, është shfrytëzuar për grumbullimin e

het të ketë marrë parasysh pa tjetër kërkesën për të krijuar një vend pushimi, qëndrimi e soditjeje të pambuluar. Qëndrimi në çardak, nën strehë e ka shqetësuar në një farë mënyre banorin e saj dhe ky e ka plotësuar kërkesën e tij me ndërtimin e kameriesë. Në rastet e tilla në Berat në sipërfaqen e shfrytëzimit të kameriesë kalohet nga çardaku (Tab. V, a) (fig. 12). Kalimi është siguruar mbi një qemer guri për t'u li-

POOR COPY

DO NOT COPY



Fig. 14



Fig. 15

dhur me kamerienë. Ballkonet e luleve janë përftuar me konsola prej pllakash guri të zeza dhe parapeti prej dy rreshtash guri. Kjo kamerie ishte pjesërisht e dëmtuar (fig. 13). Gjurmët e sigurta lejuan plotësimin e saj. U konkludua se kjo kamerie nuk është ndërtuar njëkohësisht me banesën. Në një periudhë të dytë, duke u mbyllur me muraturë guri një hark që ishte ndërtuar për shkallët e banesës, u krijua mundësia e ndërtimit të një qemeri i cili solli ndërtimin dhe komunikimin me sipërfaqen e kameriesë nëpërmjet çardakut. Kameriea në këtë banesë ka lindur si sipërfaqe e qetë pushimi megjithëse brenda çardakut ka pasur të tillë. Në çardak në drejtimin e murit që mbyll një anë të tij ekzistojnë vende të qeta pa rryma kalimi. Ndërtimi i kameriesë ka krijuar një strehë të siguruar sipër grykës së pusit.

Në një banesë të variantit me çardak të lirë (Tab. V, b) (fig. 14, 15), sipërfaqja e kameriesë është vendosur në drejtimin tërthor me çardakun. Poshtë sipërfaqes së kameriesë janë dy hapësira të mbuluara me qemer. Në atë më të madhen është vendosur porta e banesës. Nga rruga duken mjaft mirë konsolat e ballkonit që janë ndërtuar me pllaka guri të zeza të thjeshta të gdhendura me pendencë të ëmbël, ndërsa parapeti është me rreshta guri. Kameriea është mjaft e lartë dhe zotëron plotësisht rrugicën. Data e vendosur mbi kyçin e harkut të portës dhe njëkohësisht e gdhendur mbi kanatën e portës na bën të mendojmë se viti 1866 (fig. 16) është viti i ndërtimit të kameriesë dhe vetë banesës. Meqënëse kameriea është e lartë, për të mbrojtur flegrat e portës së jashtme, gjatë ndërtimit të muraturës janë vendosur katër pllaka guri konsol që si zakonisht kanë shërbyer për të krijuar strehën e portës, me të njëjtin punim si konsolat e ballkonit të luleve vetëm se më të dalë.

Në një kamerie tjetër sipër një qemeri të vetëm që vjen duke u zgjeruar në thellësi është përftuar sipërfaqja e pushimit me konfiguracion trapezoidal (Tab. VI, a) (fig. 3). Kjo sipërfaqe e çrregullt ka lindur nga vendosja e kameriesë në kryqëzimin e rrugicave. Kameriea ndërlidhet me ambientet e banimit të katit të sipërm me anën e një dere. Sipërfaqja e kameriesë është e shtruar me pllaka guri të zeza. Parapeti i ballkonit të luleve është i ndërtuar me shumë rreshta



Fig. 16

gurësh. Konsolat prej pllakash guri të zeza të ballkonit janë vendosur në dy rreshta jo si zakonisht. Ato janë të gdhendura mjaft mirë me hark nga jashtë. Vendosja e konsolave ka ruajtur lartësinë e kalimit në rrugë. Ballkoni i luleve i krijuar nga konsolat dyfishe dhe rreshtat e parapetit është i ndryshëm nga zgjidhjet e tjera arkitektonike.

Një kamerie në lagjen Mangalem është e mbuluar (Tab. VI, b). Ajo është një rast që e trashëgojmë me ndryshime në kohë. Siç duket dëmtimi i qemerit ka bërë që shesh pushimi i kameriesë të shtrohej me dërrasë dhe ajo respektivisht të mbulohej për t'u mbrojtur nga shiu dhe erërat e malit të Tomorit. Megjithatë kjo kamerie ka karakteristikë vendosjen e konsolave prej guri të parapetit të ballkonit me një ritmikë të veçantë.

Së fundi po përmendim kamerienë e datuar në vitin 1856 (Tab. VI, c) (fig. 17), që mendojmë se është data e ndërtimit të kameriesë dhe e rikonstruksionit të banesës. Kjo kamerie është ndërtuar me dy funksione gjatë adaptimit të banesës. Në radhë të parë si vend pushimi e qëndrimi dhe njëkohësisht ka shërbyer për të mbështetur dy shtyllat prej druri mbi të cilat është krijuar qoshku i sipërm i mbyllur i banesës dhe është përftuar streha dekorative e konstruimit me hark me tre qendra. Gjatë restaurimit të kameriesë në vitin 1976 është konkluduar se qemeri i kameriesë është mbështetur në muraturën e vjetër me breza

DO NOT COPY



Fig. 17



Fig. 18

druri të banesës në njërin krah (Fig. 18) dhe në krahun tjetër në një kollonë guri me seksion katërkëndësh kënddrejtë të zgjatur. Njëkohësisht në muraturën e banesës ku mbështetet qemeri është zbuluar dhe një kamare e cila tregon se muratura ka qënë e pa mbuluar. Po kështu vazhdimi i murit të portës së jashtme nuk është i lidhur me murin e vjetër të banesës por i bashkëngjitet atij. Ndërtimin e kameriesë në vitin 1856 e përforcon dhe dublimi i konsolave prej guri vetëm në vendet ku mbështeten shtyllat që mbajnë qoshkun e banesës, (Fig. 17) ndërtim i bërë vetëm për efekt të mbajtjes dhe shpërndarjes së peshës.

Muratura e ballkonit të kameriesë ka një përkujdesje më të madhe në krahasim me të tjerat. Konsolat prej pllaka guri të zeza nuk dalin nga muratura direkt por ato janë të mbështetura në një bordurë të krijuar nga një rresht pllakash guri të vendosura horizontalisht.

Nga studimi rezulton se një rëndësi të veçantë merr vendosja e kameriesë në lidhje me pozicionin që ze ajo në raport me rrugën kryesore dhe rrugicat. Vërehet në përgjithësi (Fig. 19) se nga sipërfaqja e kameriesë zotërohet mjaft mirë ambienti përreth e sidomos perspektiva e rrugës. Duke qëndruar në kamerie kontrollohet e gjithë lëvizja në rrugë dhe krijohet mundësia për të paraprirë dhe vizitorin. Kjo kërkesë e detyrueshme karshi kameriesë ka bërë që një pjesë e mirë e tyre të ndërtohet mbi sipërfaqen e krijuar mbi portat e hyrjes për në banesë. Edhe një rast i veçantë që kemi në lagjen Goricë ku kameriea është e ndërtuar pranë çardakut në oborrin e ndërtesës, ajo prapë është e vendosur në mënyrë të tillë që duke qëndruar në sipërfaqen e rrethuar me lule të saj të zotërosh të gjithë perspektivën e rrugës kryesore të lagjes drejt urës.

Kamerienë e gjejmë të ndërtuar edhe në Gjirokastër, Elbasan dhe një variant të saj mbi portën e jashtme e gjejmë dhe në fshatrat e Konispolit. Duke krahasuar kamerienë e Beratit me atë të Gjirokastrës (TAB. VIII) do të shohim se ndërmjet tyre ka ngjasime arkitektonike dhe konstruktive por ka edhe ndryshime. Në qytetin e Gjirokastrës kamerietë luanin një rol shumë të rëndësishëm në kompozimin e fasadës së banesës, sidomos ato të hapurat ndërsa në Berat kameriea merr pjesë në kompozimin planimetrik të përgjithëshëm të banesës por njëkohësisht lot një rol të rëndësishëm në kompozimin arkitektonik të rrugës. Ndryshe nga kamerietë e Gjirokastrës, ato të Beratit nuk e përdorin pjesën e poshtme për banim, vetëm ndonjëherë ajo përdoret si ambient ndihmës. Zgjidhja e kombinuar qemer, kollonë guri, si elemente konstruktivë përdoren për të dy qytetet, vetëm se në qoftë se në Berat zhvillohen në lartësinë e një kati, në



Fig. 19

Gjirokastër duke iu përshtatur banesës ato arrijnë lartësinë e dy kateve. Në Gjirokastër vendosja e kameriesë në lidhje me banesën është e përcaktuar sepse banesa gjirokastrite ka planimetri me zhvillim të rregullt. Kameriea simbas rastit mund të vendoset në njërin krah të banesës ose edhe në mesin e saj për banesa me dy krahë. Ka dhe raste kur ajo është e veçantë nga banesa. Vetëkuptohet që në të gjitha këto raste kameriea mund të ketë sipërfaqe të kon-

PDF STOP COPY

siderueshme. Në qytetin e Beratit kameriea e ka të pa përcaktuar pozicionin e saj. Ajo është funksion i planimetrisë së banesës dhe i vendosjes së saj në raport me rrugën. Planimetria e kameriesë merr forma nga më të ndryshmet por gjithmonë i bashkëngjitet banesës përveç një rasti të veçantë. Sipërfaqja e kamerieve të Beratit varion nga 2-18 m^2, por përgjithësisht ato luhasin nga 6-10 m^2, ndërsa në banesën gjirokastrite sipërfaqet janë më të mëdha.

Kameriea, sidomos trajtimi i ballkonit të luleve me një zgjidhje të larmishme arkitektonike dhe konstruktive mendojmë se nuk ka sesi të jetë diçka e rastit në banesën beratase, gjirokastrite e elbasanase, por i ka shkaqet e saja. Këto shkaqe në radhë të parë duhen kërkuar në mënyrën e jetesës e cila, ishte e tillë që kërkonte afëri të madhe me natyrën, duke futur në programin e banesës këto sipërfaqe të hapura me funksione të qartë. Duhet theksuar gjithashtu përpunimi i madh i këtyre ndërtimeve, i cili flet qartë për kulturën e pasur të banimit si një tipar që shfaqet, krahas dukurive të tjera edhe në ndërtimin e kamerieve, të cilat në Berat jo vetëm rrisin vlerat arkitektonike të banesës, por jetojnë edhe në zgjidhjen arkitektonike të rrugës.

DO NOT COPY



DETAJE TE NDRYSHME
TE KONSOLAVE NE KAME-
RIETE E QYTETIT TE Beratit

DO NOT COPY

DO NOT COPY

6




1
Kamerie
KATI I


1
12
KATI I
12


Pus
KATI PERDHE


PRERJE 1-1


KATI I


PRERJE 1-1


PRERJE 2-2


PAMJE

DO NOT COPY

a.





PRERJE 1-1







PRERJE 2-2

b











PRERJE 1-1

DO NOT COPY

a.



Kamerie





PRERJE A»A



KATI I



KATI PERDHE



PRERJE 1»1

b.



Kamerie



PAMJE



KATI PERDHE



KATI I



PRERJE 1»1

DO NOT COPY

a.









PRERJE 1-1





PAMJE

b



PRERJE 1-1









PAMJE

DO NOT COPY

a.



b





c.



a. BERAT

b. GJIROKASTER



DO NOT COPY

VENDOSJA E KAMERIESE NE BANESEN BERATASE DHE GJIROKASTRITE

Genc SAMIMI

LES MEZZANINES DE LA VILLE DE BERAT

DO NOT COPY

RESUME

Dans la composition de la ville de Berat à programme développé s'incluait aussi un volume ouvert dénommé «kamerie» (mezzanine), qui remplissait ses propres fonctions. L'approfondissement continu dans l'étude de ce volume a clarifié le mode de composition, le schéma de construction, les diverses solutions architectoniques ainsi que la fonction, le développement dans le temps et le rapport avec l'autre partie de l'habitation.

La mezzanine est un lieu de repos, de méditation et d'observation, non couvert, complètement ou partiellement entouré d'un parapet de pierre attentivement traité du point de vue architectonique, en créant la possibilité de planter des fleurs. Elle est construite en exploitant la couverture en voûtes de pierre des tout petits volumes du rez-de-chaussée. Dans les trois parties-musée de Berat, Kala, Mangalem et Gorice, sont conservées quelques mezzanines entières ainsi que plusieurs fragments, traces et parties de mezzanines endommagées.

La mezzanine se construit au-dessus du rez-de-chaussée. Au-dessus d'elle se trouvent toujours un ou deux petits volumes couverts de voûtes en pierre, utilisés dans divers buts. D'habitude au-dessous de la surface de la mezzanine s'inclut aussi la porte extérieure de l'habitation, ce qui est caractéristique de l'habitation de Berat, en participant à part entière dans la composition de l'habitation. La mezzanine est couverte de dalles en pierre ponce. En général elle est jointe à l'habitation et très rarement elle se construit à part. La communication de la mezzanine avec l'habitation ou bien son exploitation est résolu de façons différentes. Lorsque sur la mezzanine, on monte du rez-de-chaussée, elle est obligatoirement dotée d'un escalier, situé à côté ou loin de l'entrée de l'habitation. Il y aussi des cas où la mezzanine n'est pas dotée d'escalier et sa surface se lie directement avec les volumes de l'habitation. Souvent l'escalier de l'habitation dessert aussi la mezzanine. En général la surface de la mezzanine est de configuration rectangle, mais il ne manque pas non plus les formes irrégulières trapézoïdales, qui ont mis en relief l'exploitation rationnelle du lieu de construction.

Il est d'intérêt de voir aussi comment s'est développé le mode de construction et de décoration de la partie du parapet du balcon qui fait place aux fleurs. La partie de la mezzanine donnant sur la rue, est toujours construite en plaques de pierre sorties en console, qui forment des cadres aux profils différents. Ainsi toute la partie où poussent les fleurs est déplacée du mur du rez-de-chaussée.

En analysant le matériel sur les diverses mezzanines conservées encore de nos jours dans les trois quartiers musée de Berat, on peut les classer de diverses façons; en prenant en considération le nombre de volumes au-dessous de la surface de la mezzanine, c'est-à-dire avec un, deux ou trois volumes, en prenant en considération l'emplacement de la mezzanine par rapport à l'habitation ainsi que le mode de communication avec la surface de la mezzanine. On peut faire d'autres classifications en tenant compte aussi de différentes spécificités de la mezzanine tel le mode d'emplacement et de construction du balcon des fleurs, ou bien le rapport de la mezzanine avec la porte extérieure.

En entendant le terme de mezzanine (kamerie) seulement dans le sens de surface de repos et non pas comme le volume entier de la construction, on ne peut classifier les mezzanines comme celles de Gjirokastra.

C'est pour cette raison que nous pensons que le plus convenable serait la classification des mezzanines en fonction de la communication avec la surface. Selon ce critère nous aurions des mezzanines, où la communication s'assure au moyen d'escaliers particuliers et des mezzanines, où la communication s'assure directement par les volumes du premier étage.

Toutefois, sont encore conservées quelques exemples de mezzanines, où les escaliers servent en même temps l'habitation et la mezzanine. Ainsi dans la mezzanine représentée dans le tab. II.a, les escaliers conduisent en même temps à la porte d'entrée de l'habitation et sur la surface de la mezzanine. Celle-ci est jointe à l'habitation et date de la fin du XVIIIe siècle.

La mezzanine représentée dans le tab. II.b, est simple. La symétrie d'exploitation en forme de trapèze est élevée sur deux vôutes de pierre. Au-dessous de l'une d'elles sous le plancher on a construit un réservoir.

La troisième mezzanine (tab. III,a) est plus compliquée quant'à la construction, en comparaison avec les premières. Dans ce cas le maître a bien résolu architectoniquement et fonctionnellement la construction et est arrivé à des conclu-

DO NOT COPY

sions de valeur dans la mise à profit de la surface qu'il avait à sa disposition. Sous la surface de la mezzanine sont inclus la porte extérieure de l'habitation et deux volumes assez petits, dont l'un est utilisé comme volume sanitaire.

Le seul exemplaire à emplacement détaché de l'habitation qu'on a rencontré jusqu'à nos jours, se trouve dans le quartier de Kala (tab. III,b) (fig. 7). Dans sa composition, la surface de la mezzanine sont inclus l'escalier de pierre résolu selon le schéma habituel, et aussi au-dessous d'elle la porte extérieure de l'habitation et un petit volume. La surface de repos s'étend sur la voûte de pierre du volume inférieur qui servait de dépôt à divers matériaux. Les consoles, le parapet, les fleurs qui entourent la mezzanine démontrent qu'elle était contemplée des quatre côtés par les passants. En réalité sa position donnant sur les ruelles est telle qu'elle était contemplée de trois côtés. Cette mezzanine date de l'année 1827.

Une propagation plus vaste a connu le second groupe de mezzanine, sur la surface desquelles on passe par les divers volumes d'habitation, c'est-à-dire celles, qui n'ont pas de communication directe avec l'escalier qui mène dans l'habitation. En général ces mezzanines ont exploité aussi la surface créée par la voûte de la porte extérieure.

Une autre mezzanine (tab. 7) (fig. 10) du quartier de Gorice, est de surface régulière rectangle et se lie avec la méilleure pièce de l'habitation par une porte de deux battants. Par intuition et en s'appropriant le mode de composition et de construction de l'une des ailes de l'église de type croix intérieure, on a obtenu la surface de repos et de méditation de la mezzanine. La surface de la mezzanine a une hauteur considérable et cela en raison du terrain qui n'est pas accidenté mais plat et la vue, la méditation au cours du repos est couverte au-delà de la série arrière d'habitations.

Dans le quartier de Kala (tab. IV, b) se trouve une mezzanine, construite entre les deux ailes de la maison. De part sa position d'emplacement, elle ressemble tout à fait à celles de la ville musée de Gjirokastra. Sa partie inférieure, si l'on tient en considération que ce quartier souffrait du manque d'éau, était utilisé pour recueillir de l'eau.

Dans l'habitation à tchardak, la construction de la mezzanine a sans doûte prit en considération l'exigeance de créer un lieu de repos, d'arrêt et de méditation non couvert. Dans de tels cas, à Berat, sur la surface de la mezzanine, on passe par le tchardak (tab. V,a). Le passage se fait sur une voûte de pierre.

Dans une habitation de la variante a tchardak (tab. 5.b) (fig. 14, 15), la surface de la mezzanine est placée de travers par rapport au tchardak. Au dessous de la surface de la mezzanine il y a deux espaces couverts de voûtes. Dans celui le plus grand se trouve la porte de l'habitation. La mezzanine est assez élevée et domine complètement la ruelle. La date gravée au-dessus de l'arc de la porte et en même temps sur le battant de la porte nous fait penser que 1866 (fig. 16) est l'année de la construction de la mezzanine et de l'habitation même.

Dans une autre mezzanine c'est au-dessus d'une seule voûte qui va s'élargissant en profondeur, qu'est obtenue la surface de repos à configuration trapézoïdale (tab. IV,a) (fig. 3). Cette surface irrégulière est née de l'emplacement de la mezzanine au croisement des ruelles.

Une mezzanine du quartier de Mangalen est couverte (tab. VI,b). C'est un cas qu'on a hérité avec des modifications dans le temps. Il paraît qu'en raison de l'endommagement de la voûte le lieu de repos de la mezzanine est fait de planches et respectivement il a été couvert pour se proteger de la pluie et des vents de la montagne de Tomorr. Toutefois, la caractéristique de cette mezzanine est l'emplacement des consoles de pierre du parapet du balcon selon une rythmique particulière.

Pour terminer, on va mentionner la mezzanine datant de l'année 1856 (tab. VI,c) (fig. 17), date que nous pensons être celle de la construction de la mezzanine et de la construction de l'habitation. Cette mezzanine est construite pour remplir deux fonctions au cours de l'adaptation de l'habitation. Tout d'abord, comme un lieu de repos et d'arrêt et en même temps pour appuyer les deux poutres de bois sur lesquelles est créé l'encorbellement supérieur fermé de l'habitation et l'obtention de l'avant toit décoratif de la construction à arc de trois centres.

De ce qu'on vient de soumettre, il résulte qu'une importance particulière revient à l'emplacement de la mezzanine en liaison avec sa position par rapport à la grand-rue et les ruelles. C'est en raison de cette exigeance obligatoire à l'égard de la mezzanine, qu'une bonne partie d'elles se construit au-dessus de la surface créées sur les portes d'entrée de l'habitation.

On trouve la construction de la mezzanine même à Gjirokastra, Elbasan et même une de ces variantes sur la porte extérieure on la trouve dans les villages de Konispol. En comparant la mezzanine de Berat à celle de Gjirokastra (tab. VII), on remarquera qu'entre elles il y a des ressemblances architectoniques et constructives, mais il y a aussi des différences. Dans la ville de Gjirokastra les mezzanines jouaient un rôle très important dans la composition de la façade de l'habitation, surtout celles ouvertes, tandis qu'à Berat la mezzanine prend part dans la composition planimétrique générale de l'habitation, mais en même temps elle joue un rôle important dans la composition architectonique de la rue. Différement aux mezzanines de Gjirokastra, celles de Berat ne font pas usage d'habitation de la partie inférieure. Parfois seulement elle est utilisée comme volume auxiliaire. La solution combinée voûte, colonne de pierre, en tant qu'éléments constructifs s'emploit dans les deux villes, mais si à Berat elles s'élèvent à la hauteur d'un étage, à Gjirokastra, en s'adaptant à l'habitation elles atteignent la hauteur de deux étages. A Gjirokastra, l'emplacement de la mezzanine en liaison avec l'habitation est déterminé parce que l'habitation de Gjirokastra a une planimétrie à développement régulier. Dans la ville de Berat, la mezzanine a une position indéterminée. Elle est la fonction de la planimétrie de l'habitation et de son emplacement par rapport à la

rue. La planimétrie de la mezzanine revêt des formes des plus diverses mais toujours elle se joint à l'habitation à l'exception d'un cas particulier.

Nous pensons que la mezzanine, surtout le traitement du balcon des fleurs selon une solution variée architectonique et constructive, ne se peut être dû au hasard dans l'habitation de Berat, de Gjirokastra et d'Elbasan, mais il a ses propres causes. Ces causes doivent tout d'abord être cherchées dans le mode de vie, qui était telle qu'elle exigeait une grande ressemblance avec la nature, en introduisant dans le programme de l'habitation ces surfaces ouvertes à fonctions nettes. Il convient de souligner également la grande élaboration de ces constructions, qui parle clairement de la culture pure d'habitation comme un trait qui apparaît, de pair avec les autres phénomènes, même dans la construction de mezzanines, qui, à Berat, non seulement augmentent les valeurs architectoniques de l'habitation, mais vivent dans la solution architectonique de la rue.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

monumentet

Ilia PAPANIKOLLA

MASAT KUNDËR LAGËSHTIRËS NË BANESËN GJIROKASTRITE

Arkitektura jonë popullore është një shembull i qartë i arritjeve me vlerë në fushën e artit të të ndërtuarit, i aftësive të mëdha krijuese të talenteve të dala nga gjiri i popullit.

«... Zbulimi dhe studimi i monumenteve kulturore-artistike, — na mëson shoku Enver Hoxha — nuk bëhet vetëm me qëllim për të njohur të kaluarën e vendit e të popullit tonë, por në këtë punë ne udhëhiqemi edhe nga qëllimi për të mësuar nga përvoja e të parëve tanë, për të pasuruar e për të zhvilluar vlerat kulturore që na kanë lënë trashëgim, sipas kushteve e kërkesave të reja të shoqërisë sonë socialiste». Në trashëgiminë arkitektonike të ndërtimeve popullore ka shumë për të mësuar.

Mjeshtri popullor nuk është vetëm krijuesi i veprës por edhe zbatuesi i saj. Ai zgjidh në çdo rast konkret, me një intuitë të shëndoshë të ushqyer me përvojën shekullore, probleme të qëndrueshmërisë statike të konstruksionit, si dhe të rezistencës së materialit, ai është njohës shumë i thellë i materialeve rrethanore, i cilësive të tyre, i karakteristikave teknike, si dhe i mënyrës së përpunimit të tyre. Puna e tij dallohet nga një cilësi e lartë e realizimit të punimeve, siguri e plotë, saktësi dhe nga një njohje e thellë e teknologjisë së ndërtimit.[1]

Në këtë artikull do të trajtojmë masat e marra kundër lagështisë që mund të depërtojë në ndërtesë nga reshjet atmosferike, lagështi që është më e përhapura dhe më e vështira për t'u mënjanuar.

Studimi është kryer në qytetin e Gjirokastrës ku ruhet në gjendje të mirë një pasuri e madhe e krijuar gjatë shekujve nga gjenia popullore.

Qyteti i Gjirokastrës ze një vend qendror në luginën e Drinos dhe shtrihet mbi një terren mjaft të copëtuar, që karakterizohet nga një përthyerje e Malit të Gjerë, i cili përmban kurrize, luginëza, shpate me pjerrësi të ndryshme dhe shumë pak shesh.

Klima e kësaj zone është mesdhetare. Temperatura më e lartë absolute gjatë viteve 1951-1970 ka qënë + 42.2°C, ndërsa ajo më e ulta — 10.1°C. Reshjet janë të shumta.

Faktorët që kushtëzojnë karakterin e reshjeve atmosferike në vendin tonë janë: pozicioni gjeografik dhe veçoritë e relievit. Po të shikojmë shpërndarjen territoriale të reshjeve vjetore (fig. 1) vëmë re se kemi dy zona me reshje të mëdha të ndara nga njëra tjetra: zona në veri dhe ajo në jug ku ndodhet dhe qyteti i Gjirokastrës.

Shpërndarja e reshjeve brenda vitit në vendin tonë është tipike mesdhetare: reshje të shumta gjatë gjysmës së ftohtë të vitit dhe reshje të pakta gjatë gjysmës së ngrohtë; ato janë të rrëmbyeshme sidomos në dimër dhe karakterizohen me vazhdueshmëri (1 ÷ 5 ditë) (Fig. 2).

1. E. Riza, **Mjeshtrat dhe arkitektura popullore,** në «Mjeshtrat dhe arkitektura popullore», Tiranë 1976, f. 188-191.

DO NOT COPY



Fig. 1



Fig. 2

Figura 1. Është ndërtuar sipas hartës me izohieta «Shpërndarja e sasisë vjetore të reshjeve» (fig. 48). **«Klima e Shqipërisë»** botuar nga Instituti Hidrometeorologjik, Tiranë 1972; f. 212
Figura 2. Është ndërtuar sipas hartës «Numri i ditëve me reshje gjatë gjysmës së ftohtë të vitit (fig. 62). **«Klima e Shqipërisë»** Instituti Hidrometeorologjik, Tiranë 1972, f. 253.

Në tabelën Nr. 1 janë treguar reshjet mesatare vjetore, gjysmë vjetore dhe stinore për tre qytete me qëllim krahasimi:

TABELA Nr. 1

Qyteti (Stacioni)	Vjetore	Gjysmëvjetore		Stinore			
		E ftohtë	E ngrohtë	Dimër	Pranverë	Verë	Vjeshtë
Shkodër	1797	1291	506	615	398	134	615
Tiranë	1247	845	402	415	307	131	394
Gjirokastër	1708	1390	318	760	317	107	524

Shirat që bien në vendin tonë janë me intensitet të madh dhe përsëriten shpesh. Intensitete më të mëdha vrojtohen në zonën e veriut dhe të jugut, atje ku dhe reshjet vjetore janë më të mëdha. Numri mesatar i ditëve me reshje dhe maksimumi i reshjeve brenda 24 orëve për tri qytetet tregohet në Tabelën Nr. 2.

TABELA Nr. 2

Qyteti (Stacioni)	Mesatarja vjetore e reshjeve në mm (1931—1965)	Numri mesatar i ditëve me rreshje 0.1 mm në vit	Maksimumi 24 orësh i reshjeve në mm
Shkodra	1797	129.4	239.3
Tirana	1247	126,2	237.4
Gjirokastra	1708	135.5	288.0

Në zonat e vendit tonë ku bien shira të bollshme sasia e ujit që duhet larguar nga çatia e ndërtesave brenda 24 orëve mund të jetë shumë e madhe. Nga tabela Nr. 2 vërejmë se në qytetin e Gjirokastrës brenda 24 orëve mund të bien, maksimumi 290 mm shi, d.m.th. në një sipërfaqe prej 1 m² çati bien 290 litra ujë në 24 orë; ose nga 1 m² çati gjatë një viti duhet të largohen 1700 litra ujë.

Në shumicën e rasteve, në periudhën e ftohtë të vitit, shirat janë të shoqëruara edhe me erë që rrahin ndërtesën në drejtime të caktuara. Në tabelën Nr. 3 duket qartë që në qytetin e Gjirokastrës, në periudhën e ftohtë të vitit shirat e pjerrëta kanë kryesisht drejtimin juglindje, jug dhe më pak veriperëndimor. Në figurën 3 janë paraqitur grafikisht reshjet mujore për periudhën e ftohtë të vitit* dhe në figurat 4 e 5 trëndafilët e erërave për këtë periudhë.

TABELA Nr. 3

Stacioni	Stina	Q pa erë	V	VL	L	JL	J	JP	P	VP
Gjirokastër	Dimër	48,5	1.7	0,4	1.2	19,4	12.3	2,4	4,1	10.0
	Vjeshtë	53.4	1.8	0.2	0.7	13.5	11,4	2,9	6	10.0

Për mbulimin e çative janë përdorur rrasat e gurit, i vetmi material i përshtatshëm dhe i lirë që ndodhej në vend. Pjerrësia e çative shkon nga 25° deri 30°, më e zakonshmja 27°. Kufiri i pjerrësisë 25 ÷ 30° është në përpjestim të zhdrejtë me madhësinë e rrasës së gurit dhe trashësinë e lëndës së drurit me të cilën është ndërtuar konstruksioni mbajtës i çatisë. Meqenëse banesa gjirokastrite ka një zhvillim planimetrik mjaft të lirë, në çati janë krijuar shumë flegra, dhe si pasojë, kulme, kurrize dhe ullukë (ose brinjë të thelluara) që kanë vështirësuar shumë si zgjidhjen e konstruksionit mbajtës ashtu edhe atë të mbulesës.

Për ndërtimin e konstruksionit mbajtës të çatisë është përdorur dru pishe me seksion të vogël dhe gjithmonë i drejtë, i cili i ka detyruar mjeshtrit popullorë të kërkojnë zgjidhje statike ku elementet të punojnë kryesisht në shtypje dhe në tërheqje. Megjithë peshën e madhe të mbulesës ruajtja deri më sot e mjaft çative me moshë 100-150 vjet tregon se zgjidhja statike e konstruksionit mbajtës dhe kualiteti i lëndës së drurit i kanë rezistuar shumë mirë kohës.

Mbulesa me rrasa guri bëhet mbi patavra: fillon me vendosjen e rrasave më të mëdha afër strehëve, meqënëse atje rrjedhja e ujit është më e madhe dhe vazhdon duke u ngjitur për në kulm me rrasa më të vogla.

Meqenëse rrahja e shiut është shumë më e fuqishme në juglindje dhe jug, në faqet e çatisë të orientuara në këto drejtime, mjeshtri popullor, për të penguar depërtimin e shiut ka vendosur më shumë pllaka për njësinë e sipërfaqes ose ka zgjedhur pllakat më të mëdha që mbulojnë njëra tjetrën më shumë se në sipërfaqet e tjera. Në kulm janë vendosur rrasa të mëdha dhe të mënjanuara nga ana e juglindjes ose jugut, kjo varet nga drejtimi i kulmit, por në asnjë rast ato nuk janë të mënjanuara në orientimet e tjera (fig. 9, 10).

Një nga vendet ku mundësia e depërtimit të ujit të shiut është më e madhe, është edhe dalja e oxhakut në çati. Për të penguar depërtimin poshtë të ujit që rrjedh në faqet e jashtme të oxhakut në pjesën e poshtme të tij sot vendoset një qafore lla-

DO NOT COPY

marine që lidhet me muraturën (fig. 11). Këtë problem mjeshtri popullor e ka zgjidhur duke përdorur materialin më të lirë rrasat e gurit, të cilat dalin konsol, largojnë ujin e shiut dhe e derdhin mbi mbulesën e çatisë (fig. 12).

Për të penguar futjen e drejtpërdrejtë të shiut në birën e oxhakut, kokës së tij i janë dhënë zgjidhje të ndryshme si në figurat 13, 14. Më interesantja prej tyre është një lloj deflektori i cili formohet nga rrethimi i katër faqeve të kokës së oxhakut, me katër pllaka guri të mbështetura mbi konsole po prej guri (fig. 15). Këtu del në pah zgjuarsia dhe përvoja e mjeshtrit popullor të pashkolluar. Ai me intuitën e tij ka bërë një ndërtim të tillë të oxhakut, i cili jo vetëm pengon depërtimin e ujit nga reshjet e pjerrëta, por krijon në majën e oxhakut një zonë me nënpresion (presion më të ulët se ai atmosferik). Kjo ndihmon shumë në tërheqjen e tymit (fig. 16). Në figurat 17 e 18 duket qartë ngjashmëria e madhe që ka kjo zgjidhje me pajisjen që vendoset sot në majën e oxhakut për tërheqjen sa më mirë të tymit.

Sasia e madhe e ujit të shiut që rrjedh në çati, largohet prej saj në mënyrë të paorganizuar, me hedhjen e ujit vazhdimisht nga streha. E meta kryesore



Fig. 3-4-5



Fig. 6-7-8

*) Të dhënat për ndërtimin e grafikut në figurën 3 dhe të trëndafilëve të errërave në figurat 4 e 5 janë marrë nga «Klima në Shqipëri», Tiranë 1972, Tabela f. 213 dhe tabela 26, f. 71.

DO NOT COPY

e derdhjes së lirë të ujërave të shiut nga çatia është lagështia e madhe që mund t'u shkaktohet mureve të jashtëm të ndërtesës. Ujin që rrjedh nga streha, era e shtyn drejt murit të ndërtesës.

Është e qartë se lagia e mureve nga reshjet që derdhen lirisht nga çatia është e lidhur me shpejtësinë e erës dhe në një shkallë të lartë me madhësinë e daljes së strehës së çatisë. (Fig. 19).

Llojet e strehëve që hasim në banesën gjirokastrite janë përdorur në funksion të lartësisë, konstruksionit të murit, si dhe të destinacionit të mjedisit. Ato përbëjnë një shembull shprehës të njohjes së thellë të klimës së zonës ku ndërtohej. Duke e përdorur strehën në vendin e duhur asaj i është dhënë njëkohësisht edhe një zgjidhje e plotë konstruktive dhe e goditur nga ana arkitektonike.

Shtëpitë në Gjirokastër janë të ndërtuara me mure guri dhe vetëm në katin e sipërm, kryesisht në ballë të ndërtesës ku janë dhomat e miqve (odatë), për të patur sa më shumë dritare është përdorur mur i hollë me skelet drurit (çatma). Duke u nisur nga vetë materiali me të cilin ndërtohej çatmaja, një vëmendje e veçantë i është kushtuar mbrojtjes së saj nga shiu i pjerrët. Për këtë qëllim janë ndërtuar strehë çatie që në pjesën e çatmasë kanë dalje deri 1.50 m. Strehët me dalje të madhe i gjejmë të përdorura edhe në muret anësore të ndërtesës që në shumicën e rasteve janë bërë prej guri. Kjo për dy arsye: e para për efekt arkitektonik dhe e dyta se në anët lartësia e ndërtesës është përsëri e madhe (fig. 20 dhe 21).

Strehët në ndërtimet e Gjirokastrës mund t'i ndajmë në dy grupe: strehë të hapura dhe strehë të mbyllura. Strehët e hapura mund të grupohen në: strehë në formë konsoli (fig. 24) që takohen rrallë, strehë me testekë të shkurtër (fig. 23) dhe strehë me testekë të gjatë (fig. 22).[2)]

Strehët e hapura me testekë të shkurtër zakonisht mbrojnë muret anësore të banesës, ato dalin deri 1.4 m nga faqja e murit. Testekët vendosen në çdo 50 cm dhe mbështeten e fiksohen gjithmonë në brezin e mësipërm prej druri të vendosur në mur (fig. 23). Shumë rrallë i gjejmë të mbështetur edhe në muret me skelet prej druri.

Strehët e hapura me testekë të gjatë i gjejmë zakonisht në ballë të ndërtesës (fig. 22). Shkaku i përdorimit të testekëve të gjatë është se muri me skelet prej druri i katit të fundit, nuk mund të mbajë edhe peshën e strehëve të mbuluara me rrasa guri. Pesha e strehës në këtë mënyrë shkarkohet në murin prej guri me anën e testekëve të gjatë që kapin gjithë lartësinë e katit të fundit.



Fig. 9-10



Fig. 11-12-13-14

2. E. Riza, «Qyteti-muze i Gjirokastrës», Tiranë 1981 f. 138.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 15-16-17-18

Strehët e mbyllura mund të grupohen në: strehë prej guri, strehë prej çatmaje dhe strehë të veshura me dërrasa. Strehët e mbyllura prej guri zakonisht i gjejmë të përdorura në muret e prapme që janë ndërtuar krejt prej guri dhe rrallë edhe në muret anësore të ndërtesës. Forma më e thjeshtë dhe më pak e përhapur është streha që krijohet me anën e daljes së një ose dy rreshtave me rrasa guri, ndërsa forma më e përhapur dhe më e larmishme është streha që ndërtohet me gurë të latuar dhe të dalë konsol.

Strehët e mbyllura prej guri me një dalje të shkurtër 20-30 cm, përdoren kryesisht në muret e prapmë të ndërtesës, sepse këto mure për shkak të truallit të pjerrët dhe për të rritur aftësinë mbrojtëse të ndërtesës kanë lartësi të vogël. (Fig. 25, 26, 27).

Nga strehët e mbyllura të veshura me listela dhe suva ose me dërrasa, më të përhapura janë strehët e llojit të fundit dhe që me rrip të vogël suvaje rakordojnë me faqen e suvatuar të murit (fig. 28, 29, 30, 31 dhe 32).

Nga sa pamë më lart del se streha e çatisë në banesën gjirokastrite është një element shumë i rëndësishëm si nga ana funksionale e konstruktive ashtu dhe nga ana arkitektonike duke marrë parasysh se në një banesë mund të dallojmë tre dhe ngandonjëherë edhe më shumë lloje strehësh (fig. 33).

Përveç ujit që derdhet nga streha, efekt shkatërrues në muret e jashtme të ndërtesës kryejnë edhe shirat që shoqërohen me erë. Kështu edhe shirat e gjata e të imëta të shtyra nga era e lehtë e lagin murin e ndërtesës, duke shkaktuar shkatërrimin e shpejtë të saj.

Strehët e mëdha të përdorura në banesën gjirokastrite mbrojnë vetëm një pjesë të ndërtesës nga shirat e pjerrëta dhe kryesisht katin e sipërm. Mjeshtri popullor duke shfrytëzuar përvojën e ka njohur këtë dukuri dhe e ka zgjidhur mjaft mirë.

Në muret prej guri që ngrihen në lartësi, për të siguruar një lidhje tërthore janë përdorur brezat e drurit, por me qëllim që të mos kalben në anën e jashtme që rrihet nga shiu, janë futur në mur në thellësinë deri 12 cm dhe vetëm në katin e sipërm, atje ku muri mbrohet nga streha e madhe, brezat dalin deri në sipërfaqe.

Në qytetin e Gjirokastrës është vënë re një fakt i tillë: Në disa ndërtesa të reja me muraturë guri vërehet depërtimi i lagështisë deri në faqen e brendshme të murit të jashtëm, ndërsa në banesat e vjetra



Fig. 19

karakteristike nuk vërehet asnjë shenjë lagështie. Për të gjetur çelësin e kësaj dukurie duhet të futemi në mënyrën e ndërtimit të murit në këto ndërtesa.

Fugat e muraturës nga ana e jashtme nuk janë bërë të thelluara por rrafsh me sipërfaqen e tij duke mos penguar kështu rrjedhjen e ujit të shiut (fig. 34, 35, 36 e 37).

Muratura e gurit është ndërtuar me llaç gëlqereje ose me llaç argjile. Në këtë muraturë vetëm llaçi është ai që thith lagështinë dhe e thith ngadalë, pasi është në gjendje të gëlltisë shumë ujë, dhe ta lëshojë atë, po aq ngadalë sa e thith. Pra uji i shiut depërton në muret prej guri nëpërmjet llaçit.

Kur shirat nuk janë të vazhdueshme lagështia nëpërmjet llaçit depërton në një pjesë të trashësisë së murit dhe me hapjen e kohës largohet nëpërmjet avullimit. Kur shirat janë të vazhdueshëm, d.m.th. kur mbulojnë njëri tjetrin, lagështia nëpërmjet llaçit mund të depërtojë edhe murin e trashë, duke dalë në sipërfaqen e brendshme të tij (fig. 38 e 39).

Në muret e gurit të ndërtesave të vjetra në Gjirokastër, depërtimi i lagështisë pengohet në një mënyrë mjaft origjinale. Ajo nuk mbetet prapa metodave moderne që rekomandohen sot për këtë qëllim. Kjo





Fig. 25-26-27



Fig. 20-21-22-23-24

metodë qëndron në ndërtimin e një muri të hollë përpara murit mbajtës duke krijuar kështu një shtresë ajri midis tyre.[3] Uji i shiut që depërton murin e hollë rrjedh në faqen e brendshme të tij pa prekur murin e trashë mbajtës duke ruajtur kështu edhe aftësinë termoizoluese të murit (fig. 40).

Ndërtimi i murit të gurit në banesën gjirokastrite është i ngjashëm me metodën e përmendur më lart. Muri është ndërtuar me llaç vetëm në anën e brendshme dhe të jashtme në thellësinë deri 12 cm, ndërsa pjesa e mesit është ndërtuar e thatë (fig. 41) duke ndërprerë kështu kapilaritetin dhe duke krijuar mu-

3. Th. Kamberi, **Disa të dhëna mbi teknikën e ndërtimit të banesës gjirokastrite,** Monumentet 2, 1971.

DO NOT COPY



Fig. 28-29-30-31-32

ndësinë e rrjedhjes së ujit që depërton nga ana e jashtme deri në tabanin e themelit prej nga edhe largohet. Në këtë mënyrë më shumë se 3/4 e trashësisë së murit mbetet e thatë, dhe ajri që ndodhet në mes rrit aftësinë termoizoluese të murit prej guri.

Për ndërtimin e këtij muri kanë ndihmuar edhe faktorë të tjerë si p.sh. kualiteti i mirë shtresor i gurit që lejon ndërtimin e një murature solide pa llaç, si dhe harxhimi sa më i pakët i llaçit në muraturë, duke kursyer kështu edhe ujin, sigurimi i të cilit nga lumi do të kërkonte shumë shpenzime. Duhet theksuar se faktori i fundit (kursimi i llaçit) ka ndikuar në ndërtimin e këtij muri, por nuk ka qënë vendimtar sepse në Gjirokastër ku ka banesa të mëdha e të zbukuruara me dekorime shumë të kostueshme, nuk do të ishte i arsyeshëm kursimi në gëlqere dhe ujë.[4]

Për lidhjen e mureve me gurë janë përdorur brezat e drurit. Brezat e drurit përbëhen nga dy ose tre elemente horizontalë, sipas trashësisë së murit. Seksioni i këtyre elementeve ndryshon nga 8 x 3 cm deri në 15 x 5 cm. Elementet horizontalë lidhen midis tyre në drejtimin tërthor (d.m.th. në drejtimin e trashësisë së murit) me binarë të vegjël me seksion 3 x 5 cm në çdo 50 ÷ 70 cm (fig. 42 e 43).

Për të siguruar brezin e drurit nga lagështia, elementi i fundit vendoset brenda në muraturë 8-12 cm nga faqja e jashtme e murit. Në katin e sipërm ky element vendoset rrafsh me faqen e murit, sepse mbrohet nga streha e madhe e çatisë.

Në muret e brendshme elementet e brezit vendosen në faqet e murit dhe fiksohen me gozhdë kovaçi.

Brezat e drurit rrethojnë të gjithë muret duke u ndërprerë vetëm në hapësirat e dyerve dhe birat



Fig. 33

4. E. Riza, Po aty, f. 111-115.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

NDERTIMI I FUGAVE NE MURET ME GURE



fig 34

Mur me gurë me fuga të thelluara



fig 36

Mur me gurë ku mbushja e fugave është bërë rrafsh me sipërfaqen e murit.

Fig. 34-35-36-37

NDERTIMI I MURIT ME GURE



Depërtimi i lagështisë pengohet në një mënyrë origjinale, të ngjashme me metodën moderne që përdoret për këtë qëllim



fig. 40 fig. 41

Fig. 38-39-40-41

e oxhakëve, ndërsa në dritaret në disa raste elementi i fundit nuk pritet (fig. 44).

Në qoshe brezat lidhen me tërheqëse ose diagonale. Është e rëndësishme të theksojmë se lidhja e elementeve të brezit në qoshet si dhe vendosja e diagonaleve ka ngjashmëri të plotë me vendosjen e hekurave në brezat antisizmikë prej beton armeje që përdoren sot në lartësinë e çdo kati (fig. 46 e 47). Në figurën 48 tregohet vendosja e binarit diagonal, pjesërisht edhe jashtë murit në ato vende ku e lejon mjedisi.

Në këtë mënyrë shpjegohet jeta e gjatë e mureve me gurë (të thatë në brendësi të tyre) që me gjithë lëkundjet sizmike të herë pasherëshme, jo vetëm nuk janë shkatërruar, por edhe dëmet që janë shkaktuar janë minimale.

Në banesën gjirokastrite suvanë e jashtme e gjejmë të përdorur kryesisht në katin e sipërm ku muret prej guri janë më të holla se në katet e poshtme, ose janë të ndërtuara shumë të holla, me skelet druri mbushur me gurë ose çatma. Për t'i mbrojtur këto mure nga depërtimi i lagështisë që vjen nga reshjet e pjerrëta mjeshtri popullor si suva të jashtme ka përdorur një lloj suvatimi shumë të bukur, ekonomik dhe që përshkohet me vështirësi nga uji. Mbi mur është hedhur dora e parë e suva-

së, llaç argjili përzierë me kashtë të prerë. Trashësia e kësaj shtrese arrin deri në 2 cm. Mbas tharjes mirë të dorës së parë (kur plasaritjet kanë marrë fund) hidhet dora e dytë me llaç që përbëhet nga gëlqere e stazhionuar mirë përzierë me lesh dhie. Ky llaç shtrohet me mistri në një shtresë me trashësi deri 5 mm dhe pastaj me anën e një malloje fërkohet për 3-4 ditë duke krijuar në këtë mënyrë një sipërfaqe të rrafshët dhe shumë të lëmuar, si patinaturë (fig. 48, 49, 50 e 51). Uji i shiut duke rënë në këtë sipërfaqe rrjedh me shpejtësi dhe depërtimi në thellësi është shumë i vogël. Banesat e shumta që në disa pjesë të pamjes së jashtme ruajnë edhe sot këtë lloj suvatimi, dëshmojnë për jetën mbi njëqindvjeçare të tij, si dhe për mbrojtjen e murit nga depërtimi i lagështisë. Suvatimi me dy duar llaç gëlqere është më pak i përhapur dhe është përdorur mbi muraturë të thatë ose mbi muraturë guri ku si lidhës është përdorur llaç gëlqereje.



PRERJA TERTHORE
E MURIT



PAMJE NGA JASHTE E MURIT



BREZAT E DRURIT

PER LIDHJEN TERTHORE
TE MURIT



Fig. 42-43-44-45

BREZAT E DRURIT

LIDHJA NE QOSHE TE MURIT
E ELEMENTEVE TE BREZIT





NGJASHMERIA ME BREZIN
ANTISIZMIK PREJ BETON-ARMEJE
QE PERDORET SOT

Fig. 46-47

DO NOT COPY

Nga shirat e pjerrëta lagështia në ndërtesë mund të depërtojë edhe nëpërmjet dritareve kur ato nuk janë konceptuar dhe zbatuar mirë.

Dritarja si element i rëndësishëm arkitektonik ka ndjekur zhvillimin e banesës gjirokastrite në kohë. Prirja e përgjithshme ka shkuar drejt zmadhimit të sipërfaqes së saj, duke marrë përherë e më tepër pjesë aktive në formulimin e jashtëm arkitektonik të banesës. Në fillim dritarja përbëhej nga një skarë mbrojtëse druri dhe prej kapakëve po prej druri (pa xhama), më vonë në muret me gurë dritaret u ndërtuan me kanate të zakonshme me xhama. Uji i shiut që përplaset mbi dritare rrjedh poshtë dhe mblidhet në një kanal gjatësor të hapur në pragun e jashtëm të dritares prej nga largohet me anën e një bire (fig. 52, 53).

Në katin e sipërm të banesës gjirokastrite, ku balli është ndërtuar zakonisht me skelet prej druri, dritaret janë vendosur në grupe, me kanate që lëvizin në drejtim vertikal. Edhe në këto dritare janë marrë masa të sigurta, që uji i shiut të mos depërtojë në to. Në pjesën e sipërme mbi hapësirën e dritares është vendosur një kornizë dërrase e cila përveç rolit të saj dekorativ pengon ujin e shiut që rrjedh në mur të bjerë në dritare (kur shiu është shumë i pjerrët). Uji i shiut që përplaset mbi dritare, nga kanata e sipërme rrjedh në të poshtmen dhe largohet nëpërmjet pragut të dritares të përbërë nga një dërrasë e vetme me pjerrësi 8% nga ana e jashtme. (fig. 54, 55).

Përsa i përket rrahjes së shirave në muret vertikalë është interesante të përmendim edhe masën që është marrë kundër depërtimit të ujit në vendin ku takon çatia e një pjese të ulët të ndërtesës me murin e pjesës tjetër më të lartë. Për këtë qëllim, që më parë, gjatë ndërtimit të murit më të lartë në anën ku do të vijë çatia bëhen pllaka të dala konsole e të vendosura në formë të shkallëzuar dhe në mënyrë të tillë që të bien mbi mbulesën e çatisë më të ulët.

Qyteti i Gjirokastrës është ngritur mbi një truall të pjerrët dhe përgjithësisht shkëmbor. Përpara mjeshtrit popullor kjo rrethanë ka krijuar probleme mjaft të vështira për t'u zgjidhur, si përsa i përket lidhjes së ndërtimit me terrenin ashtu dhe mbrojtjes së ndërtesës nga ujërat e shirave që rrjedhin në sipërfaqen e tokës dhe përplasen në muret e ndërtesës.

Trualli i pjerrët ka bërë të mundur rritjen e sipërfaqes për çdo kat, duke siguruar kështu një lidhje organike. Gjirokastra ashtu si dhe Berati na jep një numër të madh shembujsh të lidhjes së goditur të ndërtimeve me terrenin.

Për të siguruar kullimin e ujërave dhe për të mënjanuar futjen e ujit në katin përdhe, masa e parë



Fig. 48-49-50-51



Fig. 52-53

PHOTOCOPY

është ndërperja e ngjitjes kapilare duke ndërtuar përgjithësisht themele me muraturë të thatë (të palidhur me llaç). Për ndërtimin e themeleve janë përdorur gurë të mëdhenj ose pjesë shkëmbinjsh të nxjerrë në afërsi të mjedisit ku ndërtohej. Meqënëse trualli është shkëmbor themelet nuk kanë shkuar thellë. Ka raste që ato ngrihen direkt mbi shkëmb në një lloj foleje.

Për të mbrojtur ndërtesën nga ujërat e shiut që rrjedhin në sipërfaqen shkëmbore dhe që përplasen në muret e saj, mjeshtri popullor ka marrë masa të tilla që dëshmojnë për njohuri të thella n artin e të ndërtuarit.

Në disa raste pritja e parë e këtyre ujërav është bërë në murin rrethues të ndërtesës (kryesish në anën e prapme). Në fundin e murit rrethues ësht bërë një veshje me rrasa guri horizontale dhe ver tikale në formë kunete. Rrasat e gurit janë lidhu me llaç gëlqereje ose harasan. Me llaç janë mbu shur edhe boshllëqet midis tyre. Veshja me rras guri është bërë me pjerrësi për të larguar ujin ng të dy anët e ndërtesës. Kjo veshje përsëritet edhe n murin e prapmë të ndërtesës (fig. 56 e 58).

Mënyra e dytë e pritjes së ujërave të shiut q vijnë nga lart është ndërtimi i një muri të dytë pran atij të prapmë të ndërtesës. Ky mur shkon deri la dhe mbulohet me zgjatimin e çatisë. Uji që de

DRITARET

LARGIMI I UJIT TE SHIUT

DO NOT COPY



Fig. 54-55



Fig. 56-57-58

DO NOT COPY





Fig. 59-60







Fig. 61-62-63

përton në pjesën e poshtme midis mureve largohet me anën e një kanali larg ndërtesës (fig. 57).

Mënyra e tretë është ndërtimi i një galerie. Kjo mënyrë përdoret me sukses edhe në ndërtimet e sotme që ngrihen në terrene të pjerrëta. Në vend të ndërtimit të galerisë me beton ose betonarme (fig. 60) është përdorur muratura e gurit dhe mbulimi i hapësirës është bërë me qemer (fig. 59). Ujërat që depërtojnë në galeri largohen nga ndërtesa me anën e një kunete të ndërtuar në mes. Ndryshe nga mënyra e parë (fig. 57) lartësia e galerisë nuk shkon deri në çati, por ndalet në katin përdhe dhe sipërfaqja e ndërtesës zgjerohet edhe mbi galeri.

Mënyrat e përdorura janë të lidhura ngushtë me pjerrësinë e truallit ku ngrihet ndërtesa dhe me pozicionin e saj ndaj rrugëve ose shesheve. Është për t'u vënë në dukje edhe mënyra e ndërtimit të rrugëve, kryesisht e atyre anët e të cilave kufizohen nga muret e ndërtesave. Kalldrëmi është ndërtuar me pjerrësi drejt mesit me qëllim që ujërat e shirave të cilat rrjedhin në sipërfaqe të rrugës të mos përplasen me muret e ndërtesës.

Si të gjitha elementet e ndërtesës edhe portat e poshtme mbrohen nga shirat e pjerrëta. Ato i gjejmë të futura thellë në muraturën e gurit dhe të mbuluara me harqe, ose me çati që në disa raste mbështetet edhe mbi kolona.

Një faktor tjetër që tregon për mëndjemprehtësinë e mjeshtrave tanë popullorë është dhe zgjidhja shumë e mirë e ndërtimit dhe hidroizolimit të rezervuarëve të ujit (sterave) me të cilat janë pajisur pjesa më e madhe e banesave karakteristike gjiro-



Fig. 64-65

kastrite. Kjo sepse një nga problemet më të vështira për banorët e këtij qyteti që ngrihet mbi një vend shkëmbor ku mungojnë burimet, ka qënë sigurimi i ujit (fig. 61, 62 e 63).

Sterat furnizohen me ujin e shiut me anën ullukëve të vendosur jo në gjithë çatinë e banesës por vetëm në pjesën e përparme të saj, duke pen guar kështu derdhjen e lirë të ujit direkt nga streh në anën kryesore të ndërtesës (fig. 64 e 65). Për t komanduar futjen e ujit në sterë, përdoret një hink lidhëse e lëvizshme. Duke pasur parasysh rrezik shmërinë e presionit të tepërt të ujit, në pjesën e si përme sterat janë pajisur me një tub të posaçëm që bën derdhjen e ujit të tepërt dhe e mban sterën në presion të lirë. Zakonisht lartësia e sterës bëhe sa lartësia e katit përdhe, por ka edhe raste ku ajo është ndërtuar edhe në lartësinë e dy katev (fig. 62 e 63). Në këta rezervuarë të habit fakti që në anën e jashtme të murit (në kontakt me ambient të tjera të banesës), nuk vërehet asnjë shenjë lagë shtie. Kjo është arritur në radhë të parë me ndërti min e murit të gurit në mënyrë të tillë që të mos pësojë asnjë lëvizje, dhe në radhë të dytë me anër e suvatimit të brendshëm të sterës me një llaç të posaçëm që gjirokastritët e quajnë «harasan». Ky llaç nuk është gjë tjetër veçse përzierje e gëlqeres së shu ar shumë mirë (gëlqere e stazhionuar disa vjet në gropë) me argjilë të pjekur (qeramikë) dhe të bluar shumë imët. Mbas tharjes së plotë të suvatimit me harasan sipërfaqja lyhet me 3-4 duar vaj ulliri të përzierë me të bardhë veze.

Sterat janë ndërtuar zakonisht në katin përdhe të ndërtesës në pjesën më të thellë, duke shfrytëzuar muret e vetë ndërtesës. Muratura është bërë prej guri me llaç gëlqereje me trashësi 1 m dhe sipër është mbuluar me qemer cilindrik. Suvatimi me ha rasan shkon deri në kthesën e qemerit. Poshtë stera është shtruar me kalldrëm dhe mbi të është vendo sur një shtresë harasani. Në qytetin e Gjirokastrës ka stera 100 vjeçare që funksionojnë edhe sot.

Duke e parë banesën gjirokastrite jo vetëm në përgjithësi, por edhe nga pikëpamja e mbrojtjes nga lagështia duket qartë se në të gjenia popullore ka arritur në realizime të tilla të cilat tregojnë për aftësitë e mëdha, shpirtin krijues dhe zotësinë për të ecur me pjekuri në fushën e artit të të ndërtuarit.

DO NOT COPY

Ilia PAPANIKOLLA

LES MESURES PRISES CONTRE L'HUMIDITE DANS L'HABITATION DE GJIROKASTRA

RESUME

Dans cette étude on traite des mesures prises contre l'humidité, qui peut pénétrer dans l'habitation, à cause des précipitations atmosphériques, et qui, certes, est la plus répandue et la plus dure à dominer. L'étude a eu lieu dans la ville de Gjirokastra, où se conserve en bon état une grande richesse créée au cours des siècles par le génie populaire.

Les facteurs qui conditionnent le caractère des précipitations atmosphériques chez-nous sont: la position géographique et les particularités du relief. Si l'on considère la distribution territoriale des précipitations annuelles exprimées au moyen des isohyètes, on constate qu'il y a deux zones à précipitations abondantes, séparées l'une de l'autre: la zone du Nord et celle du Sud, où se situe aussi la ville de Gjirokastra. La distribution annuelle des précipitations est typique méditerranéenne, abondantes pendant la moitié froide de l'année et peu abondantes pendant la moitié chaude, elles sont torrentielles surtout en hiver et se caractérisent par la continuité sur quelques jours. (1-5 jours).

Les pluies qui tombent chez nous sont de grande intensité et se répètent souvent. Les plus grandes intensités sont enrégistrées dans la zone du Nord et celle du Sud, là où les précipitations sont abondantes. Dans la ville de Gjirokastra, en 24 heures, il peut tomber au maximum 290 mm de pluies, c'est à dire sur une surface de toit de 1 m^2, il tombe 290 litres d'eau en 24 heures, ou bien au cours d'une année 1 m^2 de toit doit évaquer 1700 litres d'eau.

Dans la périore froide de l'année, les pluies accompagnées de vent s'abattent sur l'habitation en des directions déterminées. Dans la ville de Gjirokastra, ces pluies suivent la direction sud--est, sud et moins la direction nord-ouest.

Pour la couverture des tois on utilise des plaques de pierre, le seul matériel convenable et à bon marché, se trouvant sur place. La pente des toits va de 25-30°. La limite de la pente de 25-30° est de disproportion avec la taille de la plaque de pierre et avec l'épaisseur du bois de construction, dont est fait la construction qui supporte le toit. Puisque l'habitation de Gjirokastra connait un développement assez libre, sur le toit se sont crées plusieurs rampants, et en conséquence des combles, des crètes et des gouttières, ce qui rend difficile la solution de la construction de la charpente ainsi que de la couverture.

La couverture de plaques de pierre se fait sur des lattes. On commence par placer les plaques les plus grandes sur les avant-toits, puisque l'écoulement de l'eau y est plus abondant, et l'on continue à remonter vers le comble avec des plaques plus petites. La chute de l'eau de pluie est plus forte sur le côté sud-est et sud, c'est pourquoi, sur les rampants de toit orientés dans cette direction, le maître populaire, en vue d'empêcher l'infiltration de l'eau, a mis plus de plaques par m^2, ou bien, il a choisi les plus grandes plaques, qui empiètent sur l'une l'autre plus que sur les autres surfaces. Sur la ligne de faite sont posées de grandes plaques inclinées vers le sud-est ou le sud. Ceci dépend de l'orientation du faitage, mais les plaques ne sont jamais inclinées vers d'autres directions.

Un des endroits où la possibilité de l'infiltration de l'eau de pluie est grande, est la sortie de la cheminée sur le toit. Le maître populaire a résolu ce problème en utilisant, le matériel le plus bon marché, les plaques de pierre, lesquelles en sortant en saillie de la face de la cheminée, évacuent l'eau de la pluie sur la couverture du toit.

Pour empêcher l'introduction directe de l'eau de pluie dans le tuyau de la cheminée, on a apporté diverses solutions à la construction de son chapeau. Mais d'intérêt particulier est la solution apportée au chapeau de certaines cheminées, où l'on a créé une sorte de déflecteur, se formant par l'encerclement des quatre face du champingnon de cheminée de quatre plaques de pierre appuyées sur des consoles également de pierre. Là se met en évidence l'intélligence et l'expérience du maître populaire non instruit, qui avec son intuition a réalisé une telle construction de la cheminée qui non seulement emphêche la pénétration de l'eau des précipitations tombant en oblique, mais crée au chapeau de la cheminée une zone de basse pression qui aide beaucoup à l'évacuation de la fumée.

La grande quantité de l'eau de pluie qui coule sur le toit, en est évacuée de façon inorganisée, par les avant toits, qui la rejettent continuellement et mouillent ainsi les murs extérieurs du bâtiment. Il est clair que ceci est lié à la vitesse du vent et dans une grande mesure avec la grandeur de la saillie de l'avant toit. Les sortes d'avant toits, qu'on rencontre dans l'habitation de Gjirokastra, utilisés sur différentes parties du bâtiment, en fonction de la hauteur, de la construction du mur et de la destination du volume, constituent elles aussi un exemple clair de la profonde connaissance qu'a le maître populaire pour le climat du pays où il construit, en se servant de l'avant-toit à l'endroit requis, avec une solution constructive complète et réussie du point de vue architectonique.

Les maisons de Gjirokastra ont des murs de pierre et c'est seulement à l'étage supérieur, principalement au front du bâti-

DO NOT COPY

ment, où se sont situées les chambres des hôtes, qu'on se sert d'un mur léger avec ossature de bois, en vue d'avoir le plus de fenêtres. Afin de protéger ce mur des précipitations, on a construit des avant-toits à saillie allant jusqu'à 1,40 m. On rencontre des avant-toits avec saillie même sur les murs latéraux du bâtiment qui dans la majeure partie des cas sont faits de pierre, et ceci pour deux raisons: premièrement pour des effets architectoniques et deuxièmement parce que sur les côtés, la hauteur du bâtiment est encore grande.

Les avant-toits de pierre fermés sont utilisés d'habitude sur les murs arrière qui sont entièrement de pierre, et rarement sur les murs latéraux du bâtiment.

A part l'eau que verse l'avant-toits, un effet destructeur sur les murs extérieurs est aussi exercé par les pluies accompagnées de vent. Les grands avant-toits utilisés dans l'habitation de Gjirokastra protègent seulement une partie du bâtiment des pluies obliques et surtout l'étage supérieur. Le maître populaire, en mettant à profit l'expérience, a connu ce phénomène et s'y est opposée avec beaucoup d'intélligence.

On s'est apperçu du fait suivant: si dans quelques nouveaux bâtiments à mur de pierre construit à Gjirokastra, on remarque la pénétration de l'humidité jusque sur les parrois intérieurs du mur extérieur, dans les anciennes habitations il est caractéristique de n'y voir aucune trace d'humidité. Pour trouver la clé de ce phénomène, il nous faut pénétrer dans le monde de construction des murs de ces bâtiments.

La construction des murs de pierre dans l'habitation de Gjirokastra est faite avec du mortier seulement sur le côté intérieur et extérieur, dans une profondeur allant jusqu'à 12 cm, tandis que leur intérieur est sec et interrompt ainsi la capilarité et crée la possibilité de l'écoulement de l'eau qui pénètre du côté extérieur jusqu'aux assises des fondations et s'en éloigne. De cette façon, plus des trois quarts de l'épaisseur des murs demeurent secs et l'air qui se trouve à l'intérieur accroît l'isolation thermique des murs de pierre.

La protection des murs minces de l'étage supérieur de la pénétration de l'humidité provenant de la pluie est réalisée en utilisant une sorte de crépissage économique difficilement pénétrable par l'eau. La première couche est faite d'argile mêlée de paille hachée et la seconde de chaux bien conditionnée mêlée de laine de chèvre. L'eau de pluie qui tombe sur la surface du crépi coule avec rapidité et la pénétration à l'intérieur est très petite. L'humidité provenant des pluies obliques peut pénétrer dans le bâtiment par les fenêtres aussi, lorsque celles-ci ne sont pas bien conçues. Les fenêtres de l'habitation de Gjirokastra sont construite de façon à évacuer complétement l'eau de pluie.

La ville de Gjirokastra s'élève sur un terrain en pente et généralement rocheux. Cette circonstance a passé au maître populaire des problèmes assez difficiles à résoudre, aussi bien en ce qui concerne le lien de la construction avec le terrain, que la protection du bâtiment des eaux qui coulent sur la surface de la terre rocheuse et qui se heurtent contre les murs du bâtiment. En vue d'assurer l'écoulement des eaux et d'éviter le pénétration dans le rez-de-chaussée, on a interrompu la montée capillaire construisant en général des fondements de pierres sèches.

Dans certains cas le premier obstacle contre les eaux de pluie qui coulent sur la surface rocheuse est posé par le mur d'enceinte du bâtiment ou bien par son propre mur (surtout du côté arrière). Au bas du mur il est construit une couvette revêtue de dalles. Le second mode d'empêchement des eaux de pluies venant d'en haut est la construction d'un autre mur près du mur arrière du bâtiment. Ce mur s'élève jusqu'en haut et se couvre par le prolongement du toit. L'eau qui pénétre dans la partie Inférieure entre les deux murs en est évacuée au moyen d'un canal. Le troisième mode est la construction d'une galerie. Cette façon s'emploie avec succès même dans les constructions actuelles qui s'élèvent sur terrain en pente. Au lieu de la construction de la galerie en béton ou en béton armé, on s'est servi des murs de pierre et couvert d'une voûte. Les eaux qui pénètrent dans la galerie en sont évacuées au moyen d'une cuvette construite au milieu. Les modes utilisés sont liés étroitement à l'inclinaison du terrain où s'élève le bâtiment et à sa position par rapport aux rues et aux places. Il est à souligner aussi le mode de construction des rues, principalement des rues dont les côtés sont limités par les murs des bâtiments. Le pavé est construit avec une inclinaison vers le milieu, pour que les eaux de pluie qui coulent sur la surface de la rue ne se heurtent pas contre les murs du bâtiment.

Comme tous les éléments du bâtiment, les portes extérieures aussi sont protégées contre les pluies obliques. Les portes extérieures sont incluses profondément dans le mur et couvertes d'arcs ou de toits qui dans certains cas s'appuient même sur des colonnes.

Un autre facteur qui démontre l'habileté des maîtres populaires est aussi la solution très bonne de la construction et de la hydro-isolation des réservoirs d'eau (citèrnes) dont sont munies la plus grande partie des habitations de Gjirokastra, parce que l'un des problèmes difficiles pour les habitants de cette ville qui s'élève sur un terrain rocheux, où manquent les sources d'eau, a été l'assurance de l'eau.

La citèrne est fournie avec de l'eau de pluie, au moyen des gouttières installées non sur tous les avant-toits de l'habitations, mais seulement sur la partie frontale, en empêchant ainsi la chute de l'eau directement de l'avant toit sur le côté principal du bâtiment. Dans la ville de Gjirokastra, il se trouve des citernes vieilles de 100 ans qui fonctionnent encore de nos jours.

En voyant l'habitation de Gjirokastra non seulement en général, mais aussi du point de vue de la protection contre l'humidité, il en ressort clairement que le génie populaire y a atteint de tels combles, qui témoignent de l'aptitude intarissable, de l'esprit créateur et de l'habileté à marcher avec matûrité dans le domaine de l'art de la construction, en ajoutant sans cesse de nouvelles chouses dans l'expérience accumulée.

DO NOT COPY

Nr. 2 1982

monumentet

Mark TIRTA

MBI ZANAFILLËN E DISA MOTIVEVE NË GURËGËDHËNDJE NË SHTËPITË FSHATARE SHQIPTARE

Në popullin tonë (ashtu si dhe në popuj të tjerë), me zanafillë që nga kohë të herëshme e shumë të herëshme e me vazhdimësi deri në kohë të re, aty këtu deri në ditë të sotme, vërehen shenja e motive simbolike të ndryshme të bëra në dru, në baltë, në gur a në metal, në mënyrë të posaçme në derë të shtëpisë dhe në vatrën familjare; herë herë këto ndeshen dhe në portë a mure të oborrit, në tehe të mureve të shtëpisë. Shenja e motive simbolike të këtij lloji janë të gdhendura edhe në përmendore mbivarrore, si «banesë e dytë e njeriut», si vazhdimësi e gurëzuar e një mendësie të lashtë, e lidhur kjo me kultin e të parëve e me kultin e të vdekurve.

Për këtë problem, që ka një rëndësi të madhe për studimin e tipareve etnokulturore të popullit tonë, tipare që u zhvilluan gjatë shekujve e në kushte të caktuara historike, është shkruar shumë pak e në mënyrë anësore. Por megjithë këtë, kjo temë nuk ka mbetur jashtë vëmendjes së autorëve të ndryshëm, të huaj a vendas, që janë marrë me kërkime në lëmë të kulturës popullore shqiptare. Ndër këta mund të përmendim M. Durham,[1] F. Nopça,[2] Sh. Beshlagiq,[3] Dh. Shuteriqi[4], F. Shkupi[5], e të tjerë.[6]

Në këtë trajtesë të shkurtër (që nuk i ven vetes për detyrë të zgjidhë gjithçka, por vetëm të paraqiten disa materiale e disa mendime në mënyrë të përmbledhur) do të bëhet fjalë për disa motive të punuara në gur në derë të shtëpisë dhe në oxhak të vatrës familjare, po ashtu dhe në përmendoret mbivarrore, që u përkasin mjediseve fshatare të viseve malore të vendit tonë. Për këtë jemi mbështetur në vrojtimet e bëra e në materialet e mbledhura gjatë ekspeditave tona në Veri e në Jug të Shqipërisë e në Kosovë, materiale të cilat i kemi plotësuar dhe me të dhëna nga arkivi i Etnografisë i Institutit të Kulturës Popullore.

Në shtëpitë fshatare shqiptare të tërheqin vëmendjen në mënyrë të veçantë shenjat e motivet simbolike të bëra në gurëgdhendje në derë a në oxhak të vatrës familjare (fig. 1, 2). Kjo ka të bëjë me rolin e madh që kanë luajtur dera dhe vatra familjare në jetën e njeriut. Dera e hyrjes në banesë dhe vatra familjare janë konsideruar në mendësinë popullore si simbole të forcës e të paprekshmërisë së familjes, të unitetit të saj, të përkatësisë shoqërore, si simbole të vazhdimësisë së gjeneratës; si simbole të nderit dhe të virtyteve morale të jetës familjare si

1) M. E. Durham, **Some tribal origins laws and customs of the Balkans,** Londër, 1928 f. 101-142.

2) F. Nopcsa, **Albanien, Bauten, Trachten und Geräte Nordalbaniens,** Leipzig 1925, f. 37-118.

3) S. Bešlagić, **Stari malisorski nadgrobni spomenici u Vuksan Lekiću,** «Glasnik Muzeja Kosova», X, 1970, f. 363-383.

4) Dh. Shuteriqi, **Mbi disa vizatime rupestre mesjetare pranë Rubikut, dhe mbi disa motive skulpturore popullore në Mirditë,** Monumentet, 18, Tiranë, f. 65-71.

5) F. Shkupi, **Dekoracioni i arkitekturës popullore në qytetin e Shkodrës,** Monumentet, 12, Tiranë, 1976, f. 195-218.

6) M. Tirta, **Elemente të kulteve ilire te shqiptarët (kulti i diellit),** Kuvendi i parë i studimeve ilire, Tiranë, 1974, vëll. II, f. 281-302.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 1. Derë kulle me zbukurime gjithfarësh, Macukull (Mat).



Fig 2. Rrasa e oxhakut të vatrës familjare në një shtëpi, Çermenikë (Librazhd).

trimëria, mikpritja, atdhedashuria, besa, burrëria («derë trimash»). Në këto funksione është vështruar dhe e tërë shtëpia e banimit, por kryesore në të kanë qenë **dera** dhe **vatra.**

Dera ka shërbyer si një ndërlidhëse shoqërore e natyrore me botën që e rrethonte njeriun, familjen, dhe si mbrojtëse kundër armiqve të ndryshëm që kërcënonin jetën e tij. Vatra ka qënë vendi më i rëndësishëm i jetës, i gëzimeve e i hidhërimeve të tij. Ajo ka qenë e lidhur me kultin e të parëve (që, sipas mendësisë popullore mund të siguronte mbarësi në jetën familjare) si dhe me kultin e zjarrit, zbulimi i përftimit e përdorimi i të cilit i pruri aq të mira njerëzimit. Në jetën familjare të lashtësisë dera e shtëpisë dhe vatra, veç funksioneve praktike, kanë pasur (pikërisht për rëndësinë e tyre në jetën e njerëzve, për rolin e tyre shoqëror) vlerë si vende kulti e flijimesh të karakterit magjik: mbrojtës, mbarësiprurës e prodhimtar.

Në shumicën e rasteve motivet që gjenden në përmendoret mbivarrore janë të përafërta me ato që gjenden në dyer a në vatër të banesave fshatare.

Motivet e punuara në gur në dyer të shtëpive a në oxhak, paraqesin: një gjarpër, një ose dy duar njeriu, koka e dhisë së egër, takëmet e kafesë, armë, një luftëtar mbi kalë, fytyra njerëzish, objekte të ndryshme të jetës familjare, bimë e lule, vegla pune, fytyra të trupave qiellorë, si dielli, hëna, yjet; kafshë, shpendë, shenja të simbolikës fetare. Mbi të gjitha dallon shqiponja me dy krerë. Shpesh herë të njëjtat motive të këtij lloji i ndeshim në vise të ndryshme shqiptare si në Labëri, Përmet, Korçë, Çermenikë, Mirditë, Pukë, Dibër, Mat, Dukagjin, në Malësi të Madhe, në Kosovë, në Dibër të Madhe e në Tetovë, në viset shqiptare të Malit të Zi. Kjo gjë flet për unitet kulturor në mes krahinave të ndryshme shqiptare, unitet me zanafillë nga fillimi i mesjetës e më tej.

Shtëpi me gurgdhendje të hollë, pra dhe me motive zbukuruese, bënin vetëm familjet me gjendje ekonomike më të mirë e këto në fshatra ishin përgjithësisht të pakta.

Në shtëpi të vjetra (të shek. XIX-fill.XX) në jo pak raste vërehen motive të veçuara, kështu: vetëm një gjarpër; vetëm një dorë, vetëm një bredh, vetëm një armë; vetëm një ibrik; vetëm një çekiç, vetëm një sisë, kur në gurgdhendje janë bërë dy objekte, edhe këto janë bërë të veçuara, ta zemë, një në derë e një në tehe. Këto paraqesin një domethënie simbolike të caktuar me zanafillë të vështrimit mitologjik. Nganjëherë ashtu si dhe qoshet, ato janë të punuara në mënyrë të trashë. Në rastet e tjera, kur dera, oxhaku a tehu kanë disa motive, atëherë si vend të parë zën vështrimi zbukurues. Edhe këto të fundit paraqesin mendësi shije, qëndrim psikologjik të caktuar të gurgdhendësi

a të pronarit që i porositi, pra një pjesë e tyre mund të kenë dhe ngarkesë mitologjike. Kufij të prerë në mes motiveve me përmbajtje mitologjike dhe atyre me përmbajtje thjeshtë zbukuruese nuk mund të vihet. Megjithatë në këtë mes një farë ndarje mund të bëhet. Kështu, gjarpri, figura antropomorfe e një të pari mitik, dora, sisët, bredhi, në zanafillë të tyre janë motive me përmbajtje mitologjike, por me kohë, u është zbehur shumë ose dhe u ka humbur kuptimi i tyre i vjetër dhe kanë përfunduar në figura simbolike realiste. Ndryshe ndodh me motive të tilla si simbolet e mikpritjes, armët, kalorësi luftëtar, shqiponja me dy krerë, motive të punës së mjeshtrit gurgdhendës, lulet, që në përgjithësi janë realiste në përmbajtjen e simbolikës së tyre, qoftë dhe si zanafillë. Por edhe këto, në disa raste, janë të ndërthurura me elemente mitologjike. Në popullin tonë është i njohur kulti i mikpritjes, kulti i armës, kulti i shqiponjës, kulti i bimësisë (zbukurimi i dyerve me gjethe e lule për ditë vere e për Shëngjergj), kulti i objekteve prej hekuri që u visheshin cilësi magjike.

Kemi plot motive, që pavarësisht nga zanafilla e tyre, në kohën tonë vështrohen si zbukurime, si pririe të shqiptarit për të futur të bukurën në jetën e tij (Fig. 3, 4). Këto shprehin ndjenja, mendime, virtyte me përmbajtje historiko-shoqërore. Aty shprehet dashuria për të bukurën, optimizmi, shpirti i paepur i popullit gjatë rebesheve të historisë. Po në këtë kontekst ndeshim dhe motive të lashta dhe shumë interesante, po që kanë marrë funksione të reja zbukurimi (Fig. 5). Tradita në këto raste luan një rol të madh në zgjedhje të motiveve. Sado të thjeshta, ato janë vepra arti të mjeshtrave popullorë. Aty është derdhur aftësia e tyre krijuese në finesën e gdhendjes së motiveve e në kompozim. Në stilin popullor të kompozimit çdo figurë shpreh një subjekt të veçantë, dhe jo pa kuptim, qoftë dhe kur kemi të bëjmë thjeshtë me forma gjeometrike.

Në vështrim të prejardhjes motivet mund t'i ndajmë në dy grupe: Në grupin e parë hyjnë motivet me zanafillë vendase. Këto mund të jenë me origjinë të lashtë, por që kanë vazhduar të përdoren deri vonë, ose me origjinë nga natyra shqiptare, por si zbukurime të përdorura dokumentohen vonë. Së dyti, kemi motivet me origjinë të huaj: greko-bizantine, romake, turke, veneciane, por që kanë marrë dhe një vulë vendëse; kemi dhe shenja, formula a figura simbolike të futura si ndikim nga popujt fqinj ose nga kristianizmi e islamizmi. Në disa raste vënia e kufirit midis dy grupeve është e vështirë, në mos e pamundur.

Kemi dhe motive që janë një shartim i traditës së lashtë vendase me ndikime të huaja. Kështu kemi, ta zëmë, motivin e hënës. Kulti i saj ka burim të lashtë vendës dhe ka pasur një përhapje të gjerë në



Fig. 3. Oxhak në vatër. Nga një fshat i Korçës.



Fig. 4. Derë shtëpie. Sheshe (Rrëshen).

FOTO COPY



Fig. 5. Qerrja diellore në derë. Çermenikë (Librazhd).



Fig. 6. Përmendore mbivarrore. Jubicë, Koplik (Shkodër).



Fig. 7. Gjarpër në derë të shtëpisë. Orosh (Mirditë).



Fig. 8. Gjarpër në një kullë në Rrafsh të Dukagjinit (Kosovë).

DO NOT COPY

popullin tonë, gjë që vihet re në kultin e pjellorisë dhe, përgjithësisht, në të dhënat e ndryshme të mitologjisë popullore. Por, me pushtimin turk, hëna hyri dhe si simbol i islamizmit, si emblemë e flamurit të Turqisë. Këtu u bë një kryqëzim që disa herë mori një përmbajtje me burim oriental, por që u ushqye edhe nga baza e një kulti të lashtë vendës (fig. 6). Në mitologjinë tonë popullore kulti i hënës na paraqitet i lidhur shumë me kultin e pjellorisë së tokës, me kultin e bimësisë; ajo është e lidhur edhe me kultin e demonit mbrojtës e mbarësiprurës të grave.

Më shumë motive të gurgdhendjes vërejmë në dyert e shtëpive të ndërtuara në shek. XIX dhe në gjysmën e parë të shekullit XX. Ka raste që në një derë të gjenden një, dy ose disa motive. Në disa raste vendi i motivit ka lëvizur: është bërë diçka në derë, por veç kësaj është vënë diçka edhe në oxhak të vatrës. Në raste të tjera, janë mbushur me këto motive dhe qoshet e teheve të shtëpisë (se aty ka gurë të gdhendur me art të hollë). Ka raste të vençanta kur në një shtëpi gjenden shumë motive e aty pasqyrohen dukuri shoqërore nga më të ndryshmet që nga lashtësia e deri në ditët tona; dalin aty motive nga vendet e lindjes e të perëndimit, motive të krishterimit e të islamizmit. Ndër to gjendet edhe aeroplani, që është një arritje e shekullit tonë.

Çdo motiv, pavarësisht nga funksioni zbukurues ka një domethënie historiko-shoqërore. Gurgdhendësi dhe i zoti i shtëpisë nuk e zgjedhin kot një motiv të caktuar. Funksioni simbolik i disa motiveve është shumë i qartë, se lidhet me tradita të caktuara të popullit; puna është më e ndërlikuar në rastet ku motivet janë bërë me anë shabllonesh. P.sh., gurska litësi sheh në një tabaka të ardhur nga orienti fi gurën e një zogu e të një luleje dhe atë e merr zbukurim dhe e gdhend në gurin e derës. Ky moti ka thjesht funksion zbukurimi, pse paraqet një pamj nga natyra, edhe pse shablloni erdhi nga jashtë.

Po paraqesim këtu disa motive me prejardhje lashtë vendëse, në kuptimin se cto në përgjithësi n dëshmohen dhe te ilirët dhe së dyti, gjë që ka m rëndësi, lidhen me rite, me mite, me virtyte të popu llit tonë, pra janë zhvilluar si pjesë përbërëse etn kulturore e popullit tonë gjatë mesjetës dhe me n përhapje truallësore gjithshqiptare.

1. **Gjarpëri.** E vërejmë në dyer të shtëpive skalitje në gur në vise të ndryshme të vendit tonë në Përmet, Labëri, Çermenikë, Malësi të Madhe, M

lësi të Tiranës, Mat, Mirditë, Dukagjin, Kosovë (fig. 7,8). Më shumë kjo figurë është e skalitur në banesa të vjetra që i takojnë shekullit të kaluar dhe fillimit të këtij shekulli.

Është e kuptueshme se këtu, në zanafillë, kemi të bëjmë me shpirtin mbrojtës të shtëpisë, pra me një kult të lashtë totemik në popullin tonë. Në periudhën ilire dhe në mesjetë fytyrën e gjarpërit e njohim dhe nga dëshmitë arkeologjike. Përfytyrimin e gjarpërit si hyjni mbrojtës i shtëpisë, e njohim gjerësisht nga të dhënat e mitologjisë dhe të gojëdhënave popullore.[7] Është një kult që ka udhëtuar në shekuj bashkë me bartësit e tij. Këtë motiv e gjejmë dhe në objekte të ndryshme të jetës familjare si në furka, kërraba, lahuta, çifteli, curle dyjare; e gjejmë edhe në përmendore mbivarrore si në Këlmend, në Jubicë të Koplikut, ashtu si dhe në varret e vjetra të Vuksan Lekajt[8].

Në traditat popullore ruhej deri në shekullin tonë besimi se çdo shtëpi e ka gjarprin e saj e që quhej me emra të ndryshëm: **bolla e shtëpisë, vitorja e shtëpisë, gjarpri i shtëpisë, itoksi.** Ky gjarpër në mendësinë popullore quhej orë e shtëpisë, ruajtës i shtëpisë; ai bënte, sipas kësaj mendësie, që shtëpia të kishte mbarësi e lartësime në njerëz, në blegtori, në prodhime bujqësore, në mirqënie të përgjithëshme. Kur një familje pësonte fatkeqësi në këto vështrime, thuhej se «i është ligur bolla e shtëpisë» («vitorja»). Gjarpri quhej në përfytyrimet popullore zot i truallit të shtëpisë, njëkohësisht dhe zot i tokës që prodhon çdo lloj bimësie, prandaj quhej dhe **i tokës** (që do të thotë **i tokës, që është e tija toka).** Është krejt e natyrëshme të mendohet që këta faktorë bënë që kjo gjallesë të bëhet motiv i dashur i artit popullor të gurgdhendjes.

2. **Figura antropomorfe.** Në shtëpitë fshatare, të skalitura në qoshe të derës ose në tehe të mureve, janë të pranishme figura njerëzore, në shumicën e rasteve të bëra vetëm me vija skematike. Për nga zanafilla këto i ndajmë në dy grupe: së pari, figura me përfytyrime reale në kujtimet e tregimet e popullit, siç është rasti i figurave në një shtëpi në Qeparo të Himarës ku tregohet se aty, në atë skemë ishin skalitur katër djemtë e të zotit të shtëpisë, po kështu dhe në Mesaplik në një rast të tillë shohim skemën e katër njerëzve e na thonë se është fjala për dy djem të njërit vëlla e dy djem të vëllait tjetër që do të trashëgonin këtë shtëpi në ndërtim.

Në grupin e dytë hyjnë ato figura antropomorfe të veçuara (ku në një derë, teh shtëpie, vatër familjare,



Fig. 9. Figurë antropomorfe në teh të murit në anën e prapme të shtëpisë. Velçë (Vlorë).



Fig. 10. Sisë në teh të murit të shtëpisë. Seltë (Shpat i Elbasanit).

a përmendore mbivarrore paraqitet vetëm një figurë). Pseja e skalitjes së kësaj figure na jepet e errët, e papërcaktuar. Zakonisht të tilla figura gjenden në shtëpi të ndërtuara nga fillimi i shek. XX, nga fundi i shek. XIX ose më parë, pra në shtëpi të vjetra. Në gojën e banorëve këto shpjegohen sikur kanë të bëjnë me të parin e shtëpisë që ka vdekur, ose me një të parë që ata nuk e mbajnë mend. Në disa raste të tilla figura na paraqiten dhe në reliev a në reliev të lartë (fig. 9). Mendojmë se këto kanë të bëjnë me paraqitjen figurative të një të pari mitik të shtëpisë, i parë, që sipas besimeve popullore të kohës së ndërtimit, do t'i jepte shtëpisë mbarësi, zhvillim, shtesë në meshkuj e në pasuri. Kjo figurë mitike «do ta ruante shtëpinë nga çdo e keqe». Ndryshimet shoqërore e familjare më të reja sollën dhe humbjen e kuptimit të funksioneve të këtyre figurave të shpirtrave mbrojtës të të parëve të shtëpisë, të shpirtrave mbrojtës të shtëpisë e të vatrës familjare. Është me interes të shënohet se kjo figurë, në disa raste, skalitet në tehe të anës së prapme të shtëpisë, pikërisht në atë anë nga mendohej, sipas përfytyrimeve popullore, se vinë e rrinë shpirtrat e të parëve në ditë festash, kur duan të hyjnë në shtëpi e të marrin takim me vatrën familjare.

7) Për këtë shih dhe: M. Tirta, **Aspekte të kultit të të parëve e të të vdekurve ndër shqiptarë,** «Etnogr. Shqiptare», X, 1979, fq. 58-73.

8) S. Bešlagić, art. cit, f. 376-377.

DOKTORATURA



Fig. 11. Dorë në një derë shtëpie. Zajsë, afër Kurbneshit (Mirditë).



Fig. 12. Dorë në një derë shtëpie, në Rrafsh të Dukagjinit (Kosovë).

3. **Gjinjët.** I gjejmë të skalitura në gur (përgjithësisht në tehe të mureve e shumë rrallë në derë të shtëpisë) në shtëpi të Malësisë së Labërisë, në Malësi të Beratit, në Dukagjin, në Shpat të Elbasanit, në Çermenikë e në vise të tjera. Janë një element i vjetër që ndeshet dhe në gjetjet arkeologjike të periudhës ilire. Ato kanë të bëjnë me kultin e lashtë të pjellorisë e të mbarësisë. Vendoseshin për të prurë fat e mbarësi në familje (fig. 10). Përmbajtjen historiko-shoqërore të këtij zbukurimi e tregojnë më së miri rite, mite e besime të lashta në lidhje me gjinjët.

Muji i ciklit të kreshnikëve ishte i dobët nga shëndeti e nuk kishte forcë. Ai u bën një mirësi zanave të malit e ato në shenjë mirënjohje me anë të qumështit të gjirit i japin shëndet e forcë Mujit:[9]

«Njana shoqes zanat atëherë i kanë thanë:
Tamel gjiut Mujos për me i dhanë,
Tamel gjiut i kanë dhanë me pi,
Me tri pika djalin ma kanë ngi
E i ka falë zoti kaq fuqi
Sa me e luejtë shkambin aty për bri.»

Duke pirë qumësht në gjinjët e zanave, thotë rapsodi, «kenka ba si me kanë drangue!». Kjo ka të bëjë me kultin e gjinjëve që është aq i njohur e i dëshmuar në mitologjinë popullore shqiptare. Gjinjët u gdhendën në gurë të shtëpisë duke u nisur nga mendësia se ato bien forcë e mbarësi në familje.

4. **Dora.** Paraqitet në motive të ndryshme: një dorë, dy duar ose duar të lidhura bashkë me njëra tjetrën, sikur shprehin «besa-besë». Dy duar të shtrënguara fort njëra me tjetrën i kemi ndeshur gjatë ekspeditave në fshatra të Dibrës dhe të Mirditës. Dy duar të kapura «besa-besë» dëshmohen në shek. XIX dhe në flamurin tradicional krahinor të Shalës (në Dukagjin). Një gur gëlqeror i rrafshët mbi të cilin është skalitur një dorë njeriu ndodhet në muzeun e



Fig. 13. Bredh në derë të shtëpisë. Çermenikë (Librazhd)..

9) Q. Haxhihasani, **Këngë popullore legjendare,** Tiranë, 1955, fq. 129.

DO NOT COPY

Prizrenit. Ky gur është i gjetur diku në kala të Prizrenit dhe mendohet se e ka zanafillën në këtë skalitje (të dorës) nga mesjeta e herëshme.

Mendojmë se ky simbol ka një origjinë të lashtë vendëse: në një mënyrë a në një tjetër ka shërbyer si një mbishkrim a vendim piktografik; në disa vështrime ai simbolizon ruajtjen e unitetit të farefisit a të bashkësisë krahinore (fig. 11, 12). Në disa raste të tjera dora e përfaqësonte emrin e pronarit ose të mjeshtrit ndërtues të shtëpisë. Kur bëhej një shtëpi e re, tregojnë të vjetrit, më të moçmin e shtëpisë, edhe sikur të ishte duke vdekur, do ta ngrinin duke e mbajtur për krahësh e do ta çonin te dera në ndërtim. Aty fuste dorën në gjakun e kurbanit të shtëpisë dhe vendoste të pesë gishtat në anë të dorës a mbi derë. Pra, dora e të parit të shtëpisë, dora e të parit të fisit, shtampohej në derë. Nga kjo, thonë malësorët, u bë zakon të skalitej dora edhe në gur, në fillim në dyert e shtëpive e prej këndej kaloi edhe në oxhak të vatrës a në qoshe të teheve të murit. Në gdhendje populli e paraqet dorën dhe si simbol të besës për të ruajtur virtytet e larta të të parëve, si firmosje të një vendimi a të një porosie (testament). Këtë motiv nuk mund ta ndajmë kurrë nga tradita e besës shqiptare që lidhej nëpërmjet takimit të duarve. Ai gjendet më shumë në shtëpi të vjetra: në Labëri, Përmet, Malësi e Tiranës, Mirditë, Mat, Dukagjin, Kosovë. Në Mirditë, në Mat e në krahina të tjera të Veriut ka vazhduar të jetë e pranishme dora në duvak e në flamurin krahinor krahas me shqiponjën me dy krerë.

5. **Bredhi**. Këtë element zbukurimi e kemi ndeshur më tepër në Çermenikë (fig. 13), por aty këtu, dhe në Malësi të Madhe, sidomos në Këlmend, në Dukagjin; është i pranishëm dhe në Rrafsh të Dukagjinit (në Kosovë), por më tepër në punime artistike prej druri që i përkasin vatrës familjare si tavan, fasadë muri, sergjene, dollape muri etj. Bredhin e ndeshim dhe në vulat e bukëve rituale. Ky dru zbukurues në gurgdhendje më shumë është i pranishëm në qoshet e derës së shtëpisë e në oxhak a anash oxhakut të vatrës familjare. Në disa raste, sidomos në Çermenikë, bredhi i fytyruar ngrihet mbi një disk (ndoshta disku i diellit në përfytyrimin popullor), mbi një rozetë, mbi ganxha të lidhura me tokën, mbi objekte që kanë formën e djepit të fëmijës. Këtë objekt të dashur për popullin e gjejmë të gdhendur dhe në përmendoret mbivarrore prej guri; është me interes prania e bredhit në varret e vjetra të Vuksan Lekajt,[10] fshat në Mal të Zi, jo larg Tuzit, banorët e të cilit dhe territori i takojnë rrethinës etnografike të Hotit



Fig. 14. Bredh (në dru) në derë të shtëpisë. Çermenikë (Librazhd).

(Malësi e Madhe). Këto varre të vjetra janë datuar nga dikush si të shek. XV-XVI dhe nga të tjerë si të shek. XVIII. Ornamentika shumë interesante e këtyre varreve, mund të thuhet se është e përafërt, në mos e njëjtë me varre të ndryshme të Malësisë së Madhe që i takojnë fundit të shek. XIX e fillimit të shek. XX.

Në disa raste këtë bimë e kemi gjetur të gdhendur në dru, sidomos në dyer të shtëpisë (fig. 14). Ky motiv në gurgdhendje e drugdhendje gjendet më shumë në vise me pyje të shumta, të pasura sidomos me bredha. Në përgjithësi ky motiv gjëndet diçka si i veçuar e jo i gërshetuar me motive të tjera, përveç motivit mbi të cilin ngrihet (si djep, rozetë etj.).

Që ky është një motiv i vjetër vendës e me një domethënie me shumë peshë për mendësinë popullore të traditës më të herëshme, për këtë nuk ka asnjë dyshim. Sot në popull njihet si objekt zbukurimi dhe

10) S. Bešlagić, **art. cit.**, f. 373.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 15. Takëmet e kafesë pranë derës së shtëpisë. Lëkundë (Mirditë).



Fig.16. Pajisjet luftarake të një burri, në një derë shtëpie. Bu gar, Mirditë.

në mënyrë shumë të errët si motiv me kuptim ritual. Le të kujtojmë faktin që në viset tona malore në disa raste është përdorur dega e bredhit në zbukurimet rituale të dyerve e të dritareve për ditë vere a për shëngjergj. Ndoshta lidhur me këtë fakt kaloi dhe në zbukurime në gur në derë, në vatër e gjetiu.

Bukuria natyrore e bredhit (i gjatë, i drejtë, simetrik, madhështor në pamje, me njomësi e freski gjallëruese të përherëshme) e ka bërë këtë të dashur në popull e prej këtej, krahas përmbajtjes rituale, u fut si motiv në skalitjet e tij artistike në dru e në gur. Por duke u nisur nga disa të dhëna gojore të popullit dhe nga fakti se shumë herë këtë motiv e kemi të shoqëruar me një disk a me djepin e fëmijës poshtë, në pikëpamje të zanafillës na del si simbol i ripërtëritjes së jetës, si simbol i fëmijës që rritet e zëvendëson brezin e vjetër, që siguron vazhdimësinë e gjeneratave. Pra është simbol i forcës së pakëputshmërisë së jetës.

6. **Simbole të mikpritjes shqiptare.** Takëmet e kafesë; ibriku, filxhanet, tabakaja, është krejt e kuptueshme, janë simbole të mikpritjes shqiptare, aq proverbiale në popullin tonë: «Mirë se erdhe e me zemër të bardhë: bukë e krypë e kafe!», «Bukë e krypë e zemër!» (fig. 15). Motive me këto objekte ndeshen disa në derë e disa në oxhak të vatrës, në dhomën e miqve. Simbolet e mikpritjes i gjejmë dhe në përmendore mbivarrore e që duan të tregojnë se i varrosuri ka qenë shtëpi mikpritëse. Mund të mendohet se kafja ka hyrë vonë në popullin tonë e këto objekte erdhën nga orienti. Mendoj se takëmet e kafesë kanë zëvendësuar simbole të tjera të përafërta të mikpritjes shqiptare që është shumë më e lashtë se përdorimi i kafesë. Simbol më i lashtë i mikpritjes ka qënë rakia e vera a pije të tjera që përdoreshi si çajra. Pra dhe mjetet e përgatitjes dhe të pirjes s tyre kanë qënë të përafërta me ato të kafesë.

Një gjë është e vërtetë: objektet e skalitura n gur si zbukurime mund të jenë vendëse ose të ar dhura nga jashtë, po dukuria që ato simbolizojnë mikpritjen e që ka një domethënie të madhe shoqë rore psikologjike, si virtyt i popullit tonë, ka patjetë një themel krejt vendës e nuk mund të jetë kurrses një huazim nga popujt e tjerë. Thelbi këtu është për mbajtja simbolike e motiveve e jo forma me të cilë janë shprehur këto mendime nga gurgdhendësi popullor.

7. **Armët, kalorësi luftëtar.** Mbi dyer gjejmë të gdhendura armë të ndryshme, nga më të vjetrat der te më të rejat. Këto kanë të bëjnë me traditat luftarake të popullit tonë (fig. 16, 17). Me to shqiptari ka mbrojtur lirinë, ka siguruar jetëgjatësinë e kombit të vet, prandaj i ka pasur shumë për zemër, i ka dashur më shumë se jetën. Nga kjo është krijuar në popullin tonë dhe kulti i armës. Këtë objekt kaq të dashur mjeshtri popullor e gdhendi dhe në derë të shtëpisë, në vatër, në përmendore mbivarrore. Me simbolin e trimërisë e të traditave luftarake ka të bëjë dhe paraqitja e kalorësit me armë në dorë. Në këto vitet e fundit gjejmë të gdhendur dhe Skënderbeun me shpatë në dorë ose vetëm portretin e Skënderbeut me përkrenare si në Lajthizë (Mirditë), Fandi (Mirditë), në Kelmend (Malësi e Madhe).

8. **Shqiponja me dy krerë.** Është motiv shumë i përhapur në skalitje në gur, në popullin tonë. Këtë e ndeshim në çdo vis shqiptar që nga Çamëria e deri në Kosovë (fig. 18, 19, 20). Në mënyrë të veçantë ky motiv ndeshet në malësitë e Veriut si Mat,



Fig. 17. Armë në një përmendore mbivarrore. Jubicë, Koplik (Shkodër).



Fig. 18. Shqiponjë mbi derë të shtëpisë. Ndërshenë (Miditë).

Miditë, Pukë e tjera, ku ze mbi 60% të rasteve me zbukurime të dyerve e oxhaqeve të vatrës. Ky simbol i unitetit kombëtar u përhap shumë që nga Rilindja Kombëtare e këtej. Megjithatë shqiponja ka pasur një kult të vjetër në popullin tonë. Ky motiv më shumë gjendet mbi dyer, po diku diku dhe në oxhak ose në përmendore mbivarrore; bëhet me përmasa të mëdha dhe ze vend qendror në mes të motiveve të tjera. Ky simbol kaq i dashur i unitetit dhe kompaktësisë në mes shqiptarëve është përjetësuar në gurët qëndrorë të shtëpisë, gjë që dëshmon për ndjenjat atdhetare të shqiptarit, për ngritjen e ndërgjegjes kombëtare të shqiptarëve kudo që të jenë.

9. **Motive të punës së mjeshtrit gurgdhendës.** Në disa raste vetë mjeshtri, krahas shenjave simbolike të lashta a të kohës që u takojnë në përgjithësi zotëruesve të shtëpisë, diku ka gdhendur në mur, afër derës a në qoshe të teheve të murit, motive që përjetësojnë vetë ndërtuesin gurskalitës e murator. Gjejmë diku të punuar në mur figurën e peshores së drejtimit të murit në lartësi, ose figurën e nivelatorit. Në disa raste kemi gjetur të skalitur dorën duke e lënë me fjalë që të tregohet që «kjo është dora e mjeshtrit». Kështu e kemi gjetur në Çermenikë, në Labëri e gjetiu. Diku mjeshtri ka gdhendur me skalitje dhe emrin e tij. Por ajo që është më e rëndomtë e që tregon përjetësimin e punës së mjeshtrit është çekiçi (fig. 21), vegla e tij kryesore, në disa raste i shoqëruar dhe me daltën. Mjeshtri murator e gurskalitës e ka ndjerë dhe e ka menduar punën e tij jo vetëm si një burim për të nxjerrë mjetet e jetesës, por dhe si një vepër arti të dashur për të, si një objekt që atij do t'i bëjë emër të mirë, që do ta bëjë të pavdekshëm në kujtimet e njerëzve që do të vërejnë veprën e tij.

Nga ky shqyrtim i thjeshtë del sa vijon:

1. Përdorimi në përgjithësi i motiveve të vjetra me karakter vendës, disa prej të cilave i shqyrtuam këtu, dëshmon për unitet pa dallim krahinash, në gjithë popullin tonë. Këto zbukurime në gur janë shprehje e vetëdies së tij kombëtare të zhvilluar gjatë mesjetës, shprehje e lidhjeve të tij ndërkrahinore.

2. Në mënyrë të veçantë spikat tema me origjinë të lashtë vendëse, që ka të bëjë me truallin shqiptar dhe me veçoritë e zhvillimit të tij historik, etnokulturor gjatë mesjetës e më tej.



Fig. 19. Oxhak i vatrës familjare. Çermenikë (Librazhd).



Fig. 20. Zbukurime në oxhak të vatrës familjare. Lëkundë (Miditë).

DO NOT COPY



Fig. 21. Çekiç i mjeshtrit, në një teh muri të shtëpisë, Velçë (Vlorë).

3. Nëpërmjet motiveve të shqyrtuara paraqite virtytet më të lashta të shqiptarit, si: shpirti i tij paepur, dashuria për të futur të bukurën në jetën tij, ndjenja e unitetit, trimëria dhe shpirti luftarak i tij, qëndresa e papërkulur e tij në shekuj, besa burrëria e mikpritja, virtyte që shqiptari i ka ruajtur e i ka zhvilluar për shekuj e sot në kushtet kulturës së re socialiste do t'i zhvillojë e t'i çojë më tej, mbi një bazë të re shoqërore e botëkuptimore.

Studimi i shenjave e motiveve simbolike e me karakter zbukurimi në gurgdhendje, punë krijuese dorës dhe e mendjes së mjeshtrave popullorë, mendoj se është një temë me interes të veçantë shkencar. Kërkimet e vazhdueshme në të ardhmen në këtë fushë do të hedhin dritë të re në njohjen e rrugëve nga ka kaluar ndër shekuj zhvillimi etnokulturor popullit tonë, si zhvillim i brendshëm unitar, po dhe duke dhënë e duke marrë me popujt e tjerë fqinj. Fqinjësia mijëravjeçare me popuj të tjerë shpjegon dhe praninë e elementeve të njëjta në zbukurime të këtij lloji.

DO NOT COPY

Mark TIRTÀ

SUR L'ORIGINE DE CERTAINS MOTIFS GRAVES DANS LES MAISONS PAYSANNES ALBANAISES

RESUME

Dans ce petit écrit, il sera question de certains motifs décoratifs gravés sur des pierres ciselées de la porte de la maison et des encoignures extérieures des murs, des cheminées du foyer, ainsi que des monuments qui s'élèvent sur les tombes, appartenant aux milieux ruraux des régions montagneuses de notre pays. Les données ont été recueillies par l'auteur pendant les expéditions sur place, dans ce même but ont été consultées aussi les collections photographiques et les matériaux des archives éthnographiques de l'Institut de la Culture Populaire.

Dans la maison paysanne, l'ottention est attirée de façon particulière par certains signes et motifs symboliques gravés sur pierre à la porte et à la cheminée du foyer familial. Ceci relève du grand rôle qu'ont joué la porte et le foyer familial dans la vie de l'homme. La porte d'entrée et le foyer ont été considérés dans la mentalité populaire comme symboles de la force et de l'inviolabilité de la famille, de son unité, de son appartenance sociale, comme symboles de la continuité de la génération, comme symboles de l'honneur et des vertus morales de la famille comme la bravoure, l'hospitalité, l'amour de la patrie, la parole d'honneur (besa), la vaillance («porte de braves»). C'est dans ces fonctions qu'est vue aussi toute la maison d'habitation, mais ce qui est principal en elle, ce sont la porte et le foyer. Les motifs gravés sur pierre dans la maison paysanne, ainsi que ceux faits sur les monuments, s'élevant sur les tombes, représentent en général: un serpent, une ou deux mains d'homme, la tête du chamois, les services à café et d'autres symboles de l'hospitalité, un combattant à cheval, des visages humains, divers objets de la vie familiale, plantes et fleurs, outils de travail, des images de corps célèstes comme: le soleil, la lune, les étoiles, des animaux: chèvres, moutons, vaches, chevreuils; des signes symboliques religieux. Au-dessus de tout se distingue l'aigle bicéphale. Souvent on rencontre les mêmes motifs de cette espèce dans différentes régions albanaises comme en Labëri, à Përmet, à Korça, en Çermenikë, en Mirditë, à Puka, en Dibër, en Mat, en Dukagjin, en Malësi e Madhe, en Kosovë, à Dibër e Madhe et à Tetovë, dans des contrées albanaises de Monténégro, ce qui témoigne de l'unité culturelle de notre peuple.

On y trouve des motifs tirant leur origine de la mythologie populaire comme: le serpent, la figure anthropomorphe d'un ancêtre mythique, la main, les seins, le sapin, mais qui à l'époque actuelle ont revêtu des fonctions purement décoratives. On a aussi des motifs qui à l'origine ont des contenus réalistes et reflettent des mentalités et des vertus différentes du peuple: hospitalité, force, parole d'honneur, amour de la patrie, bravoure, amour du beau dans la vie familiale. Les motifs témoignés sur les territoires albanais dans l'antiquité, au moyen-âge et qui continuent jusqu'à l'époque actuelle, et d'autre part, qui sont liés étroitement à des traits éthnoculturels de ce peuple, nous les avons appelés d'origne autochtone, indépendamment du fait que de tels motifs se trouvent chez d'autres peuples. On a aussi des motifs qui se distinguent comme étant de source gréco-byzantine, romaine, turque, vénétienne: des signes et symboles introduits par le christianisme et l'islamisme. On a aussi des motifs tels que la lune par exemple, qui a un culte ancien autochtone, mais qui est aussi renforcé par les traits de l'influence orientale islamique. Il n'y est pas de frontières tranchées entre les motifs à nature autochtone et ceux d'influence étrangère.

* * *

Nous allons présenter ci-dessous quelques motifs d'origine ancienne autochtone, dans ce sens qu'en général ils sont témoignés aussi chez les illyriens et deuxièmement, ce qui est plus important, ils sont liés à des rites, à des mythes, à des vertus de notre peuple, donc ils sont développés comme partie constituante éthno-culturelle de ce peuple, au cours du Moyen-Age et ont une étendue territoriale pan-albanaise.

1. Le serpent. *On le relève sur des portes de maisons paysannes et des monuments tombales dans diverses régions albanaises. A l'origine, nous avons à faire là avec l'esprit protecteur de la maison, donc à un culte ancien totémique chez notre peuple. A là période illyrienne et au Moyen-Age, l'image du serpent on la connaît des témoignages archéologiques et de la littérature écrite. L'imagination du serpent comme une divinité protectrice de la maison on la connaît largement des données mythologiques et des traditions orales populaires. Ce motif on le trouve fréquemment aussi sur divers objets de bois comme des quenouilles, des houlettes de bergers, des lahouta (instrument de musique à une seule corde), des tchiftéli (petit instrument de musique à deux cordes) des pipeaux doubles, des placards, et des trapazans de foyer familial.*

Dans la tradition populaire, subsistait jusqu'à notre siècle, la croyance que toute maison avait son propre serpent, appelé

DO NOT COPY

par différentes appellations comme: la couleuvre de la maison, la «vitore» de la maison, le serpent de la maison, l'itoks. Ce serpent dans la mentalité populaire s'appelait l'heure de la maison, le garde de la maison; selon cette mentalité, il portait bonheur à la maison, aux hommes, dans l'élevage, dans les productions agricoles, dans le bien-être général. Il s'appelait «itoks» (i tokës = de la terre) dans le sens: il est possesseur de la terre.

Il est tout à fait naturel de penser que ces facteurs ont fait que cet être devienne un motif bien aimé de l'art populaire de la gravure.

2. Les figures anthropomorphes. On ne va pas parler ici de certaines figures réalistes, qui dans les contes populaires représentent des personnes bien déterminées. On va parler d'un groupe de figures, qui se présentent séparément (non en groupe). Ces figures représentent, selon la mentalité populaire, un ancêtre mythique de la maison, dont le pourquoi de la gravure est obscur, indéterminé. Cette figure se trouve dans des maisons construites au XIXe siècle et plus tard. Il est d'intérêt de noter que cette figure, dans certains cas, est gravée sur des encoignures extérieures du côté arrière de la maison notamment sur le côté, d'où venaient et y restaient, selon l'imagination populaire, les âmes des ancêtres les jours de fête, lorsqu'elles veulent entrer dans la maison et prendre contact avec le foyer familial.

3. Les seins. On les trouve gravés en relief sur des murs dans les maisons paysannes dans diverses régions albanaises. Ce sont un élément ancien qu'on relève aussi dans les trouvailles archéologique de la période illyrienne. Ils sont reliés au culte ancien de la fertilité et de la prospérité. Les fées au moyen du lait de leurs seins rendent puissant, «comme s'il était un dragon», le héro culturel Mujo.

4. La main. C'est un élément qu'on trouve souvent gravé sur pierre. Dans les contes populaires, elle représente le maître de la maison et de la famille; dans d'autres cas elles représente une alliance, surtout lorsqu'on trouve deux mains serrant l'une l'autre. Dans certains cas elle représente même le graveur. Il y a des cas où la main représente une décision ou un testament. On la rencontre aussi comme symbole de l'hospitalité.

5. Le sapin. Il est gravé dans diverses régions seul comme objet, mais en bas il a un berceau ou bien un disque solaire ou une rosette. Nous pensons qu'à l'origine, il est relié au culte de la végétation et du renouvellement de la vie (avec le berceau d'enfant).

6. Des symboles de l'hospitalité albanaise. C'est dans ce sens que parfois apparaît aussi la main qui accueille le hôte, mais on trouve plutôt gravé le service à café ou d'autres objets servant à boire ou à manger. Leur ancienne tradition du pays s'explique par l'hospitalité albanaise si proverbiale chez notre peuple.

7. Les armes, le chevalier combattant. On trouve des armes des plus diverses ciselées comme des couteaux, des épées, des pistolets, des carabines, des fusils et même des armes d'une époque plus récente. Elles sont liées aux traditions combattives de notre peuple. Le peuple a beaucoup aimé l'arme parce qu'elle a été liée avec sa vie et son existance. Les armes du chevalier combattant, on les trouve souvent même sur les monuments tombales.

8. L'aigle bicéphale. Elle est très propagée sur des portes de maisons dans toutes les contrées albanaises au Sud et au Nord de l'Albanie, en Kosove, et en Çamëri. Ce motif a une tradition médiévale vernaculaire, mais il s'est multiplié en gravure, surtout depuis le temps de la Renaissance (XIXe siècle) comme symbole de l'expression du patriotisme et de l'unité nationale. Les régions où il s'emploie le plus sont celle du Mat, de Puka et de la Mirdita.

9. Des motifs de travail du maître graveur. Le maître a gravé sur pierre même les signes symboliques de son travail comme la main (avec l'inscription: «Celle-ci est la main du maître»), le plomb, et surtout le marteau et le ciseau. Le maître a senti et pesé son travail non seulement comme une source de moyens de vie, mais aussi comme une oeuvre d'art qu'il aime, comme une oeuvre qui va laisser le bon souvenir de son nom dans la mémoire des hommes.

Ces motifs anciens de source vernaculaire témoignent d'un lien ethnoculturel interrégional pan-albanais, élaboré au cours des siècles du Moyen-Age; ceci parle des particularités du développement historique de notre peuple depuis l'antiquité jusqu'à notre temps nouveau; ces motifs représentent des vertus anciens de l'albanais comme l'esprit flexible, l'effort déployé en vue de conserver ses particularités ethnoculturelles, l'amour visant à faire introduire le beau dans la vie, le sentiment d'unité, de bravoure et l'esprit combattif, la résistance inflexible au cours des siècles, la parole d'honeur (besa), la bravoure, l'hospitalité, l'esprit d'artiste, autant de vertus que l'albanais a conservés et développés au cours des siècles et qu'aujourd'hui, dans les conditions de la nouvelle culture socialiste, il développera et portera plus en avant sur une nouvelle base sociale et de conception du monde.

Les études futures mettront au nouveau jour ce thème si important de l'art populaire albanais.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

monumentet

KRITIKE E BIBLIOGRAFI

Ali MUKA

BANESA POPULLORE E KOSOVËS NË VEPRËN «GJURMË E GJURMIME» TË MARK KRASNIQIT

Vepra e studiuesit të mirënjohur kosovar, prof. Mark Krasniqit, me titullin kuptimplotë **«GJURMË E GJURMIME»**, është botuar për herë të parë në Prishtinë, në vitin 1979. Duke u nisur nga vlerat që ka dhe ndihmesa që sjell në njohjen dhe studimin e kulturës mbarëshqiptare, libri u ribotua kohët e fundit nga Shtëpia Botuese «8 Nëntori» (Tiranë) në bashkëpunim me Institutin e Kulturës Popullore dhe u vu në qarkullim.

Me këtë shkrim, nuk pretendohet një analizë tërësore e shterruese e veprës. Pasi të japim një vështrim me karakter njohës për përmbajtjen e vëllimit dhe të vëmë në dukje disa nga vlerat e tij, do të ndalemi disi më gjerë për karakterin e vendbanimeve dhe të banesës popullore në Kosovë. Për problemin e fundit, përveç të dhënave me interes që sjell M. Krasniqi në veprën e sipërpërmendur, do të kihet parasysh edhe ndonjë punim i botuar tek ne për arkitekturën popullore të Kosovës.

* *
*

Për t'u njohur me përmbajtjen e librit, lexuesin e ndihmon paraprakisht edhe parathënia e autorit. Aty mësojmë se kemi të bëjmë përgjithësisht me studime të shkruara në kohë të ndryshme që fillojnë nga viti 1958 e deri më 1979. Ato janë botuar në revista e organe të ndryshme brenda e jashtë Jugosllavisë. Në parathënie njihemi edhe me synimet e autorit për këtë botim. Ai, nga pozita e shkencëtarit patriot, dëshëron të plotësojë zbraztësinë në fushën e studimeve etnografike në Kosovë. Madje, në fund parathënia ka një tingull aktual: «Kultura popullore ka qënë një mbrojtje e fuqishme gjatë historisë nga asimilimi, shkombëtarizimi dhe zhdukja e plotë e kombit shqiptar nga faqja e dheut. – Prandaj është detyrë jo vetëm e jona, por edhe e brezave që vijnë, që atë ta duam, ta mbledhim e ta studiojmë me pasion».

Për nga natyra libri ka karakterin e një përmbledhësi studimesh etnografike, me një tematikë të gjerë e të larmishme nga kjo fushë. Përfshihen gjithsej 24 artikuj e studime. Të gjitha shkrimet shoqërohen në fund me nga një përmbledhje në gjuhën frënge. Një pjesë të këtyre studimeve, për vetë karakterin e natyrën e tyre, autori e ka shoqëruar me fotografi, skica, planimetri, harta e grafikë të ndryshëm. Gjithashtu, mjaft të dhëna statistikore që sillen në ndonjë shkrim, janë përmbledhur në formë tabelash. Të gjitha këto që thamë, po t'u shtohet edhe gjuha e qartë dhe e rrjedhshme e autorit, e bëjnë librin komunikues jo vetëm me specialistët, por edhe me masën e gjerë të lexuesve.

Kur e shikon në tërësi vëllimin, vëren se nuk respektohet renditja kronologjike në radhën e vendosjes së artikujve. Autori për këtë çështje është nisur nga përmbajtja e karakteri i studimit, pavarësisht nga koha kur është shkruar ai. Nga kjo mënyrë renditjeje përfitojnë më shumë specialistët, të cilët i gjejnë pranë e pranë artikuj e studime me tematikë të njëjtë ose të përafërt. Kjo, nga një anë, ndihmon në plotësimin e njohurive për tema të caktuara dhe, nga ana tjetër, rrit në mënyrë shkallëzore njohuritë për aspekte të ndryshme të kulturës popullore të kësaj treve. Për studiuesin e arkitekturës popullore kanë rëndësi të veçantë artikujt: **«Kulla në Rrafshin e Dukagjinit»** (f. 326-365), **«Shtëpia shqiptare në Kosovë»** (f. 365-434), **«Funksioni i odës së miqve në Kosovë në epokën e**

Lidhjes së Prizrenit» (f. 434-443) dhe **«Gdhendja artistike e drurit në fshatrat e Kosovës»** (f. 443-465). Të gjithë këta artikuj i kalojnë 140 faqet. Po të kemi parasysh se libri ka gjithsej 465 faqe, atëhere kuptohet lehtë se studimet e mësipërme, duke zënë rreth një të tretën e vëllimit, kanë një peshë të rëndësishme. Kjo nuk qëndron thjesht në anën sasiore, por, në radhë të parë, në materialin interesant që ofron.

Gjithashtu, me rëndësi të shumanshme për studiuesin e arkitekturës popullore shqiptare janë edhe artikujt: **«Krahinat etnografike të Kosovës»** (f. 12-26) **«Strukturat demografike në Kosovë»** (f. 26-51), **«Familja e madhe patriarkale shqiptare në Kosovë»** (f. 197-239), **«Organizimi i jetës shoqërore në një familje të madhe në rrethin e Pejës»** (f. 239-250) dhe **«Struktura sociale e familjes së madhe Shehu në Hasin e Prizrenit»** (f. 250-260). Këta artikuj që radhitëm tani, kapin gjithsej rreth 90 faqe, pra gati një të pestën e vëllimit. Të marrë së bashku, dy grupet e artikujve që përmendëm më lart, zenë rreth gjysmën e vëllimit.

Treguesit e mësipërm të bindin pa mëdyshje se vepra në fjalë është me interes edhe për studiuesin e arkitekturës popullore shqiptare. Ajo jo vetëm na jep panoramë të gjerë njohëse për këtë problem në Kosovë, por edhe zgjeron e thellon njohuritë tona për banesën popullore mbarëshqiptare. E veçanta në vlerën e domethënien e këtyre studimeve qëndron në faktin që ato janë trajtuar me syrin e një etnografi me përvojë, i cili i ka pasqyruar fenomenet e dukuritë në radhë të parë me gjuhën dhe mjetet e kësaj disipline të mirëfilltë shkencore.

Në shkrimet e tjera që përfshihen në këtë vepër e që, për nga titujt, kapin më shumë se gjysmën e vëllimit, me interes janë ato që i kushtohen rolit të besës shqiptare (f. 175-197 e gjetiu). Një vend të dukshëm zenë artikujt kritikë për disa të huaj që kanë shkruar për shqiptarët ose për trojet e tyre. Këtu konkretisht është fjala për Mark Milanin **(«Shqiptarët në veprat e Mark Milanit»,** (f. 275-286), Vuk Karaxhiqin **(«Etnografi serb Vuk Karaxhiqi për shqiptarët»,** f. 286--291), Hilferdingun **(«Shqiptarët në veprën e një diplomati rus»** f. 291-312) dhe Evlia Çelebiun **(«Shqiptarët në udhëpërshkrimin e Evlia Çelebiut»,** f. 312-318). Në grupin e këtyre shkrimeve hyn edhe artikulli **«Sytë e Simonidës»** (f. 155-168), që në thelb i kushtohet qëndrimeve të poetit serb Milan Rakiq ndaj shqiptarëve.

Të marrë në tërësi, këta artikuj kritikë kanë vlera të shumanshme. Ata pasurojnë këtë lloj literature shkencore ndaj së cilës studiuesit shqiptarë janë gjithmonë borxhlinj, po të kemi parasysh baltën që është hedhur në adresë të popullit shqiptar dhe të kulturës së tij.

Nga studimet vlerësuese-kritike, lexuesit i le mbresa në mënyrë të veçantë artikulli **«Sytë e Simonidës»** Veçanërisht të thella e prekëse janë gjykimet e autorit në këtë artikull. Aty ndihet mprehtësia e shkencëtarit dhe e kritikut të brumosur me ndjenjat e patriotit. Me argumente të shëndosha e bindëse hidhen poshtë qëndrimet e pabazuara të serbomadhit Milan Rakiq, që shkruan i veshur me petkun e poetit. Me thjeshtësinë dhe qartësinë e tij artikulli ruan një forcë të madhe aktuale. Ngjarjet e fundit në Kosovë tregojnë qartë se Rakiqët apo Hilferdingët, tanimë të zhveshur nga ndonjë pekt i mjergullt që u përpoqën të mbanin përkohësisht e formalisht, janë jo vetëm gjallë, por dhe në aktivitet të plotë kundër popullit shqiptar dhe kulturës së tij.

Jo vetëm në këta artikuj, por në mbarë librin autori tregohet i matur e objektiv në dhënien e gjykimeve dhe të vlerësimeve. Ai di të verë mirë në ballancë e të diferencojë fjalët dhe veprimet që qëndrojnë pas tyre. Tipik në këtë kontekst është portreti i Mark Milanit. Në shkrimet e tij ky autor jep në adresë të shqiptarëve vlerësime të ndjeshme pozitive, ndërsa kur ka qënë fjala për veprime e qëndrime praktike e konkrete, në adresë të të drejtave që u janë marrë nëpër këmbë shqiptarëve, Mark Milani është vënë në mënyrë të ndërgjegjshme në krahun e armiqve të tyre. Kështu, ndjenjat e shovinizmit pansllavist nuk i kanë munguar as Mark Milanit.

Në të njëjtën kohë lexuesi nuk e ka të vështirë të konstatojë se autori nuk ngatërron ithtarët e borgjezisë serbomadhe e të kujtdo tjetër, me popullin serb dhe popujt e tjerë fqinj. Jo rrallë në rrjedhë të historisë fati i këtyre popujve ka qënë i lidhur me fatin e popullit shqiptar.

* * *

Në mënyrë të përmbledhur disa nga vlerat dhe tiparet e veprës së Mark Krasniqit janë:

1. Tematika e shqyrtuar ka një shtrirje të gjerë. Ajo është e larmishme dhe nga fusha të ndryshme të historisë së kulturës popullore shqiptare. Megjithatë, librit, të marrë në tërësi, nuk i mungon një bosht e njëherazi një objektiv: Atë e përshkon ndjenja e dashurisë për Kosovën, për njerëzit e saj, për historinë dhe kulturën kombëtare të këtyre njerëzve e të këtyre trojeve. Objektivi i autorit është që, nga një anë, t'u tregojë të huajve se ky popull është gjithë gjallësi, prandaj edhe ka një histori dhe një kulturë të tillë. Nga ana tjetër, autori synon që me këtë libër të nxisë sa më shumë brezat e rinj të Kosovës që të punojnë me përkushtim për njohjen dhe kultivimin e mëtejshëm të vlerave pozitive të kësaj

PHOTOCOPY

2. Duke lexuar librin bindesh se autori jo vetëm ka zbritur në terren por dhe e njeh atë, duke mos qënë një vrojtues pasiv. Pikërisht informacioni i saktë që bie nga terreni, informacion që në mjaft raste arrin deri në ditët tona, është një tregues me rëndësi i origjinalitetit të studimeve që na ofron ky autor.

3. Studime të organizuara e sistematike për Kosovën, veçanërisht në fushën e etnografisë, kanë munguar. Vlerat e veprës rriten edhe më shumë, po të kemi parasysh këtë mungesë. Artikujt me tematikën e tyre, plotësojnë njëri-tjetrin dhe së bashku ndihmojnë për një përfytyrim të gjerë njohës të kulturës popullore të kësaj treve.

4. Autori i shmanget trajtimeve artificiale. Ai asnjëherë nuk përdor fraza të errëta. Pra, gjuha e thjeshtë dhe qartësia janë tipare dalluese të këtij vëllimi. Me këtë thjeshtësi e qartësi në të shkruar, autori paraqitet edhe optimist, edhe tendencioz. Motoja e autorit është: «Dashuria ndaj popullit nuk mund të jetë e sinqertë, nëse nuk çmohet dhe duhet kultura e tij» (f. 8-9).

Veçoritë kombëtare ose karakterin kombëtar të dukurive që shqyrton, autori nuk do të mund t'i vinte në dukje, po t'i shikonte e t'i trajtonte ato të shkëputura ose jashtë historisë së Kosovës, veçanërisht, e të kombit të tij përgjithësisht. Në këtë histori notat e optimizmit nuk kanë munguar asnjëherë. Në mënyrë të veçantë bie në sy interesimi dhe ndjenja e krenarisë së autorit për temën e lëvizjes kombëtare shqiptare. Duke u kthyer e rikthyer shpesh tek idetë dhe bëmat e saj, ato marrin forcë të madhe edukuese në kushtet aktuale.

5. Theksuam që autori është edhe tendencioz. Larg paragjykimeve, ai përpiqet t'i analizojë e t'i interpretojë dukuritë deri në atë shkallë që i njeh nga materiali bindës që disponon. Veçse asnjëherë nuk e zhvendos vëmendjen nga kryesorja tek anësorja. Autori nuk është tendencioz vetëm pse kërkon të evidentojë kombëtaren, por, para së gjithash, për frymën popullore me të cilën i bën analizat e trajtimet. Ai me bindje e pa mëdyshje do të tregojë se kultura jonë popullore nuk ka qënë një kulturë dosido. Ajo ka qënë dhe është e aftë për të transmetuar vlera e njëherazi edhe për të përfituar nga vlerat pozitive që kanë krijuar popujt e tjerë.

6. Autori analizon e përgjithëson nga pozita të përparuara të shkencës etnografike bashkëkohore. Kështu, krahas përdorimit të mjeteve dhe rrugëve tradicionale të etnografisë, ai jo në një rast ka kërkuar edhe ndihmën e shkencave të tjera. Kjo i ka çuar argumentimet dhe analizat më tej, duke i bërë ato më bindëse.

7. Vepra, me materialin e gjerë faktik që përmban, shërben edhe si burim dokumentar, kur është fjala për studime krahasuese gjithshqiptare.

*
* *

Përveç artikujve që trajtojnë drejpërdrejt arkitekturën popullore në Kosovë, autori edhe në ndonjë artikull tjetër të këtij vëllimi, prek sado shkurt aspekte të kësaj arkitekture. Të tilla gjen në faqet 15, 18-19, 20, 79, 131 etj.

Në artikujt kryesorë që i kushtohen banesës, Mark Krasniqi merr përsipër të shqyrtojë, në aspektin etnografik, banesën fshatare në Kosovë.

Duke e lexuar artikullin **«Shtëpia shqiptare në Kosovë»** (f. 365-434), bindesh se ke përpara një studiues me përvojë. Autori, pasi ka gjurmuar në terren e ka rrëmuar në literaturë, pra pasi është njohur mirë me problemin, e ndjen se për temën e marrë përsipër mungojnë analizat e hollësishme e paraprake të nevojshme për një punim sintezë. Me gjithë ndihmesën e lavdërueshme që sjell, ai me modesti dhe me gjykim objektiv, thekson se merr përsipër të ndriçojë problemin në atë masë, sa të paktën të duken konturet e tij kryesore (f. 366-367).

Në fillim na bën të njohur rolin e faktorëve natyrorë dhe ekonomiko-shoqërore në zhvillimin dhe ecurinë e arkitekturës popullore. Vështrimi i shkurtër fiziko-gjeografik për Kosovën dhe informacioni që sjell për klimën apo hidrografinë dhe karakterin e tyre në këtë zonë, janë gjithashtu pjesë të kësaj hyrjeje. Mjaft të dhëna numerike, të bazuara në dokumente zyrtare, plotësojnë kuadrin e tablosë njohëse paraprake me këtë trevë, me vendbanimet dhe banorët e saj. Duke u mbështetur kryesisht në të dhënat zyrtare të vitit 1971, autori na bën të njohur se në Kosovë përfshihen 1438 vendbanime, nga të cilat 7 qytete. Me interes janë edhe të dhënat për shtimin mesatar vjetor të popullsisë në Kosovë, të cilat janë nga më të lartat në Evropë.

Vendin qendror në artikull e zenë ndërtimet popullore dhe deri në një farë mase edhe karakteri i vendbanimeve, gjithmonë i parë në lidhje me dukurinë e parë. Përveç analizës së ndërtimeve të veçanta, qofshin këto për banim ose ndihmëse ekonomike, me interes është edhe shqyrtimi i oborrit të banimit dhe i strukturës së tij.

Theksuam se autori e ka ndjerë mungesën e analizave paraprake e të hollësishme që ndihmojnë drejtpërdrejt për një kategorizim të përpiktë të tipave të banesave. Ndërkohë, rruga që ka zgjedhur për realizimin e mirë të kësaj detyre, ka domethënien

e vet. Autori në themel të shqyrtimit të materialit ka vënë kriterin gjeografik të përhapjes së vendbanimeve. Është fjala për përhapjen vertikale-hapësinore të fshatrave në Kosovë. Mbi bazën e kësaj përhapjeje, ndërtimet popullore i shqyrton për dy breza gjeografike themelore. Së pari, merr në shqyrtim vendbanimet e viseve malore që shtrihen të paktën 1000 m mbi nivelin e detit. Së bashku me karakterin e tyre shqyrton edhe ndërtimet popullore. Më tej shqyrton po këto dukuri në vendbanimet e vendosura në viset fushore.

Artikulli i ndërtuar me këtë bosht ndihmon në përftimin e një tabloje të gjerë njohëse për arkitekturën popullore dhe karakterin e vendbanimeve në Kosovë.

Për një shqyrtim më analitik të materialit, autori edhe brenda viseve malore dallon dy nënndarje: nënndarjen e parë ose të sipërme dhe nënndarjen e dytë ose të poshtmen.

Tipar dallues i nëndarjes së sipërme është se aty ndodhen vendbanimet e përkohshme stinore. Ndërtimet më karakteristike të këtyre vendbanimeve janë **tëbanat** ose **stanet e barinjve.** Ato janë përdhese e ndërtohen kryesisht me lëndë druri. Deri edhe për lidhjet, në vend të gozhdëve, përdoren kunja druri. Ndërtime të tilla u shërbejnë barinjve për të kaluar natën ose ditët me shi.

Në vitin 1980, gjatë një kalimi të shkurtër në Rugovë, ne na ra në sy që ende përdorej në stane një ndërtim i tillë.

Një koncept i tillë ndërtimor ka shërbyer edhe si banesë e familjes. Në këto raste asaj i shtohet edhe ndonjë aneks tjetër, qyleri i bulmetit ose çaraniku. Pavarësisht nga materiali ndërtimor i përdorur, studimet për arkitekturën tonë popullore kanë treguar se banesa përdhese njëkthinëshe ka qënë në përdorim në mjaft zona të vendit tonë. Siç pohon edhe autori, ajo është e përhapur edhe në vise të tjera malore të Ballkanit.

Tipar dallues i nëndarjes së dytë ose të poshtme të regjionit malor janë vendbanimet e përhershme. Ato janë relativisht të vogla dhe kanë karakter të shpërndarë. Ndryshe nga stani i barinjve, ku banesa ka vetëm një kthinë që përmbush disa funksione, këtu banesa është me disa kthina, bile ndërtohet kryesisht dykatëshe. Një banesë e tillë, duke pasur karakter të përhershëm, edhe kthinat i ka me funksione të përcaktuara. Të tilla janë «oda e miqve», «shtëpia e zjarrit» dhe «qylerët» për fjetjen e çifteve bashkëshortore. Kurse kati përdhes i banesës dykatëshe zakonisht shërbente për strehimin e bagëtisë.

Nga larmia e banesave dykatëshe, autori në mënyrë të veçantë i vë theksin asaj banese që populli e njeh me emrin «çardak». Zakonisht ajo ndërtohej pjesërisht me mure guri (kati përdhes) dhe pjesërisht me lëndë druri (kati i sipërm). Të paktën si koncept ndërtimor, vazhdon të përdoret edhe sot. Në vitin 1977, ndërtime të ngjashme kemi parë në rrethinat e Rozhajës, të Plavës e të Gucisë, në të cilat banojnë mjaft shqiptarë. Po kështu, ndërtime të tilla vumë re me shumicë edhe në fshatin Bogë të Rugovës, në vitin 1980. Ato nuk kanë munguar edhe në zona të tjera verilindore të vendit tonë, sikurse është vënë në dukje në artikujt e botuar për këto krahina. M. Krasniqi vë në dukje gjithashtu se gjurmë të përdorimit të kësaj banese janë vënë re edhe në vendbanimet e viseve fushore e kodrinore të Kosovës. P. Thomo gjurmë të tilla, si ndërtime të vjetra, ka gjetur në fshatra që shtrihen midis Pejës e Gjakovës, në një ekspeditë të kryer në vitin 1978.

Në viset malore blegtoria ka qënë degë me rëndësi e ekonomisë, prandaj ka pasur ndikimin e saj jo vetëm në banesë, por edhe në karakterin, rolin dhe vendin e ndërtimeve ekonomike. Edhe këto ndërtime autori i analizon hollësisht. Ai vë në dukje se vërtet prodhimet bujqësore në këto zona janë të pakta, por edhe prodhimet blegtorale megjithëse disi më të shumta, nuk zenë shumë vend në banesë ose në anekset e saj.

Në ndërtimet ekonomike të viseve malore autori përfshin pojatën, pozllomin, torishtën, hambarin prej dërrasash ose kosherin prej thuprash dhe mullarë të ndryshëm. Mjaft nga këto objekte të vendosura rreth ose pranë banesës dhe së bashku me të, të rrethuara me mure ose me gardh, i japin ndërtimeve të familjes karakterin e një grupimi.

Përfundim me rëndësi i autorit është se të gjitha këto ndërtime, duke filluar që nga sipërfaqja e përgjithshme e oborrit, kanë përmasa të vogla, janë me funksione të kufizuara, me një numër jo të madh kthinash dhe me realizime gjithsesi jo aq të shënuara, në krahasim me ndërtimet analoge të vendbanimeve fushore.

Konstatim me interes është edhe dukuria se familjet e mëdha në zonat malore tanimë janë të rralla në raport me këtë dukuri në zonat fushore.

Të gjitha problemet e mësipërme që trajtoi për viset malore, autori i trajton më tej, natyrisht më me hollësi dhe më gjerë, për viset fushore. Këtu ai ka parasysh vendbanimet që shtrihen nga rrëza e Bjeshkëve të Nemuna në perëndim, e gjer afër Vranjës e Bujanovcit në lindje. Për këtë pllajë të gjerë autori na informon se ndërtimi gjeologjik, klima dhe jeta ekonomike, kanë specifikat e tyre. Këtu vendbanimet janë të dendura. Banesat e çdo vendbanimi janë të grumbulluara diku në një skaj të fushës, për të lënë

FOTOCOPY

kështu më shumë fushë të lirë për bujqësi. Banesat janë të grupuara nëpër mëhallë sipas gjinisë, bajraqeve ose vëllazërisë.

Autori na njeh në mënyrë të shkallëzuar me ndërtimet e përdorura për banim, që nga format më primitive e deri tek ato më të zhvilluarat. Format më primitive të banimit kanë qënë **kasollja** e ndërtuar me gardh dhe e lyer me baltë dhe **përdhesja** e ndërtuar me qerpiç, tulla, gurë ose kombinime të tyre. Ndërsa kasollja ka mbetur në format e saj të thjeshta me një, e shumta, dy kthina, përdhesja në mjaft raste ka shërbyer si njësi bazë. Më tej asaj i janë mbështetur kthina të reja, të vendosura njëra pas tjetrës në formë vargu e të mbuluara me një çati. Struktura planimetrike e lindur nga kjo vendosje nuk i nënshtrohet spontanitetit, por bëhet sipas një kriteri përgjithësisht të përcaktuar. Tipike në këtë drejtim është skica që autori sjell në faqen 386 të librit. Materiali është marrë nga zona fshatare e Prishtinës. Aty vërejmë se në njërin skaj është vendosur kthina e miqve, në tjetrin «shtëpia e zjarrit», ndërsa ndërmjet tyre janë qylerët për çiftet bashkëshortore. Një banesë e tillë ka në ballin e përparmë një hajat me përmasa jo të mëdha. Një ndërtim i tillë, në të kaluarën, ka qënë banesë tipike e çifçinjve dhe ka pasur përhapje më të gjerë në Pllajën e Kosovës sesa në Rrafshin e Dukagjinit. Pa mohuar përhapjen e gjerë në Ballkan, autori thekson se kjo banesë në Kosovë ka tiparet e veta specifike ku në radhë të parë bie në sy oxhaku i madh karakteristik.

Një shembull tjetër i rëndësishëm është ai i sjellë në skemën planimetrike numër dy të faqes 390, që është marrë nga Gollaku i Kosovës. Ndryshe nga shembulli që shqyrtuam më lart, këtu vërejmë grupime ndërtimesh brenda një oborri. Dhoma e miqve është një ndërtim i veçantë.

Një zgjidhje me interes është dhe ajo që na jepet në mënyrë grafike në faqen 408, ku gjejmë përngjitjen e «kullës» me «shtëpinë e gjatë». Kjo strukturë planimetriko-volumore ka arritur zgjidhje mjaft interesante në Kosovë, sidomos në familjet e mëdha që janë ende karakteristike për mjaft fshatra të Rrafshit të Dukagjinit. Në shembullin grafik që sillet në faqen 411, vërejmë se brenda oborrit të një familjeje të madhe përfshihen njëmbëdhjetë ndërtime për banim dhe ndërtime ndihmëse ekonomike. Ky shembull ilustron mjaft mirë edhe vetë karakterin e oborrit të banimit të një familjeje të madhe fshatare në Rrafshin e Dukagjinit.

Përveç ndërtimeve të mësipërme, të cilat i përmendëm shkurt, në Rrafshin e Dukagjinit ka pasur një përhapje të gjerë banesa e fortifikuar, që në popull njihet me emrin **«kullë».** Kësaj banese, autori i kushton edhe një artikull të veçantë, sikundër e kemi përmendur. Pra, nga e gjithë pasuria që ka Kosova në fushën e arkitekturës popullore, autori ndalet më gjatë për kullën. Ai thekson me të drejtë se, kur flitet për arkitekturën popullore shqiptare të Kosovës, menjëherë të shkon mendja te ai tip shtëpie që është më karakteristike dhe më i bukuri në këtë trevë. Nga i gjithë materiali dhe argumentat bindëse që sjell autori, lexuesi e kupton se ecuria dhe arritjet e kësaj banese janë rrjedhim i veprimit të faktorëve të brendshëm e aspak kopjim apo imitim mekanik gjedhesh të huaja. Ai hedh mendimin se banesa e vjetër e njohur me emrin **çardak** duhet të jetë një hallkë e rëndësishme në kalimin drejt banesës së fortifikuar ose kullës. Studimet e kohëve të fundit, të kryera nga studiuesit tanë, nëpërmjet një parashtrimi relativisht më analitik të materialit kanë hedhur dritë mbi idenë e mësipërme.

Duam të theksojmë, gjithashtu, se autori jo vetëm në këtë studim, por edhe në raste të tjera, i kushton një kujdes të veçantë vendit të kullës në etnopsikologjinë e popullit. Në folklorin e tij gojor populli e ka përjetësuar mirë këtë dukuri.

Duke u ndalur në analizën e kthinave të banimit, autori i kushton një vend të rëndësishëm «odës së miqve» si një kthinë me tipare mjaft dalluese mbarëshqiptare. Kësaj kthine ai i kushton një artikull të veçantë, që vë në dukje rolin e saj në planin shoqëror në epokën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Nuk është e rastit që në traditën e popullit tonë kjo kthinë zë një vend me individualitet të qartë. Ajo, në vështrim arkitektonik, është kthina më e përpunuar dhe më komodja në raport me kthinat e tjera. Në zgjidhjet planimetriko-volumore ajo zë gjithmonë katin më të lartë. Në plan etnografik, ajo është kthina ku vihen në përdorim pajisjet, takëmet, shtresat, mbulesat dhe gjithshka tjetër më e mirë e më e bukur që ka familja. Kjo kthinë materializon traditën e mikpritjes dhe burajinë e zemrës shqiptare.

Vendin e tyre në studimet për arkitekturën popullore të Kosovës kanë edhe problemet e teknikës së ndërtimit, të materialeve të ndërtimit të përdorura dhe të mjeshtërve ndërtues. Aty mësojmë se, përveç mjeshtërve shqiptarë të Dibrës, në mjaft rrethina etnografike të Kosovës ka mjeshtër të talentuar vendas. Në mënyrë të veçantë spikasin ata që merren me përpunimin artistik të objekteve prej druri, që vazhdojnë këtë traditë me dashuri edhe në ditët tona.

*
* *

Banesa popullore shqiptare ka shënuar në rrjedhë të kohës arritjet e saj. Ajo, si mjaf dukuri të

Dokument

tjera të historisë e të jetës së popullit tonë, ka tërhequr në të kaluarën vëmendjen e studiuesve të ndryshëm. Nga ky realitet nuk bën përjashtim banesa popullore e Kosovës. Për arkitekturën popullore të Kosovës ka shkruar edhe ndonjë studues jugosllav. Edhe në ato raste, kur përgjithësisht s'ka munguar objektiviteti, për të ose është heshtur ose, e shumta, ajo është trajtuar në mënyrë anësore, asnjëherë e plotë e tërësore. Prandaj nisma e marrë nga Mark Krasniqi dhe botimi i veprës kanë vlera të posaçme. Ato, për nga gjerësia me të cilin e rrahin problemin dhe për nga materiali faktik që sjellin, përbëjnë një ndihmesë me vlerë për studimin e arkitekturës popullore shqiptare. Këndvështrimi i autorit për problemin e mësipërm është i gjerë. Aty gjejmë të karakterizuar fshatin kosovar jo vetëm në shekullin e kaluar ose në fillimet e shekullit XX, por deri në ditët tona. Një nga pohimet më të rëndësishme e më domethënëse të autorit, është ai që ndërtimet në viset malore janë të ngjashme me ato të viseve fushore. Ato siç e thamë ndryshojnë nga përmasat dhe shkalla e përpunimit dhe e përkujdesjes. Në shkallët e ndryshme të arritjeve e ka thënë fjalën e vet edhe karakteri i ekonomisë dhe shtresëzimi shoqëror i fshatarësisë, i cili ka qënë vazhdimisht i pranishëm. Pra, në mënyrë të përmbledhur, duke përdorur fjalët e autorit, mund të themi se Kosova edhe në fushën e arkitekturës popullore është një «fushë e begatë», një «fushë pjellore».

Larmia e ndërtimeve që takojmë në Kosovë, shkallëzimet e tyre që nga format e thjeshta primitive e deri tek format e arritura tregojnë se: **Së pari,** shoqëria fshatare e kësaj treve me gjithë trysninë e gjatë e të shumanshme të pushtimeve të huaja, e ka njohur zhvilimin edhe në këtë fushë. **Së dyti,** kjo shoqëri nuk ka qënë as nomade dhe as primitive, por një shoqëri ndejtare me një shtresëzim shoqëror-klasor të kristalizuar qartë. Vendbanimet e ngulitura, karakteri kompleks i ekonomisë, ku vendin kryesor e zënë bujqësia dhe blegtoria, flasin për këtë. **Së treti,** në arritjet themelore të arkitekturës popullore të kësaj treve shihet veprimi i padyshimtë dhe i drejtpërdrejtë i ligjeve të brendshme të zhvillimit të saj brenda kushteve, mundësive dhe rrethanave që diktonte koha. Për këtë arsye ecuria e saj duket e natyrshme e pa sforcime në kalimet nga format e thjeshta tek ato të zhvilluarat. Të mos harrojmë se ajo është realizim i mjeshtrit shqiptar të Dibrës ose i mjeshtërve të dalë nga vetë fshatrat e Kosovës. **Së katërti,** trajtimi i banesës popullore të Kosovës përgjithësisht, dhe i kullës së Dukagjinit, veçanërisht, japin një pasqyrim të gjallë dhe veprimtar të botës psikologjike të shqiptarit që jeton në trojet e veta stërgjyshore. Vërtet kulla në radhë të parë është banesë, por në realizimin e saj ka lozur rolin e vet edhe bota psikologjike e shqiptarit të Kosovës, që e ka pasur gjithnjë pushtuesin mbi kokë. Momenti më thelbësor që spikat nga kjo botë, është lufta jo për një gjallesë dosido, por për një ekzistencë me dinjitet e krenari kombëtare. Natyrisht, autori e shpreh qartë se ky faktor nuk është as i vetmi, as kryesori, por thekson se edhe ai ka luajtur rolin e vet të padyshimtë. Jo rastësisht autori ve në dukje se në vendet e Ballkanit përdorimi në masë i kullës me tiparet e saj individuale vërehet vetëm në trojet shqiptare. Në vende të tjera të Ballkanit ajo, si kategori ndërtimore, ka qënë vetëm banesë e fedualit. **Së pesti,** në të gjitha konceptet themelore të materializuara në këtë arkitekturë ne vërejmë ngjashmëri e deri njëjtësi të plotë me arkitekturën popullore të mjaft zonave të tjera brenda kufijve të sotëm politikë të Shqipërisë. Kjo përbën dëshminë më të pakundërshtueshme se këtu kemi të bëjmë me një popull e me procese kulturore të tij, që kanë vazhdimësi të pandërprerë.

DOKTORATURA

Ali MUKA

L'HABITATION POPULAIRE DE KOSOVA DANS L'OEUVRE «TRACES ET RECHERCHES» DE MARK KRASNIQI

DO NOT COPY

L'oeuvre de l'homme d'études connu de Kosovë, Prof. Mark Krasniqi, au titre significatif «Traces et Recherches» fut publiée pour la première fois à Prishtina, en 1979. Partant de ses valeurs et de son apport dans la connaissance de l'étude de toute la culture albanaise, ce livre a été publié de nouveau ces derniers temps par la Maison d'Edition «8 Novembre» (Tirana) en collaboration avec l'Institut de la Culture Populaire et a déjà été mis en circulation.

On ne prétend pas, dans cet écrit faire une analyse intégrale et exhaustive de l'oeuvre. Après avoir donné un exposé de caractère informatif sur le contenu du volume et mis en relief quelques'unes de ses valeurs, nous allons nous arrêter un peu plus longuement sur le caractère des centres habités et de l'habitation populaire en Kosovë. Sur ce dernier problème, à part les données d'intérêt qu'apporte M. Krasniqi dans son oeuvre susmentionnée, on tiendra aussi compte de quelque autre article, publié chez-nous, sur l'architecture populaire en Kosove.

* * *

Pour faire connaissance du contenu du livre, le lecteur est aussi aidé préliminairement par la préface de l'auteur. On y apprend qu'on a généralement à faire à des études écrites à des temps différents entre l'année 1958 et l'année 1979. Elles ont été publiées dans les revues et organes divers à l'intérieur naissance aussi avec les visées de l'auteur dans cette publication. De la position de l'homme de science patriote, il vise, à remplir le vide existant dans le domaine des études éthnographiques en Kosovë. Et même, à la fin la préface revêt un son actuel: «La culture populaire, a été une défense puissante au cours de l'histoire, contre l'assimilation, la dénationalisation et l'anéantissement complet de la nation albanaise de la face du globe. — C'est pourquoi, il est de notre devoir et des générations futures de la recueillir et de l'étudier avec passion».

De part sa nature le livre a le caractère d'un recueil d'études éthnographiques, d'une thématique vaste et variée relevant de ce domaine. Il inclut en tout 24 articles et études. Tous les écrits sont accompagnés à la fin d'un résumé en français. Une partie de ces études, par leur caractère et nature même, l'auteur les a accompagnées de photographies, d'esquisses, de planimétries, de cartes et de graphiques divers. Assez de données de statistiques apportées dans quelque écrit, sont également résumées en forme de tableaux. Tout ce qu'on vient de dire, si l'on ajoute aussi le langage clair et naturel de l'auteur, rendent le livre communicatif non seulement pour les spécialistes, mais aussi pour les larges masses de lecteurs.

Lorsqu'on considère le volume dans sa totalité, on se rend compte que l'ordre cronologique des articles n'est pas respecté. Dans cette question l'auteur est parti du contenu et du caractère de l'étude, indépendamment de l'époque où elle a été écrite. Cet ordre des choses fait profiter plus les spécialistes, qui trouvent les uns à côté des autres les articles et études à thématique indetique ou similaire. Ceci, d'un part, aide à compléter les connaissances sur des thèmes déterminés et, d'autre part, accroît de façon graduelle les connaissances sur divers aspects de la culture populaire de cette contrée. Pour l'homme d'étude de l'architecture populaire sont d'une importance particulière les articles: «Les «kulla» (maisons fortifiées) de Dukagjin» *(p. 326-365)*, «La maison albanaise de Kosovë *(p. 365-434)* «La fonction de la chambre des hôtes en Kosovë à l'époque de la Ligue de Prizren» *(p. 434-443)* et «La gravure artistique sur bois dans les villages de Kosovë *(p. 443-465)*. *Tous ces articles dépassent les 140 pages. Si l'on tient compte du fait que le livre a en tout 465 pages, on comprend facilement alors que les études ci-dessus, en comptant un tiers du volume, sont d'un poids important. Ceci ne tient pas seulement sur le côte simplement quantitatif, mais, en premier lieu, sur le matériel interessant qu'elles offrent.*

Sont également d'importance multilatérale pour les hommes d'études de l'architecture populaire albanaises les articles: «Les régions éthnographiques de Kosovë» *(p. 12-26)*, «Les structures démographiques en Kosovë» *(p. 26-51)*, «La grande famille patriarcale albanaise en Kosovë» *(p. 197-239)*, «Organisation de la vie sociale dans une grande famille à l'arrondissement de Pejë» *(p. 239-250)* et «La structure sociale de la grande famille Shehu dans le Has de Prizren» *(p. 250-260). Les articles qu'on vient de citer comptent en tout 90 pages, donc presque un cinquième du volume. Pris ensemble, les deux groupes d'articles, mentionnés*

plus haut, occupent environ la moitié du volume. Ces indices nous persuadent sans doute que l'oeuvre en question est d'intérêt même pour l'homme d'étude de l'architecture populaire albanaise. Non seulement elle nous présente un vaste panorama informatif sur ce problème en Kosovo, mais aussi elle élargit et approfondit nos connaissances sur l'habitation populaire albanaise. Le particulier dans la valeur et la signification de ces études demeure dans le fait qu'elles ont été traitées avec l'oeil d'un homme d'étude expérimenté, qui a reflété les phénomènes avec le langage et les moyens d'une discipline scientifique appropriée.

Parmi les autres écrits inclus dans cette oeuvre et qui de part leurs titres, occupent plus de la moitié de volume sont d'intérêt ceux dédiés au rôle de la «bessa» (la parole d'honneur) albanaise (p. 175-197 et ailleurs). Une place évidente est prise par les articles critiques sur quelques étrangers qui ont écrit sur les albanais ou sur leurs terres. Il s'agit là concrètement de Marc Milan («Les albanais dans les oeuvres de Marc Milan», p. 275--286), Vuk Karadzic («L'éthnographe serbe Vuk Karadzic sur les albanais» p. 286-291), Hilferding («Les albanais dans l'oeuvre d'un diplomate russe», p. 291-312) et Evlia Çelebi («Les albanais dans les chroniques de voyage d'Evlia Çelebi», p. 312-318). Dans le groupe de ces écrits rentre aussi l'article «Les yeux de Simonide» (p. 155-168), qui dans le fond est consacré aux attitudes du poète serbe Milan Rakiq envers les albanais.

Pris dans leur totalité ces articles critiques ont des valeurs multilatérales. Ils reflètent ce genre de littérature scientifique à l'égard de laquelle les hommes d'étude albanais sont toujours redevants, si l'on tient compte de la boue qu'on a jetée sur le peuple albanais et sa culture.

Parmi les études d'apréciation et critiques, le lecteur est frappé de façon particulère par l'article «Les yeux de Simonide». Les jugements de l'auteur sont particulièrement profonds et touchants dans cet article. On y sent la perspicacité du critique petri de sentiments patrotiques. C'est avec des arguments sans réplique et persuasifs qu'il rejette les attitudes non basées de mégalomane serbe Milan Rakiq, qui écrit sous le couvert de poète. Simple et clair l'article conserve une grande force actuelle. Les derniers événements en Kosovë ont témoigné clairement du fait que les Rakiq et les Hilfeding, maintenant dénudés de quelque couvert obscur qu'ils s'employèrent à garder temporairement et formellement, non seulement sont vivants, mais en pleine activité contre le peuple albanais et sa culture. Non seulement dans ces articles, mais dans tout le livre, l'auteur c'est montré pondéré et objectif dans la formulation de ces jugements et apprétiations. Il a su bien peser et differencier les mots et les actes qui demeurent derrière eux. Dans ce contexte, le portrait de Mark Milan est typique. Dans ses écrits, cet auteur porte à l'adresse des albanais des appréciations sensiblement positives, tandis que lorsqu'il s'agit d'actions et attitudes pratiques et concrètes, à l'égard des droits des albanais refoulés aux pieds, Mark Milan s'est conciemment rangé du côté de leurs ennemis. Ainsi les sentiments du chauvinisme panslaviste n'ont pas manqué à Mark Milan.

Cependant, il n'est pas difficile au lecteur de constater q l'auteur ne mélange pas les adeptes de la bourgeouasie még lomane serbe ou de quiconque d'autre, avec le peuple serb et les autres peuples voisins. Il n'est pas rare, qu'au cours d l'histoire, le sort de ces peuples ait été lié au sort du peup albanais.

* * *

De façon sommaire, certains des valeurs et traits de l'oeuv de Mark Krasniqi sont:

1. Les thèmes traités sont d'une vaste étendue. Ils so variés et appartiennent à divers domaines de l'histoire de l culture populaire albanaise. Toutefois le livre, pris dans so intégralité, ne manque pas d'un axe et en même temps d'u objectif à atteindre: Il est impréigné de sentiments d'amour pou le Kosovo, ses hommes, l'histoire et la culture nationale de ce hommes et de ces terres. L'objectif visé par l'auteur consist d'une part, à démontrer aux étrangers que ce peuple est plei de vitalité, et c'est pourquoi il a une telle histoire et une tell culture. D'autre part l'auteur vise, au moyen de ce livre, inciter le plus possible les nouvelles générations de Kosovë travailler assiduement pour la connaissance et l'éléboration plu poussée des valeurs positives de cette culture.

2. En lisant ce livre on est persuadé que l'auteur est déscend sur le terrain, n'étant pas un observateur passif. C'est précisé ment l'information exacte apportée du terrain, qui, dans assez d cas arrive jusqu'à nos jours, qui constitue un indice important d l'originalité des études que nous offre cet auteur.

3. Des études organisées et systématiques sur la Kosova particulièrement dans le domaine de l'éthnographie, ont fait dé faut. Les valeurs de l'oeuvre sont encore plus grandes, si l'o tient compte de ce manque. Les articles, avec leurs thèmes, com plètent l'un l'autre et ensemble aident à avoir une conceptio plus large de connaissance sur la culture populaire de cett contrée.

4. L'auteur évite les traitements artificiels, Il ne fait jamai usage de phrases obscures. Donc, le langage simple et la clarté sont des traits distinctifs de ce volume. Avec cette simplicité e cette clarté d'écriture, l'auteur se présente et optimiste et tenden cieux. Le visée de l'auteur est: «L'amour à l'égard du peuple ne peut être sincère, si l'on ne peut apprécier et aimer sa culture» (p. 8-9).

Les particularités nationales ou le caractère national des phénomènes, qu'il examine, l'auteur ne pourrait les mettre en évidence, s'il les voyait et les traitait détachés ou bien en dehors de l'Histoire de Kosovo, en particulier et de sa nation en général. Dans cette histoire les notes optimistes n'ont jamais fait défaut. On est particulièrement frappés par l'intérêt et le sentiment de fierté que l'auteur porte au mouvement national albanais. Venant et revenant souvent sur ses idées et ses gestes, ceux-ci revêtent une grande force éducative, dans les conditions actuelles.

5. Nous avons souligné que l'auteur est aussi tendencieux.

NO COPY

Loin des préjugés, il essaie d'analyser et d'interpréter les phénomènes selon le degré de connaissance qu'il en a grâce au matériel persuasif qu'il dispose. Mais jamais il ne déplacera l'attention de l'important au marginal. L'auteur n'est pas tendencieux uniquement parce qu'il cherche à identifier ce qui est national, mais avant tout, par l'esprit populaire avec lequel il effectue les analyses et interprétations. Avec conviction et sans hésitation il affirmera que notre culture populaire n'a pas été une culture négligée. Elle a été et continue d'être capable de transmettre des valeurs et en même temps de profiter des valeurs positives que les autres peuples ont créées.

6. L'auteur analyse et généralise de positions avancées de la science éthnographique contemporaine. Ainsi, de pair avec l'utilisation des moyens et voies traditionnels de l'éthnographie, plus d'une fois, il a bénéficié de l'aide des autres sciences. Ceci a poussé plus loin ses arguments et analyses, en les rendant plus persuasifs.

7. L'oeuvre, par le vaste matériel de fait qu'elle contient, sert aussi de source documentaire, lorsqu'il s'agit d'études comparatives panalbanaises.

* * *

A part les articles traitant directement de l'architecture populaire en Kosovo, l'auteur même dans quelque autre article de ce volume, touche, tant peu soit il, des aspect de cette architecture. Telles sont les pages 15, 18-19, 20, 79, 131, etc.

Dans les articles, principaux consacrés à l'habitation Mark Krasniqi prend à charge d'examiner, dans l'aspect éthnographique, l'habitation paysanne en Kosovë.

En lisant l'article «La maison albanaise de Kosovë» (p. 365--434), on est persuadé d'avoir en face un homme d'étude expérimenté. L'auteur, après avoir effectué des recherches sur le terrain et fouillé dans la littérature, donc après avoir bien connu le problème, sent qu'au thème qu'il a pris à charge manquent les analyses détaillées et préliminaires nécessaires à un travail de synthèse. Malgré l'aide louable qu'il apporte, avec modestie et jugement objectif, il souligne qu'il s'engage à éclairer le problème à tel degré, qu'on remarque au moins ses contours principaux (p. 366-367).

Au début, il nous présente le rôle des facteurs naturels et économico-sociaux dans le développement et l'évolution de l'architecture populaire. La brève vue phisico-géographique sur le Kosovë et l'information qu'il apporte sur le climat ou bien l'hydrographie et leur caractère dans cette zone, font également partie de cette introduction. Assez de données noumériques, basées sur des documents officiels, complètent le cadre du tableau préliminaire de connaissance avec cette contrée, avec les centres habités et leurs habitants. En s'appuyant principalement sur des données officielles de l'année 1971, l'auteur nous fait savoir qu'en Kosovo il y a 1438 centres habités, dont 7 villes. D'intérêt sont aussi les données sur l'accroissement moyen annuel de la population en Kosovo, qui sont des plus hautes de l'Europe.

La place principale dans l'article revient aux constructions populaires et dans une certaine mesure au caractère des centres habités, toujours considéré en liaison avec le premier phénomène. A part l'analyse de constructions particulières, qu'elles soient destinées à être habitées ou bien auxiliaires économiques, d'intérêt est aussi l'examen de la cour de l'habitation et de sa structure.

Nous avons déjà souligné qua l'auteur a senti le manque d'analyses antérieures détaillées qui aident directement à la catégorisation précise des types d'habitation. Cependant, la voie qu'il s'est choisie pour la bonne réalisation de cette tâche, a sa propre signification. A la base de l'examen du matériel, l'auteur a mis le critère géographique de la dispersion des centres habités. Il s'agit là de la dispersion verticale et spaciale des villages de Kosovë. Sur la base de cette dispersion, il examine les constructions populaires sur deux plans géographiques essentiels; D'abord il examine les centres habités de montagne, s'étendant au moins à 1000 m au dessus du niveau de la mer. En même temps que leur caractère, il examine également les constructions populaires. Plus loin il examine ces même phénomènes dans les centres habités situés dans les contrées de plaine.

L'article construit sur cet axe aide à l'obtention d'un vaste tableau informatif sur l'architecture populaire et le caractère des centres habités en Kosovë.

En vue d'un examen plus analytique du materiel, l'auteur à l'intérieur même des contrées des montagnes distingue deux subdivisions: la première subdivision ou celle supérieure et la seconde subdivision ou celle inférieure.

Le trait distinctif de la subdivision supérieure est le fait que là se trouvent les centres habités temporaires saisonniers. Les constructions les plus caractéristiques de ces centres habités sont les cabanes ou les parcs de bergers. Ce sont des constructions de rez-de-chaussée faite principalement en bois. Même au lieu des clous on se sert de piquets de bois. De telles constructions servent aux bergers d'abris à passer la nuit ou les jours de pluie.

En 1980, pendant un court passage à Rugovë, on s'est aperçu qu'encore de nos jours une telle construction était en usage dans les parcs à bétail.

Une telle conception constructionnelle a servi même d'habitation à la famille. Dans ces cas elle se voit ajouter quelque autre annexe, la cave à laitage[5]) ou «çaranik». Indépendamment du matériel de construction utilisé, les études sur notre architecture populaire ont démontré que l'habitation à simple rez-de-chaussée d'une pièce a été en usage dans assez de zones de notre pays. Comme l'auteur l'avoue aussi, elle est propagée même dans d'autres contrées montagneuses des Balkans.

Le trait distinctif de la seconde subdivision ou de celle inférieure de la région montagneuse ce sont les centres habités permanents. Ils sont relativement petits et ont un caractère dispersé. Différement aux parcs de bergers, où l'habitation a

DO NOT COPY

DO NOT COPY

seulement une pièce, qui remplit quelques fonctions, ici l'habitation possède quelques pièces, et même principalement a deux étages. Les pièces d'une telle habitation, de caractère permanent, remplissent des fonctions déterminées. Telles sont «la chambre des hôtes», «la maison du feu» et les «chambres à coucher» des couples conjugaux. Tandis que le rez-de-chaussée de l'habitation à deux étages d'habitude servait d'abris au bétail.

Dans la variété d'habitations à deux étages, l'auteur souligne de façon particulière l'habitation que le peuple dénomme «tchardak». D'habitude elle etait construite en partie avec des murs de pierre (le rez-de-chaussée) et en partie en bois (l'étage supérieur). En tant que conception constructionnelle au moins elle est en usage encore de nos jours. En 1977, on a vu des constructions semblables dans les alentours de Rozhajë, de Plavë et de Guci, où habitent pas mal d'albanais. De même on s'est apperçu de telles constructions en grand nombre dans le village de Bogë à Rugovë, en 1980. Elles n'ont pas manqué même dans d'autres zones du nord-est du pays, comme il a été mis en évidence dans les articles publiés sur ces régions. M. Krasniqi démontre aussi que des trâces de l'utilisation de cette habitation ont été relevées même dans les centres habités des contrées de plaine et de colline de Kosovë. P. Thomo a découvert de tels vestiges, comme des constructions anciennes, dans des villages s'étendant entre Pejë et Gjakovë, au sours d'une expédition effectuée en 1978.

Dans les régions montagneuses, l'élevage a été une branche importante de l'économie, c'est pourquoi il a exercé son influence non seulement sur l'habitation, mais aussi sur le caractère, le rôle et la place des constructions économiques. Même ces constructions, l'auteur les analyse minutieusement. Il met en évidence qu'il est vrai que les produits agricoles dans ces zones sont moindres, mais les produits d'élevage également, bien qu'en quantité un peu plus grande, n'occupent pas beaucoup de place dans l'habitation ou bien dans ces annexes.

Dans les constructions économiques des régions montagneuses, l'auteur inclut «pojata»,[1]), «pozllomi»,[2]) «torishta»,[3]) «hambar dërrasash»,[4]» kosheri prej thuprash,[5]) et diverses meules. Plusieurs de ces objets situés autour ou a proximité de l'habitation, et ensamble avec elle, entourés de murs ou de haies, donnent aux constructuons de famille un caractère de groupement.

Une conclusion d'importance de l'auteur est que toute ces constructions, en commençant par la surface générale de la cour, ont de petites dimensions, remplissent des fonctions limitées, elles ne possèdent pas grand nombre de pièces et représentent des réalisations tout de même pas tellement réussies, en comparaison avec les constructions analogues des centres habités de plaine.

Une constatation d'intérêt est aussi le phénomène que les grandes familles des zones montagneuses sont actuellement rares par rapport à ce phénomène dans les zones de plaine.

Tous les problèmes ci-dessus que l'auteur a traité sur les régions montagneuses, naturellement il les reprend plus loin avec plus de détails et de façon plus large, pour les régions de plaine. Là il traite des centres habités, qui s'étendent des pieds des «Bjeshkët e Nëmuna» jusque dans le voisinage de Vranje et de Bujanovc dans l'Est. L'auteur nous informe que la construction géologique, le climat et la vie économique de ce vaste plateau ont leur spécialités. Là les centres habités sont denses Les habitations de chaque centre habité sont réunies quelque part sur les limites de la plaine, laissant ainsi plus de champs disponibles à l'agriculture. Les habitations sont groupées en quartiers selon la parenté, la propriété ou bien la fraternité,

L'auteur nous présente de façon graduelle les constructions utilisées comme logement, depuis les formes les plus primitives jusqu'à celles les plus évoluées. Les formes les plus primitives d'habitation ont été la chaumière construite en bois et enduite d'argile boueuse et la maison à simple rez-de-chaussées, construite de pisé, de briques, de pierres ou de leurs combinaisons Alors que la chaumière est restée dans ses formes simples avec une, ou au plus, deux pièces, la maison à simple rez-de-chaussée dans assez de cas a servi d'unité de base. Par la suite, de nouvelles pièces adjacentes se sont ajoutées à elle situées l'une après l'autre en série et couvertes par le même toit. La structure planimétrique née de cet emplacement ne se soumet pas à la spontanéité, mais se fait selon un critère généralement déterminé Typique dans ce sens est l'esquisse que l'auteur apporté sur la page 386 du livre. Le matériel est fourni par la zone urbaine de Prishtinë. On s'y apperçoit que sur un bout est située la pièce des hôtes, sur l'autre «la maison du feu», tandis que, entre elles se trouvent les chambres à coucher des couples conjugaux. Une telle habitation a sur le front avant un vestibule de petites dimensions. Une telle construction, dans le passé a été l'habitation typique métayers et a été plus largement répandue sur le Plateau de Kosovë que sur le Rrafshi i Dukagjinit. Sans nier la large propagation aux Balkans, l'auteur souligne que cette habitation en Kosovë a ses propres traits spécifiques où tout d'abord frappe la grande cheminée caractéristique.

---

1. *Pojata* – est utilisé pour abriter le bétail.
2. *Pozllomi* – comporte des divisions intérieures et s'utilise pour le bétail et d'autres besoins de la famille.
3. *Torishta* – une enceinte de haies qui se construit de pair avec pojata, ou «pozllom».
4. *Hambar dërrasash* – où l'on conserve de différents produits agricoles.
5. Koshi est utilisé pour garder le maïs.

1) une sorte d'armoire en bois qui sert à garder frais les aliments.

DONIKOLI

Un autre example important est celui apporté sur le schéma planimetrique numéro deux de la page 390, qui a été emprunté à Gollaku i Kosovës. Différement à l'example qu'on a examiné plus haut, on y remarque des groupements de constructions à l'intérieur de la cour. La chambre des hôtes est une construction particulière.

Une solution d'intérêt est aussi celle donné de façon graphique sur la page 408 où l'on trouve la conjonction de la «kulla» avec la «maison longue». Cette structure planimétrique et volumétrique a eu des solutions assez intéressantes en Kosove, surtout dans les grandes familles, qui sont encore caractéristiques dans pas mal de villages du Rrafshi i Dukagjinit. Dans l'example graphique apporté sur la page 411, on remarque qu'à l'intérieur de la cour d'une grande famille sont inclues onzes constructions destinées au logement et des constructions auxilières économiques. Cet example illustre assez bien le caractère même de la cour de l'habitation d'une grande famille paysane dans le Rrafshi i Dukagjinit.

A part les constructions ci-dessus, qu'on vient de mentionner brièvement, dans le Rrafshi i Dukagjinit a eu une grande propagation la maison fortifiée, que le peuple dénomme «kulla». A cette habitation l'auteur consacre un article particulier, comme on l'a déjà dit. Donc, de toute la richesse que le Kosovë possède dans le domaine de l'architecture populaire, l'auteur s'arrête plus longuement à la «kulla». Il souligne avec raison que, lorsqu'on parle de l'architecture populaire albanaise de Kosovë, immédiatement on pense à ce type de maison qui est le plus caractéristique et le plus beau dans cette contrée. De tout le matériel et des arguments persuasifs que l'auteur apporte, le lecteur comprend que l'évolution et les réalisations de cette habitation sont la conséquence de l'action des facteurs intérieurs et pas du tout de la copie ou de l'imitation mécanique de modèles étrangers. Il lance l'idée que l'habitation ancienne connue sous le nom de «tchardak» doit être un maillon important dans le passage vers l'habitation fortifiée ou la «kulla». Les études récentes, effectuées par nos hommes d'étude, au moyen d'une présentation relativement plus analytique du matériel ont éclairé l'idée susmentionnée.

Nous voudrions souligner, également que l'auteur, non seulement dans cette étude, mais aussi dans d'autres cas, prête une attention particulière à la place de la tour dans l'éthnopsychologie du peuple. Dans son folklore, le peuple a rendu éternel ce phénomène.

En s'arrêtant sur l'analyse de pièce habitées, l'auteur accorde une place importante à la «chambre des hôtes» en tant que pièce aux traits distinctifs albanaise. A cette pièce il consacre un article particulier, qui met en évidence son rôle sur le plan social à l'époque de la Ligue Albanaise de Prizren.

Il n'est pas dû au hasard que dans la tradition de notre peuple, cette pièce occupe une place à l'individualité nette. Du point de vue architectonique, elle est la pièce la plus élaborée et la plus commode par rapports aux autres pièces. Dans les solutions planimétriques et volumétriques, elle occupe toujours l'étage supérieur. Sur le plan éthnographique, elle est la pièce où l'on fait usage des équipements, meubles, literies, et de toute autre chose des meilleurs et des plus beaux que la famille possède. Cette pièce matérialise la tradition de l'hospitalité et de la générosité du coeur albanais.

Dans les études d'architecture populaire de Kosovë, une place à part revient aux problèmes de la technique de construction, des matériaux de construction utilisés et des maîtres constructeurs. On y apprend que, à part les maîtres albanais de Dibra, dans pas mal d'endroits éthnographiques de Kosovë il y a des maîtres indigènes de talent. De façon particulière brillent ceux, qui s'occupent du traitement artistique des objets on bois qui poursuivent avec amour cette tradition même de nos jours.

* * *

C'est dans le temps que l'habitation populaire albanaise a obtenu ces réalisations. Comme tant d'autres phénomènes de l'histoire de la vie de notre peuple, elle a attiré dans le passé l'attention de divers hommes d'études. L'habitation populaire de Kosovë n'est pas exclue de cette réalité. Sur l'architecture populaire de Kosova ont écrit aussi quelques chercheurs Jougoslaves. Même dans les cas où généralement l'objectivité n'a pas fait défaut, à propos d'elle ou bien on s'est tu, ou bien, au plus, on la traitée de façon marginale, jamais intégralement et pleinement. C'est pourquoi l'iniciative prise par Mark Krasniqi et la publication de l'oeuvre ont une valeur spéciale. Par la largeur avec laquelle elle traite du problème et par le matériel du fait qu'elle apporte, cette oeuvre constitue une aide précieuse dans l'étude de l'architecture populaire albanaise. La vue de l'auteur sur le problème ci-dessus est vaste. On y trouve caractérisé le village de Kosovë, non seulement au siècle passé ou bien au début du XXe siècle, mais jusqu'a non jours. Une des constatations les plus importantes et les plus significatives de l'auteur, est celle que les constructions dans les régions montagneuses sont semblables à celles des régions de plaine. Comme on l'a déjà dit elle diffèrent quant'aux dimensions et quant au degré d'élaboration et des soins prêtés. Au divers degrés de réalisations, a eu son mot à dire aussi le caractère de l'économie et la structure des couches sociales de la paysannerie, qui a toujours été présent. Donc en résumé, en se servant des paroles de l'auteur, on peut dire que Kosova même dans le domaine de l'architecture populaire est une «terre riche» une «plaine fertile».

La variété des constructions populaires qu'on rencontre en Kosovë, leur graduation depuis les formes simples primitives jusqu'aux formes réussies démontrent que: Premièrement, la société rurale de cette contrée malgré la longue pression multilatérale des envahisseurs étrangers, a connu le développement même dans ce domaine. Deuxièmement, cette société n'a été ni nomade ni primitive, mais une société sedentaire avec une structure sociale de classe cristalisée de façon nette. Les centres habités implantés, le caractère complexe de l'économie, où la place principale est prise par l'agriculture et l'élevage, témoignent de cela. Troisièmement, dans les réalisations essentielles de

l'architecture populaire de cette contrée on s'aperçoit de l'action certaine et direct des lois intérieures de son developpement dans les conditions, les possibilités et les circonstances dictées par l'époque. C'est pourquoi son évolution paraît naturelle dans le passage des formes simples à celles les plus dévlopées. N'oublions pas qu'elles est la réalisation du maître albanais de Dibra, ou bien des maîtres sortis des villages mêmes de Kosova. Quatrièmement, *le traitement de l'habitation populaire de Kosovë en général, et de la tour de Dukagjin, en particuier, donne une reflet vivant et actif du monde psychologique de l'albanais, qui vit dans ces terres ancestrales. Il est vrai que la «kulla» est tout d'abord une habitation. Dans sa réalisation, a eu son rôle à jouer même le monde psychologique de l'albanais de Kosove, qui a subi continuellement l'envahisseur. Le moment le plus essentiel qui ressort de ce monde, n'est pas la lutte pour une vie ordinaire, mais pour une existence pleine de dignité et de fierté nationale. Naturellement l'auteur exprime clairement que ce facteur n'est ni le seul, ni le primordial, mais il souligne qu'il a, lui aussi, joué son propre rôle indubitable. Il n'est pas par hasard que l'auteur met en relief que dans les pays des Balkans, l'usage massif de la «kulla» au traits individuels propres, se voit uniquement sur les terres albanaises. Dans d'autres pays des Balkans, en tant que catégorie constructionnelle, elle a été seulement l'habitation du féodal.* Cinquièmement, *dans toutes les conceptions essentielles matérialisées dans cette architecture nous remarquons la similarité et même l'identité integrale avec l'architecture populaire de beaucoup d'autres zones à l'intérieur des frontières actuelles politiques d'Albanie. Ceci constitue le témoignage incontestable qu'on a à faire à un peuple et à ses processus culturels, qui ont une continuité ininterrompue.*

DO NOT COPY

Aleksandër MEKSI

DO NOT COPY

MONUMENTET NË NJË VEPËR HISTORIKE

Alain Ducellier «La façade maritime de l'Albanie au moyen âge, Durazzo et Valona du XIe au XVe siecle»
Institut for Balkan Studies, Thesaloniki, 1981, XLI, 682, XIV tab,

Libri Prof. A. Dyseliesë përbën një kontribut të ri në studimin e historisë mesjetare të Shqipërisë, duke trajtuar apekte të shumta të saj. Autori veç hyrjes (XI-XIV) i paraprin tre pjesët përbërëse të saj me një paraqitje të burimeve të shfrytëzuara në hartimin e monografisë (XV-XLI), një pjesë e të cilave të pabotuara deri më sot si dhe me literaturën e përdorur duke dhënë shpjegimet e nevojshme në çdo rast. Pjesa e parë (1-118) titullohet «Shqipëria provincë bizantine, lidhjet perandorake dhe faktorët shpërbërës». Në të trajtohet periudha historike deri në rënien e Kostandinopojës në duart e latinëve, duke shqyrtuar aspektet e ndryshme të pushtetit bizantin dhe të zhvillimit të vendit, e në mënyrë të veçantë jepet një paraqitje e vendbanimeve, rrugëve e monumenteve më të rëndësishëm mesjetarë. Pjesa e dytë (119-320), «Zgjidhja perëndimore. Venediku, Epiri dhe mbretëria e Napolit», trajton periudhën që pason ndarjen në mes fuqive perëndimore bizantine, luftrat për sundim në mes tyre dhe Despotatit të Epirit si dhe vendosjen e sundimit anzhuin në Shqipëri. Në këtë pjesë një vëmendje e veçantë i kushtohet gjendjes ekonomike të vendit, marrëdhënieve ekonomike të vendit me perëndimin, strukturës administrative dhe qëndrimit të shqiptarëve ndaj pushtuesve të huaj. Pjesa e tretë (321-644); «Pavarësia e humbur e shek. XIV, Rënia e principatave shqiptare», që është dhe më voluminozja në krahasim me dy të parat trajton rrugën drejt pavarësisë, krijimin e principatave shqiptare, jetën ekonomike të bregdetit shqiptar, strukturën shoqërore të vendit. Një vend të veçantë edhe në këtë pjesë i kushtohet marrëdhënieve tregtare të perëndimit me Shqipërinë, nëpërmjet porteve dhe posedimeve të tyre në bregdet. Libri mbyllet me përfundimet (645-654) dhe shoqërohet me indeksin e vendeve (655-663) të emrave (664-673) dhe të çështjeve (674-682) mjaft të nevojshëm në konsultimin e një vepre të tillë. Në libër gjithashtu janë përfshirë një sërë hartash dhe ilustrimesh të monumenteve më të rëndësishëm (gjithsej 14 tabela).

Si një punim monografik që trajton ndodhitë historike të Shqipërisë Mesjetare, libri i prof. Alen Dyseliesë mbështetet dhe në të dhënat që ofrojnë monumentet, qofshin ato tashmë vetëm në dokumentacionin historik. Në këtë aspekt të dytë puna e autorit përbën një kontribut më vete në tërësinë e monografisë nëpërmjet shfrytëzimit mjaft të gjerë të dokumentacionit historik përkatës. Në këtë recension do të vështronim vetëm aspektin e parë të këtij problemi, pasqyrimin dhe marrjen në konsideratë të monumenteve mesjetare në shqyrtimin e ndodhive historike dhe interpretimin e tyre si dokumenta materiale.

Që nga koha e shkrimit të librit, në Shqipëri janë kryer mjaft kërkime e studime në fushën e monumenteve, të cilat mund të gjenin një vend më të mirë në këtë monografi dhe për këtë duhet të kihen parasysh gjatë studimit të saj. Ne do të përpiqemi, përsa do të jemi në gjendje, t'i plotësojmë

apo qartësojmë këto boshllëqe duke dhënë dhe literaturën përkatëse që lexuesi të thellohet më mirë në Historinë e Shqipërisë, për të krijuar një lidhje më të mirë të ngjarjeve historike me vendet dhe monumentet mesjetare, për aq sa ato thirren në hartimin e saj si dëshmi materiale. Këto dëshmi janë për ne me vlera të dorës së parë, dhe sjellin përgjithësisht përfundime të pakontestueshme.

Qytetet mesjetare shqiptare vijojnë në më të shumtën e rasteve qytetet e periudhës antike edhe pse në disa raste ndërrojnë emrat.[1]) Ndër ta qyteti i Lezhës (Lisusi i antikitetit, Elisoni i mesjetës së hershme), siç vëren Dyselie (f. 11-12) lot një rol të madh në historinë mesjetare të Shqipërisë, falë pozitës së tij dhe rëndësisë së tij për mbrojtjen e Durrësit nga sulmet sllave që vinin nga veriu. Kërkimet e fundit kanë evidentuar muret mesjetare në kalanë e sipërme dhe në qytetin e poshtëm.[2]) Do të vërenim këtu se rindërtimi i kësaj kalaje në kohën turke i takon sulltan Sulejmanit dhe jo sulltan Selimit (1512-20).[3])

Përsa i përket ndërtimeve të kalasë së Krujës (f. 13-14) studiuesit e saj kanë dalluar në të mjaft faza ndërtimore të periudhës mesjetare,[4]) që e bënë të mundur praninë e një kalaje që gjatë mesjetës së hershme dhe mbase edhe në antikitetin e vonë, deri sa nuk mund të ishte një qendër peshkopale një qytet i pafortifikuar, i pasigurtë në kohët e turbullta. Si qendër e tillë Kruja njihet që në fund të shek. IX, kur peshkopi David merr pjesë në koncilin e vitit 879.[5])

Një qendër tjetër të cilën Dyselie (f. 15) e ve në radhën e fortifikimeve mesjetare është Preza, e përmendur me sa duket në vitet 1082-84[6]) Kalaja e Prezës është datuar ndërkohë nga studiuesit shqiptarë si e shek. XV,[7]) si e periudhës turke (fundi i shek. XV-fillimi i shek. XVI[8])) me mundësi të ndërtimit mbi mure të vjetra, mbështetur kjo në të dhënën e Barletit për një kala të rrënuar aty, çka është mjaft e rëndësishme por që përfundimisht fjalën do ta thonë kërkimet e mëtejshme arkeologjike. Lidhur me kalanë e Ndroqit, për mendimin tonë Dyselie pa të drejtë e quan një qendër të banuar me origjinë greke vetëm për emrin e vjetër Andronik-leri të cilin na e jep regjistrimi turk i viteve 1431-32. Studimi i saj ka treguar se në të kemi një ndërtim të parë në kohën e Justinianit, më tej në shek. XIII-XIV dhe së fundi një rindërtim të kohës turke (shek. XVIII).[9])

Siç vëren dhe autori (f. 16-17) një rol të rëndësishëm në ruajtjen e rrugës nëpër Krrabë që lindhte Dyrrahun me luginën e Shkumbinit paraqiste kështjella e Petrelës. Studimet për të kanë evidentuar një sërë fazash ndërtimore, ndër të cilat pjesa më e madhe i takojnë periudhës mesjetare, ndër to nuk lidhet ndonjëra me venecianët, siç mendon Dyselie.[10]) Faza më e vjetër, pjesa e brendshme e kullës perëndimore është ndërtuar në shekullin e VI dhe është një kullë vrojtimi. Më vonë, gjatë mesjetës së hershme (shek. VII-X) ndërtohet një mur që ndan pjesën me mbrojtje natyrale si dhe një ambient brenda saj. Këto sipas studiuesve përbëjnë dhe muret që rindërtohen në kohën e luftrave normando-bizantine. Janë Topiasit ata që në fund të shek. XIV ndërtojnë një kullë tjetër rrethore, riparojnë kullën e vjetër, i lidhin ato me një mur ku është hyrja e sotme, si dhe krijojnë disa ambiente në pjesën më të lartë të terrenit. Kësaj kohe i takon dhe muri rrethues i poshtëm që shton mundësitë mbrojtëse

1. Nuk na duket i drejtë qëndrimi i autorit (f. 9) lidhur me këtë problem duke i vështruar ato si vijim të qendrave helenistike e romake, ndërkohë kur shumica e tyre nuk kanë qënë asnjëherë koloni (deri më sot njihen si të tilla Dyrrahu dhe Apollonia) dhe kur banorët e tyre janë ilirët dhe kultura e ilirëve ka në to një fytyrë të vetën si gjatë periudhës helenistike ashtu edhe gjatë pushtimit romak.
2. Gj. Karaiskaj, **5000 vjet fortifikime në Shqipëri,** Tiranë, 1981, 135-138, fig. 12, 98.
3. Mbishkrim i këtij rindërtimi e daton këtë ndërhyrje në vitet 1521-22 nën mbikqyrjen e Mahmud Dervish Uzgurit (nga familja e Skurajve), **Mbishkrimet ndërtimore turko-osmane të Shqipërisë,** (Arkivi i Institutit të Historisë).
4. Për kalanë e Krujës shih S. Adhami, **Gjurmime rreth themelimit dhe rindërtimeve kryesore të kalasë së Krujës,** Monumentet 1971, 87-101; Gj. Frashëri, **Problemi i restaurimit të oborrit të fortifikuar të kalasë së Krujës,** Monumentet 12, 1976, 65-74; Gj. Karaiskaj, **vep. cit.,** 158-165.
5. **A. Alb.,** Dok. 57, novembri 879.
6. K. Luka, **Toponime shqiptare në kangën e Rolandit lidhur me disa ngjarje të viteve 1081-1085,** S.H. 2, 1967, 136-137.
7. Ll. Papajani, **Kalaja e Prezës,** Monumentet 7-8, 1974, 167-181.
8. Gj. Karaiskaj, **vep. cit.,** 214, shih dhe shën. 13.
9. Gj. Frashëri, **Kalaja e Ndroqit (koha e ndërtimit dhe funksionet e saj),** Monumentet 4, 1927, 185-190.
10. A. Baçe-Gj. Karaiskaj, **Kështjella e Petrelës,** Monumentet 5-6, 1973, 146; Gj. Karaiskaj, **Vep. cit.,** 129-133, fig. 95-96 ab.

POROTY

të kësaj kështjelle të mirëfilltë feudali shqiptar. Gjatë shek. XV këto dy kulla dhe muri që i lidh ato vishen me një mur në formë skarpate për t'i përforcuar ndaj goditjeve të artilerisë. Të tjera përforcime bëjnë dhe turqit mbasi shtien në dorë kështtjellën në shek. e XV.

Gjithashtu nuk na duket i drejtë mendimi i autorit se Babagora është në Qafën e Krrabës (f. 17). Ne jemi të një mendje me studiuesit e mëparshëm se Babagora duhet të jetë, në malet Kandave në afërsi të fshatit Babie.[11])

Identifikimi i qytetit mesjetar të Devollit përbën një çështje të rëndësishme për historinë mesjetare të Shqipërisë, përderisa me të lidhen mjaft ndodhi historike. Dyselie me të drejtë nuk bën të tijën vendosjen e qytetit Deabolis në Gostimë nga ana e Zllatarskit (f. 19) por, për mendimin tonë në mënyrë të gabuar e vendos në zonat e Gramshit, në afërsi të kodrës së Shën/e Premtes (f. 20), ku deri më sot nuk është gjetur ndonjë gjurmë e një qyteti kaq të rëndësishëm. Interpretimi i diplomave të Vasilit II si edhe i të dhënave të Kedrenit e Ana Komnenës e të tjera, të prura nga vetë Dyselie, tregon qartë që Deabolis ndodhet pranë Ohrit dhe Kosturit. Emri i tij i ka mbetur lumit, degës së Semanit dhe fushës apo më mirë një zone të tërë. Mendojmë se në të duhet të kërkohet edhe qyteti i vjetër i Devollit. Një qendër e tillë, pranë lumit, buzë maleve dhe në lidhje të afërt me Ohrin dhe Kosturin përbën kalaja e Zvezdës. Lik[12]) është ai që i pari e bëri këtë identifikim me të cilin jemi edhe ne. Emri Selasfor gjendet së pari i gjymtuar në absidën e kishës së Shën Akileut në Prespë (fundi i shek. X), në fronet peshkopalë.[13]) Më tej këtë e gjejmë në një sërë listash të kryepeshkopatës së Bullgarisë apo të Ohrit në të cilat, në të njëjtin vend herë jepet e Devollit e herë e Selasforit.[14]) Në shek. XIV peshkopata quhej e Selasforit dhe Korçës. Jo vetëm kjo, por në këtë zonë janë dhe dy Devollet, të kuptuara si fusha, Devolli i Madh në drejtim të Korçës dhe i Vogli në drejtim të Bilishtit e udhës për në Kostur.[15]) Në kala të Zvezdës gjatë punimeve u gjetën në sipërfaqe fragmente qeramike mesjetare, të tjerë akoma në një sipërfaqe më të madhe, në fushën në këmbët e Shkëmbit të Kalasë.[16])

Përsa i përket Beratit (Antipatrea, Pulheriopolis, Belgrad) janë bërë disa studime si dhe gërmime arkeologjike që provojnë vijueshmërinë nga antikiteti i vonë në mesjetë.[17]) Muret rrethuese të tij i takojnë periudhës ilire e mbi të ngrihen ndërtimet e periudhave të shumta mesjetare. Por, do të deshnim të ndaleshim në identifikimin e këtij qyteti me Belgradin e diplomës së Vasilit II (1019) (f. 20). Edhe pse botuesit e «Acta Albanica» e venë në dyshim këtë çështje, në to mbështeten të gjithë ata që e pranojnë këtë. Studiues të tjerë përpara e kanë treguar se kemi të bëjmë me Belgradin e Serbisë dhe një gjë e tillë del dhe nga renditja e peshkopatave në diplomat e mësipërme. Në të mirë të kësaj është edhe përmendja e Belgradit dhe me emrin e tij të vjetër Sigjindum në listën e kryepeshkopatës së Ohrit.[19]) Veç kësaj, kur roli i Gllavenicës bie ajo kthehet në një peshkopatë të Gllavenicës dhe Pulheriopolisit,[20]) që nuk do të kishte kuptim po të ishte ndërkohë vetë Berati qendër peshkopate.

I njëjti gabim bëhet duke identifikuar Gradecin në vartësi të Belgradit për Bylisin (f. 25). Për mendimin tonë Gradicion i Noticias së kohës Jan Cimiskes[21]) duhet të jetë ose Gradeci i Beratit ose ai i Skraparit, ndërkohë që Bylisi si qendër peshkopale është zëvendësuar me Gllavenicën.

Një qendër që del shpesh në dokumentacionin historik është dhe Gllavenica, e identifikuar me sukses me Ballshin që nga koha e gjetjes në të një shtylle me mbishkrimin për kthimin e bullgarëve në fenë e krishtere.[22]) Përfundimisht në të

11. L. Heuzey-H. Daumet, **Mission archeologique de Macedoine,** Paris 1876, 346.
12. W. M. Leake, **Travels in northern Greece,** London 1835, V. I, 339.
13. I. Ivanov, **Bëllgarski starini iz Makedonija,** Sofia 1931, 57. Po ai jep mbishkrimin e rindërtimit të vitit 1365 nga Grigori episkop i Devollit Selasforit (f. 39).
14. H. Gelzer, **Ungedrückte und wenig bekannte Bistumerverzeichnisse der orientalischen Kirche,** BZ, 1, 1892, 257.
15. Për këtë shih dhe të dhënat e Gjin Muzakës (1570) i cili në disa vende i përcaktoi qartë këto fusha. Ch. Hopf, **Chroniques Greco-Romanes immedites ou peu connues,** Berlin 1873, 280, 294.
16. Gj. Karaiskaj-P. Lera, **Fortifikimet e vona antike në rrethin e Korçës,** Monumentet 7-8, 1974, 91-92, të cilët gjithashtu janë për një identifikim të tillë të qytetit të Devollit.
17. A. Baçe, **Qyteti i fortifikuar i Beratit,** Monumentet 2, 1971.
18. **A. Alb.,** 15.
19. H. Gelzer, **Vep. cit.,** f. 257.
20. V. Zllatarski, **Izvestijat na bëllgarit V hronikata na Simeona Metafrasta i Llogoteta,** Sb. H.Y.K. XXIV, (1908), 76 shën. 1.
21. **A. Alb.** IV, 15.
22. C. Praschniker, **Muzakhia und Mallakastra,** JOAI, Wien, 1922, 194-197.

Boshtoby

mirë të këtij mendimi janë dhe të dhënat e gërmimeve arkeologjike, nga të cilat është zbuluar një bazilikë e shek. VI që mbetet në përdorim gjatë gjithë mesjetës dhe ka ndërtime të ndryshme në shek. XI-XII e më vonë.[23]) Jo pa vlerë është dhe përputhja e emrave të vendit: Ballsh – Kefalini – Gllavenicë.

Idea e Dyseliesë që kështjella e Mylit për të cilën bëhet një betejë ndërmjet trupave bizantine të komanduara nga Kantakuzeni dhe normandëve të Bohemundit në vitin 1108[24]) duhet të ndodhet më afër Vjosës së Devollit (f. 24) gjen konfirmim nga identifikimi i bërë nga N. Ceka në kështjellën e Cakranit ku gjenden gjurmë ndërtimesh mesjetare.[25])

Lidhur me kishën e manastirit të Apollonisë të datuar prej nesh përpara vitit 1250, si dhe trapezarinë e saj e fundit të shek. XIII, që paraqet një sanktuar në qytetin antik tashmë pa jetë të Apolonisë, ne nuk do të ndalemi këtu.[26])

Qendra më e madhe mesjetare e bregdetit shqiptar, Durrësi ruan dhe sot pjesë të rrethimeve të tij të dikurshme. Për to kemi tashmë studime që datojnë si muret e antikitetit të vonë në Durrës e Portë,[27]) ashtu dhe rindërtime të ndryshme të mesjetës[28]) duke përcaktuar konkretisht vendet ku janë kryer ato. Lidhur me kapelen e amfiteatrit (f. 33-34) datimi i mozaikëve të së cilës është trajtuar në një sërë artikujsh, mendimet lëkunden në një periudhë kohe që nga fundi i antikitetit të vonë deri në fillimin e shek. X. Mendimi ynë është se në panelin jugor të kishës nuk kemi paraqitje të perandorit Aleksandër (912-13),[29]) për të cilën kohët e fundit janë shprehur një sërë studiuesish[30]).

Gjatë viteve të fundit në fshatin Arapaj në shpinë të Plazhit të sotëm, në vendin ku Hezei një shekull e gjysëm më parë përcaktoi vendndodhjen e manastirit të Shën Mëhillit, nga gërmimi arkeologjik po del në dritë një bazilikë e madhe trenefshe e shek. VI, me planimetri trekonkëshe me rindërtime mesjetare. Me mjaft interes në të është një ambient në anën jugperëndimore shtruar me mozaik shumëngjyrësh me motive antropo-zoomorfe.[31])

Mendimin se në kalanë e Bashtovës (f. 35-36) në breg të lumit Shkumbin 4 km nga bregu i sotëm i detit, duhet të shohim qendrën mesjetare të Vregos (apo brego-Bregu në gjuhën shqipe), ne e shohim me vend. Por siç ka treguar studimi i saj, kalaja e Bashtovës rezulton të jetë ndërtuar gjatë mesjetës[32]) dhe jo në shekullin e VI. Ne jemi të mendimit se kështjella duhet të jetë ndërtuar kur përmendet njëkohësisht si një qendër tregtare dhe seli peshkopate «Vregensis» gjatë shek. XIV,[33]) dhe jo gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit të shek. XV, pas rindërtimit të kalasë së Elbasanit në vitin 1466 nga sulltan Mehmeti II.

Me interes është gjetja e mbetjeve të Pirgut (Turris, Pirgi, Turris de Dievali), 2 km larg bregut të detit, buzë shtratit të dikurshëm të Semanit të quajtur nga vendasit Dell-i.[34]) Në një bregore rëre që njihet me emrin e vjetër Pirg ruhen gjurmët e mureve të kullës me planimetri pesëkëndëshe me dy brinjë 17 m e të tjerat 14 m, të ndërtuara me gurë e copëra të rralla tullash ndërmjet tyre. Aty pranë janë rrënojat e një kishe dhe gjenden të shpërndara fragmente keramike mesjetare, dëshmi e një qendre të vogël të banuar, të formuar gjatë fundit të shek. XIV, fillimit të shek. XV kur në dokumentacionin mesjetar përmendet në fillim skela e më vonë kështjella.

Përsa i përket vendndodhjes së Spinaricës ne nuk jemi në gjendje të ofrojmë ndonjë të dhënë materiale. Do të donim vetëm të shënonim se hipotezat e Dyseliesë për ta kërkuar atë rreth fshatit të sotëm të Zvërnecit (f. 36-37) ku duhet të kërkohen gjurmë mesjetare, nuk janë pa vlerë. Të tilla gjurmë nuk kemi akoma dhe për kështjellën mesjetare të Vlorës që Dyselie mendon se duhet të ketë qënë buzë kodrës ku shtrihet dhe sot qyteti.

23. S. Anamali, **Bazilika e Ballshit,** Iliria VII-VIII, 1977-1978, 301-306.
24. **Burime tregimtare bizantine për Historinë e Shqipërisë shek. X-XV,** Tiranë, 1975, 122-123.
25. Informatë gojore, për të cilën e falenderojnë.
26. Shih për këtë reçensionin tonë në Monumentet, 1, 1982 (në shtyp).
27. K. Zheku, **Zbulime epigrafike në muret rrethuese të kalasë së Durrësit,** Monumentet 3, 1972, 35-46; Gj. Karaiskaj-A. Baçe, **Kalaja e Durrësit dhe fortifikimet përreth në antikitetin e vonë.** Monumentet, 9, 1975, 5-33.
28. Gj. Karaiskaj, **Kalaja e Durrësit në mesjetë,** Monumentet 13, 1976.
29. V. Toçi, **Amfiteatri i Durrësit,** Monumentet 2, 1971, 37-42.
30. N. Thierry, **Uné mosaique a Dyrrachium,** Cahiers Archeologiques, XVIII, 1968, 227-229; H. Nallbani, **Mozaiku i kishës së Amfiteatrit në Durrës,** Monumentet 7-8, 1974, 111-116.
31. S. Hidri, **Bazilika e Arapajt dhe mozaiku i saj.** «Drita» 27 Dhjetor 1981.
32. Gj. Karaiskaj, **Kështjella e Bashtovës,** Monumentet 5-6, 1973.
33. **A. Alb.,** II, 254, datë 19.4.1363; 258, datë 18.9.1397.
34. N. Ceka, **Pirgu i Myzeqesë,** në Monumente historike në vendin tonë, Tiranë 1978, 68-71.

Studimet për kalanë e rëndësishme të Kaninës kanë nxjerrë në dukje periudhën ilire, antike të vonë dhe faza të shumta mesjetare.[35]) Emrin e saj e hasim së pari në vitin 1019 por gjurmët materiale dhe gërmimet e bëra tregojnë qartë për një banim të pandërprerë të kësaj qendre të rëndësishme në gjirin e Vlorës që nga lashtësia deri në ditët tona.

Ndër skelat mesjetare që hasim në dokumentacionin historik është edhe Shufadaja, për të cilën Dyselie (f. 539-576) mendon se është në derdhje të Ishmit. Për këtë kohët e fundit është hedhur hipoteza se duhet ta kërkojmë pranë grykëderdhjes së lumit të Matit.[36])

Megjithëqë studimet mesjetare janë të mangëta për Jerikohë, të dhënat historike e përmendin atë si qendër të një treve që në fund të shek. X, në kohën e sundimit të perandorit Jan Cimiskes (969-976),[37]) për të ridalë në shekujt e mëvonshëm si në vulën e njohur që jep dhe Dyselie (f. 40) ashtu dhe në një sërë dokumentash të tjerë që dëshmojnë për rëndësinë e kësaj qendre.

Për qendrën antike e mesjetare të Butrintit, studimet e kohëve të fundit kanë prurë të dhëna me vlerë në drejtim të fortifikimeve mesjetare.[38]) Kështu që në mesjetën e hershme kemi ndërtimin e një sërë kullave e deri riparimin e mureve antike të dëmtuar ndërkohë.

Hetimi nga ana e Dyseljesë e kohës së sundimit të anzhuinëve në Shqipëri dhe i shtrirjes territoriale të tyre na ndihmuan për të shpjeguar rrethanat historike, zgjidhjen e veçantë të kishës së manastirit të Mesopotamit, në dyshemenë e së cilës janë vizatuar tre lule zambaku të stemës së anzhuinëve.

Mjaft nga ndodhitë historike të mesjetës për të cilat dokumentacioni është i pakët mund të bëhen më të qarta në se do të identifikohen mjaft vende që takohen në burime. I tillë është përshembull rasti i qendrës peshkopale të Stefaniakës, që përmendet duke filluar nga shek. IX të cilën studiues të ndryshëm e kanë vendosur në zonat e Matit pranë fshatit Shqefën.[39]) Deri më sot nuk është mundur të përcaktohet vendndodhja e selisë peshkopale të Kunavisë e njëkohëshme me të mësipërmen.

Po aq e vështirë është të përcaktohet vendndodhja e fortesës së Melies ndërtuar nga Topiasit në gjysmën e dytë të shek. XIV në afërsi të Durrësit. Portulanët na japin një vend të tillë në gjirin e Durrësit. Ne nuk gjejmë tjetër fortesë të vjetër aty veç kalasë së Turrës në kepin jugor të Gjirit të Durrësit nga e cila ruhet sot vetëm emri.[40])

Gjithashtu nga kërkimet në terren është arritur të përcaktohet edhe vendndodhja e Kishës së vjetër të Shën Kollit që përmendet në mjaft burime mesjetare.[41])

Përsa i përket kishave mesjetare për to janë botuar ndërkohë një sërë artikujsh të cilët evidentojnë vlerat e tyre arkitekturale si dhe kohën e ngritjes së tyre. Studimi i tyre, numri jo i vogël dhe larmia e tipareve kanë treguar se kemi të bëjmë me një trevë arkitekturale jo pa rëndësi dhe mbi të gjitha me një drejtim të vetin të dallueshëm brenda drejtimeve më të mëdha siç janë arkitektura bizantine për Shqipërinë Jugore dhe arkitektura romanikо-gotike për bregdetin dalmatin dhe Shqipërinë Veriore.

Këtu nuk duam të zgjatemi mbi karakteristikat e arkitekturës mesjetare të vendit tonë, por nuk mund të jemi të një mendjeje me autorin kur thotë se kemi të bëjmë me një arkitekturë të huazuar (brenda kuadrit më të gjerë të kulturës) (f. 651). Është e vërtetë që ndërtimet mesjetare të Shqipërisë së Mesme dhe të Jugut janë të inkuadruara në arkitekturën bizantine. Por, kjo duhet të kuptohet si një drejtim arkitekturor me shtrirje në tokat e perandorisë bizantine, në të cilën dallohen shkolla të ndryshme, që në pjesën më të madhe të rasteve përputhen me shtrirjen e kombësive të ndryshme të përfshira në këtë perandori universale, apo të shteteve mesjetare të formuara prej tyre në periudha të caktuara. Kufijtë veriorë të shtrirjes së ndërtimeve janë në përputhje me shtrirjen e sundimit bizantin pra dhe të peshkopatave ortodokse në vartësi të Durrësit dhe Ohrit. Ndërsa deri në shek: XI-XII ky kufi

35. A. Baçe, **Qyteti i fortifikuar i Kaninës,** Monumentet D. Komata, Sistemi fortifikues i kështjellës së Kaninës, Iliria IX-X.
36. K. Biçoku, **Rrugët nëpër vilajetin e Krujës të shek. XV dhe lokalizimi i Shufadasë,** Monumentet 1, 1982, 46-48.
37. N. Oikonomides, **Les listes de préséance byzantines des IX et X siècles,** Paris 1972, 399 cit. sipas V. Tapkova-Zaimova, **Les frontieres occidentales des territoires conquis pas Tzimisces,** Studia Balcanica, 10, Sofia 1973, 113.
38. Gj. Karaiskaj, **Fortifikimet mesjetare të Butrintit,** Monumentet 20, 1980, 5-31.
39. Th. Ippen, **Denkmäler verschiedener Alterstuffen in Albanien,** WMBH, X, 1907, 23; D. Kurti, **Një qytet i lashtë ilir në rrethin e Matit,** S. H. 1, 1967, 186; S. Anamali, **Stelushi, qytet i Skënderbeut në Mat,** S. H. 4, 1967, 107.
40. I këtij mendimi është edhe H. Myrto, **Harta e monumenteve dhe e gjurmëve antike të rrethit të Durrësit,** Monumentet 1, 1982, 18.
41. **Po aty,** 11-12.

Fotokopje

përfshin Lezhën, Pultin (Polatum) dhe Peshkopinë, në shek. XIII-XIV ky zbret më poshtë në zonat rreth Durrësit e Krujës në lëkundje të vazhdueshme.

Shqipëria e Veriut dhe në përgjithësi tokat nën juridiksionin kishtar të kryepeshkopatës katolike të Tivarit dhe më vonë dhe ato nën Durrësin katolik, përfshihen gjatë shekujve të mësipërm në shkollën arkitektonike të Bregdetit dalmatin dhe Shqipërisë së Veriut, me drejtim të sajin artistik, atë romanik e romaniko-gotik, në të cilën kontributi i mjeshtrave shqiptarë është i madh.

Të dy këto drejtime ecin në një rrugë të tyren në vartësi të traditave arkitekturale, nivelit ekonomik e shoqëror të vendit dhe rrethanave politike e kontakteve të shumëllojta me vendet fqinje. Për studiuesin është e lehtë të vërej një fizionomi të veçantë në tërësinë e ndërtimeve shqiptare të mesjetës gjithë duke patur në to të qarta ndikimet e huaja. Edhe brenda zonave të shtrirjes së këtyre dy drejtimeve është e mundur në një kohë të caktuar të dallohen ndërtimet tona nga ato të vendeve apo popujve të tjerë.

